REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 KORRIK 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARJA E KUVENDIT
LINDITA NIKOLLA
(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 03.07.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores).*

2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores).*

3. Raporti i veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2022 *(neni 19, pika 1, germa "ll" e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 134/2018 "Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik" dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).*

Paraqitja e raportit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zoti Ilirjan Celibashi - jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).*

Koha e votimit të projektrezolutës.

4. Raporti i veprimtarisë vjetore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2022 *(neni 10, pika 2 e ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit*

për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë" dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).

Paraqitja e raportit nga kryetarja e Autoritetit, zonja Gentiana Sula - jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).*

Koha e votimit të projektrezolutës.

5. Raporti i veprimtarisë vjetore të Institutit të Statistikave INSTAT-i për vitin 2022 *(neni 13, pika 2, shkronja "d" e ligjit nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).*

Paraqitja e raportit nga drejtoresha e Përgjithshme, zonja Elsa Dhuli - jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).*

Koha e votimit të projektrezolutës.

6. Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022 *(neni 39 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar"" dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).*

Paraqitja e raportit nga Inspektorja e Përgjithshme, zonja Evgjeni Bashari - jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).*

Koha e votimit të projektrezolutës.

7. Raporti i veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2022 *(neni 25, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neni 21, pika 1 e ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).*

Paraqitja e raportit nga kryetari i ERRE-s, zoti Petrit Ahmeti - jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).*

Koha e votimit të projektrezolutës.

8. Projektligji "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera" *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim).*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

9. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, lidhur me një hua koncesionale për programin "Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore pas tërmetit të vitit 2019" *(në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim).*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

10. Projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar" (*në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim).*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

11. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim).*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

12. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 113, datë 10.7.2023 "Për shkarkim ministri" *(në mbështetje të nenit 98, pika 1 e Kushtetutës, dhe nenit 58, pika 2 e Rregullores, votim i hapur me shumicë absolute).*

13. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 114, datë 10.7.2023 "Për emërim ministri" *në mbështetje të nenit 98, pika 1 e Kushtetutës, dhe nenit 58, pika 2 e Rregullores, votim i hapur me shumicë absolute).*

14. Projektvendimi "Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit", i ndryshuar *(në mbështetje të nenit 78, pika 1 e Kushtetutës, dhe neneve 21, pika 1 dhe 55, pika 1 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim).*

15. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.*)

Lindita Nikolla - Të nderuar deputetë, hapim seancën plenare!

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, ju bëj të njohur rendin e ditës për seancën e sotme plenare:

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Vijojmë me miratimin e procesverbalit të seancës plenare, të datës 3 qershor 2023. Procesverbalin e keni marrë në rrugë elektronike.

A ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te njoftimet.

Ju njoftoj se në Kuvend, gjatë kësaj jave, janë depozituar tri akte nga Këshilli i Ministrave dhe dy dekrete të Presidentit të Republikës. Titujt e çështjeve të depozituara i gjeni në sistemin këtu në sallë, ndërsa materialet në sistemin *e-parlament* dhe në faqen e Kuvendit në internet.

Ju njoftoj se nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është paraqitur një kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës, në bazë të nenit 31 të Rregullores së Kuvendit.

Ju informoj se nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është paraqitur kërkesa me numër protokolli 9431, datë 07.07.2023, e cila kërkon miratimin dhe dhënien e autorizimit për caktimin e masës arrest me burg ose heqjen e lirisë, në çfarëdolloj forme, apo kontroll personal ose kontroll të banesës së deputetit Arben Ahmetaj.

Kjo kërkesë, e theksoj, është depozituar në Kuvend në datën 10.07.2023. Në bazë të nenit 118, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, u zhvillua menjëherë, në datat 11 dhe 12.07.2023, mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të dëgjuar pretendimet dhe pyetje-përgjigjet e palëve.

Në zbatim të nenit 118, pika 3 e Rregullores së Kuvendit, do të hartohen raportet për në seancën plenare, të cilat rekomandojnë rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit për caktimin e masës arrest me burg ose heqjen e lirisë, apo kontroll personal ose kontroll të banesës së deputetit Arben Ahmetaj.

Raporti i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, sipas këtij neni të Rregullores, u shpërndahet deputetëve.

Ju sqaroj se në nenin 118, pika 4 e Rregullores, përcaktohet saktë se shqyrtimi i kërkesës vendoset si pikë e parë e rendit të ditës të seancës pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Në bazë të këtij neni, në seancën plenare i jepet fillimisht fjala deputetit për të cilin është paraqitur kërkesa. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do t'i paraqesë raportet e tij në Kuvend duke filluar pas ditës së premte dhe seanca plenare do të zhvillohet ditën e hënë, në datën 17.07.2023, ora 17:00, me qëllim që deputeti për të cilin është paraqitur kërkesa dhe deputetët e tjerë të Kuvendit të njihen me raportet, siç e kërkon Rregullorja.

Po, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi - Përpara se të flas për kërkesën që kemi paraqitur, zonja Kryetare, sa kohë brenda 4 ditëve kanë ndodhur dy ngjarje, për të cilat kryetari juaj, Kryeministri i vendit, do të duhet të vijë dhe të japë llogari para parlamentit, besoj se është në nderin tuaj të ndërprisni seancën plenare dhe t'i kërkoni Kryeministrit të vijë në seancë plenare. Kjo është një kërkesë që bazohet në nenin 47, pika 1 e Rregullores. Është e papranueshme që Edi Rama fshihet pas Rrahman Rrajës për rastin e Krujës dhe fshihet pas Arben Ahmetajt për rastin e inceneratorëve. Qoftë e para, qoftë e dyta, të dyja janë thelbi i qeverisjes së një njeriu dhe për këto arsye është në detyrimin e tij dhe në të drejtën tonë, për të kërkuar pezullimin e seancës plenare, dhe t'i kërkohet Kryeministrit të vijë dhe të japë llogari për licencën që i ka dhënë deputetit në kundërshtim me ligjin, në veprimtarinë në guroren që i shkatërroi shtëpitë një fshati të tërë dhe që solli atë ngjarje shokuese, besoj, për secilin prej nesh. Nuk mund të kalohet ajo me dorëheqjen e një deputeti që, në fakt, nuk duhej të ishte fare në këtë sallë.

Së dyti, ka një kërkesë të prokurorisë për arrestimin e zëvendësit të tij. Në atë kërkesë përmenden, të paktën, 4-5 ministra të tjerë të kabinetit qeveritar, kështu që, nuk është aferë personale e Arben Ahmetajt, por është aferë e qeverisë së Edi Ramës, është aferë e Edi Ramës. Prandaj duhet të vijë në seancë, të japë llogari për të dyja çështjet, t'u përgjigjet qoftë deputetëve, qoftë opinionit publik. Është i vetmi në territorin e Republikës së Shqipërisë që nuk ka folur ende për asnjërën nga të dyja ngjarjet e rënda që, në fakt, tregojnë thelbin e qeverisjes së tij.

Kjo është kërkesa e parë: pezulloni seancën dhe njoftojeni, në përputhje me nenin 47, pika 1! Nuk besoj se ka punë më të rëndësishme sesa të japë llogari për një aferë 430 milionë euro dhe për

një aferë tjetër, që e kishte shpallur një zonë në qendër të Shqipërisë, shumë pak kilometra larg Tiranës, si zonë nën urdhrat e një fisi të deputetit të tij. Nuk kishte as ligj, as polici, as institucione në atë zonë, kishte vetëm një familje, kishte vetëm një njeri për shkak të pushtetit që i ka dhënë Edi Rama.

Lindita Nikolla – Po. Zoti Shehi, për çfarë e kërkoni fjalën, për procedurë?

Dashamir Shehi - Po.

Desha t'u kujtoj kolegëve deputetë, përtej halleve dhe problemeve të këtyre ditëve, se para pak ditësh vdiq një kolegu ynë, një burrë shumë i nderuar, Tomor Malasi. Ka qenë nënkryetar i parlamentit të parë pluralist të Shqipërisë, ka qenë kryetari i parë i Bashkisë pluraliste të Tiranës. Vdiq një burrë i nderuar, që u nis 33 vite më parë për të bërë një Shqipëri më të mirë. Nuk ia arriti, por besoj se ia vlen ta kujtojmë me respekt, sepse vdiq tek apartamenti i vet, i kohës së Enver Hoxhës. Kjo do të thotë se Shqipëria i ka ende ca burra që nuk janë bërë pis, dhe në këtë kohë milionash, them që ia vlen t'i kujtojmë disa, sepse meritojnë respekt. Nuk them që të varrosen me të shtëna topi, të gjithë ata që kanë dalë nga kjo sallë, por një kujtesë ky parlament duhet ta bëjë për njerëzit që 30 e ca vjet përpara, pa e ditur se ku do të shkojnë, u nisën drejt një rruge të re. Kaq kisha.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në lidhje me kërkesën për një ndryshim në rendin e ditës, duhet të sqaroj, për të gjithë kolegët deputetë, se kërkesa që paraqiti zoti Bardhi nuk ka bazament, sa i takon natyrës së procesit, në të cilin përfshihet Kuvendi, kur bëhet fjalë për kërkesa që vijnë nga organi i prokurorisë dhe detyrës që kemi ne.

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Bërtisni, se e keni zakon! Punë e madhe fort.

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Ju nuk dëgjoni as njëri-tjetrin. Sapo e lexoi Kryetarja e Kuvendit, para se të fliste zoti Bardhi (dëgjoni, kini mendjen të paktën), që ka një kërkesë për rendin e ditës, dhe më pas shpjegoi se çfarë ka ndodhur!

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Po çfarë t'ju them? Nuk keni asgjë seriozisht.

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Tani, do të flas për publikun jo për ju, se ju nuk dëgjoni as njëri – tjetrin, ç'rëndësi ka të merremi me ju.

Tani logjika është kjo: procesi për të cilin diskutohet, nuk është një proces politik, është një proces procedural dhe duhet të mbizotërojë interesi i drejtësisë, jo interesi politik i ditës. Interesi i drejtësisë është të respektohen parimet e shtetit të së drejtës. Ne kemi bërë një proces në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe kemi një opinion. Sipas vijimit të procedurës do të duhet të bëhen një ose dy raporte, nuk ka rëndësi, logjika është që në nenin 118 të Rregullores normohet qartë ky proces dhe thuhet: "Brenda dy javëve hartohet një raport për seancën plenare". Ne e kemi mbaruar dje shqyrtimin. Kemi vendosur, me njoftim të Kryetares, që raporti të dorëzohet nesër dhe të hënën është seanca, dhe për këtë ka një logjikë, sepse në nenin 118, pikën 4, parashikohet një procedurë, që nënkupton se ka një garanci procedurale të njohur, nga ato që konsiderohen korpusi i të drejtave kushtetuese, e drejta për t'u dëgjuar e deputetit. Do të duhet të respektojmë këto garanci procedurale, për të respektuar atë që thashë në fillim, shtetin e së drejtës, përndryshe, procesi këtu do të ketë cenim dhe mund të jetë i kontestueshëm dhe ne do t'u biem ndesh interesave të drejtësisë, që duhet të jenë interesat mbizotëruese në këtë gjykim. Ju tani kërkoni që procesi të jetë me cen, apo kërkoni që drejtësia të bëjë punën e vet? A kemi thënë të ndihmojmë drejtësinë, ta mbështesim drejtësinë?! A kemi thënë të respektohen parimet e shtetit të së drejtës?!

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Jo pra, nuk po e tregoni këtë, zonja Tabaku, sepse dje në Këshill ju ishit gati, kolegët tuaj ishin gati pa dëgjuar palët, pa bërë procesin e rregullt ligjor, dhe kjo e cenon drejtësinë, nuk e ndihmon drejtësinë. Drejtësia është ta ndihmosh me vepra, jo me fjalë.

Pra, do të duhet të zbatojmë procedurën, do të duhet të veprojmë me shpejtësi, duke respektuar të drejtat kushtetuese dhe parimet e procesit të rregullt, përndryshe nuk e ndihmojmë drejtësinë, por e cenojmë procesin. Në këtë kuptim, thashë që kjo është një kërkesë pa bazament, ka sfond politik, por kurrsesi bazueshmëri në Kushtetutë dhe në parimet e një procesi të rregullt ligjor. Prandaj, nuk ka pse të

diskutohet, sepse ne nuk kemi kundërshtim, ne kemi dhënë një opinion në Këshill, pra një rezultat është, çfarë do të ndryshojmë? Po flasim për një proces procedural, ku ka disa garanci kushtetuese, që proceduralisht, teknikisht, Kuvendi do të duhet t'i zbatojë.

Sa u takon argumenteve politike, nuk është ky vendi dhe nuk është ky momenti. Ne nuk jemi as gjykata, as prokuroria. Atje janë vendet ku diskutohen këto çështje. Ne këtu jemi për të dhënë shembullin dhe për të zbatuar detyrimet kushtetuese, të drejtat procedurale dhe jo të sillemi ndryshe dhe të veprojmë ndryshe.

E fundit që dua të them është se në qoftë se ne nuk veprojmë në përputhje me Kushtetutën dhe me garancitë e procesit të rregullt dhe të shtetit të së drejtës, mos prisni, kolegë, nga organet e tjera të shtetit, nga prokuroria dhe nga gjykata t'i respektojnë ato, sepse modeli i keq këtu do të replikohet edhe në institucionet e tjera.

Ndaj, nuk ka kërkesë për t'u marrë në konsideratë, zonja Kryetare, sepse nuk hyn tek ato çështje për të cilat mund të bëhet një kërkesë për ndryshim në rendin e ditës.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Po, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare,

Kur ju të njoftoni se do të shqyrtojmë kërkesën, që ne kemi paraqitur, për ndryshimin e rendit të ditës, pa diskutim që do ta marrim fjalën për të diskutuar për atë kërkesë dhe për të gjitha argumentet që prezantoi para kohe kolegia. Kam bërë një kërkesë procedurale, të pezullohet seanca, thirr përgjegjësin e të dyja aferave që kanë ndodhur gjatë katër ditëve dhe që kanë tronditur të gjithë opinionin publik, e përsëris, të mos fshihet pas Rrahman Rrajës dhe Arben Ahmetajt, janë përgjegjësi e tij edhe rasti i Krujës, edhe afera e inceneratorëve, prandaj duhet të vijë në parlament t'u japë llogari deputetëve dhe qytetarëve! Nuk mund ta kalojë në heshtje, duke bërë sikur po zgjidh hallet e të gjithë botës, ndërkohë që nuk ka zgjidhur akoma hallet e korrupsionit të vet qeveritar. Ka formuar një grup parlamentar, aktualisht në burg, po pret të formojë një grup tjetër, por duhet të vijë këtu dhe të na sqarojë qoftë rastin e Krujës, qoftë rastin e aferës së inceneratorëve.

Nuk është përgjegjësi individuale, e përsëris, e Arben Ahmetajt ajo që ka sjellë prokuroria. Ai sigurisht mban përgjegjësi penale, por ka një përgjegjësi politike, është e gjithë qeveria e përfshirë në atë aferë.

Shoh Elisën të ngrejë dorën, i sugjeroj të mos e marrë fjalën, sepse pastaj do të duhet të hyjmë te përmbajtja e kërkesës, që ka sjellë prokuroria. Ajo është një aferë që përfshin Edi Ramën dhe qeverinë e tij. Zotëria duhet të vijë këtu, ta lerë kafen, që është duke pirë në zyrë dhe negociatat në distancë me Arben Ahmetajn, dhe të japë llogari për të dyja aferat. Pas asaj, të kalojmë më pas te shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin e rendit të ditës.

Lindita Nikolla – Më falni, zoti Bardhi, kemi kaluar te shqyrtimi i kërkesës!

Gazment Bardhi – Jo, nuk kemi kaluar akoma...

Lindita Nikolla – Patjetër, do të vazhdojmë me rendin e ditës. Siç ju thashë, ju paraqita edhe opinionin tonë...

Gazment Bardhi – Jo, nuk kam paraqitur asnjë opinion...

Lindita Nikolla – Po.

Gazment Bardhi - ...sepse kam bërë një kërkesë përpara nisjes së seancës.

Lindita Nikolla – Edhe një herë, po vazhdoj me seancën, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Atëherë, po ju kërkoj, në përputhje me nenin 47, pika 1, në të cilën thuhet: "Anëtarët e Këshillit të Ministrave e kanë për detyrë të marrin pjesë në seancë plenare kur kërkohet nga deputetët". Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kërkoj prezencën e një anëtari të Këshillit të Ministrave, konkretisht të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, në seancë plenare. Kam bërë një kërkesë procedurale dhe pa u shqyrtuar kjo, nuk mund të kalojmë te pikat e tjera të rendit të ditës. Të shqyrtojmë një herë këtë kërkesë procedurale dhe pastaj të kalojmë te kërkesa që kemi bërë për ndryshimin e rendit të ditës.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Po, zonja Spiropali.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pas zonjës Spiropali.

Elisa Spiropali – Nëse ka një çështje për të cilën nuk na kompleksoni dot, është raporti ynë me drejtësinë. Ju me të gjithë...

(Zhurmë në sallë)

Qetësohuni!

(Duartrokitje në sallë)

Faleminderit shumë!

Nëse doni që t'ju marr shembuj të pafund të raportit tonë qytetar, institucional dhe ligjor me drejtësinë...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Qetësohu, të lutem, mos thuaj gjëra qesharake!

...ky është rasti.

Por, sigurisht që ju jeni mësuar me kryeministra që për drejtësinë kanë folur, nuk kanë vepruar. Kryeministri Rama nuk flet për drejtësinë, nuk komenton mbi drejtësinë, nuk e përdor politikisht drejtësinë, nuk e përdor si armë drejtësinë, nuk e përdor si hanxhar drejtësinë, nuk bën populizëm dhe politikë me drejtësinë, por i lë institucionet e drejtësisë të bëjnë punën e tyre, duke besuar deri në fund se ato institucione, ata njerëz që i drejtojnë, do të përdorin ndërgjegjen dhe profesionalizmin e tyre për të bërë drejtësi, jo politikë. Ne këtë besim kemi te sistemi i drejtësisë dhe të gjitha garancitë ligjore, edhe në Kuvend, edhe si shumicë, ne i kemi dhënë. Ne kemi bërë një ndarje një herë e mirë nga politika, që për drejtësinë vetëm flet, që i shpall njerëzit fajtorë përpara se ata të gjykohen, që i akuzon kundërshtarët politikë dhe u bën gjyqin publikisht pa fakte, por ndërkohë nuk i çon te vendi aty ku duhet, sepse ruan ekuilibrat. Ne kemi bërë ndarje, Gazi, me gjithë respektin që kam për ty, që besoj se ndryshon nga ata që ke pas vetes, ta bëjmë një herë e mirë këtë ndarje.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Unë fjalën do ta marr sa herë që gjykoj se e drejta këtu po cenohet.

Në lidhje me Kryeministrin Rama, nuk ka asnjë gojë dhe nuk ka asnjë argument që mund ta bëjë atë pis në raport me drejtësinë. Ju, jo vetëm ju, por institucionet e drejtësisë, të cilat i sulmoni sa herë ju intereson, edhe publikisht, "skap"-i, ky i krimit, ai i këtij, mashë e drejtësisë, këtë e bëni për t'i kompleksuar ata. Unë uroj shumë që ata të mos kompleksohen, por të bëjnë punën e tyre me ndërgjegje dhe me profesionalizëm deri në fund. Për këtë e kemi votuar reformën në drejtësi dhe këtë mbështetje do të japim deri në fund. Të respektohen procedurat, të respektohen ligjet dhe hajdutët të shkojnë aty ku e kanë vendin, meqë dikush nga fundi bërtiti, meqë hajduti bërtiti "kapeni hajdutin".

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Edhe një herë ju bëj me dije për kërkesën tuaj, zoti Bardhi, se, referuar nenit 89 të Rregullores, shqyrtimi i pyetjeve, i interpelancave dhe i mocioneve për zhvillimin e një debati bëhen veçmas nga çdo diskutim tjetër, pasi kjo të vendoset në Konferencën e Kryetarëve.

Po, zoti Berisha.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Atë po kërkon, që të japë përgjigje për çështjet që parashtruat.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Sali Berisha – Të dashura qytetare dhe qytetarë,

Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Mblidhemi në këtë seancë pasi ka ndodhur akti më i turpshëm, më i pashembullt, më i jashtëzakonshëm në historinë e një vendi: figura e dytë e narkoqeverisë është arratisur. Ky është raporti juaj me drejtësinë?! Ky është akti më i turpshëm! Pasi ka vjedhur, vjedhur dhe vetëm vjedhur, si Gobsek, pasi ka mbushur baulet duke vjedhur më të varfrit e Shqipërisë, ia ka mbathur, duke kryer aktin më të turpshëm të një hajduti ordiner. A jeni ju të vetëdijshëm se ç'do të thotë kjo për një zyrtar, se ç'do të thotë kjo për një deputet, se ç'do të thotë kjo për një ministër?! Si reagoni në këtë mënyrë?!

Unë nuk dua t'ju them se jeni "Ahmetër", sepse nuk është e lehtë të hedhësh akuzën e fajit kolektiv, por mos harroni se faji kolektiv ekziston në doktrinë, ekziston në realitet dhe faji kolektiv në këtë rast është që, në vend të ndalemi të diskutojmë për këtë ngjarje që tejkalon çdo përmasë, një njeri që ju ua servirët shqiptarëve si njeriun e supersuksesit, si zëvendësin e Edi Ramës, ikën në mënyrën më të turpshme. Ikën dhe e informoni që të iki, sepse 4 orë para se t'i vinte parlamentit njoftimi, ai mori lajmin dhe ishte në Kakavijë. E përcolle ti Damian, apo jo, atje, ma thuaj pak këtu, se dikush e përcolli atë?

Pse reagoni në këtë mënyrë, ju?

Jo, unë nuk e di, por po të pyes.

Çfarë është ky reagim? I the ti apo jo atij, Taulant Rraja, e njoftove gjë ti apo Xhaferri, që të ikte? Në vend që të dilni këtu kokulur dhe secili prej jush t'u kërkojë të falur shqiptarëve që ju kanë dhënë votën... A keni ju moral, cipë shtetari, zyrtari, përfaqësuesi?!

Lindita Nikolla – Mbaroi koha, zoti Berisha.

Sali Berisha – Mbaroi koha, por nuk mbarojnë kurrë krimet e kësaj qeverie. Ulsi...

(Zoti Berisha flet pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zonja Zhupa, për procedurë.

Ju lutem, përmbajuni procedurës, përndryshe do t'jua ndërpres fjalën!

Ina Zhupa – Patjetër.

Faleminderit, Kryetare!

Në fakt, ju ndoshta jo qëllimisht, nuk dua të dyshoj që është qëllimisht, ngatërroni kërkesën e bërë nga ne, me atë që thotë Rregullorja. Në asnjë moment ne nuk kërkuam interpelancë, nuk kërkuam seancë pyetje-përgjigje, që ju i referoheni atij neni, por kërkuam prezencën e Kryeministrit Edi Rama në seancë. Është një nen tjetër, që ju nuk e lexoni. Sigurisht që Edi Rama nuk flet dot, zonja Spiropali ka të drejtë, sepse çdo gjë që do të thotë, do të përdoret kundër tij në SPAK dhe në drejtësi, sepse kur Edi Rama erdhi në komisionin hetimor të inceneratorëve, tha: "I kam të dyja duart brenda, jo vetëm kam dorën brenda, por i kam të dyja duart brenda në aferën e inceneratorëve...". Dhe sepse, nuk është Arben Ahmetaj apo Lefter Koka...

Lindita Nikolla – Kjo nuk është për procedurë, këto janë komente. Ju ndërpres.

Ina Zhupa – Jo, dua ta sqaroj që bëhen padi...

Lindita Nikolla – Jo, do t'jua ndërpres fjalën.

Zonja Tabaku, fjala për ju.

E patë thelbin e çështjes së procedurës, ishin komente.

Jorida Tabaku – Zonja Nikolla, kërkesa e bërë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është një kërkesë e drejtë për një çështje që ky parlament e ka debatuar që në vitin 2018. Ky parlament, vjeshtën e shkuar ngriti edhe një komision hetimor për këtë çështje. Qeveria u bë avokatja e tre personave në kërkim ndërkombëtar dhe tre personave përpara drejtësisë. Minimumi është që sot qeveria të japë llogari. Është turp publik që i keni dalë për zot një vepre korruptive. Është turp publik që u keni dalë për zot njerëzve që kanë vjedhur e zhvatur buxhetin e shtetit.

Sot gjysma e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste përmendet në dosjen e SPAK-ut; sot gjysma e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ka dhënë një tender, ka firmosur një koncesion, ka pasur lidhje me tre personat në kërkim; sot gjysma e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste duhet të ishte larguar, duhet të ulte kokën; sot gjysma e shtetit shqiptar është vendosur para përgjegjësisë për të mbrojtur 3 persona në kërkim, 3 anëtarë të mazhorancës, që kanë bërë aferën e shekullit; sot qeveria nuk mund të fshihet pas një akuze që Partia Demokratike ia ka bërë për 7 vjet me radhë, pasi keni shkuar të gjithë tek inceneratori i Elbasanit dhe keni bërë mbledhje të grupit parlamentar, pasi i keni vendosur fytyrën tuaj korrupsionit dhe pasi keni dëshmuar nën betim, në komisionin hetimor, që nuk keni asnjë lidhje me ta.

Janë të paktën 6 ministra dhe ish-ministra, është një zëvendëskryeministër, janë 4 kryetarë bashkish, 3 ndër ta ende në detyrë, të cilët sot duhet të përgjigjen para drejtësisë; është Këshilli i Ministrave që ka ngritur të gjithë shtetin në këmbë për t'u dhënë një kontratë korruptive 3 personave, që erdhën vetëm prej miqësisë së tyre me 2 ish-ministra.

Sot është minimumi i llogarisë publike që të flitet këtu për këtë çështje, të flitet pasi ish-zëvendëskryeministri, ish-ministri i Financave, ish-ministri i Ekonomisë, ish-ylli në ngjitje i qeverisë socialiste, ish-gardiani i financave publike ka çelur buxhetin e shtetit për 3 persona në kërkim dhe është bërë mbrojtësi më i mirë i korrupsionit, por njëkohësisht edhe zbatuesi më i mirë i vjedhjes së buxhetit të shtetit.

Sot, në qoftë se do të kishte përgjegjësi politike, duhet të kishit dhënë dorëheqjen të gjithë me radhë. Kjo është afera më e madhe që ka pasur ndonjëherë shteti shqiptar; kjo është afera që duhet të diskutonte ky parlament sot. Kushdo që flet dhe e mbron ende, bëhet thjesht pjesë e krimit. Është turp që ky parlament të mos diskutojë sot për këtë!

Lindita Nikolla – Zoti Gogu, fjala për ju.

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Pas zotit Gogu, jeni ju, zoti Spaho.

Toni Gogu – Faleminderit, e nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Keni një zakon të vjetër që flisni gjithmonë para se të flasë drejtësia, dhe kur vjen puna te rregullat dhe procedurat, ju doni t'i shkelni me të dyja këmbët. Rregullorja është shumë e qartë. Anëtarët e Këshillit të Ministrave e kanë të drejtën...

(*Ndërhyrje pa mikrofon nga salla*)

Një sekondë, të mbaroj, zoti Bardhi, se unë ju dëgjoj me vëmendje. Ne ngaqë dëgjojmë me

vëmendje arrijmë të fitojmë, të kemi edhe rezultate.

Pra, anëtarët e Këshillit të Ministrave, të cilit iu referuat, e kanë të drejtën, kur u kërkohet, ka edhe instrumente se si u kërkohet, të cilat janë: mocioni, kërkesa, interpelanca, pra është një kre i tërë i lidhur me këtë. Kështu që ne sot, me dëshirën më të madhe për të votuar kërkesat tuaja, s'kemi lëndë, nuk kemi çfarë të votojmë. Mos na sillni gjëra bosh. Nuk mund të disponojmë mbi "boshin". Çohet "boshi" dhe do që ne të disponojmë mbi "boshin". Ne disponojmë mbi lëndë.

Kështu që, zonja Kryetare, kërkesa jonë është që të vazhdojmë me seancën, për shkak se nuk kemi lëndë mbi të cilën të disponojmë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Spaho, fjala për ju.

Edmond Spaho – Zonja Kryetare,

Javën e kaluar kemi pasur zhvillime shumë të rënda për këtë vend dhe kërkesa që bëri zoti Bardhi për të ardhur Kryeministri është jo vetëm e përputhur proceduralisht, siç parashikon Rregullorja, por duhet të kini parasysh se ka edhe një moral politik dhe shoqëror. Qytetarët e vendit tonë presin që Kryeministri të japë shpjegime. Përse? U shkarkua ministri i Brendshëm për një ngjarje banditeske. Askush nuk jep shpjegime. I pari që duhet të përgjigjet është Kryeministri.

Së dyti, kërkohet arrestimi i krahut të djathtë të Ramës, dhe Kryeministri nuk vjen të japë shpjegime. Krahu i djathtë i Ramës ia ka mbathur në arrati. A ndodhin këto në ndonjë vend normal në Europë, ku Kryeministri të mos vijë e të japë shpjegime? Jo vetëm që duhet të jepte shpjegime, por duhet të kishte dhënë dorëheqjen dhe vendi të kalonte menjëherë në zgjedhje të parakohshme. Jo vetëm që Kryeministri nuk vjen, por dëgjojmë edhe dokrra (më falni për fjalën) nga kolegët e mazhorancës, a thua se me shkopinj bejsbolli dolën përfaqësuesit e opozitës; a thua se u shkarkua ministri i Brendshëm i opozitës; a thua se ka ikur në arrati krahu i djathtë i kreut të opozitës dhe akuzohet për vjedhje!

Ne si opozitë mund të kemi shumë të meta, por hajdutë nuk jemi...

Lindita Nikolla – Zoti Spaho, ju lutem, ju po komentoni, nuk po flisni për procedurë.

Edmond Spaho – Nëse dikur vidhnit...

Lindita Nikolla – Do t'ju ndërpres fjalën zoti Spaho, sepse nuk po flisni për procedurë!

(*Ndërhyrje pa mikrofon nga salla*)

Ka kërkuar fjalën për procedurë zoti Sula.

Ju lutem, përmbajuni procedurës!

(*Ndërhyrje pa mikrofon nga salla*)

Dashnor Sula – Faleminderit, zonja Kryetare!

Këtu është për të qarë dhe për të qeshur! Unë nuk e kam ndër mend të diskutoj dhe as të flas për procedurë, por dy fjalë do t'i them, që të na dëgjojnë të gjithë shqiptarët.

Miqtë e mi,

Keni vjedhur ju apo kemi vjedhur ne?!

I keni në burg ju apo i kemi në burg ne?!

Ia keni dhënë popullit në gojë ju apo ia kemi dhënë ne?!

Çfarë ka ngelur këtu tani, të heqim edhe pantallonat në mes të parlamentit?! Vetëm kjo ka ngelur këtu! A ka turp më të madh se kaq?! Të na vijë turp si neve, ashtu edhe juve, për çfarë po ndodh në këtë vend! Jemi kthyer në barsoleta. Çfarë nuk qarkullon e çfarë nuk na thonë, sepse situata është aq e rënduar, aq e turpshme, aq komike sa s'ka ku të shkojë.

Lindita Nikolla – Do t'jua ndërpres fjalën, njësoj si kolegëve, sepse nuk po flisni për procedurë!

Dashnor Sula – Zonja kryetare e Komisionit të Ligjeve tha: "Zoti Bardhi nuk ka bazament". Po, zoti Bardhi, nuk ke bazament, sepse nuk ke vjedhur.

Ama ka një gjë për sa i përket raportit: kur ju si mazhorancë doni të miratoni një projektligj, brenda 24 orëve e përgatitni raportin dhe e sillni. Tani, keni 3 raste: rastin e Saimir Tahirit, për të cilin brenda 24 orëve erdhët dhe votuat për heqjen e imunitetit të tij; për rastin e sotëm keni një javë dhe s'po merrni asnjë masë, dhe unë nuk e kuptoj se çfarë doni më shumë ju; keni edhe rastin e zonjës Xhaçka, për të cilin keni 3-4 muaj që nuk keni bërë një raport. Pra, ju gjeni gjithmonë artifica dhe justifikime vetëm e vetëm për t'u dhënë mundësi personave që duhet të jenë para parlamentit, për të fshehur gjurmët e për t'u zhdukur. Ky është problemi. Pra, ju nuk e bëni sepse po ju dhimbset procedura, siç thotë zonja kryetare e Komisionit të Ligjeve. Jo, ne nuk po kërkojmë të shkelim procedurën. Procedura le të bëhet, të respektohet, por në Rregulloren e Kuvendit nuk thuhet se duhen patjetër 7, 8 apo 10 ditë, thuhet se pa diskutim duhet të kalojë procedura.

Më jepni një shpjegim, zonja Kryetare e Kuvendit, pse u shty dy herë mbledhja e Këshillit për Mandatet? U shty, sepse zotëria që duhet të ishte para komisionit, nuk u paraqit. Tani, është faji ynë pse nuk erdhi ai?! Urojmë që të vijë, se do të ishte gjë shumë e mirë të vinte, dhe të japë shpjegime.

Tani, kthehemi në anën tjetër, a ka problematikë më të madhe (e tha shumë qartë edhe zonja Tabaku) se fakti që keni kryetarë bashkish në burg, deputetë, ministra...

Lindita Nikolla – Ju mbaroi koha. E thatë mendimin tuaj për procedurë. S'mund të merrni fjalën për procedurë dhe të bëni diskutime! Ju lutem!

Zoti Noka.

Flamur Noka – Se çfarë ka ndodhur javën e kaluar dhe çfarë po ndodh këto ditë, e sheh çdo shqiptar dhe çdo ndërkombëtar. A ka gjë më të rëndë se këto zhvillime që kaloi ky vend dhe politika, që të vish sot këtu e t'ju shohësh juve që buzëqeshni dhe duartrokisni recitimet e zonjës kur mbron organizatën kriminale që quhet "qeveri", e cila është e zhytur në dosjen e zëvendëskryeministrit nga koka te këmbët, e zhytur me emër e mbiemër, pra e gjithë organizata kriminale në vjedhje?! Kemi vite që jua kemi thënë se inceneratori është megavjedhja e shekullit dhe është bërë vetëm e vetëm që ju të vidhni shqiptarët. Keni qeshur, keni fytyrë e qeshni edhe sot!

A ka turp më të madh që ajo karrige sot, në ditën kur po ndodhin zhvillimet më dramatike të kësaj politike, rri bosh?!

Cili është raporti që keni ju, cili është raporti që ka kjo organizatë kriminale këtu (organizatë kriminale jeni) me ligjin, me qytetarin? I kaloni gjërat duke u zgërdhirë?! Po si mund të pranoni që këtu të diskutohet një çështje e tillë pa qenë këtu shefi i Ahmetajt, ose shefi i hajdutëve?! Jeni apo nuk jeni përfaqësues të qytetarëve të këtij vendi? Si mund të ketë seancë normale këtu? Çfarë është kjo?! Mos vallë ka thyer këmbën një lopë diku në Borizanë dhe ne po e kalojmë me të qeshur këtu, dhe le të merret veterineri?! Çfarë përfaqësoni ju këtu? A e kuptoni se me këtë të qeshur që bëni, në këtë moment kaq dramatik për këtë shoqëri, po tregoni se përfaqësoni vetëm hajdutët dhe në asnjë moment qytetarët?

Në këtë sallë, pa llogaridhënie të Kryeministrit, kurrë nuk mund të kalojë kjo.

Në çdo vend demokratik, zonjë, një kryeministër dhe një qeveri, përballë 1/10-ës së këtyre skandaleve tuaja, do të kishte ikur me turp jo vetëm nga qeveria, por edhe nga politika.

Ndaj, pa Kryeministrin, harrojeni se do të ketë seancë sot! Të vijë këtu e të japë llogari dhe të ikë së bashku me shpurën e hajdutëve. Iku zëvendëskryehajduti, por kryehajduti dhe hajdutët janë këtu. Pa ardhur ai këtu dhe pa u zhvilluar debati me të, pa u kërkuar ju ndjesë shqiptarëve dhe pa e larguar këtë organizatë kriminale, nuk mund të ketë parlament dhe as debat këtu në sallë. Sepse hajdutët dhe përfaqësuesit e qytetarëve nuk mund të rrinë bashkë. Të babëziturit dhe njerëzit e ligjit, nuk mund të rrinë bashkë. Mostrat që vetëm vjedhin dhe përfshihen në krime dhe njerëzit që luftojnë për ligjin, për të drejtën, për të mbrojtur qytetarët, bashkë këtu, jo! Duhen ndarë dhe është momenti...

Lindita Nikolla – Ju mbaroi koha, zoti Noka.

Edhe një herë e përsëris nenin 89 të Rregullores, ku thuhet se shqyrtimi i pyetjeve, i interpelancave dhe mocionet zhvillohen veçmas, pas një procedure të caktuar, që është mbledhja e Konferencës së Kryetarëve.

Ju lutem, vazhdojmë normalisht me rendin e ditës!

Ju bëj me dije, ju sqaroj, sepse ka shumë abuzime, që kërkesa e SPAK-ut është depozituar në Kuvend në datën 10 korrik. Edhe pse mban datën 7, në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar në datën 10 korrik dhe Këshilli i Legjislacionit ka filluar menjëherë mbledhjen. Janë bërë 2 mbledhje, sepse mbrojtja ka kërkuar kohë dhe është e drejtë kushtetuese për të pasur një proces të drejtë ligjor. I dhamë jo më shumë se 1 ditë kohë, megjithëse në Rregullore thuhet se duhen 2 javë për përcaktimin e raportit dhe për dërgimin e tij deputetëve, ne po veprojmë shumë shpejt.

Po ashtu, ju bëjmë me dije se e njëjta procedurë ka qenë edhe në rastin e zotit Tahiri, ku ka ardhur në datën 19 dhe në datën 25 korrik është mbledhur seanca plenare. Ndaj, nuk ka asnjë deformim dhe asnjë dyshim që ju doni të hidhni mbi aktivitetin e Këshillit të Mandateve dhe të parlamentit, të Kuvendit.

Atëherë, ju lutem, mund ta kërkoni fjalën për procedurë, por nuk mund të flisni për çështje të tjera pastaj!

Përmbajuni procedurës, zotëri!

Zoti Manja ka kërkuar fjalën. Është ministër dhe i jepet menjëherë fjala.

Ulsi Manja – Rri pa merak Flamur, sepse normalisht edhe unë për procedurë e mora fjalën!

E nderuar zonja Kryetare,

Unë kërkoj të vazhdojmë me rendin e ditës, sepse heshtja jonë sot ka të bëjë me respektin për drejtësinë, por jo me respektin për një pjesë të këtyre kolegëve këtej, pasi, kur vjen puna për të na bërë moral për ndershmërinë, për politikën dhe për drejtësinë, një pjesë juaja këtej, është fundi i parlamentarizmit. Heshtja jonë ka të bëjë vetëm me atë për të cilën në korrik të vitit 2016 u pajtuam për të votuar reformën në drejtësi.

Kjo që bëni ju sot, të nderuar kolegë, është shërbimi më i mirë që i bëni jo shtetit, por antishtetit, është shërbimi më i mirë që ju i bëni krimit, sepse këtë porosi keni marrë nga krimi dhe mesazhin e krimit kërkoni ta përcillni edhe sot në këtë sallë të parlamentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këtë arsye, zonja Kryetare, drejtësia le të vazhdojë të bëjë punën e vet! Ky parlament duhet të merret me punën që i takon, kështu që të ftoj të vazhdojmë me rendin e ditës një orë e më parë, sepse e gjithë retorika politike e këtij krahu të djathtë këtu i shërben krimit dhe vetëm krimit, i shërben mbulimit të së vërtetës dhe nuk e ndihmon drejtësinë të bëjë punën e saj. Mos e merrni heshtjen tonë për dobësi, sepse heshtja jonë është respekt për drejtësinë dhe ligjin.

Lindita Nikolla – Është respekt për drejtësinë dhe për ligjin, dhe procesi i kërkuar nga ju, zoti Bardhi, është proceduralisht i parealizueshëm dhe teknikisht i pamundur, sepse ky është një proces ku mbizotëron interesi i drejtësisë dhe jo ai i debatit politik. Kemi detyrimin kushtetues për njoftim dhe marrje pjesë të deputetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është sms, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po lexoj argumentet. Patjetër!

Pra, njoftimi i deputetit është detyrim kushtetues. Edhe në nenin përkatës të Rregullores thuhet se fjala e parë i jepet deputetit, ndaj ne nuk mund ta nisim këtë proces me cene dhe ta çojmë në paligjshmëri, duke votuar në parlament.

(Debate pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare,

E para, (unë nuk e kuptoj, është në nderin tuaj, ju jeni numri 2 i shtetit shqiptar) ka një kërkesë të deputetëve, të cilët po të pyesin se ku është Kryeministri dhe ju nuk merrni guximin as ta pyesni Kryeministrin, nëse do të vijë apo jo në seancë. Kjo mungesë e kurajës nga ana juaj tregon që jeni në atë pozicion jo në shërbim të parlamentit, jo në interes të qytetarëve, por në interesin personal të Edi Ramës.

Unë do ta shpjegoj kërkesën, për të mos krijuar ngërç, por ne nuk heqim dorë nga kërkesa. Edi Rama është përgjegjësi i të dyja ngjarjeve, nuk është përgjegjësia e Rrahman Rrajës. Pa mbështetjen e Edi Ramës, Rrahman Rraja nuk do të kishte licencë për gurore në Krujë; pa mbështetjen e Edi Ramës, Arben Ahmetaj, Damian Gjiknuri, Lefter Koka dhe çdo ministër që është për të shkuar në burg për aferën e inceneratorëve, nuk miratonte dot 17 vendime brenda ditës. Dhe ju flisni këtu për procedurë?! Po a e keni lexuar dosjen e ardhur nga SPAK-u? Ku ka procedurë aty? Çdo shkresë që ka firmosur secili prej tyre e kishte bërë Klodian Zoto dhe ua çonte me *email.* Çdo vendim të këshillit bashkiak e kishte bërë Klodian Zoto dhe ua çonte me *email*. Çdo urdhër të kryetarëve të bashkive e kishte bërë Klodian Zoto dhe ua çonte me *email.* Dhe ju flisni për procedurë?! Për cilën procedurë flisni?! Procedurë për të mbrojtur të drejtat e Arben Ahmetajt?! Po ju mbroni të drejtat e qytetarëve shqiptarë, ju mbroni lekët e qytetarëve shqiptarë! Aty duhet të jeni garantë të procedurës, jo tek të drejtat e Arben Ahmetajt! Arben Ahmetaj, nëse donte të mbrohej, le të mos arratisej, siç u arratis ditën kur u firmos urdhri nga SPAK-u për arrestin e tij. Le të vijë këtu në parlament, të përballet me drejtësinë, të tregojë bashkëpunëtorët në qeveri në aferën e tij prej 430 milionë eurosh dhe të mos shëtisë nga njëri aeroport në tjetrin me paratë që na ka vjedhur neve, sepse kjo është e papranueshme.

Zonjë, ke marrë një raport, dhe mos më fol për raporte dhe të drejta, sepse (kur doni ju) keni futur jashtë procedure ligjin për kanabisin, i cili nuk është fare në kalendar. Është në interes të grupeve kriminale dhe e keni futur dhe miratuar në të gjitha komisionet. Vini këtu dhe na tregoni neve procedurën! Cilën procedurë na tregoni? Ku e keni në kalendar ligjin për kanabisin që e keni futur dhe miratuar në çdo komision? Zotrote, do të mbledhësh në seancë plenare sot Komisionin

për Ligjet! Çfarë urgjence ka, përveç garancisë që u ka dhënë Edi Rama grupeve kriminale që e ndihmuan në zgjedhjet e 14 majit? Ku vini ju dhe bëni teatër?! Secili nga ju e ka lexuar dosjen, jo vetëm anëtarët e Këshillit të Mandateve. A nuk ju vjen turp për atë që ka ndodhur në atë dosje? A ndjeni përgjegjësi ju që u bëtë fasada e inceneratorëve dhe nisët fushatën e tyre? A nuk ju vjen turp që në Komisionin Hetimor u dolët garant mafiozëve të inceneratorëve dhe atyre që kanë vjedhur 430 milionë euro, të cilët sot po përballen me drejtësinë, duke u nisur nga ju?! I nxorët të gjithë pa asnjë përgjegjësi, nga Lefter Koka tek Arben Ahmetaj, nga Damian Gjiknuri tek Ermonela Felaj.

(Debate pa mikrofon)

I nxorët të gjithë pa përgjegjësi, por ja që paska përgjegjësi! E keni lexuar dosjen? Vetëm në inceneratorin e Tiranës, Klodian Zoto paradite, pa dalë procedura, e çon 16 milionë euro dhe pas 6 orësh thotë: "Jo 16 milionë euro, por 220 milionë euro".

(Debate pa mikrofon)

Shiko! Palaço mua më ka thënë kryemafiozi yt dhe tani vjen nga një hajdute si ty, nga një gjobaxhie, nga ty që ke pushtuar Prokurorinë e Tiranës, për t'i vënë gjoba biznesit! Yt shoq vetëm në çështjen e rimbursimit të TVSH-së ka marrë ryshfet 1,5 milionë euro nga 4 biznese. Kjo je ti! Ti je familje e hajdutëve! Ti je një hajdute, një gjobaxhie, që ke edhe guxim të vish këtu e të flasësh! Ti nuk duhet të ishe aty, zonjë! Je pjesë e dosjes! Ke pushtuar Prokurorinë e Tiranës për t'u vënë gjoba bizneseve, për t'u vënë gjoba qytetarëve! Je fasada e inceneratorëve! Ke shkuar dhe u ke vënë fytyrën për të mbuluar krimin! Ti, ti! Ti dhe një pjesë prej këtyre!

(Debate pa mikrofon)

Ti dhe një pjesë prej këtyre jeni bërë fasadë për inceneratorët! Dhe ju flisni për procedura! Për cilat procedura flisni ju këtu?! A erdhi drejtuesi...

(Debate pa mikrofon)

Mbylle, moj gore, gojën! Mbylle, moj hajdute, gojën!

Lindita Nikolla – Zoti Bardhi!

(Debate pa mikrofon)

E dëgjoi, Erion, patjetër!

Zoti Bardhi flet pa mikrofon – Hape mikrofonin!

Lindita Nikolla – 5 minuta kohë kishe dhe i përfundove. Të mos e kishe ndërprerë, zoti Bardhi!

(Debate pa mikrofon)

Hapeni edhe 1 minutë mikrofonin!

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare,

Ju dhe ne, anëtarët e Këshillit të Rregullores dhe Mandateve, jemi dëshmitarë të pohimit të drejtuesit të prokurorisë që Arben Ahmetaj gjatë kësaj jave ka tentuar të intimidojë dëshmitarë, ka tentuar të prishë prova. Ju po bëheni bashkëpunëtorë në krim, që Arben Ahmetaj të vazhdojë të intimidojë dëshmitarë, të vazhdojë të prishë prova, të negociojë me Edi Ramën për të fshehur prova, por kjo nuk mund të ndodhë. Nëse keni shprehur vullnet për t'i hequr imunitetin Arben Ahmetajt, nuk ka asnjë arsye për t'u vonuar. I vetmi qëllim, që ju doni të arrini me këtë, është ekzaktësisht ajo që tha Altin Dumani (le ta dëgjojë edhe media) në mbledhjen e Këshillit të Rregullores dhe Mandateve. Drejtuesi i prokurorisë deklaroi se prej një jave Arben Ahmetaj, me fuqinë e tij si deputet, si ish-ministër, si ish-zëvendëskryeministër, ka intimiduar e ka tentuar të prishë prova dhe prokuroria kërkon arrestimin e tij të menjëhershëm, për të shmangur prishjen e provave, intimidimin e dëshmitarëve, zhdukjen e provave. Këta zotërinjtë që janë këtu duan ekzaktësisht këtë! Duan t'i japin kohë Arben Ahmetajt të prishë prova dhe të negociojë me Edi Ramën. Kjo nuk ka për të ndodhur! Edi Rama duhet të vijë këtu dhe të tregojë se çfarë ka thënë gjatë këtyre 48 orëve me Arben Ahmetajn, se si po shkojnë negociatat e dorëzimit të kontrolluar, siç ka bërë deri më sot me secilin prej atyre që vendos të lëshojë në një moment të caktuar! Le të vijë këtu dhe të japë llogari për Damian Gjiknurin, sepse ka bërë një sfidë me mua zoti Gjiknuri! E mbani mend kur i nxora udhëtimet me Klodian Zoton dhe Mirel Mërtirin dhe më tha: "Po i provove udhëtimet, o unë, o ti në këtë sallë!", edhe pse unë ia provova me sistemin TIMS? Sot nuk ka ardhur, sepse, me sa po kuptoj, e paska aq burrni, dorëzoi edhe mandatin, se ia ka provuar prokuroria të gjitha udhëtimet dhe dhuratat që ka marrë nga mafiozët e inceneratorëve.

Zonja Kryetare, thirre Edi Ramën, hidhe në votim kërkesën për ndryshim të rendit të ditës dhe të shtohet si pikë e parë heqja e imunitetit për Arben Ahmetajn dhe vënia tij para drejtësisë. Kjo

është ndihmë për drejtësinë, nuk është ajo se nuk na flisni ju**!** Çfarë do të thoni ju tek ajo dosja?! Ju bëni mirë të heshtni, secili prej jush.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbarova. Edhe një minutë.

Çfarë do të thoni ju për atë dosje?!

Lindita Nikolla - Mbaroi koha!

Ju dhamë dy minuta shtesë, jo një minutë.

Gazment Bardhi - Nga i pari tek i fundit, ju jeni pjesë e asaj dosjeje dhe, sigurisht që do të zbatoni parimin e të pandehurit...

Lindita Nikolla- Zoti Bardhi, mbaroi koha!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi- Jo, nga i pari tek i...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla - Këtu jam, këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër!

Zoti Bardhi, përfundojeni fjalën tuaj!

Fjala për zotin Gogu.

Toni Gogu- Faleminderit, e nderuar zonja Kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla - Foli zoti Bardhi, tani radhën e ka zoti Gogu.

Çfarë ka?!

Toni Gogu- Të nderuar kolegë,

Kërkoj vetëm dy minuta durim dhe qetësi nga ju.

Të nderuar kolegë,

Ne, kur e kemi nisur këtë legjislaturë, të gjithë jemi betuar mbi Kushtetutë dhe Rregullore, ndaj edhe drejtësia i ka të mbyllur sytë dhe me gojë flet pasi ka marrë vendimin. Ajo çfarë ka ndodhur, që e kemi mësuar fare mirë nga mediat, por edhe nga kolegët që kemi pasur të pranishëm, është që ka pasur një kërkesë nga kryeprokurori i SPAK-ut, që seanca të bëhej me dyer të mbyllura për shkak se bëhej fjalë për sekret hetimor....

(Zhurmë në sallë)

Të nderuar kolegë,

Po citoj kryeprokurorin e SPAK-ut.

Ndaj ne operojmë së bashku me një Rregullore. Shtetin ligjor, sado emocione të kemi ne, e mban në shina rregulli. Sado të indinjuar të jemi ne për njerëz të vrarë në shesh, për para të vjedhura publike, ne na mban në shina vetëm Rregullorja jonë. Rregulloren e shpjegoi shumë mirë Kryetarja. Nuk ka një kërkesë të dokumentuar në zbatim të Rregullores, kështu që ne duhet të vazhdojmë seancën.

Ndërkohë, ju bëj thirrje, të nderuar kolegë opozitarë, i nderuar zoti Bardhi, boll me nxjerrjen e sekretit hetimor dhe boll me bërjen pis të një procesi! Ne jemi shumë herë më të interesuar se ju që drejtësia të vihet në vend, sepse këtë drejtësi, në këtë ditë, e ka sjellë kjo anë e parlamentit dhe do ta çojë deri në fund. Padurimi juaj sot, humbja e qetësisë suaj sot dhe shkelja, të paktën, e Rregullores, për të cilën unë flas, sepse për ligjin penal flasin të tjerë, me nxjerrjen e sekretit hetimor sot, dje dhe pardje, ju bën me goxha faj. Kështu që, ju lutem, me kujdes!

Zonja Kryetare, ne kërkojmë vazhdimin normal të seancës, siç kemi rënë dakord në Konferencën e Kryetarëve.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Ju lutem, kolegë deputetë, nuk mund të abuzoni duke kërkuar pa fund fjalën për procedurë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk mund të abuzoni duke kërkuar pa fund fjalën për procedurë, madje edhe nga 2 apo 3 herë.

Edhe një herë, fjalën e ka zoti Shehu për procedurë.

Tritan Shehu - Faleminderit, zonja Kryetare!

Zonja Kryetare, ju duhet të vendosni në vend respektin ndaj parlamentit, nderin e parlamentit dhe parlamentin në detyrat e tij. Kryeministri dhe qeveria janë zgjedhur nga ky parlament. Kryeministri dhe qeveria raportojnë në këtë parlament dhe diskutojnë në këtë parlament. Shqipëria sot është në gjendje të jashtëzakonshme, jo thjesht parlamenti. Skandal pas skandali, dhunë pas dhune, korrupsion pas korrupsioni. Ku do të shkojë më tepër?! Kryeministri avullon, nuk vjen në këtë parlament të japë llogari, të flasë me deputetët dhe të procedojë normal. Kjo nuk ndodh në asnjë vend demokratik të botës. Në çdo vend demokratik, në një situatë të tillë kaq tragjike për vendin, kaq tragjike për institucionet, për imazhin dhe për të drejtat, Kryeministri duhet të ishte i pari atje, i pari që të kërkonte të shpjegohej me deputetët, i pari që të kërkonte të fliste me deputetët, jo të avullonte e të zhdukej dhe vendimet e mëdha strategjike t'i komunikonte nga Mali i Zi dhe jo nga Shqipëria.

Kryeministri nuk duhet t'i shmanget çdo diskutimi që bëhet për korrupsionin e lartë, për

bëmat e mëdha, për dhunën e tmerrshme që pamë pak ditë më parë. Prandaj është e paimagjinueshme kjo gjë. Ky parlament, në të drejtën legjitime të tij dhe në të drejtën që i jep Kushtetuta kërkon të fillojë me këtë gjë: me Kryeministrin atje, me një debat të diskutuar midis nesh, me një mocion ndaj tij dhe qeverisë, pikërisht për këtë situatë kaq të vështirë dhe kaq të rëndë që po kalon e gjithë Shqipëria. Nuk mund të fshihemi prapa gishtit. Nuk mund të fshihemi si struci. Të gjithë e kanë vendin në parlament dhe të gjithë duhet ta kuptojnë se respekti ndaj parlamentit është respekti ndaj demokracisë, është respekti ndaj vendit, është respekti, në fund të fundit, ndaj votës së qytetarëve, e cila është shkelur dhe është shpërbërë me këto bëma të mëdha që po bëhen në këtë periudhë. Prandaj, nuk ka si të vazhdohet më tej.

Gjëja e parë që duhet bërë është që Kryeministri dhe deputetët të jenë këtu dhe të bëhet një debat i hapur për këtë çështje, absolutisht, të jemi të bindur për këtë gjë. Kjo është e drejta e parë e parlamentit dhe respekti ndaj tij. Duke respektuar parlamentin, respektohet edhe drejtësia, edhe institucionet, edhe shteti dhe të gjithë, sepse çdo gjë fillon nga parlamenti shqiptar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Faleminderit!

Parlamenti respektohet duke respektuar rregullat. Ju ftoj të lexoni nenin 89 të Rregullores, respektoni rregullat që të respektoni parlamentin dhe parlamentarizmin.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

(Zhurmë në sallë)

Ju bëj me dije se nga KQZ-ja është depozituar në Kuvend vendimi nr.693, datë 12.07.2023 "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërorë të Partisë Socialiste, qarku Durrës, zotit Arkend Bashkim Balla për krijim të vakancës në Kuvend për shkak të dorëheqjes nga mandati i deputetit, zotit Rrahman Rraja".

Ftoj deputetin të bëjë betimin!

(Zhurmë në sallë)

Patjetër!

Ftoj deputetin të bëjë betimin!

Teksti i betimit: "Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend, do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t'i bindem kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat e liritë e shtetasve dhe do të punoj me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e atdheut dhe mirëqenien e popullit tim".

Arkend Balla - Betohem!

Lindita Nikolla - Urime dhe suksese!

Arkend Balla- Faleminderit!

(Zhurmë në sallë)

Lindita Nikolla - Edhe një herë, zoti Bardhi, ju sqarova që nuk mund të hedhim në votim një çështje që nuk ka lëndë.

(Zhurmë në sallë)

Jo, nuk ka lëndë.

A janë njoftuar deputetët përmes raportit të Këshillit të Mandateve? Jo. A është njoftuar deputeti...

(*Zhurmë në sallë)*

Jo, nuk është njoftuar deputeti. Rregullorja lë dy javë kohë, ne kemi marrë shumë më pak kohë, kemi vepruar në mënyrë shumë serioze dhe shumë dinjitoze, në respekt të drejtësisë dhe në respekt të rregullave të parlamentit. Kaq e thjeshtë është. Të dyja palët jemi dakord, por sot nuk mund të votojmë një gjë që është pa lëndë dhe një gjë që është antiligjore. Dakord? Kështu që vazhdojmë me rendin e ditës.

(Zhurmë në sallë)

Zoti Korreshi e ka fjalën për procedurë, si anëtar i Këshillit të Legjislacionit dhe anëtar i Këshillit të Mandateve.

Saimir Korreshi - Zonja Kryetare, së pari është i turpshëm nga ana juaj drejtimi i kësaj seance; nuk mund të ma japësh fjalën për procedurë, sepse nuk je ti që selekton se cili deputet do të flasë dhe cili jo. Së dyti, unë jam anëtar i Sekretariatit të Procedurës, Etikës dhe Votimeve dhe kjo zonja këtu duhet të dalë përjashta, urgjent, sepse fjalor rrugaçësh dhe rruge këtu nuk mund të përdoret.

(Zhurmë në sallë)

Shoku Edi Rama, për të cilin na mori malli ta shohim dhe ta përqafojmë një herë lartmadhërinë, të marrë defet dhe t'i bashkohet kabasë së Myzeqesë, sepse na kanë mbytur plehrat me ata inceneratorë, të cilët nuk i ndizni dhe lekët ua dërgoni atyre që janë në arrati. Turp të keni!

(Zhurmë në sallë)

Lindita Nikolla - Zoti Balla e ka kërkuar fjalën.

Taulant Balla - Zonja Kryetare e Kuvendit, sot...

Flamur Noka - Nxirre direkt prej këtu!

Rrugaçe, përjashta, përjashta rrugaçe, ec!

Nxirre përjashta!

Taulant Balla - Zonja Kryetare e Kuvendit, sot Kuvendi ka të parashikuar një debat të rëndësishëm për raportin e Komisonerit për Zgjedhje.

Unë e kuptoj që këta, kur vjen fjala "zgjedhje", nuk bëjnë dot debat, edhe pse do të ishte mirë, edhe për shqetësimet që kanë ngritur të dyja copat e opozitës, të bëhej një diskutim siç duhet në Kuvendin e Shqipërisë, për raportin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vitin 2022, ku kemi pasur zgjedhjet e 6 marsit. E di fare mirë që ju debat për zgjedhje nuk bëni dot, sepse ia keni marrë dorën nga humbja në humbje.

Me qëllim rikthimin e seancës në normalitet dhe zhvillimin e një debati normal për zgjedhjet, i kërkoj Kryetares së Kuvendit 5 minuta pushim. Deputetët të qetësohen dhe Komisioneri Celibashi të bëhet gati për raportim.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - 5 minuta pushim!

(Pas pushimit)

Lindita Nikolla – Të nderuar kolegë,

Vijojmë me seancën.

Atëherë, sipas radhës, e ka kërkuar fjalën për procedurë zonja Jorida Tabaku.

Jorida Tabaku – Diskutojmë, tha zoti Balla, për zgjedhjet. Po, zoti Balla: "Urime PS-Përmet!", i çon Mirel Mërtiri mesazh Arben Ahmetajt, sepse, pasi kishte marrë tenderët e Divjakës, të Korçës, të Beratit, pasi kishte shkuar edhe tek tenderi i Fierit, i erdhi radha tenderit të Bashkisë së Përmetit.

"Urime PS-Përmet", kjo ishte fraza që më mbeti në mendje nga e gjithë dosja që pashë dhe lexova nëpër medie. A ka degjenerim më të madh të shtetit se një person në kërkim të çojë mesazh urimi: "Urime PS-Përmet"?! Po, sigurisht, sepse prej PS-së u ngritën Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri; aty i morën tenderët Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri; aty u bënë biznesmenë Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri; aty arritën që t'i marrin shtetit 430 milionë euro.

"Urime PS"; "Urime PS-Përmet!", për këtë duhej të diskutohej sot; nuk ka asnjë diskutim për zgjedhjet sot, kur ti e shikon që zgjedhjet në këtë vend, që kur Partia Socialiste nuk ishte në pushtet (po flasim për zgjedhjet e 2011-ës) janë marrë, janë vjedhur, janë paguar nga këta tri biznesmenë në çdo zonë ku ka shkuar Arben Ahmetaj.

Unë nuk besoj se ka skandal më të madh për shtetin shqiptar se ajo dosje hetimore që i ka ardhur parlamentit. Sot, kushdo që ka qenë në komisionin hetimor parlamentar për inceneratorët, që është bërë avokat publik i tri personave në kërkim, por njëkohësisht edhe i tri personave që sot duhet të ishin para drejtësisë, ish-ministra, duhet të ketë turp, sot duhet të ulë kokën, sot duhet t'u kërkojë ndjesë shqiptarëve që ka mbrojtur, është bërë fasadë për të mbrojtur 430 milionë euro, që i mungojnë sot buxhetit të shtetit.

Sot, kushdo që ka sulmuar PD-në për një betejë që e nisi më 2017-ën, duhet të ketë turp; sot duhet të ketë turp edhe e gjithë makineria qeveritare, që m'u vu kundër mua, e vetme në komisionin hetimor! Unë, zonja Dhurata Çupi, zoti Lefter Gështenja, zoti Helidon Buzhati, zonja Ina Zhupa dhe kushdo që ndenji deri në fund të komisionit hetimor, u bëmë tabelat tuaja të qitjes për korrupsionin tuaj dhe të kësaj qeverie.

"Urime PS-Përmet!", kjo është fraza që më ngeli në mendje dhe duhet t'i mbesë në mendje çdo shqiptari se si zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë drejtoheshin nga dy persona, sot në kërkim: Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, që erdhën me duar në xhepa dhe i bëtë me 430 milionë euro në xhepat e tyre nga buxheti i shtetit shqiptar, i bëtë biznesmenë nga asgjëja.

Ky është tërmeti që duhet të diskutojmë sot, sepse kështu ishte edhe Dibra; kështu ka qenë edhe Vora; kështu ka qenë në çdo palë zgjedhje që ka fituar kjo qeveri.

"Urime PS-Përmet!", besoj se tregon më mirë fytyrën e kësaj qeverie, kur e urojnë dy persona në kërkim ndërkombëtar!

Lindita Nikolla – Zonja Ina Zhupa e ka fjalën.

Ina Zhupa – Faleminderit, zonja Kryetare!

Ju edhe vetë e kuptoni se bëhet fjalë për t'i dhënë mbrojtje dhe garanci Arben Ahmetajt për të lëvizur lirisht, pa kërkim ndërkombëtar, derisa ai të sistemohet; kjo është arsyeja pse e vononi raportin.

Duhet thënë se nuk janë as Arben Ahmetaj, as Lefter Koka ata që sot vazhdojnë pagesat e inceneratorëve. A mund të na thoni: kush i vazhdon sot pagesat e një afere kriminale? A i vazhdojnë këta të dy, që janë në kërkim, apo ata

që janë në burg? Jo, i vazhdon vullneti politik i Edi Ramës, i vazhdon qeveria e Edi Ramës. Është kjo qeveri që i vazhdon sot pagesat dhe ky Kryeministër që i vazhdon sot pagesat, i cili duhet të jetë prezent për ato para që vazhdojnë të vidhen edhe në këto sekonda që ne flasim. Arben Ahmetaj në arrati nuk vazhdon t'i paguajë inceneratorët; Lefter Koka në burg nuk vazhdon t'i paguajë inceneratorët; ai që vazhdon t'i paguajë inceneratorët është Edi Rama.

Nëse ne nuk e trajtojmë ashtu siç është: një grup i strukturuar kriminal, që quhet Këshilli i Ministrave, dhe një kryetar grupi, që quhet kryetar i Këshillit të Ministrave dhe Kryeministër, Edi Rama, atëherë ne fshihemi pas të vërtetave dhe thjesht çojmë disa koka turku në burg, të cilët, shumë mirë, le të jenë atje, krijoni edhe atje një grup parlamentar dhe një shoqatë bashkie. Ky parlament deri më sot është me një dhomë, por, nëse doni ta bëni me dy dhoma, një senat në burg dhe një dhomë këtu, që të diskutojmë, atëherë hajdeni të bëjmë një reformë kushtetuese!

Edi Rama e ka detyrim para qytetarëve, e ka detyrim para këtij parlamenti që të vijë këtu dhe të vërë fytyrën, siç ka vënë firmat fap e fap në milionat që merrte, duke filluar me atë të parin dhe të tjerët që fshihen pas kësaj afere. Nuk ka mundësi që një Kryeministër të mos dijë çfarë bën zëvendëskryeministri, çfarë bëjnë ministrat apo çfarë bëjnë drejtorët.

Kur i lexova Kryeministrit në komisionin hetimor për inceneratorët aktakuzën e SPAK-ut për Lefter Kokën dhe i thashë se ka thënë: "Vepro në bashkëpunim", iku, sepse bashkëpunimi ishte me vetë atë.

Shumë faleminderit, zonja Kryetare!

Lindita Nikolla – Zoti Berisha, për procedurë!

Sali Berisha – Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Zonja Kryetare,

Unë mendoj se për një shef ekzekutivi nuk mund ketë ngjarje më të rëndë, nuk mund të ketë ngjarje me amorale sesa arratisja e zëvendësit të tij. Ky është standardi më i ulët që vendos një zyrtar, standardi më i neveritshëm, më poshtërues për një shoqëri dhe Edi Rama kërkon të fshihet pas sharjeve, pas shthurjes së gojës të bashkëpunëtorëve të Arben Ahmetajt në këtë krim.

Ju nuk ju nderon fakti që nënkryetarja e parlamentit shthur gojën në mënyrën më të papranueshme ndaj një deputeti dhe nuk mbani qëndrim. Merrni, shpërndani të gjithë banalitetin dhe vulgaritetin e qëndrimit të saj. Nuk ka përdorim më të keq të atij vendi aty, sesa ky që bëni sot. Nëse ajo zonja lëshon gojën, ajo vetë duhet të dalë jashtë. E bëri se nuk e kontrolloi dot veten apo e bëri nga zemërimi është puna e saj, por nuk iu tha asgjë jo e vërtetë, ajo e ka emrin në dy inceneratorë, pa diskutim.

Së dyti, çdo institucion duhet të ruajë disa standarde minimale për t'u quajtur i tillë. Unë disaprovoj qëndrimin tuaj, sepse ajo nuk mund të ishte kurrë në atë komision, ajo s'mund të votonte kurrë në komision, përveçse në bodrumet tuaja; ajo ose duhej të tërhiqej vetë, ose duhej të zëvendësohej nga ju.

Së treti, unë e thashë jashtë, po e them edhe këtu, ju deklaruat këtu se jeni njoftuar ditën e hënë. Prokuroria ka deklaruar se e ka dërguar në parlament ditën e premte. Unë, në këtë rast absolutisht besoj prokurorinë, se prokuroria nuk mund të bëjë një gënjeshtër të tillë, por prapë, për të mos thënë se ju jeni bashkautorë, dhe mund të jeni, s'e përjashtoj, ju duhet të nisni një hetim brenda parlamentit. Kush janë ata që të fshehën ty, nëse është siç thua ti, nëse është siç thoni ju, kush janë ata banditë që fshehën kërkesën e prokurorisë? Çfarë po ndodh? Edi Rama fshihet, Arben Ahmetaj ia mbath. Komisioni përbëhet nga njerëz që kanë konflikt interesi. Pse do të shtyhej...

Lindita Nikolla – Kaluat një minutë, zoti Berisha.

Sali Berisha – Më fal, një minutë!

Prandaj, thirre Edi Ramën të vijë këtu, e ka pasur zëvendës, ia ka besuar të gjitha; ata kanë ndarë së bashku pará dhe çdo gjë, dhe të japë llogari sot. Pra, ta bëjmë seancën siç është.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Felaj keni fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ermonela Felaj – Unë do ta marr fjalën për replikë, si një replikë me të gjithë ata që guxojnë ta përdorin pozicionin e deputetit për të nxjerrë frustrimin e tyre gjatë gjithë kohës.

Unë, po, jam Ermonela Felaj, dhe askush në këtë sallë nuk më bën dot moral as për fjalët dhe as për qëndrimet. Qëndrimet e mia janë të

shprehura e zeza në të bardhë. Kush do t'i lexojë, le t'i lexojë.

Parafolësi i ka bërë jehonë më shumë se një herë, por njihet që është gënjeshtar; njihet edhe për kopjet, se si ia marrin dhe ia shpërndajnë fjalën. Kaq për ditën e sotme.

Ndërkohë, për të gjithë ata kolegë që shpifin, gënjejnë dhe gënjejnë, në fakt, mua duhet të më vinte keq, sepse janë të frustruar, por sot nuk më vjen keq, sepse i meritojnë një për një të gjitha ato cilësime që unë shpreha pak më parë.

Lindita Nikolla – Andia Ulliri e ka fjalën.

Të përgatitet zoti Petrit Vasili.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vijojmë.

Zonja Ulliri fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qetësohu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Uluni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rregullorja i ka përcaktuar procedurat dhe rastet se kur merren masa disiplinore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ulliri fjala për ju.

Andia Ulliri - Zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Ne sot jemi përballë faktit që ky parlament po funksionon në një mënyrë abuzive me standarde të dyfishta, të trefishta, të katërfishta, ku ne përballemi me gjuhën abuzive dhe ofenduese të kolegëve të mazhorancës, të cilët asnjëherë nuk i dalin përpara përgjegjësisë dhe nuk përgjigjen për ato që thonë.

Për më tepër, sot, kur flitet me termat e shtetit të së drejtës dhe ne duhet të japim mbështetjen me heshtje, mua kjo më duket shumë qesharake. Shteti i së drejtës nuk është ky për të cilin flasim ne sot, por është ai shtet që sjell përpara përgjegjësisë njerëzit që kanë abuzuar me pushtetin, të cilët korrupsionin e kanë pasur kryefjalë të fushatës së veprimtarisë së tyre parlamentare, ose jo. Shteti i së drejtës nuk mbështetet me heshtje, shteti i së drejtës mbështetet me akte. Aktet janë duke filluar nga pranimi i propozimit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për ndryshimin e rendit të ditës, për të sjellë përpara përgjegjësisë të gjithë ata kolegë që sot po i zbrazin karriget e tyre. Mendoj se ky precedent duhet të ishte vënë, këto karrige duhet të ishin bosh. Dhe gjatë diskutimit të pikës së parë të rendit të ditës, që ju keni caktuar për raportin e KQZ-së, do të doja që dikush nga ju të merrte përsipër, të dilte këtu dhe të fliste për mbështetësit e listave të Partisë Socialiste, për listat e Partisë Socialiste, për të treguar se cilët janë këta persona dhe të përballen me përgjegjësinë, në mënyrë që të mos sjellim në parlament figura të denigruara, por që vërtet të vendosim një standard të ri për shtetin e së drejtës.

Ju lutem, kur të flisni me këto terma, duhet të pastroni gjuhën tuaj, duhet të flisni me etikë dhe me integritet, sepse korrupsioni po kundërmon në të gjithë sallën.

Faleminderit!

Linidita Nikolla – Fjalën e ka zoti Vasili.

Po i lexoj edhe një herë emrat e deputetëve që do të marrin fjalën për procedurë: zoti Nallbati, zoti Likaj, zoti Balla, zoti Bardhi, zoti Alizoti, zonja Vokshi, zoti Baçi dhe zonja Spiropali.

Petrit Vasili – E nderuar zonja Kryetare,

Sot po bëjmë këtë debat, besoj anormal për mënyrën se si po trajtohet, sepse po bashkëjetojmë me dy realitete. Ka një merak të madh për të mos e bërë procedurën, për të mos e pasur Kryeministrin, për të mos diskutuar për këtë aktualitet, por, ndërkohë, këtu në sallën e parlamentit është thirrur me urgjencë një mbledhje e Komisionit të Ligjeve, që ta mbarojmë sa më parë ligjin e kanabisit. Pra, brenda javës kemi një deputet me një bandë që kryen një veprim rrugaçërie të përsëritur, një zëvendëskryeministër dhe deputet njëherësh, atje ku ishte, dhe një kryetar bashkie që sapo ka lënë detyrën në Fushë Arrëz; sot, të gjithë kanë pasur poshtë të njëjtën firmë që u ka dalë zot, firmën e Edi Ramës. Për këtë ne hapim librat e procedurave, ndërsa për kanabisin ecet me një shpejtësi rrufeje të jashtëzakonshme. Kujt nuk i pret puna për kanabisin, kur priti 10 vjet? Si mund t'ua thoni shqiptarëve? Të gjitha këto gjëma tregojnë se kemi një qeverisje të shpartalluar moralisht, politikisht dhe ligjërisht dhe ndërkohë, është merak i madh se mos vonohet ndonjë ditë premtimi që u është dhënë atyre, që t'u zbrazen magazinat e kanabisit. E para.

E dyta. E kam thënë dhe po e them: boll me historinë që parlamenti është prona juaj, nuk është prona juaj. Ju keni pronë vetëm momentin e votimit, ku ka një mazhorancë dhe një minorancë.

Në këtë sallë, ju dhe ajo zonja, që e ka drejtuar jo pak herë parlamentin, keni pasur

kurajën të merrni një seri të pafundme masash ndëshkimore. Bashkë me të tjerët edhe unë kam qenë pjesë e këtyre ndëshkimeve. Po si ka mundësi që keni kaq shumë kurajë sa të përdorni dy standarde? Ç 'është kjo kurajë e vdekur, që për një skandal që bëhet, për një ofendim kaq mizerabël në sallë, nuk guxoni as të hiqni vërejtje? Ndërkohë, të tjerët janë nxjerrë me forcë nga salla e parlamentit. Çfarë do të thotë kjo? Është prona juaj? Çfarë do të thotë ky standard? Do të thotë që nëse një ditë, po të mos jeni ju, ata që do të kenë shumicën (e këtij vendi) të bëjnë të njëjtën gjë?! Ky është standardi?! Po ju për një ngritje zëri nga vendi keni tundur dynjanë, keni dhënë vërejtje pas vërejtjesh dhe keni futur Gardën në sallë. Përse nuk keni kurajë ta mbani këtë standard? Apo është ideja: "E kemi ne parlamentin dhe nuk ka asnjë problem"?

Megjithatë, zonja Kryetare, po jua them përsëri: vendosni standardin e kërkimit të llogarisë për qeverisjen, mos vendosni standardin e kanabisit!

Sot shqiptarët e dinë që nuk jepet llogari për një hajdutëri shtetërore, për një rrugaçëri apo për një vjedhje të paparë, ndërkohë meraku i madh është që kanabisi të kalojë me shpejtësi. Vriteni këtë standard, sepse është në të mirën e shqiptarëve, por më shumë në të mirën tuaj!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Nallbati.

Bledion Nallbati – Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë e kuptoj që halli i madh ju ka zënë, gjylja e madhe plasi dhe ju nuk keni çfarë të bëni, veçse të përpiqeni të mbroheni, ashtu siç keni bërë gjithë këto vite, kur opozita denonconte këtë aferë, ju të gjithë me radhë, keni dalë dhe e keni mbrojtur këtë aferë dhe keni kundërshtuar opozitën. Sot që këto akuza vijnë zyrtarisht përpiqeni t'u shpëtoni, duke bërë pirueta me Kushtetutën dhe Rregulloren. Unë ju garantoj se as piruetat, as gjuha fyese dhe joetike ndaj kolegëve, nuk ju shpëtojnë dot. Ndaj ju ftoj, ju dhe të gjithë deputetët e mazhorancës: ruani një minimum dinjiteti; pranoni kërkesën e opozitës për të ndryshuar rendin e ditës; fusni me urgjencë vendimin për të diskutuar raportin për heqjen e mandatit të zotit Ahmetaj, për t'i dhënë autorizimin prokurorisë që të bëjë arrestimin dhe kontrollin e banesës së tij. Mjaft kohë i dhatë për të pastruar provat. Po ta kishit kaq merak, në ditët që i kanë ngelur, kishit shkuar të gjithë si grup parlamentar me punë vullnetare, ia kishit pastruar shtëpinë dhe nuk do të kishit nevojë për më shumë kohë. Futni me urgjencë ndryshimin e rendit të ditës dhe të vazhdojmë të procedojmë, duke i shërbyer drejtësisë, ashtu siç e propagandoni ju. Drejtësisë i shërbehet duke iu hapur rruga autorizimit, që Prokuroria të vazhdojë punën e saj.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Likaj.

Ramadan Likaj – Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë jam dakord me të gjithë parafolësit. Po bëhen gati 2 orë që vazhdon të bëhet replikë dhe kundër-replikë, ndërkohë që seanca nuk po vazhdon punën e saj normalisht.

Është bërë një kërkesë e ligjshme nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, që Kryeministri i Shqipërisë të jetë në këtë sallë për të thënë fjalën e tij për këtë aferë të jashtëzakonshme, të cilën mund ta quaj "afera e shekullit", sepse ne si deputetë dhe në mënyrë të veçantë të gjithë qytetarët shqiptarë i kanë sytë te ky parlament, për të dëgjuar se çfarë thuhet, se çfarë flitet dhe për të ditur se cilët janë të korruptuarit e tjerë që nuk kanë dalë akoma në skenë. Ndërkohë, këtu vazhdojnë pafund diskutimet koti dhe ti thua: "Rendi i ditës".

Po si mund të ketë rend dite në një vend të tillë demokratik, me situatën në të cilën ndodhemi sot, me gjithë këtë aferë? Ndërkohë, ju thoni: "Rendi i ditës". Kjo është e papranueshme.

U bëj thirrje të gjithë kolegëve: ne nuk duhet të pranojmë në asnjë moment të vetëm në këtë parlament, që seanca të vazhdojë me rendin e ditës, pa u marrë në shqyrtim kërkesa e Partisë Demokratike. Kjo është rruga e duhur. Kjo është rruga që shqiptarët presin për zgjidhjen e këtij problemi. Le t'i hapim rrugën një herë e mirë prokurorisë, që të vazhdojë rrugën që ka nisur, me qëllim që kjo aferë të marrë goditjen e merituar.

Ndaj për ofendimet që vijnë pa fund nga ana e mazhorancës, ju lutem, jepni emra nëse keni. Mos u merrni me opozitën në tërësi, sepse ne nuk jemi hajdutë. Ne kemi ardhur të japim kontributin tonë të ndershëm, pa asnjë lloj afere. Absolutisht, ne nuk mund të qëndrojmë të heshtur për gjithë këto gjëra që po ndodhin në këtë vend.

Është në nderin tuaj si Kryetare e Parlamentit që ta merrni në shqyrtim kërkesën, ta ndryshoni rendin e ditës, të vijë Kryeministri dhe seanca të vazhdojë normalisht.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare, kemi humbur ekzaktësisht 2 orë kohë nga momenti kur ne kemi paraqitur një kërkesë procedurale. Minimalisht keni detyrimin të na informoni se çfarë masash keni marrë. A keni komunikuar apo jo, me Kryeministrin? A ka ardhur nga Himara, apo jo? Unë e kuptoj se është lodhur shumë këto 2 ditë, ndaj ka marrë helikopterin për të shkuar me pushime në Himarë. Ju lutem, a keni komunikuar? A ka ndonjë sens përgjegjësie ky njeri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ne e dimë që nuk ka asnjë sens përgjegjësie, por, a do të vazhdojë gjithë jetën duke u fshehur pas rrahmanëve, pas arbenëve dhe pas ermonelave? Nuk shtyhet gjatë kështu.

Ju lutem, për të zhbllokuar seancën, komunikoni me Kryeministrin. Merrni 5 minuta kohë, merreni guximin, se nuk është një gjë kaq e madhe, komunikoni me Kryeministrin dhe kërkojini të vijë në seancë. Dhe na e përcillni përgjigjen e tij, që të dimë se cili është qëndrimi i tij. Përse ka frikë të përballet me të dyja çështjet? Përse fshihet sa herë që ka një skandal?

Lindita Nikolla – Zoti Bardhi, qetësohuni dhe mos na jepni detyra si Kryetar i parlamentit, apo nuk e di se çfarë.

Dhe e dyta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, rri i qetë. Nëse vetë je mësuar t'i marrësh detyrat me sms, ta dish që këtë nuk e bëjnë të gjithë, por mund ta bëni vetëm ju.

E dyta. Jeni ju që po e mbani 2 orë parlamentin zvarrë me diskutime dhe me kërkesa për procedurë pafund.

Fjalën e ka zoti Tomor Alizoti.

Tomor Alizoti – Të nderuar kolegë,

Mendoj se një nga skandalet më të mëdha është edhe ky i sotmi, sepse Shqipëria është republikë parlamentare dhe shteti në nocionin e tij ka 3 elemente, të cilat janë: morali (virtyti), etika dhe forca.

Unë mendoj se këtij shteti, këtij parlamenti i ka humbur çdo element morali, vlere dhe i ka mbetur vetëm forca. Parlamenti nuk mund të jetë pronë e një grupimi, dhe një grupim tjetër të injorohet totalisht. Gjithsesi, kthehen në elemente.

Është amorale që numri dy i qeverisë, i dyti i shtetit, njeriu më i rëndësishëm (këtu hyj që në themelimin e shtetit, që kur është krijuar njerëzimi, bazike në themelin e tij ka moralin), të arratiset dhe të arratiset në këtë lloj mënyre.

Në çdo lloj gjykate, në çdo lloj sistemi drejtësie është e shkruar se ligji është i barabartë për të gjithë. Ligji në këtë vend nuk ka qenë kurrë i barabartë për të gjithë. Nëse sot qelitë e Shqipërisë janë mbushur me njerëz, janë mbushur me minorenë, janë mbushur me hallexhinj, duhet që edhe njeriu i dytë i shtetit shqiptar të përballej atje, si një burrë, për hir të etikës së tij, për hir të etikës së shtetit shqiptar, të parlamentit shqiptar dhe të Partisë Socialiste, që është një parti e madhe, të cilën unë nuk e kam dashur dhe nuk do ta dua ndonjëherë, por është pronë kombëtare, ndaj duhet të dalë dhe të përgjigjet.

Po ju flas sinqerisht, si një qytetar. Ky është një vend shumë i varfër, por bëhet fjalë për një shumë rreth 430 milionë euro. Si mund t'ua shpjegojmë ne 430 milionë euro jetimëve shqiptarë? Si mund t'ua shpjegojmë emigrantëve shqiptarë që janë mbytur në det? Si mund t'ua shpjegojmë mbi 500 mijë emigrantëve që janë në Greqi, e qindra e mijërave në Itali? Zëvendëskryeministri i Shqipërisë ka frikë të vijë dhe të përballet në parlament, aq më keq edhe Kryeministri i Shqipërisë.

Zonjë e nderuar, unë mendoj se parlamenti shqiptar, pozitë dhe opozitë, shoqëria shqiptare në sytë e mi është e tëra në krizë. Ju të gjithë, socialistë e demokratë, kushdo qofshi, duhet të mbani dinjitetin tuaj, sepse jeni të votuar nga njerëzit tuaj, dhe ai zotëria, i cili ka qenë në kohërat më të rëndësishme: në krizën e pandemisë dhe në krizën e tërmetit, duhet të ketë kurajë, sepse njeriu në këtë jetë nuk është i përjetshëm, gjithsesi ka një emër, një identitet dhe një etikë. Ju lutem, për hir të Shqipërisë, ai bashkë me Kryeministrin duhet të vijnë këtu, ndryshe ky vend nuk ka asnjë tipar shtetformues! Ky është një vend, i cili kandidon që të jetë pjesë e BE-së. Vetëm një zëvendëskryeministër është arratisur, mbase një pjesë e madhe nuk e dinë, Bashar al-Assad-it i është arratisur zëvendëskryeministri, i cili ka shkuar në Emiratet e Bashkuara. Zëvendëskryeministri i Shqipërisë ka ikur dhe kjo është në turpin e tij, por ne të gjithë si parlamentarë shqiptarë nuk mund ta mbajmë turpin e tij. Ai duhet të jetë këtu.

Ju falënderoj dhe shpresoj që të reflektojmë të gjithë dhe ta mbyllim sa më shpejt këtë turp që na ka zënë!

Lindita Nikolla – Zonja Vokshi, fjala për ju.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Ne kemi bërë disa kërkesa konkrete. E para, zoti Bardhi ka dorëzuar një kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës. Pse nuk e kaloni në procedurë? Zbatoni Rregulloren. Pse hezitoni? Po e shkelni me të dyja këmbët Rregulloren, dhe këtë e keni bërë në mënyrë sistematike.

Së dyti, është bërë një kërkesë tjetër legjitime, ku kërkohet që këtu të vijë sot Kryeministri Edi Rama, sepse nuk mund të ketë asnjë çështje tjetër më të rëndësishme për t'u diskutuar sot në parlament sesa çështja e inceneratorëve, e cila është një nga skandalet më të mëdha të kësaj qeverie, e cila nuk mund të ketë emër tjetër përveçse një qeveri hajdute. Kjo qeveri drejtohet nga hajdutë dhe është qeveri hajdute. Kjo është qeveria më e korruptuar, jo vetëm në rajon, por edhe në Europë.

Kam një pyetje për ministren e Financave: sa miliona shkojnë çdo ditë, sot që ne flasim, për këta inceneratorë fantazmë? Sa miliona në ditë shkojnë nga taksat tona, nga taksat e shqiptarëve, për pagesat e kësaj organizate të strukturuar kriminale, ku pjesa më e madhe e tyre janë në kërkim ose janë arratisur? Ndaj kjo çështje duhet diskutuar sot, dhe nuk mund të ketë asnjë çështje tjetër para kësaj.

E treta, të gjithë deputetët e opozitës kemi bërë një kërkesë që ju të merrni masa, bazuar në Rregullore, për përjashtimin e deputetes dhe nënkryetares së Kuvendit, zonjës Ermonela Felaj. E keni bërë pis këtë parlament, e keni bërë që nuk shihet më! Sot të gjithë qytetarët shqiptarë janë duke e parë parlamentin. Sot të gjithë presin se çfarë do të ndodhë dhe se çfarë do të diskutohet; a do të futet në rend të ditës miratimi i raportit për heqjen e mandatit, por ju nuk guxoni ta ndryshoni rendin e ditës, sepse ju i merrni urdhrat me sms.

Unë i bëj thirrje çdo deputeti të mazhorancës të distancohet nga kjo qeveri hajdute; qeveri që sot duhej të kishte rënë, sepse ish-numri 2 është në arrati. Sot çdo socialist i ndershëm duhet të distancohet nga kjo qeveri e korruptuar dhe hajdute. Ju lutem, futini në rendin e ditës tri kërkesat tona, përndryshe nuk mund të ketë vijim normal të seancës së sotme!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Luan Baçi, fjala për ju.

Luan Baçi – Radhën për të folur e kisha shumë më shpejt, por nuk e di pse gjithmonë më harroni, nuk arrij ta kuptoj. Gjithsesi, ju kërkoni që sot të kemi një seancë normale dhe të vazhdohet sipas procedurës, por mendoj se kjo seancë do të ishte normale nëse do të zbatohej kërkesa me shkrim që ka bërë opozita për ardhjen këtu të Kryeministrit. Kjo kërkesë është në bazë të Rregullores. Nuk e kuptoj se çfarë e pengon Kryeministrin të vijë sot këtu për të zhvilluar një "seancë normale" për problemin që ka ndodhur. Nuk besoj se duhet t'ju kujtojmë që ndodhia, pra urdhër-arresti për zëvendëskryeministrin dhe largimi i tij, nuk është një ngjarje e zakonshme që nuk përbën lajm, por, mbi të gjitha, është përgjegjësi e këtij parlamenti.

Gjithashtu, zonja Kryetare, ju kujtoj se shpeshherë në këtë parlament janë marrë me dhjetëra masa, sidomos për deputetët e opozitës, për një bllokim 5-minutësh të foltores apo për një ngritje të vogël zëri dhe për këto ka pasur përjashtime për ditë e me javë të tëra. Në fakt, shikoj që përdoret një standard i dyfishtë për sjelljen që bëhet nga deputetët e mazhorancës. Dikush nga deputetët e mazhorancës, të më falin qytetarët, në qoftë se më dëgjojnë në këto momente, përdori edhe fjalët "Na çanë trapin!" Ne nuk kemi ardhur këtu "për të çarë trapin" e askujt nga deputetët e mazhorancës; ndonjëri që mund ta ketë zanat, mund ta kërkojë gjetkë. Ky fjalor është i papranueshëm këtu në parlament! Ju kërkoj shumë ndjesë ju, zonja të nderuara të këtij parlamenti, edhe të gjitha zonjave që dëgjojnë në të gjithë Shqipërinë! Kjo është e pafalshme!

Zonja Kryetare, ngrihuni në lartësinë e detyrës! Pavarësisht se ata janë deputetë të mazhorancës, ju duhet të merrni masa për ta, se nuk jeni thjesht Kryetare e mazhorancës, por jeni Kryetare e këtij Parlamenti!

Problemi i inceneratorëve është një problem shumë i madh. Tashmë është bërë publike në të gjithë Shqipërinë mega-afera me miliona euro që ka ndodhur ndonjëherë në një vend të varfër, siç është Shqipëria. Inceneratorët nuk funksionojnë. Më lejoni t'ju them se jo më larg se dje në Grabjan të Lushnjës kanë dalë të gjithë banorët e zonës, duke bllokuar mjetet e mbetjeve urbane të Bashkisë së Lushnjës, të cilat i depozitojnë në kanale, në gropa dhe në fusha në mënyrë të

paautorizuar. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në Azotikun e Fierit, ku mbetjet urbane depozitohen fshehtazi natën. Pra, duke parë këtë gjendje shumë alarmante, e cila mund të konsiderohet një emergjencë mjedisore, edhe falë hetimit të SPAK-ut, por me ndihmën e opozitës, e cila prej vitesh e ka denoncuar këtë aferë korruptive, punët janë vënë disi në vijë.

Do t'ju lutem sërish ta zbatoni në mënyrë të barabartë Rregulloren e Kuvendit, siç e meritojnë të gjithë deputetët!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Ju lutem, të njëjtën kërkesë kam edhe unë, për të zbatuar Rregulloren e Kuvendit! Shikoni Rregulloren e Kuvendit për mënyrën se si operohet për kërkesat që ju bëtë dhe t'i respektojmë të gjithë!

Fjala për ju, zonja Elisa Spiropali.

(*Ndërhyrje pa mikrofon nga salla*)

Edhe ju folët dy herë.

(*Ndërhyrje pa mikrofon nga salla*)

Është ministre.

Elisa Spiropali – Kolegë,

Ne i jemi drejtuar shumë shpesh njëri-tjetrit me batare fjalësh, përgjigjesh e replikash. Këto nuk na mungojnë.

Sot, sinqerisht, dua t'ju them se ajo që ju përsërisni tani pa pushim, nga njëri tek tjetri, për procedurën, për etikën në këtë Kuvend, shkelet me të dyja këmbët dhe përdhoset, më së pari, nga ju dhe, mbi të gjitha, nga ju.

Dua t'ju them se, sipas Rregullores së Kuvendit, nuk mund ta quash tjetrin "hajdut", nuk mund ta quash tjetrin "kriminel", nuk mund ta quash qeverinë e vendit tënd "strukturë kriminale", nuk mund t'i tregosh me gisht deputetët, kolegët, me të cilët këtu në Kuvend zihesh e grihesh duke i quajtur "kriminelë" dhe "hajdutë", por në kafen e parlamentit u drejtohesh me mirësjellje, me respekt e me shaka.

Të dashur deputetë, kjo quhet hipokrizi e një niveli olimpik. Nëse doni të na tregoni neve, apo të na tregoni me gisht për çështje të etikës, pa mikrofon, reflektoni për ato që thoni ju në mikrofon, kur i drejtoheni jo vetëm kësaj salle, por të gjithë qytetarëve shqiptarë, të gjithë shoqërisë shqiptare, të rinjve të këtij vendi, që te parlamenti i tyre duhet të shikojnë reflektimin e një përgjegjësie të lartë, duhet të shikojnë përfaqësuesit e tyre që debatojnë për çështje të rëndësishme, pse jo, që tregojnë edhe gishtin për politika, por nuk i shpallin njerëzit "kriminelë" pa procese gjyqësore.

Ne kemi reminishenca të theksuara të sistemit të kaluar, kur gjyqi, jo vetëm i individëve, jo vetëm i politikanëve, por edhe i qytetarëve në fshatin më të largët, bëhej ende pa u mbledhur trupa gjyqësore. E kemi bërë edhe ne, patjetër, si reflektim të këtij debati të sëmurë. Ky debat nuk prodhon asgjë.

Ne ju sfidojmë në raportin tonë me drejtësinë; ne ju sfidojmë në standardin tonë për t'i shqyrtuar kërkesat për të cilat ju folët, nga Prokuroria e Posaçme, në kohë rekord. Rregullorja dhe Kushtetuta japin afate, japin garanci 2 javë, ndërsa ne i kemi përfshirë, i kemi diskutuar në kohë rekord dhe, në momentin kur e kuptuat se ne nuk jemi barrierë për askënd, për t'u mbrojtur pas imunitetit apo pas partisë, filluat sërish sulmet, edhe pse ne garantojmë hetim të plotë, sepse nuk mbrojmë askënd, as publikisht, as me procedurë, as në Këshillin për Mandatet, as në seancë, as me votë, askund! Ky është standardi ynë.

Turp është të kesh mbajtur në detyrë ish-drejtorin e Tatimeve me masë sigurie "arrest"; turp është të kesh mbrojtur gardistët kur kanë vrarë në bulevard dhe të mos i japësh prokurorisë të drejtën të hetojë; turp është ta kesh quajtur Kryeprokuroren ashtu siç dini ju t'i quani njerëzit kur ju dalin përballë; turp është të vrasësh; turp është të kesh hedhur në erë 27 njerëz dhe të mos përballesh kurrë me drejtësinë, por të dalësh krenar e të ndërtosh fabrika boronicash në vendin e krimit! Turp janë të gjitha këto. Turp nuk është të qëndrosh përballë drejtësisë dhe të japësh votën që të hetohen të gjithë, nga i pari tek i fundit, nga të gjitha kahet e politikës, dhe dosjet të mos flenë aty.

Të mos merret për dobësi qytetaria jonë, të mos merret për dobësi respekti që ne kemi ndaj ligjit, por të hetohen të gjithë, edhe ata që i bëjnë presion drejtësisë nga mëngjesi në darkë. Patjetër që kanë të drejtë ta quajnë "skap" për sa kohë nuk i ka kapur e t'i çojë aty ku e kanë vendin.

Lindita Nikolla – Zoti Noka, fjala për ju.

Flamur Noka – Zonja Ministre na sfidoi, por unë do ta pyes: e para, zonja Ministre, e njeh Salarjon Totajn?

E dyta, mos vallë e ka emrin në dosjen e inceneratorëve si negociator për t'i dhënë Mërtirit tenderin e Fierit?

E treta, zonjë, ne këtu jemi deputetë të zgjedhur për të përfaqësuar dhe për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve. Zëvendëskryeministri i zonjës që foli, tani është kapur duke vjedhur. Ne nuk jemi votuar për këtë gjë.

Zonjë, në dosje nuk është vetëm zëvendëskryeministri, por edhe burri i zonjës, edhe zëvendëskryetarja e Kuvendit, janë edhe një tufë ministrash, është e gjithë qeveria. Si quhet kur janë kapur të gjithë duke vjedhur? Quhet "organizatë kriminale"!

Kjo është arsyeja pse Kryeministri nuk guxon të vijë këtu sot. Çfarë duhet të kishte ndodhur në këtë vend, që Kryeministri të vinte për të dhënë llogari? Në vende të tjera qeveria jep dorëheqjen kur një titullar i nivelit dytësor kapet në një skandal. Po këtu?!

Cili është misioni i një qeverie në një vend demokratik? Cili është misioni i kësaj organizate kriminale, ku janë të gjithë të zhytur në vjedhje dhe në krim? Misioni nuk është për të qeverisur, ne e kuptojmë. Me këtë që po bëni sot, ju po u jepni një mesazh shqiptarëve: që misioni juaj është të vidhni, të vidhni dhe vetëm të vidhni, dhe nuk ka qenë asnjë ditë mision për të qeverisur, se ju nuk keni lidhje me qeverisjen, ju thjesht kacavirreni pas qeverisjes për t'i vjedhur shqiptarët. A ka turp më të madh?! Nuk besoj se ka turp më të madh, kur jeni kapur duke vjedhur, jeni kapur në krim, të zhytur në korrupsion, dhe këtu, në vend që të ulni kokën, qeshni dhe na sfidoni! A ka gjë më të neveritshme? Shqiptarët ju shohin, mos kujtoni se shqiptarët e fusin kokën si struci në rërë, siç e fusni ju kur kapeni duke vjedhur. Jo, shqiptarët e dinë që ju duhet të shporreni, jo të largoheni, se nuk keni asnjë lidhje me shqiptarët. Ju keni lidhje me barbarët, se jeni hajdutë, jeni barbarë dhe të inkriminuar kokë e këmbë; barbarë dhe asgjë më tepër!

Lindita Nikolla – Zonja Spiropali, keni fjalën.

Elisa Spiropali – Më vjen shumë mirë që ka mësuar kuptimin e fjalës "barbar", por mësymjet këtu në Kuvend nuk i bëjmë ne.

Sa i takon raportit që do të vijë pas pak për zgjedhjet, besoj se nuk ka sqarim më të bukur, nuk ka arsye më të fortë se pse ju i humbni zgjedhjet çdo herë, çdo dy vjet, nga fakti që ju gënjeni në mënyrën më trashanike të mundshme. Ju jeni aq larg të vërtetës, sa të gjitha shpifjeve, sado trashanike të jenë, ju prapë u përgjigjeni.

Unë nuk kam përgjigje për të dhënë, sepse përgjigjen, zotëri, e ke aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk kam përgjigje, se nuk ka asgjë që të më lidhë as me inceneratorët, as me historinë e procedurave, as më këtë e as me atë, as kurrë, se kjo është shpifja më e madhe që kam dëgjuar në jetën time. Përgjigjen, zotëri, do ta marrësh sa herë të shkosh në zgjedhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ik, ore zotëri!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Të fala të kesh!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkëshorti im ka qenë drejtor i ujësjellësit në vitin 2010 dhe nuk ka asnjë lidhje as në këtë botë, as në atë botë, as në qiell e as në tokë, me inceneratorët. Ju jeni aq i trashë, mund të përdor edhe termin "barbar", saqë nuk e kuptoni se duke i ikur kaq shumë të vërtetës, bëheni kaq të pabesueshëm, sa edhe nëse keni çështje të cilat mund të ngrihen, nuk ju beson më njeri. Mjafton të verifikohet se çfarë pune ka bërë dhe në cilat vite dhe do të kuptoni që jo vetëm ju mungon vërtetësia, por edhe zgjuarsia. Duke bërë bashkë gjëra që nuk kanë lidhje fare, ju dilni ashtu siç jeni, pra njerëz që jo sot, por as për 100 vjet nuk do të qeverisni dot, se me pushtetin keni po aq lidhje sa me të vërtetën.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Balla.

Taulant Balla – Zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk u heq asnjë pikë e asnjë presje atyre që tha zonja Spiropali. Në fakt, e mora fjalën për diçka tjetër. Besoj se të gjithë këtu bashkëndajmë shqetësimin e zhvillimeve të para pak momenteve në Kuvendin e Kosovës. Unë mendoj se ngjarje të tilla nuk duhet të ndodhin as në Kuvendin e Kosovës, as në Kuvendin e Shqipërisë, nisur nga premtimet dhe angazhimet që sapo bëri një deputet i pjesës së fundit të rreshtit të krahut tjetër.

Dua t'u them të gjithë kolegëve deputetë këtu se është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Shqipërisë të vazhdojë punë normalisht. Në rastin për të cilin pretendohet se ka një kërkesë, sqarimi i Kryetares së Kuvendit ishte shterues, dhe e vërteta është se biem të gjithë dakord që edhe vetë kolegët, të cilët ngrihen për procedurë, e dinë fare mirë që Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të përfshijë në procedurë diçka që nuk ka lëndë. Pra,

lënda është në mungesë sot. Sapo të jetë gati raporti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, unë ju respektova!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Raporti i Këshillit po shkruhet dhe do të jetë një material i shkëlqyer, prandaj besoj se kjo çështje tashmë është sqaruar më së miri nga Kryetarja e Kuvendit, si dje, ashtu dhe sot, madje e ka bërë disa herë këtë gjë.

Zonja Kryetare e Kuvendit, grupi ynë parlamentar mezi po pret të bëjë një diskutim pas raportimit të KQZ-së, sepse kemi plot çështje me rëndësi për të diskutuar, duke theksuar këtu edhe nevojën që Kuvendi i Shqipërisë të ecë përpara me reformën zgjedhore, të cilën duhet ta kryejmë si një detyrim.

Faleminderit, zonja Kryetare!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Vijojmë me rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ezaurove procedurën. Ke folur tri herë për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos abuzoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju e sqaruat edhe lëndën, edhe përgjigjen, edhe argumentin, madje edhe ofenduat në prezantimin tuaj, duke thënë "hajdute", "gjobaxhie" e me radhë. Ishit me mikrofon, me zë dhe me figurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani të vazhdojmë me procedurën.

Zoti Bardhi, keni fjalën për herë të fundit për këtë çështje.

Gazment Bardhi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, unë isha duke mbajtur fjalën time në foltore dhe ishte krahu tjetër që ndërhyri. Unë thashë ekzaktësisht të vërtetën siç është, pa asnjë deformim.

Po të doni më shumë të dhëna, zonja Kryetare, unë mund t'jua jap, si dhe pse i përdora ato fjalë.

Për të kaluar nga ai debat, e para, keni lënë pa përgjigje kërkesën tonë procedurale për të thirrur në seancë Kryeministrin. Po jua them se nuk kemi bërë kërkesë as për mocion, as për pyetje, as për debat, kemi kërkuar praninë në seancë të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 47, pika 1, të Rregullores.

E dyta, siç ju jeni në dijeni, zonja Kryetare, edhe me 5 anëtarë të Këshillit, i cilin ka gjithsej 10 anëtarë, mbledhjet konsiderohen të vlefshme, po ashtu edhe vendimmarrja e Këshillit. 5 anëtarët e opozitës në Këshill e kanë dorëzuar raportin, është protokolluar, ju jeni dëshmitarë, u dorëzua dje në sekretarinë e Këshillit, në protokollin e Kuvendit, është firmosur nga 5 anëtarë, dhe kërkesa për të ndryshuar rendin e ditës ka lëndë, madje në kërkesë, po ta lexoni me vëmendje (nuk e di kush jua ka dhënë këtë argument), thuhet: "5 anëtarë të Këshillit, që janë të nevojshëm dhe të mjaftueshëm për të marrë një vendim, kanë hartuar dhe paraqitur një raport për seancën plenare, ku rekomandojmë miratimin e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurisë sipas kërkesës që ka sjellë prokuroria".

Ne nuk i kemi votat për ta ndryshuar rendin e ditës dhe kjo është e qartë, por ju do të duhet të shprehni vullnetin tuaj me votë, që të regjistrohet në këtë parlament që secili prej jush i dha edhe 4 ditë më shumë kohë Arben Ahmetajt për të bërë atë që tha drejtuesi i SPAK-ut, pra për të intimiduar dëshmitarët, për të prishur provat, për të negociuar dorëzimin e kontrolluar me Kryeministrin Edi Rama ose për të humbur gjurmët atje ku ka shkuar. Kjo do të duhet të regjistrohet, që të jetë momenti i turpit të këtij parlamenti, se, nga njëra anë, thoni se po mbështesni drejtësinë dhe, nga ana tjetër, keni një javë që i zvarrisni procedurat, duke e penguar drejtësinë. Ne nuk jemi gjykatë dhe nuk shpallim pafajësi apo fajësi, ne kemi një detyrim, dhe ai është t'i hapim rrugë prokurorisë të bëjë detyrën e vet.

Meqë e mbështesni drejtësinë, se u tha këtu nga 10 kolegë të mazhorancës, kthehemi në vitin 2012, kur PD-ja propozoi heqjen totale të imunitetit për deputetët, dhe ne jemi të gatshëm të ndërhyjmë në Kushtetutë dhe t'ia heqim këtë kompetencë parlamentit, meqë ia kemi dhënë besimin SPAK-ut. Prandaj, merreni edhe ju guximin ta votojmë bashkë dhe ta heqim fare imunitetin e deputetëve, meqë ju jeni ndihmësit e drejtësisë. Keni votuar ju për ta mbajtur imunitetin, ekzaktësisht për ta zvarritur ku duhet ose për t'u sjellë siç u sollët në rastin e Saimir Tahirit, duke ia mohuar kërkesën prokurorisë për të autorizuar arrestimin.

E përfundova, zonja Kryetare, edhe një fjali kam. Ju lutem, hidheni në votë, rrëzojeni, se nuk do t'ju marrim kartonët që të votojmë ne për ju, por të paktën procedurat parlamentare keni për detyrë t'i respektoni qoftë për kërkesën e parë, qoftë për të dytën! Nuk doni ta ndryshoni rendin e ditës? Rrëzojeni me votë, por të shënohet në procesverbal që Lindita Nikolla, Kryetarja e Kuvendit, dhe të gjithë deputetët e mazhorancës i dhanë 4 ditë me shumë kohë Arben Ahmetajt që të intimidojë dëshmitarët, të prishë prova e të humbë gjurmët e vendndodhjes së tij. Duhet shënuar kjo, zonja Kryetare, dhe jo të kalojë me një fjali tuajën, që jua kanë shkruar dhe ju e lexoni, se nuk shkon kështu! Parlamenti ka procedurë dhe Rregullore.

Lindita Nikolla – Nuk është farë ashtu.

Gazment Bardhi – Ke marrë një kërkesë me shkrim. Kolegu Gogu tha që nuk ka kërkesë, përkundrazi, e kemi depozituar kërkesën në përputhje me nenin 31 të Rregullores, është e regjistruar dhe e protokolluar.

Lindita Nikolla – E thatë një herë, mos e përsërisni!

Gazment Bardhi – Po pra, e thamë. Atëherë, hidhe në votim!

Lindita Nikolla – Jo, unë nuk mund të hedh në votim një paligjshmëri.

Gazment Bardhi – Nuk është fare paligjshmëri, paligjshmëri është kjo që bën ti.

Lindita Nikolla – Me qetësi! Po ju tregoj edhe një herë që nuk ka lëndë.

Gazment Bardhi – Ja ku është lënda, ja dhe raporti!

Lindita Nikolla – Në Rregullore thuhet: "Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli, brenda dy javëve, harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit..."...

Gazment Bardhi – Ja ku është raporti me numër protokolli 2183/4!

Lindita Nikolla – Ju lutem tani, mos bëni mbivendosje! Çfarë e keni këtë zakon?!

Gazment Bardhi – Është e protokolluar.

Lindita Nikolla - A ka mundësi të flas unë?

Gazment Bardhi – Po referoj faktet siç janë.

Lindita Nikolla – Mbarove?

Gazment Bardhi – Dakord.

Lindita Nikolla – Atëherë të flas unë.

Në Rregulloren e Kuvendit thuhet: "Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli, brenda dy javëve, harton një raport për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit, për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme, apo kontrollit personal ose të banesës. Raporti i Këshillit u shpërndahet deputetëve". Raporti nuk u është shpërndarë deputetëve, kjo është e vërteta, madje një pjesë e Këshillit po punon me raportin dhe ne vendosëm në mbledhjen e Këshillit që, deri ditën e nesërme, në orën 12:00, të dorëzohet raporti. Ja ku është mungesa e lëndës.

"Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme, apo të kontrollit personal ose të banesës së një deputeti vendoset si pikë e rendit të ditës së seancës pasardhëse, pas paraqitjes së raportit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Pra, pasi është paraqitur raporti, vendoset në rendin e ditës së seancës si pikë e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është shpërndarë raporti, deputetët nuk e kanë marrë atë.

Edhe një herë, nuk ka lëndë. A ka mundësi? Janë dy argumente që nuk ka lëndë.

Argumenti tjetër: "Në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për të dhënë shpjegime ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve". Deputeti nuk është njoftuar për seancën dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...ne nuk mund ta fusim përmes një procedure të parregullt ligjore procesin e drejtësisë në ngërç, për shkak të një papërgjegjshmërie parlamentare që ju po kërkoni.

Kështu që, ne do të vazhdojmë me rendin e ditës.

(Deputeti Bardhi flet nga vendi, pa mikrofon.)

Siç e thashë, nuk mund ta hedhim në votim, sepse nuk ka lëndë.

Vijojmë me raportin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2022.

Zoti Celibashi, keni fjalën. Koha në dispozicion është deri në 20 minuta.

(Debat në sallë)

Zoti Celibashi, fjala për ju.

(Deputeti Bardhi flet nga vendi, pa mikrofon.)

Ju lutem, kolegë deputetë, a ka mundësi të uleni?

Jo, nuk e hedh në votim...!

(Deputetët e opozitës krijojnë zhurmë në sallë.)

Edhe një herë, ju lutem, neni 115 i Rregullores i njeh të drejtën Kryetares së Kuvendit, drejtuesit të seancës, për të interpretuar Rregulloren...

(Deputeti Bardhi flet nga vendi, pa mikrofon.)

...interpretimin e së cilës unë e bëra dhe thashë se nuk mund të ketë votim për një çështje të paligjshme.

(Deputeti Bardhi flet nga vendi, pa mikrofon.)

Zoti Celibashi, ju lutem, e di që është e vështirë, por...

Ilirjan Celibashi – Është pa sens fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem, jo.

(Deputeti Bardhi flet pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Bëjmë pesë minuta pushim.

(Pas pushimit)

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka procedurë, sepse ia kam dhënë fjalën zotit Celibashi më përpara se ta kërkonit ju!

Zoti Celibashi...

Zonja Çupi, jo, ju lutem unë juve. I kam dhënë fjalën zotit Celibashi.

(Deputetja Çupi kërkon fjalën për procedurë, pa mikrofon.)

Të mbarojë zoti Celibashi dhe pastaj do ta merrni fjalën ju.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Po, zonja Çupi.

Dhurata Çupi – ...atëherë, ju e mbyllët këtë moment të mbledhjes, duke thënë që këtu kërkohet përgjegjshmëri. Po, dakord, për përgjegjshmëri po flasim, por a e dini se çfarë ka ndodhur nga ora 12:00 deri në orën 12:10? Për 10 minuta, sepse në orën 12:15 ministrja e Shëndetësisë ishte aty? Janë votuar 45 nene të ligjit "Për kanabisin".

(Ndërhyrje pa mikrofon)

45 nene të ligjit "Për kanabisin" janë votuar në një sallë të fshehtë këtu...

Gazment Bardhi – Në banjat e parlamentit!

Dhurata Çupi – ...pa pasur as procesverbal, as kamera, as regjistrim, ndërkohë që nuk ka pasur as kuorum, sepse një pjesë e anëtarëve të Komisionit të Ligjeve ishin këtu në sallë, ose ulur, ose nëpër sallë. Pra, nuk ka pasur as kuorum...

Foton mund ta bëni tani, por unë po flas që në momentin kur është bërë, nuk ka pasur kuorum.

Janë votuar në mënyrë abuzive 45 nene të ligjit "Për kanabisin", pa kamera, pa regjistrim, pa procesverbal, pa opozitën, pa kuorum, që është më e rëndësishmja, madje më thonë që brenda në votim, përveçse nuk ka pasur kuorum, edhe nga aty ka pasur deputetë që kanë abstenuar ose kanë qenë kundër. Pra, është një ligj i pamiratuar dhe në fshehtësi të plotë!

Ky është një turp dhe papërgjegjshmëri, zonja Kryetare!

Kësaj i thonë papërgjegjshmëri, zonja Kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Celibashi.

(Debat në sallë)

Jua dhashë sqarimin: nuk mund të hedh në votim një kërkesë të pabazuar në Rregullore.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Lexoni nenet 116 dhe 118 të Rregullores!

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Jo, sepse është e pabazuar në ligj!

Jo, sepse deputetëve nuk u është shpërndarë as raporti, as është njoftuar deputeti, kështu që nuk mund të hedh në votim një kërkesë të paligjshme!

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Neni 116 i Rregullores më lejon të bëj interpretimin e saj, ndaj vijojmë...

Po, e përmenda Rregulloren.

Ju lutem! Patjetër, do t'i shohim sipas të gjitha shqetësimeve tuaja.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Jo, nuk e hedh në votim dhe ta sqarova! Mos kërko 100 herë të njëjtën gjë!

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

E sqarova, kërkesa nuk ka lëndë!

Zoti Celibashi, fjala për ju.

(Debat në sallë)

Vijojmë, zoti Celibashi.

Zotërinj deputetë, a ka mundësi të uleni nëpër vende? Tregoni qytetari!

Ju lutem, uluni nëpër vende dhe na lini të vijojmë me seancën!

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Nuk mund të hedh në votim një kërkesë të paligjshme, të pabazuar në Rregullore.

Po, pra. Jo, nuk është e ligjshme dhe nuk e hedh në votim!

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Jo, jo, nuk e hedh në votim, nuk e çoj Kuvendin në një moment paligjshmërie!

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Jo se dëshironi ju, sepse ju mund të dëshironi shumë gjëra. Ne po ndjekim rregullin dhe ligjin për ta bërë këtë një proces drejtësie pa cen, ndërkohë që ju kërkoni ta bëni me cen.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Jo, nuk ndodh, zoti Bardhi. Uluni dhe ndiqeni nga vendi!

Mirë, por uluni në vend tani!

Zoti Celibashi, ju lutem, edhe në këtë zhurmë, nuk kemi ç'të bëjmë, do të vijojmë punën.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Nuk e hedh kërkesën në votim, po ta përsëris 100 herë!

Bëjeni kërkesën siç duhet dhe, po, do ta shikojmë.

Jo, nuk dënoj *apriori* unë, pa pasur faktet.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

A ka mundësi tani të uleni në vend? Ju lutem, uluni në vendin tuaj!

(Debat në sallë)

Ka instrumente Rregullorja që i verifikon. Jo, nuk është vetëm fjala juaj!

Ju lutem!

(Debat në sallë)

Zoti Celibashi, do ta merrni fjalën?

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Bëjmë 5 minuta pushim.

(Diskutime në sallë)

E ke marrë katër herë fjalën për procedurë dhe, ndërkohë, ia kisha dhënë fjalën zotit Celibashi para se ta kërkonit ju.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Të lutem, zoti Bardhi, mos krijo skena të pakuptimta! Nuk ka...

Po pra, të mbarojë zoti Celibashi dhe do t'jua jap fjalën juve për procedurë.

(Deputeti Bardhi ndërhyn pa mikrofon.)

Jo, uluni në vend dhe do t'jua jap unë fjalën për procedurë.

Fjala për ju, për procedurë.

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare, ke tri orë që ke bllokuar seancën plenare me një argument qesharak, që kërkesa e opozitës për të ndryshuar rendin e ditës nuk ka objekt. Madje, ke lexuar 70 nene të Rregullores dhe asnjë nen i saj nuk ka lidhje me të.

Për ju, Rregullorja, në fakt, është ashtu siç një deputet juaji, për turpin e të gjithë mazhorancës, i quajti opinionet e Bashkimit Europian: "paçavure". Pra, ju Rregulloren e bëni paçavure sa herë të doni.

Kur ju kërkojnë grupet kriminale të kaloni me urgjencë ligjin për kanabisin, nuk ka rëndësi për ju Rregullorja.

Në nenin 32, pika 3, të Rregullores, zonja drejtuese e seancës (ju, gardiania e Rregullores, që keni tri orë që bllokoni seancën në emër të Rregullores, por në kundërshtim me Rregulloren) thuhet: "Komisionet e përhershme nuk mund të mblidhen gjatë kohës kur Kuvendi zhvillon punimet e seancës plenare, përveçse me urdhër të Kryetarit të Kuvendit". Keni nxjerrë urdhër ju që të mblidhet Komisioni i Ligjeve për të miratuar ligjin për kanabisin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në cilën pikë të kalendarit të punimeve të Kuvendit është i përfshirë ligji për kanabisin?

Gazment Bardhi - Pra, për grupet kriminale, për shërbime ndaj grupeve kriminale, ju nuk pyesni për Rregulloren, ndërsa për të ndihmuar drejtësinë, për të çuar Arben Ahmetajn një orë e më parë përpara drejtësisë, për ta lokalizuar atje ku ju e keni fshehur, keni 3 orë që e bllokoni Kuvendin në shkelje të Rregullores dhe thoni: "Kërkesa e opozitës nuk ka objekt". Seanca nuk vazhdon dot, zonja Kryetare. Nuk kemi nevojë për raportimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Le të vijë të raportojë këtu për tenderë, se për gjëra të tjera nuk kemi nevojë. Po pati ndonjë raportim për tenderët, le të vijë të raportojë, për gjëra të tjera s'është nevoja fare të raportojë. Seanca nuk vijon, nëse nuk respektoni minimumin e minimumit të të drejtave të opozitës. Kemi paraqitur një kërkesë, të cilën e ke për detyrë ta hedhësh në votim. Rrëzoje, po të them, se i keni votat për ta rrëzuar, por ti nuk mund të injorosh të drejtat kushtetuese që Rregullorja ua garanton deputetëve të opozitës, se parlamenti nuk është pronë juaja. Lekët e buxhetit i keni bërë sikur t'i keni lekët e xhepit tuaj, i shpërndani dhe i ndani milionat sipas shokëve e

miqve, por të drejtat e opozitës nuk i mohon dot, as ti, as Edi Rama, i cili në këtë moment është duke bërë plazh në Dhërmi.

Lindita Nikolla – Atëherë, unë e di që vazhdoni ende dialogun politik dhe doni të fitoni pikë politike.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Patjetër, kjo është detyra juaj. Jua përsërita edhe një herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Jo, nuk e hedh dot në votim kërkesën, pasi është një kërkesë që nuk ka substancë.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Ka dy momente të cilat bien ndeshen edhe me të drejtën kushtetuese, edhe me Rregulloren e Kuvendit: nuk janë njohur deputetët me raportin; nuk është shpërndarë raporti. E para.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Sepse e vendosëm në Këshillin e Mandateve që do të bëhet ditën e premte, në orën 12:00.

E dyta, nuk është njoftuar deputeti. Unë e di që ju kërkoni ta bëni me cen këtë proces, por ne nuk duam ta bëjmë me cen këtë proces. Ne duam t'i japim drejtësisë mundësinë që të bëjë drejtësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Ju e dini fare mirë se dakordësinë për imunitetin e deputetit Arben Ahmetaj e kanë dhënë të dyja palët dhe është lënë që ditën e hënë të bëhet seanca, duke zbatuar të gjitha kriteret që thuhen në Kushtetutë dhe në Rregullore.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Për sa i takon faktit që nuk e hedh në votim, ju them të lexoni nenin 116, pika 1, ku thuhet: "Kur ngrihen pretendime gjatë zhvillimit të seancës plenare lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje, është kompetencë e drejtuesit të seancës për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi". Kaq e thjeshtë dhe qartë është.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Tani, në qoftë se nuk doni ta dëgjoni zotin Celibashi, raporti është dorëzuar, e kanë të gjithë deputetët.

Vazhdojmë me diskutimet.

Faleminderit, zoti Celibashi!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Zoti Toni Gogu, keni fjalën.

(Debate dhe zhurma në sallë)

Ta sqarova.

Pse bën njëqind herë të njëjtën pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Ta sqarova.

Jo, nuk e hedhim në votim kërkesën, sepse është antiligjore. Kaq e thjeshtë është.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Nuk është bazuar në ligj. Nuk mund ta fus Kuvendin në një proces të paligjshëm. Kaq e thjeshtë është.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Patjetër, do ta ndjek. Çështjen për të cilën folët do ta ndjek dhe do ta verifikoj se si është.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Nuk është vetëm fjala juaj fakti kryesor.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

A ka mundësi të vazhdojmë?

(Debate dhe zhurma në sallë)

Zoti Gogu.

Toni Gogu – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Sot ka vetëm një arsye për gjithë këtë skenë të pahijshme për çdo familje shqiptare, për çdo shqiptar: zgjedhjet. Ky zotëria, që sot po bërtet dhe i thotë Kryetares së Kuvendit: "Si po e zbaton ti Rregulloren?", me shumë të drejtë, kur ishte kryetar i statutit dhe i mandateve në Partinë Demokratike e mori dhe e lexoi rregulloren e Partisë Demokratike siç donte vetë. Sot i thotë Kryetares së Kuvendit: "Si e zbaton ti Rregulloren?". Ka vetëm një arsye: këta duan të pengojnë drejtësinë, këta duan të prishin procesin, se e dinë se çfarë po vjen nga pas. Këta e dinë se çfarë po vjen nga pas. Ju doni të prishni procesin.

Rregullorja, që e citoi Kryetarja e Kuvendit, u jep deputetëve dy javë kohë, më jep mua, edhe ty, dy javë kohë, sepse nesër do të vijë kërkesa për ty, zoti Bardhi, dhe ti do proces të rregullt ligjor; do të vijë për padrinon politik, dhe ai do dhe meriton proces të rregullt ligjor, megjithëse, kur ai ishte në detyrë, urdhëronte moszbatimin e urdhrave të prokurorit të Përgjithshëm.

Kështu që, vijmë te kjo e sotmja. Sot këta kanë bërë veprimin më të turpshëm, duke mos e lejuar kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të raportojë dhe t'u thotë shqiptarëve se si kanë shkuar taksat e tyre për organizimin e dy palë zgjedhjeve brenda një afati shumë të shkurtër kohor. Sot këta kanë një standard të dyfishtë, që i bën me turp, sepse më 6 mars thanë se ishin zgjedhjet më të mira, më të drejta, sepse fituan një bashki, "foltorja" fitoi një bashki. Ndërkohë, në zgjedhjet e 14 majit, megjithëse "foltorja" përsëri fitoi 10%, pra 6 ose 7 bashki,

këta thonë se procesi është blerë nga ky, nga ai, madje shkojnë nëpër dynja dhe gjejnë blerës votash. Ndërkohë, sot flet e gjithë Rrogozhina për kandidatin e tyre, se si me paratë e atij burrit, që prej dy vjetësh e mban "Air Albania"-n me qira, mban medien dhe merret me secilin prej nesh që sapo kemi futur këmbët në këtë parlament, një e nga një, sot i ka bashkuar, i ka bërë bashkë.

Zotërinj, lëreni ligjin të sundojë në mënyrë të barabartë mbi të gjithë ne dhe mos e shkelni Rregulloren e Kuvendin!

Kaq kisha.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Tabaku.

Jorida Tabaku - Zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj se do të ishte në nderin e këtij parlamenti të mbulonte trupin që e ka zënë sot qeverinë shqiptare, parlamentin shqiptar, që të votonte për heqjen e imunitetit dhe lejimin e arrestit të ish-zëvendëskryeministrit, ish-ministrit të Financave, ish-ministrit të Rindërtimit, ish-ministrit të Ekonomisë e kushedi sa ish-ë të tjerë, për një aferë së cilës ky parlament i ka dalë për zot.

Sot, në fakt, e gjithë qeveria shqiptare duhet t'u kërkonte ndjesë qytetarëve shqiptarë. Kushdo që është përmendur në atë dosje duhej të ulte kokën me turp e t'u kërkonte ndjesë qytetarëve shqiptarë, sepse u dolën për zot 3 personave në kërkim ndërkombëtar; u dolën për zot 3 personave që sot duhet të jenë para drejtësisë; u dolën për zot 3 ministrave dhe ish-ministrave; i dolën për zot një ish-sekretari të Përgjithshëm; i dolën për zot Këshillit të Ministrave në një aferë korruptive prej 430 milionë eurosh.

Kur unë në komisionin hetimor për inceneratorët thosha se i gjithë shteti është i ngritur në këmbë, nuk e mendoja kurrë se adresa e qeverisë nuk ishte Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", por ishte "Sky Tower, kati 13, zyra 133".

Të nderuar kolegë, a e dini që dokumentet e shtetit janë shkruar të gjitha te Sky Tower-i, në katin e 13-të? A e dini që keni ngritur dorën dhe keni votuar për dokumente që i kanë shkruar biznesmenët? Kur ne flasim për kapje shteti, a ka kapje shteti më të madhe sesa ligjet, vendimet e këshillit bashkiak, sesa përgjigjet e ministrive t'i kthejë një biznesmen që sot është në kërkim ndërkombëtar? Kjo është kapja e shtetit.

A ka kapje më të madhe shteti sesa ish-zëvendëskryeministri të thërrasë kryetarët e bashkive socialiste, një e nga një, në një restorant në periferi të Tiranës dhe t'i detyrojë të gjithë me radhë që t'i japin tenderë Klodian Zotos dhe Mirel Mërtirit? Kjo është kapja e shtetit. Nuk ka kapje tjetër shteti. Nuk ka diskutim tjetër ky parlament, përveç kërkesës që ka bërë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për heqjen e imunitetit dhe arrestimin e zotit Arben Ahmetaj.

Ndërkohë, ka pasur edhe shumë zyrtarë të ndershëm. Unë dua të vlerësoj ish-ministrin e Financave, zotin Cani, i cili ka bërë rezistencë deri në fund. Ka pasur shumë zyrtarë të ndershëm, ashtu siç thuhet dhe në dosjen e SPAK-ut. Drejtoresha e Përgjithshme e Buxhetit, zonja Mimoza Dhëmbi, dhe një numër i madh zyrtarësh në Ministrinë e Financave i kanë rezistuar deri në fund Arben Ahmetajt, kur i thërriste në zyrë dhe i vendoste përpara përgjegjësisë, kur u bënte presion punonjësve të shtetit, një e nga një, duke u thënë të firmosnin letrat e inceneratorëve. Për këtë duhet të flisni sot, që i keni lënë punonjësit e shtetit në duart e kriminelëve; për këtë duhet të flisni sot, për administratën publike, që ua keni çuar biznesmenëve në zyrë dhe u keni thënë: "Firmosni letrat e inceneratorëve". A ka kapje shteti më të madhe? A ka sot krim më të madh se ky, që një shtet i tërë të ketë shkruar letra koncesionesh? Si nuk keni turp?! I keni bërë avokatinë publike një afere, duke sulmuar Partinë Demokratike, e cila e ka denoncuar me dinjitet për 7 vjet.

Sigurisht, kjo vjen edhe pas skandalit të Rrahman Rrahjas në Krujë, skandali ku i forti në politikë, i forti në biznes, ia del pa folur asnjëherë në parlament, duke ardhur në parlament me gojën mbyllur, duke shkuar në zonën e tij për të drejtuar nga gurorja, deri te bizneset e zonës, apo deri te kultivimi i kanabisit. Për çfarë është zgjedhur Rrahman Rrahja në parlament? Për çfarë janë zgjedhur 20 deputetë të tjerë të inkriminuar në parlament? Për çfarë, për programin e Partisë Socialiste? Kjo është oferta politike që ka kjo qeverisje?

Po citoj Kryeministrin tuaj në vitin 2014, i cili ka thënë: "Ajo që është bërë me Krujën është e pashembullt në histori. Siç ia hëngri malet Krujës Partia Demokratike, asnjë sulltan tjetër nuk ia ka ngrënë, e të gjithë sulltanët bashkë. Ne

e mbyllim këtë plagë të tmerrshme dhe të gjitha guroret brenda vitit që vjen".

Çfarë ndodh sot? Sot janë 50 gurore në qytetin e Krujës. Çfarë ndodhi me sistemin që ju do të rrëzonit, që e perfeksionuat, e rritët, e morët në menaxhim, duke ndarë favoret sa tek të fortët në politikë, sa tek të fortët në biznes, se "Rrahmanët" e politikës dhe të biznesit sot kanë kapur parlamentin?

Nëse unë do të isha deputete e Partisë Socialiste, sot do të kisha ulur kokën dhe do u kisha kërkuar ndjesë shqiptarëve për 430 milionë eurot që i keni hequr nga buxheti i shtetit dhe vazhdoni t'i mbroni sot.

Ministrja e Financave duhet të fliste sot se si e ka lejuar kompaninë nën hetim të marrë një koncesion, pasi ka qenë drejtoreshë e Tatimeve. Sot të gjithë deputetët që kanë qenë kryetarë bashkish, të cilët i ka thërritur ish-zëvendësministri, një e nga një, për të firmosur tenderë për Arben Ahmetajn, duhet të japin llogari dhe të kërkojnë ndjesë.

Sot, kushdo që ka qenë në komisionin hetimor për inceneratorët, edhe në konflikt interesi, që i ka mbrojtur ata 3 individë në konflikt interesi, duhet të kërkojë ndjesë. A ka turp sot? A moral sot, që ju vini këtu e na akuzoni përsëri ne?

Me çfarë lartësie morali flet Ulsi Manja, i cili ka dosje në prokurori? Me çfarë lartësie morali kërkon të diskutojë këtu për zgjedhjet, ndërkohë që i ka vjedhur zgjedhjet? Kjo është mënyra si Partia Socialiste i ka fituar zgjedhjet: me "Rrahmanët" e Krujës dhe "Rrahmanët" e biznesit. Ky është modeli që keni ngritur në politikë, që sot të rinjtë largohen nga vendi për shkak se nuk e gjejnë veten këtu. Për këtë duhet të keni turp dhe duhet t'u kërkoni ndjesë shqiptarëve, sepse ky model po e vret sot Shqipërinë.

Unë besoj se nga Partia Socialiste ka edhe shumë kolegë të ndërgjegjshëm. Ashtu si ish-ministri Cani dhe si shumë ish-punonjës të administratës, që kanë refuzuar të firmosin, ka edhe shumë deputetë, të cilët nuk janë bërë pjesë e kësaj afere. E di që nuk jeni të gjithë njësoj, por ata që nuk janë bërë pjesë, sot duhet ta ngrenë zërin dhe duhet të kërkojnë patjetër që të futet në rendin e ditës dhe të votohet kërkesa për heqjen e imunitetit dhe arrestimin e ish-zëvendëskryeministrit. Sot Parlamenti i Shqipërisë ka një njollë të tmerrshme turpi (e ka pasur politika shqiptare me kriminelët në politikë, kurse sot e ka parlamenti), sepse numri dy i qeverisë është arratisur me lejen tuaj, ndërkohë që e keni mbrojtur për një vit me radhë. Numri dy në qeveri, me gjithë mbrojtjen tuaj politike, arriti të largohet nga Shqipëria dhe kjo është njolla e parlamentit.

Unë besoj se ka ardhur momenti që ne t'i ndajmë gjërat në politikën shqiptare. Sigurisht, e di që ndoshta mund të jem idealiste, që ndoshta do të duhet pak më shumë kohë që historia t'i japë të drejtë Partisë Demokratike për çështjet e saj të drejta, si dekriminalizimi dhe korrupsioni, beteja që i kemi bërë parimore, por, gjithashtu, diçka e di me siguri: turp më të madh se ky që ka mbuluar Parlamentin e Shqipërisë, nuk ka. Ata deputetë që janë bërë avokatët e Arben Ahmetajt me shokë, avokatët e korrupsionit më të madh në histori, avokatët e instalacioneve të korrupsionit, që sot as nuk janë në terren, sot duhet të largohen me turp nga ky parlament.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Fjala për zotin Lavdrim Krrashi.

(Zhurmë në sallë)

Lavdrim Krrashi - Në fakt, unë dua ta filloj fjalën duke u kërkuar të gjithë qytetarëve shqiptarë një ndjesë njerëzore, mbi të gjitha, për sjelljen e 140 deputetëve të Parlamentit të Shqipërisë në këtë seancë të pazakontë! Nuk na e ka borxh asnjë qytetar i Shqipërisë këtë sjellje jonormale të 140 deputetëve të parlamentit.

Kryekomisioneri për zgjedhjet sot do të paraqiste përpara deputetëve një raport prej 60 faqesh. Druaj se e keni lexuar të gjithë, kurse unë e kam lexuar germë për germë dhe rresht për rresht dhe do të ndalem vetëm në një pjesë shumë të vogël të tij.

Patjetër që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si çdo institucion, ka të metat dhe gabimet e tij, por duhet vlerësuar edhe për ato punë që i ka bërë mirë.

Unë nuk do të merrem me pjesën e vlerësimeve, sepse e bëjnë vetë ata, por do të merrem me një çështje mjaft sensitive, e cila kërkon vëmendjen e të gjithëve. Përpara 3 vjetësh, konkretisht, në tetor të vitit 2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ngarkua me detyrën për të siguruar të drejtën e votës së qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë, një e drejtë e mohuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

I dashur zotëri, unë flas për pikën e rendit të ditës, kurse ju flisni për çfarë të doni.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Në vitin 2020 Kuvendi...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Lindita Nikolla - E sqarova 100 herë dhe nuk kam ndër mend t'jua sqaroj për të 101-tën. Keni njerëz që nuk kanë dëshirën për të kuptuar. Nuk mund të vazhdojmë kështu.

Po, zoti Krrashi.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Zoti Krrashi, ju lutem, kushtet janë të vështira, por duhet të vijojmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Zoti Krrashi, ju lutem, vazhdoni!

Lavdrim Krrashi - Unë nuk kam asnjë siklet, i dashur zotëri, por populli thotë: "Në një vend ku nuk të dëgjojnë dhe ku hanë e nuk të japin, mos fol".

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Unë po flas për rendin e ditës dhe ju kërkoj me shumë respekt të më dëgjoni. Ndoshta ju nuk keni dëshirë të dëgjoni kur diskutohet për të drejtën e votës së qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë, por unë kam. Kjo është arsyeja pse unë dua të flas.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Për ta mbyllur, unë i kërkoj Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore të respektojë vendimin më të fundit të Gjykatës Kushtetuese për të siguruar të drejtën e votës së qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Lindita Nikolla - Faleminderit, zoti Krrashi!

Fjala për zotin Dashnor Sula.

Dashnor Sula – Zonja Kryetare, kjo nuk është një seancë normale, madje, është një seancë totalisht e jashtëligjshme, totalisht në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, një seancë që nuk do të duhej të zhvillohej në normalitet.

Pa diskutim, opozita ka gjithë të drejtën e saj ta kundërshtojë, ndaj unë do t'i listoj më poshtë se çfarë bëni ju.

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Si mund të mashtroni opinionin publik shqiptar në prani të 140 deputetëve dhe të gjithë medies? Si mund të mblidhet Komisioni i Ligjeve në mënyrë të fshehtë, pa e lajmëruar opozitën, pa kuorumin e nevojshëm, pa u mbajtur procesverbal, pa regjistrim, pa transmetim, pa asgjë, pa e ditur asnjë deputet i opozitës në Komisionin e Ligjeve, dhe për 10 minuta të marrë një vendim për legalizimin e drogës në Shqipëri? Tani na thoni ne se po shkelim Rregulloren. Jo, ne nuk po shkelim Rregulloren, por po kërkojmë respektimin e parlamentit dhe të Rregullores, zonja Kryetare.

Zonja Kryetare, unë jam deputet që nga viti 2005 dhe po ju them se në Rregulloren e Kuvendit është përcaktuar shumë qartë edhe rasti kur kemi depozitim të kërkesës me shkrim, si rasti i kërkesës së zotit Bardhi, edhe rasti kur kemi depozitim të një amendamenti të ashtuquajtur "gojor", meqë ndonjëri prej jush e ka shumë qejf gojoren: flet një folës pro dhe një folës kundër dhe pastaj hidhet në votim. Pra, kjo do të thotë se kërkesa me shkrim e zotit Bardhi duhet të hidhet në votim. Le të ishte gabim, por të paktën të votojmë. Po ju kërkojmë vetëm respektimin e Rregullores, kurse ju keni harruar çfarëdolloj normaliteti.

Ju ju ka kapur aq shumë arroganca sa s'ju bën syri tërr. Lefter Koka e furnizoi me oriz inceneratorin, sepse aq i thoshte mendja. Nuk ju bën syri tërr dhe kjo është arrogancë. Ai tjetri e nxori në mes të tavolinës, sepse nuk ka më turp. Ai tjetri shet diamante. Pra, këtu nuk flitet më për çështje, por për arrogancë.

Pa diskutim, në atë krah ka burra dhe zonja të nderuara, të cilët jam i sigurt që skuqen dhe u vjen turp, por nuk kanë çfarë të bëjnë, sepse këtu ka arritur atje ku s'thuhet, deri këtu sipër.

Pa diskutim që të gjithë kemi gjynahe, zonja Kryetare, përfshirë edhe opozitën, por mos harroni se kam qenë në parlament në vitin 2012, kur mazhoranca e asaj kohe ka propozuar heqjen e imunitetit për çdo deputet të Parlamentit të Shqipërisë, por ishte pikërisht opozita e asaj kohe dhe mazhoranca e sotme që nuk pranoi të votohej, duke e lënë imunitetin në gjendjen ku është sot.

Ne po ju kërkojmë të mblidhni Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, bëni raportin dhe ta votojmë në fund të seancës. Pse nuk votohet?

Pra, ju mblidhni Komisionin e Ligjeve 5 minuta dhe merrni një vendim për legalizimin e drogës dhe nuk merrni një vendim për Arben Ahmetajn. A ka logjikë kjo punë? Nuk e kuptoj si keni arritur deri në këtë pikë, se njeriu ka pak cipë në faqe edhe kur e bën një veprim.

Kolegu Shalsi e ka thënë mirë në vitin 2013: "Ne nuk do të vjedhim si ju, por me lezet". Pra, bëjini me lezet punët. Ju ju ka kapur arroganca dhe nuk arrini të shikoni më asgjë. Me të drejtë nuk na llogarisni as ne, se kemi edhe ne gjynahet tona, por sot nuk duhet të kishte pasur fare parlament, por duhet të ishin përmbysur tavolinat për shkak se ka ndodhur një ngjarje e rëndë. Çfarë duhet të ndodhë më shumë se kaq?

Siç e thashë edhe kur mora fjalën për procedurë, deputetë, kryetarë bashkish, drejtorë, ministra dhe zëvendëskryeministri kanë përfunduar në burg. Çfarë duhet të ndodhë më, të hyjmë edhe ne në burg, që ju të kujtoheni se ka opozitë dhe është shkelur ligji? Pra, ju keni arritur në këtë lloj arrogance, por të jeni të sigurt se çdo gjë e ka një fund. Ndoshta unë nuk do të jem nesër deputet, por do të jetë kolegu im, zoti Korreshi, apo të tjerët, dhe historia do të vazhdojë. Siç e tha edhe zoti Bardhi, ne duam thjesht të ngelë në dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë.

Zotërinj, jeni dakord që kërkesa e zotit Bardhi për sa i përket raportit të votohet apo jo në këtë seancë? Po ju kërkojmë thjesht një votim. Ju e keni forcën e kartonëve dhe mund ta rrëzoni. Pse e keni kaq të fortë këtë lloj arrogance? Pse e bëni një gjë të tillë?

Për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri, si: dajak, hunj, tavolinë, gojore e gjithçka, sot nuk duhet të kishte parlament.

Lindita Nikolla - Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Zoti Sula, ju lutem, përmbajeni fjalorin sa të keni mundësi!

E dyta, zonja Kryetare, mendoj që ju, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit, duhet ta ndërprisni seancën, në mënyrë që të kemi mundësi të bëjmë një konsultë me anëtarët e Konferencës së Kryetarëve, sepse, siç është shprehur edhe në Këshillin e Mandateve, të gjithë kemi dëshirën e mirë për të gjetur një zgjidhje. Kështu që, mendoj të bëjmë 5 minuta pushim në mënyrë që të thërrasim anëtarët e Konferencës së Kryetarëve dhe t'i japim një zgjidhje kësaj çështjeje.

Lindita Nikolla – Për të qenë e saktë, do të bëjmë 15 minuta pushim.

(Ndërpritet seanca)

(Rifillon seanca.)

Lindita Nikolla - Më lejoni t'ju informoj se Konferenca e Kryetarëve vendosi që, meqenëse ne kemi hyrë në rendin e ditës, në pikën e parë të rendit të ditës, seanca e parlamentit për çështjen e imunitetit të zotit Arben Ahmetaj, do të zhvillohet nesër në orën 10:00.

Vijojmë, fjalën e ka...

(*Ndërhyrje pa mikrofon nga salla*)

Po.

Jorida Tabaku - Thjesht për të informuar kolegët dhe opinionin publik, Partia Demokratike kërkoi që seanca të mbahet një orë e më parë dhe diskutimi të fillonte që sot. Meqenëse rendi i ditës sot ka filluar, mazhoranca u tërhoq nga seanca e ditës së hënë dhe vendosëm të mbahet një seancë e posaçme nesër. Ne gjykojmë që edhe nesër, sigurisht që është vonë, seanca duhet të ishte zhvilluar me kohë. I kërkojmë Partisë Socialiste që anëtarët e saj në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të dorëzojnë menjëherë raportin dhe pjesën e tyre takuese të raportit.

Partia Demokratike e ka dorëzuar raportin e saj, në mënyrë që të jenë të plotë nesër në orën 10:00 në seancë. Partia Socialiste duhet ta dorëzojë sot në një mbledhje tjetër të Këshillit të Mandateve, që duhet të zhvillohet po sot, nëse palët bien dakord. Nëse jo, atëherë nesër në seancë do të lexohen të dyja raportet e paraqitura nga grupet parlamentare.

Lindita Nikolla - Kemi rënë dakord që vetëm do të paraqitet raporti, nuk ka nevojë për mbledhje.

Fjala për zotin Sali Berisha. 5 minuta keni në dispozicion.

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Do të marrë nga koha juaj? Atëherë, 10 minuta për zotin Berisha.

Sali Berisha -Të nderuar qytetare dhe qytetarë,

Ky parlament sot mblidhet në shenjën e turpit historik. Mblidhet, kur shqiptarët dhe bota kanë mësuar se njeriu i dytë më i rëndësishëm i qeverisjes socialiste, Arben Ahmetaj është larguar, është arratisur nga vendi i tij, si një hajdut i damkosur, si një njeri që ka vjedhur, që e ka shfrytëzuar pushtetin për të vjedhur qytetarët e tij.

Megjithatë, mazhoranca në vend që të ulë kokën, të përdorë ndjesën, të kërkojë zgjidhje me largimin e kësaj qeverie, përkundrazi shpreh krenari, duartrokitje dhe rrahje gjoksi. E gjitha kjo nuk bëhet për Arben Ahmetajn, e gjitha kjo bëhet sepse Edi Rama në këtë aferë, duhet ta kemi të qartë, është shumëfishi i Arben Ahmetajt.

Të dashur qytetarë,

Sot me dhjetëra e qindra dokumente, të cilat u paraqitën në komisionin hetimor parlamentar, u paraqitën nga media dhe gazetarë të shumtë për këtë çështje, kanë faktuar katërcipërisht se kemi të bëjmë me një vjedhje të tmerrshme. Nga buxheti i shtetit janë marrë qindra milionë dollarë, euro, për të ndërtuar tre djegës, të cilët do të mjaftonin për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë dhe figuron vetëm një vjetërsirë në Elbasan që tre muaj punon dhe tre muaj nuk punon, dy djegësit e tjerë nuk janë kurrkund. Paratë tuaja kanë shkuar, por djegësit nuk ekzistojnë, se ato para janë vjedhur nga 'arbenë ahmetër', në proporcion. Natyrisht, vjedhjen më të madhe e ka bërë Edi Rama, që ka qenë njeriu më i angazhuar.

Ju duhet ta dini, se në datën 5 shkurt të vitit 2015, jo Lefter Koka, që si ministër i takonte të shkonte në zyrën e Kryeministrit, por Edi Rama dhe Engjëll Agaçi zbresin në zyrën e Lefter Kokës për të falsifikuar dokumentin. Në atë zyrë kishte pesë zëvendësministra të quajtur anëtarë të Komitetit të Emergjencave, që i kishte shpallur për të vjedhur Edi Rama. Për hir të së vërtetës, dy prej tyre nuk e firmosën. Ylli Manjani, dhe, në mos gaboj Arben Isaraj, nuk pranuan të firmosin me gjithë presionin që u bëri Edi Rama me Agaçin.

Edi Rama, për të krijuar terrenin për këtë vjedhje të madhe, mori çdo vendim fals, por, mbi të gjitha, ai krijoi kuadrin antiligjor mbi të cilin u bazua e tërë kjo vjedhje. Ky kuadër qëndron me firmën e tij, në kundërshtim me rekomandimin e Agjencisë Kombëtare të Prokurimeve Publike, që është me ligj dhe me Kushtetutë autoriteti përgjegjës ligjor në fushën e prokurimeve. Në kundërshtim me atë, Edi Rama firmosi t'i jepej "Zotos" (se Zoto nuk është asgjë tjetër, veçse agjenti i Edi Ramës), me negociatë të mbyllur, tenderi i Elbasanit.

Edi Rama hapi rrugën, të dashur qytetarë, krijoi mekanizmin e vjedhjes dhe tenderi, pa asnjë pjesëmarrje, iu dha atij që deshi Edi Rama me Engjëll Agaçin, Arben Ahmetajn, Lefter Kokën e me radhë.

Edi Rama është përgjegjësi kryesor, sepse dora e tij e zezë qëndron prapa prokurimit të djegësit të Fierit, me një çmim të dyfishtë me të Elbasanit.

Qytetarë dhe qytetare,

Djegësit e Fierit dhe të Elbasanit janë thjesht, strikt investim publik, janë paratë tuaja të vjedhura nga qeveritarët për të blerë djegësit, në një kohë kur në ligj, në frymë dhe në germë, ato detyrime duhet t'i bënin Bashkia e Fierit dhe Bashkia e Elbasanit. Po pse nuk iu dha bashkive të Fierit dhe të Elbasanit t'i bënin tenderët? Sepse, duke ia dhënë firmës së tyre "Zoto", tenderi i Elbasanit u mbyll me 9 apo 10 milionë euro, dhe 10 milionë euro tepruan në xhepat e Ramës dhe të ministrave të tij. Kurse sa i përket tenderit të Fierit, nuk iu dha Bashkisë së Fierit të bënte tenderin, iu dha përsëri "Zotos", por tani iu dha dyfishi (se oreksi vjen duke ngrënë) dhe nuk mbetën më 10 milionë euro në xhepat e Ramës dhe të qeveritarëve, por mbetën 23 milionë euro.

Po si mund t'i dilni zot ju kështu? A e dini ju që ju ndjekin edhe familjarë, rrethi juaj, por nuk pajtohen kurrë me këto qëndrime? A e dini ju këtë gjë, apo jo?

Ç'bëri pastaj Edi Rama? Pse është Edi Rama, njeriu më kryesor? Sepse oreksi vjen duke ngrënë, vodhën këtu 20, tjetrin e bënë 40 e ca, tani duhen 120. A, 120?! E gjetën mekanizmin në koncension! A e dini ju që Erion Veliaj ka falsifikuar, ka firmosur për këshillin bashkiak dhe për këshillin e Qarkut të Tiranës? Ka firmosur për 5 bashki, në një kohë kur të katërta kanë qenë kundër, dhe këtë e ka bërë totalisht me miratimin e Edi Ramës. Arben Ahmetaj nuk e ka firmosur, por nuk del kurrë jashtë përgjegjësisë, se për një zyrtar, ligji është veprim dhe mosveprim, aq më tepër që ai e dinte që po shkelej me dy këmbë, por Edi Rama diktonte dhe natyrisht ndante copa.

Pra, tani, pas 6 vjetësh të kontraktimit të djegësit të Tiranës, nuk ekziston asnjë objekt i ndërtuar, zero objekte, në një kohë kur janë dhënë mbi 100 milionë euro. Kanë përfunduar të gjitha në xhepat e Erion Veliajt, të Edi Ramës dhe të çetës së tyre të hajdutëve. Asnjë aferë nuk ka përfshirë... Juve do t'ju djegin flakët, ja, jua them unë këtu, mbajeni mend, do t'ju djegin flakët e djegësve që nuk u ndërtuan! Është e vështirë të gjesh njërin prej jush që nuk ka... Ja, tani po lexoja: Zoto paska qenë këshilltari i Salarjanit, apo si quhet ai, bashkëshorti i Elisës. Nuk ka vend që nuk gjendet, në çdo sirtar, ja ku e kam vendimin këtu.

(*Ndërhyrje pa mikrofon nga salla*)

Dil, dil dhe lexoje pak! Nuk ka vend, në çdo sirtar tuajin që të hapni, ju del Zoto, ju del Mërtiri.

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Dhe ty, Ulusi, do të të dalë diku, po nuk ka se si, nuk mund të jesh përjashtim ti.

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Atje, te krimi elektoral, atje e ke absolutisht ti, do të dënohesh deri në ditët e fundit të jetës, ke për ta parë. Jo, jo, ke për ta parë, u thuaj të të bëjnë një vend gati atje, se atje do të shkosh ti.

Pra, këta janë të gjithë të implikuar. Dhe këta, në vend që të dënojnë, të paktën ata që nuk janë të implikuar, mbrojnë Edi Ramën. Ku është ai sot? Si mund të pranoni ju, që të mos jetë ai këtu sot? Ia mbathi edhe ai, ia mbathi. Ai tjetri u arratis, edhe ky diku tjetër fshihet tani.

Lindita Nikolla - Zoti Berisha, kaloi një minutë nga koha.

Sali Berisha - Pra, e kuptoni ju që me mungesën e tij, ai nxin. Afera shkon në 720 milionë euro dhe nuk tërhiqeni, dhe Prokuroria nuk guxon të konfiskojë veprat e krimit, nga presioni juaj.

Lindita Nikolla - Ju lutem, mbaroi koha, e keni ezauruar edhe...

Sali Berisha - Mbaroi koha, po vjedhjet tuaja nuk mbarojnë kurrë! Koha mbaroi, por vjedhjet tuaja nuk mbarojnë kurrë.

Lindita Nikolla - Fjalën e ka zonja Zhupa, 5 minuta.

(*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon*)

Pas Inës, jeni ju.

Ina Zhupa - Në fakt, nuk ka ngjarje më të rëndë sesa, nga e enjtja në të enjte, grupit këtej t'i mungojnë dy deputetë; nga e enjtja në të enjte, kur bënin foto së bashku Arben Ahmetaj dhe Rrahman Rrajën, atje në fund të sallës, në këtë të enjte njëri është në arrati dhe kërkohet t'i hiqet imuniteti, dhe tjetri ka dhënë dorëheqjen për një batërdi që ka bërë ai, fisi i tij, me urdhër të tij, me mbrojtje nga ju, në Krujë. Ja, kjo është panorama më e saktë e asaj që jeni ju, dhe e asaj që përfaqësoni ju. Mos u çuditni që në gusht të na sillni në ndonjë seancë të jashtëzakonshme, sepse për atë që ishte regjistruar sot dhe e tërhoqi fjalën, Damian Gjiknurin, do të duhet t'i japim një autorizim SPAK-ut që të lërë imunitetin. Sot tha se e njeh Klodian Zoton. Nuk është mëkat të njohësh. Në komisionin hetimor nuk e njihte Klodian Zoton, tani e njeh, dhe pas pak ditësh, do të ketë edhe bashkëpunuar me të dhe do të dalin edhe gjëra të tjera.

Ja, ky është standardi juaj, ky është standardi i kësaj mazhorance, sepse këta emra që përmenda, nuk është se janë një përgjegjës në një fshat të fundit atje, por janë zëvendëskryeministra, ministra më me peshë, deputetë, drejtues politikë, njerëzit më të rëndësishëm të Partisë Socialiste. Sot i keni drejtuesit politikë të listës së Qarkut të Durrësit ose në burg, ose të larguar nga parlamenti: Lefter koka në burg, Vangjush Dako në burg, Rrahman Rraja iku me turp. Këta ishin drejtuesit tuaj politikë, që ju siguruan ato mandate në Durrës.

Sot ju na tregoni forcën e kartonit dhe doni të flisni për zgjedhjet. Po për cilat zgjedhje?! Për zgjedhjet që bënë këta, me paratë që ua vodhën qytetarëve shqiptarë? Për çfarë do të flasim ne këtu sot, kur këtu sot duhet të kishim atë, Kryeministrin, me firmën e të cilit vazhdon sot e kësaj dite të paguhen inceneratorët, që nuk ekzistojnë. Kam vajtur në Sharrë, është një fushë me bar, ndërkohë që në Elbasan dhe në Fier janë dy godina që thjesht rrinë atje. Për këto, ne duhet të japim para?! Po si ka mundësi që dy ministra, një deputet si Alqi Bllako dhe dy ministra kanë bashkëpunuar me njeri – tjetrin, por nuk u quajtkan grup i strukturuar kriminal?! Ai që u jep komandë atyre dhe që e vë vulën dhe firmën, nuk u quajtka kryetar i grupit të strukturuar kriminal?! Si është e mundur? Ato para vazhdojnë dhe jepen, kur ata janë në arrati dhe ata janë në burg, sepse është vullneti politik juaji. Në komisionin hetimor Edi Rama, me zë dhe figurë tha: "Jo, unë i kam të dyja duart brenda". I ka të dyja duart brenda, siç e dimë të gjithë. Të vijë pra dhe të japë llogari, se me cilën dorë bën, çfarë. Të japë llogari se me cilën dorë komunikon me prokurorët, me cilën dorë firmos dhe me cilën dorë numëron paratë. Le të vijë këtu dhe t'u tregojë qytetarëve shqiptarë, sepse janë taksat e tyre, për një krenari, sipas tyre, për inceneratorët që groposin mbetje, sepse nuk bëjnë asgjë tjetër.

Dikur Ben Blushi, në këtë foltore, ju ka ndarë në dy kategori: kanabistë dhe krenaristë. Sot e vërtetuat këtë gjë: si kanabistë, e kaluat për 15 minuta ligjin e kanabisit fshehurazi, pa kuorum, vetëm për t'u plotësuar dëshirën grupeve kriminale për të vazhduar të qetë të transportojnë dhe të prodhojnë drogë në Shqipëri; dhe si krenaristë, na bëtë moral sa krenarë jeni për këtë drejtësinë e re, sa krenarë jeni që ju heshtni para drejtësisë, se nuk keni se çfarë të thoni. Krenaristë dhe kanabistë të vitit 2023, që bashkohen në këtë Kuvend, që vetëm është përkeqësuar për nga

përfaqësimi i mazhorancës, që nga koha kur të paktën ishte një person që fliste këtu edhe kundër jush, brenda mazhorancës. Sot, askush brenda mazhorancës nuk thotë dot një fjalë, edhe pse kolegët i ikin ditë pas dite, dhe pse karriget përkrah i ndërrohen ditë pas dite. Nja 15 deputetë, që nga lista e parë e zgjedhjeve të vitit 2021 e deri sot, i keni mangët nga ata që duhet të kishin qenë fituesit e zgjedhjeve dhe fituesit e listave të vitit 2021. A keni moral politik ju që të vazhdoni të qeverisni?!

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Zoti Leskaj, 5 minuta.

Bujar Leskaj - E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Nuk është ndonjë zbulim që po bëjmë ne deputetët e opozitës, por është një zhvillim objektiv, që kjo mazhorancë do të vazhdojë skandal pas skandali, po, siç thotë populli: "Zullumi me të trashur, këputet!"

Problemi, detyra dhe detyrimi që kemi ne si deputetë të opozitës, nuk është thjesht të denoncojmë skandalet e kësaj mazhorance, të qeverisë së saj, të sektit "Rama", por është t'i paraprijmë së ardhmes, për atë detyrim që kemi ndaj qytetarëve shqiptarë, demokratë, socialistë dhe të kujtdo besimi politik.

Unë mendoj se detyra jonë kryesore, kondicionimi ynë kryesor, krahas denoncimit që duhet të bëjmë në Kuvend, në media dhe kudo në forume të tjera vendase, kombëtare dhe ndërkombëtare, është parapërgatitja për zgjedhjet e ardhshme. Zgjedhjet e ardhshme mund të zhvillohen në vitin 2025, që këta të vazhdojnë të ecin skandal pas skandali, ose mund të jenë zgjedhje të parakohshme. Por, ne kemi përgjegjësi të fokusohemi aty ku dikur kemi mësuar: te hallka kryesore e zhvillimit të ngjarjeve të mëpasshme, dhe kjo është domosdoshmëria e reformës zgjedhore.

Kemi dy variante: variantin bazë, që është dakord e gjithë shoqëria shqiptare sot, që në Shqipëri duhet të ndryshojë urgjentisht Kushtetuta e vitit 1997-1998, pra të ndërtohet nga e para, të ndërtohet sistemi i qeverisjes në vend, i legjislativit, i gjyqësorit, institucionet e pavarura e të tjera, çka kërkon kohë; dhe, e dyta, të reformohet sistemi zgjedhor. Kjo e dyta është te vullneti ynë, te vullneti i opozitës dhe i pozitës.

Kuptohet, ne të opozitës duhet ta kemi si detyrë. Ne duhet ta kemi detyrë dhe duhet të fokusohemi, madje (unë e kam shprehur edhe herë të tjera në Kuvend) të kondicionojmë këtë mazhorancë me faktin që komisioni i reformës zgjedhore duhet të funksionojë normalisht dhe të sjellë produktin e tij sa më shpejt. Edhe këto që bëjmë ne, të gjitha protestat kanë vlerën e tyre; unë personalisht kam mendim tjetër, por moralisht, kuptohet, jam me kolegët e mi. Ne duhet të kapemi te hallka kryesore.

Kërkohet urgjentisht reformimi i sistemit zgjedhor, pasi përndryshe, i bie që në vitin 2025 apo edhe po u zhvilluan zgjedhje të mëparshme, ne do të tradhtojmë në njëfarë mase interesat e shqiptarëve, interesat e elektoratit tonë.

Sa i përket sistemit të zgjedhjeve, ajo çka duhet t'i kërkojmë komisionit për reformën zgjedhore, i cili po fle, nuk po punon dhe kjo bëhet jo pa qëllim nga sekti "Rama", ne duhet të kërkojmë një sistem zgjedhor zgjedhjesh ose, pa prekur Kushtetutën, proporcional- rajonal me numër të kufizuar rajonesh, nga 12 t'i kalojmë në 4; ose, duke prekur Kushtetutën, të kërkojmë një sistem proporcional kombëtar.

Pse duhet ta bëjmë ne këtë? Ne duhet ta bëjmë këtë, në radhë të parë për t'i dhënë barazi votës, për t'u krijuar mundësi të gjitha partive të reja që duan të futen në sistem dhe partive të vogla parlamentare dhe joparlamentare të marrin një numër mandatesh, që iu korrespondon numrit të votave të fituara. Vetëm kështu mund të themi që konfirmojmë, plotësojmë, punojmë, ndërtojmë dhe rindërtojmë shtetin e së drejtës.

Ne duhet të përqendrohemi dhe të paktën ne, deputetët e opozitës, duhet të mbështesim urgjentisht nismën e deputetit Dashamir Shehi dhe të një grupi deputetësh, kryetarë të partive të vogla dhe deputetëve të tjerë, që e kanë ngritur këtë, për rregullimin e sistemit zgjedhor: listat të jenë 100% të hapura. Nuk duhet të kemi më deputetë të kryetarit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për fat të keq, ne duhet të pranojmë se ndryshimet e vitit 2008 ndikuan negativisht në zhvillimin e vendit dhe ne sot ndiejmë të gjithë peshën e të qenit "deputetë të kryetarit". Jo, ne duhet të jemi deputetë të zgjedhësve tanë. Edhe Kushtetuta e ka parashikuar që mandati i deputetit nuk ka asnjë detyrim, përveçse nga zgjedhësit e tij. Pikërisht ky ka qenë qëllimi, që ne të jemi të lirë nga trysnia, nga shtypja, në mënyrë figurative, e presionit të kryetarit dhe e mënyrës së zgjedhjes.

Nga ana tjetër, duke ndërtuar një sistem proporcional rajonal me numër rajonesh të kufizuara ose proporcional kombëtar, ne arrijmë që të kemi edhe barazinë e deputetëve të zgjedhur për numër votuesish, pra, nuk kemi pse ta kemi si sot. Fjala vjen një deputet i Vlorës zgjidhet në bazë të votimit të 9000 qytetarëve dhe ai i Kukësit të 14 000 qytetarëve. Pse të jenë këto diskordanca? Ndryshimi i sistemit zgjedhor i mundëson dhe i rregullon këto.

E fundit, në këto pak sekonda që më kanë ngelur dua të them se ne, duke respektuar edhe atë çfarë kemi shprehur politikisht, duke respektuar edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të dhjetorit të vitit 2020, duhet të vendosim me shpejtësi dhe që edhe diaspora të votojë. Janë 1 milion e 600 mijë shqiptarë sot në botë, diasporë e vjetër dhe e re, më shumë e reja, por edhe ata të vjetrit që e kanë mbajtur gjithmonë gjallë flakën e shqiptarizmit kudo, në cilindo vend që kanë qenë, emigrantë të viteve ’20 apo të pas viteve ’44. Emigrantëve antikomunistë, por edhe atyre të pas viteve ’90, duhet t’u krijojmë mundësinë që të votojnë.

Këtë nuk e realizon dot Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, sado dëshirë të mirë të ketë, por jemi ne që duhet ta realizojmë, në veçanti ne, deputetët e opozitës; nuk e realizon dhe nuk do ta realizojë sekti “Rama”. Rama dhe këta të vetët, i mbajnë vetëm me “ujë të ngrohtë”.

Edhe Ministrinë e Diasporës (gjetën një vend për deputetin e nderuar, Majko, si ministër), sado që zoti Majko u përpoq të nxirrte ato frytet te kjo ministri, këta e shumëzuan me zero. Nuk ishte thjesht shumëzim me zero për deputetin Majko, pavarësisht tentativës që iu bë te vendosja në lista, por ajo është punë e tij (Majko është partiak i bindur, është edhe deputet i mirë, sipas mendimit tim), por është fakt që ata e shumëzuan me zero punën për diasporën (nuk besoj se do të bëjë replikë zoti Majko), për të mos i dhënë mundësinë të krijohej e plotë korniza ligjore dhe organizative për të votuar diaspora dhe për të arritur atë që të gjithë qytetarët shqiptarë, në bazë të Kushtetutës, të kenë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në Kuvendin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Petrit Vasili.

Keni 5 minuta në dispozicion.

Petrit Vasili – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Absolutisht që ky raportim duhej të kishte qenë një kryeçështje, pasi vijmë pas zgjedhjeve vërtet të neveritshme, të cilat kanë verifikuar dhe provuar të gjitha llojet e formave të manipulimit mafioz politik, njëra më e shëmtuar se tjetra, njëra më e dënueshme se tjetra dhe njëra më e ligë se tjetra. Absolutisht, në këtë situatë, e cila vinte pas zgjedhjeve të mëparshme të vitit 2021, normalisht të gjithë kanë pritur, patjetër, një pozicion shumë ligjor, shumë të fortë e të pakapërcyeshëm, veçanërisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Por, mjerisht, ashtu sikurse nuk ka ndodhur në mënyrë të dukshme në të shkuarën, kur nuk ka qenë identifikuar si institucion që ishte në majën e problemeve të administrimit të paligjshmërisë, sot KQZ-ja, faktikisht është në pozicionin më të shëmtuar që mund të ekzistonte ndonjëherë, thjesht të një garantueseje të paligjshmërisë. Pas ndryshimeve të bëra përpara vitit 2021, kur u garantuan pafundësisht ndryshime ligjore, të cilat dënonin shumë rreptë, të paktën në ligj, përdorimin e administratës shtetërore dhe të të gjitha burimeve të tjera të të gjitha formave, ka ndodhur pikërisht e kundërta: kemi parë përdorimin më të përbindshëm, më të paparë ndonjëherë në historinë e Shqipërisë të administratës shtetërore, të kthyer në një *detachment* të neveritshëm në fuqi në zyrat e tyre dhe në çdo cep anembanë vendit, që nuk i shërbenin detyrës, por i shërbenin manipulimit të madh të zgjedhjeve.

E përballë tyre ishte një KQZ, thjesht dhe vetëm një zgjatim, një celulë politike shtesë e mazhorancës, që ishte streha më e mirë për të shuar e për të bërë zero mijëra shqetësime që janë bërë publike dhe formale me shkrim, zyrtarisht, duke u kujdesuar të mbante gjithmonë në dorë pompën e ujit të ftohtë për t’i shuar, për t’i asgjësuar e për të mos mbajtur kurrë qëndrim. Dhjetëra e dhjetëra dëshmi, fakte, njëri më tronditës se tjetri, që do të bënin të skuqej e të turpërohej këdo, në KQZ gjetën strehën, gjetën shfajësimin, gjetën alibinë, pasi kurrë nuk u trajtuan me seriozitet, kurrë nuk u trajtuan me të gjithë ashpërsinë e ligjit, përkundrazi u dha mesazhi i tolerancës së paparë, pra mund të vazhdoni të bëni ç’të doni se ne jemi në krahun tuaj.

Të gjitha strukturat në mënyrë të veçantë, KQZ-ja drejtpërdrejt, ku shpesh një shumicë dërmuese u soll si një KQZ politike e njëanshme në vend të një institucioni të paanshëm shërbëtor të ligjit, në mënyrë të veçantë Këshilli i Ankimeve dhe Sanksioneve, që praktikisht është një institucion i vdekur nga çdo pikëpamje, bënë të gjitha bashkë varrosjen e standardit të zgjedhjeve në Shqipëri.

Sot, për fat të keq, ne jemi në një situatë, në udhëkryqin më të rrezikshëm që ka Shqipëria. Sot, ne flasim, dhe unë i bashkohem çdo diskutimi për të riparë çdo gjë, por praktikisht të gjithë duhet të jenë të bindur që me këtë situatë, me këtë Komision Qendror të Zgjedhjeve, me këtë sjellje të mazhorancës politike, të gjitha ndryshimet ligjore, të të gjitha formave qofshin këto, që nga rregullimet e administrimit të zgjedhjeve e më tej ideja apo biseda për të folur për sistemin, rezultojnë një hiç, sepse në fund të ditës mekanizmi mafioz, manipulativ që fillon nga qeveria, e cila ka përgjegjësinë e administrimit të zgjedhjeve, deri te KQZ-ja, është një cirk i mbyllur që vret dhe asgjëson çdo lloj ideje apo edhe novatorizmi në drejtim të legjislacionit elektoral.

Kështu që, praktikisht, edhe KQZ-ja ka qenë një bashkëpjesëmarrëse në funeralin e standardit të zgjedhjeve dhe është, ashtu sikurse edhe institucione të tjera, nën akuzë si pjesë e këtij manipulimi në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të vetëdijshme. Kështu që besoj se gjithçka sot është betejë për një standard zgjedhjesh normale. Ky standard përfundimisht është rrënuar në Shqipëri.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Taulant Balla.

Taulant Balla – E mora fjalën për këtë çështje, sepse mendoj dhe besoj që në çdo vend, kur raporton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pikë së pari për opozitën, por edhe për mazhorancën, është momenti i duhur për të diskutuar mes njëri-tjetrin për rregullat e zgjedhjeve. Keqardhje sot për pamundësinë e një diskutimi të gjerë nga ana e opozitës, të të gjitha pretendimeve, nga fundi deri në fillim të sallës, por më së shumti në fund të sallës, pasi prej javësh ka pasur pretendime për të ashtuquajturin "manipulim zgjedhor" më 14 maj.

Në këtë raportim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bëhet fjalë për vitin 2022, por edhe kur kemi pasur përsëri zgjedhje më 6 mars, zgjedhje të pjesshme vendore në 6 bashki, nuk kishte asnjë ankesë për cilësinë e zgjedhjeve. E vërteta është dhe besoj se duhet të biem të gjithë dakord, që zgjedhjet e 14 majit ishin ndër zgjedhjet më të mira të zhvilluara, natyrshëm kjo edhe për faktin se sapo përfunduan zgjedhjet, drejtuesit, palët e opozitës dolën dhe shpallën edhe fitoren. Ju e mbani mend se të dielën në orën 19:07, dalja e parë publike ishte nga njëra prej palëve garuese, e cila shpalli fitoren. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në rastin e zgjedhjeve të vitit 2021 dhe mua më pëlqen ky fakt që opozita sapo mbyllen zgjedhjet shpall fitoren, por keqardhja më e madhe është që pasi certifikohen zgjedhjet, nuk e njeh rezultatin.

Tani po kthehem te reforma zgjedhore.

Kolegë deputetë, është koha e duhur që në shtator Kuvendi i Shqipërisë të çojë përpara me një ritëm tërësisht të ri, reformën zgjedhore. Përgjegjësia këtu, doni apo nuk doni, është e opozitës. Ne jemi të gatshëm, e kemi thënë prej ditës së parë, që të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it t'i çojmë përpara. Personalisht, vazhdoj të insistoj, siç e kam bërë këtu në këtë foltore prej shumë vitesh, se depolitizimi i komisioneve zgjedhore është një domosdoshmëri, administrimi i zgjedhjeve nga persona apolitikë është një model, i cili garanton sukses dhe një përshpejtim të daljes së rezultatit të zgjedhjeve. Por nuk mund të harroj pa përmendur dot këtu nevojën se duhet të marrim vendimet e duhura sot, të adresojmë sot vendimin e Gjykatës Kushtetuese, për të garantuar që në prill apo deri në mes të majit të vitit 2025, ne të kemi mundësinë që motrat dhe vëllezërit tanë që jetojnë jashtë territorit, kudo, në të gjitha kontinentet, të kenë mundësi të votojnë. E kjo votë mund të realizohet shumë mirë përmes votimit me postë, po të kemi parasysh shpërndarjen e madhe që ka sot diaspora shqiptare.

Prandaj, nëse unë do të kisha qenë sot kryetar i grupit parlamentar të opozitës, deputet i thjeshtë i opozitës, do të isha ndalur pikërisht te këto çështje që lidhen me nevojën për të pasur gati rregullat e lojës në demokraci. E dini apo nuk e dini që ne jemi i vetmi vend që nuk bëjmë dot zgjedhje, nëse do të duam të bëjmë një palë zgjedhje, sepse Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar Kodin Zgjedhor për ndarjen e

mandateve? Këto duhet të ishin çështjet për të cilat duhet të flisnit.

Ka një thënie të mençur: "Nëse do të shkosh në destinacion, mos u merr të flasësh rrugëve, çfarë të dalë rrugës". Nëse do të ishit ju një opozitë që donit pushtet (po ju vetë nuk e imagjinoni dot, jo më ata që duhet t'ju vijnë prapa, se mund të vini një ditë), duhet të filloni të silleni si një forcë e përgjegjshme dhe të fillojmë të dialogojmë për reformën zgjedhore.

Dua të sqaroj në fund të kësaj ndërhyrjeje, ndoshta e fundit si kryetar i grupit parlamentar në këtë sallë, diçka që lidhet me vendimmarrjen e sotme të Kuvendit të Shqipërisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kuvendi i Shqipërisë për rastin e ngjashëm ka njohur standarde të ndryshme. Po ia komunikoj publikut: e dini ju që në një rast të ngjashëm, kur njëri në fund të sallës drejtonte qeverinë, drejtonte edhe parlamentin, në rastin e Lulzim Bashës, ndaj të cilit prokuroria kërkoi autorizimin nga ana e Kuvendit, procedura mori 3 muaj në Kuvendin e Shqipërisë. Kërkesa, në mos gaboj, erdhi diku nga fillimi i tetorit (unë jam shumë i saktë me datat), dhe diku nga dhjetori u bë i mundur votimi në Kuvendin e Shqipërisë. 3 muaj.

Kjo mazhorancë...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, nuk ka ndryshuar ajo pjesë e Rregullores, nuk ka ndryshuar as përcaktimi në Kushtetutën e vendit, është i njëjtë siç ka qenë, ky paragraf nuk ka ndryshuar, është çështje tjetër heqja e imunitetit për hetimin, por arrestimi, ndalimi e të tjera me radhë janë çështje që ne i kemi ruajtur në formë. Përsëri bëhej fjalë për autorizim, zotëri, pra Kuvendit të Shqipërisë iu kërkua një autorizim nga prokuroria dhe e mbajtët tre muaj.

Kur i kërkonim ish-Kryetares së Kuvendit, tashmë në jetën e dytë të saj brenda Partisë Demokratike: "Më fal, Rregullorja dhe tradita thonë menjëherë", ajo thoshte "që menjëherë po e bëj". Për mua menjëherë është 3 muaj.

Ja pra, e vërteta është që për rastin e zotit Tahiri janë marrë 6 ditë dhe shqetësimi i vetëm që ka pasur kjo mazhorancë ka qenë që procesi duhet të jetë një proces i rregullt ligjor. Që nga momenti i mbërritjes së kërkesës për autorizimin, doni apo nuk doni, vetë Këshilli i Mandateve kthehet në një *quasi* gjykatë, në të cilën çdo moment i shkeljes së procedurës mund të rrezikojë bërjen e procedurës të pavlefshme; çdo shkelje e afatit ligjor, këtu futen edhe afatet e Rregullores së Kuvendit, duke qenë se Këshilli vepron si *quasi* gjykatë, mund të rrezikojë ligjshmërinë e procesit. Prandaj, ishte tërësisht i pamundur zhvillimi sot, sepse duhej parashikuar të paktën 48-orëshi nga momenti i mbylljes së Këshillit të Mandateve. Në cilësinë e kryetarit të grupit parlamentar, në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, kam propozuar ditën e nesërme, dhe kjo gjë u miratua me konsensus, që të jemi korrektë, se këtu gënjehet edhe kur gjërat janë ashiqare.

Zotërinj kolegë të opozitës, duhet të jeni ju ata që duhet të insistoni për ta çuar përpara reformën zgjedhore. Gatishmëria jonë është aty për të bërë disa detyra dhe është turpi ynë që nuk i kemi bërë ende (dhe shkojmë pastaj e mbyllemi nëpër ambasada, gjë që nuk ka për të ndodhur më, se e kemi thënë këtë, për të bërë marrëveshje të momentit të fundit), depolitizim të administratës zgjedhore, dhe ajo që është mbi të gjitha, t'u garantojmë shqiptarëve dhe shqiptareve, që jetojnë kudo në botë, që të kenë edhe ata vendimmarrjen e tyre për çfarë ndodh në Shqipëri, në zgjedhjet e përgjithshme të prillit apo të majit të vitit 2025.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zonja Kryetare, e kërkova edhe më parë, por nuk ma dhatë fjalën.

Do t'ju rendis disa gjëra shpejt e shpejt.

Së pari, për diskutimin që kemi nuk mund të sillet këtu historia e depolitizimit të administratës zgjedhore, pa zbatuar rekomandimin prioritar të vitit 2019: "të depolizohet administrata publike", thotë ODIHR-i, nuk e them unë. Ka qenë pikërisht kjo, që në vitin 2020, për marrëveshjen e 5 qershorit, Bashkimi Europian, me shkresë, ka sjellë qëndrimin se nuk mund të zbatohej propozimi i Partisë Socialiste për depolitizim, sepse administrata publike që do të përfshihej, ishte e politizuar dhe për këtë arsye u tërhoq. Pa ndodhur kjo (mekanizmi i balancës politike që ka sot Kodi Zgjedhor), ju kërkoni vetëm të rikonfirmohet ajo që keni bërë më 6 mars të vitit 2022 dhe në zgjedhjet e vitit 2023.

Po ju them edhe diçka tjetër. Është detyrim për KQZ-në dhe Ministrinë e Brendshme që të marrin masa për votimin e diasporës dhe dispozitat janë të mjaftueshme. Nuk duhet të shërbejë vendimi i Gjykatës Kushtetuese si pengesë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

apo për Ministrinë e Brendshme. Pyetje: çfarë ka bërë Ministria e Brendshme për regjistrin e emigrantëve? Zero deri më sot. Pa u bërë kjo, çdo masë tjetër është pa vlerë.

E fundit. Në vitin 2012, pas shumë përpjekjesh për të hequr imunitetin, për të filluar hetimin, pra autorizimin për hetim, më së fundi arritëm të merrnim me zor konsensusin e Partisë Socialiste që ankoheshin te ndërkombëtarët "duan ta heqin imunitetin se na godasin ne", për të mbrojtur veprat korruptive". Ka qenë Sali Berisha kryeministër, që e propozoi në vitin 2012 dhe është kjo dispozitë që është sot.

Kështu që t'i lëmë gjërat e paqena dhe ta votojmë menjëherë pa asnjë vonesë, sepse në fund fare, edhe kjo është për procedurë, zonja Kryetare, procedura që keni futur në Rregullore është antikushtetuese. Kuvendi nuk mund të kthehet në gjykatë, siç e keni kthyer ju me këtë dispozitë, nuk mund të shqyrtojmë ne provat që vijnë nga prokuroria.

Prokuroria, jo vetëm që nuk ka detyrim të respektojë Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, e kemi ne, vetëm për ne është ky detyrim, por prokuroria duhet të shkojë në gjykatë të marrë vendimin e gjykatës dhe ky parlament, pasi gjykata të ketë parë provat dhe të ketë kërkuar arrestimin e Arben Ahmetajt, duhet ta mbyllë gojën dhe të votojë. Kjo që bëni ju është antikushtetuese.

Lindita Nikolla – Vijojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, raporti i veprimtarisë vjetore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2022. Në bazë të nenit 103, pika 2 e Rregullores së Kuvendit dhe nenit 10, pika 2 e ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë", sot do të paraqesë raportin vjetor për vitin 2022, kryetarja e Autoritetit, zonja Gentjana Sula.

Zonja Sula, fjala për ju.

Koha që keni në dispozicion është deri në 20 minuta.

Gentjana Sula – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Raportimi i sotëm përmbledh punën e bërë nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit gjatë vitit 2022. Do t'ju përmbledh arritjet, sfidat, objektivat dhe synimet për më tej.

Siç jeni në dijeni, Autoriteti është krijuar në frymën e rezolutës 1481, të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës "Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste", të vitit 2006.

Sot, 84 vjet nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore, në prag edhe të 80-vjetorit të çlirimit të vendit, 32 vjet pas rënies së komunizmit, AIDSSH-ja, sikurse njihet, e zhvillon veprimtarinë e vet në respekt të vlerave europiane properëndimore, me qasje strategjike ndaj dokumenteve historike dhe kujtesës, duke pasur në themel të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e tij, lirinë, demokracinë, barazinë para ligjit dhe shtetin e së drejtës.

Viti 2022 ka qenë i rëndësishëm për Autoritetin, pasi përfundoi mandatin e vet të parë 5-vjeçar dhe Kuvendi zgjodhi anëtarët e rinj, duke konsistuar në dhjetor të vitit 2022, kryetaren e mandatit të dytë.

AIDSSH-ja ka hyrë në vitin e gjashtë të funksionimit, duke mundësuar ushtrimin e së drejtës të çdo të interesuari për t'u informuar mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Viti ka pasur jo pak përpjekje, por edhe suksese. Autoriteti është një organ kolegjial që ka kryer 62 mbledhje, ka marrë 761 vendime, ka verifikuar 210 kandidatë apo zyrtarë; kandidatë për detyra të larta, ku 6 prej të cilëve kanë figuruar me probleme në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; ka marrë 65 kërkesa institucionale për t'i bërë këto verifikime; kemi pasur 555 aplikime individuale, 9 kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh; 295 kërkesa për qëllime rehabilitimi apo dëmshpërblimi apo pajisje me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit për efekt pensioni; 122 kërkesa studimore dhe mediatike, duke vënë në dispozicion një grup të madh dosjesh, prej të cilave vitin e kaluar janë digjitalizuar 155 mijë dokumente.

Autoriteti ka qenë transparent, pasi për të gjitha proceset ka pasur vendime dhe kemi qenë transparentë në verifikimin e kandidatëve për detyra të larta, të kërkesave individuale, studimore dhe mediatike, duke i publikuar të gjitha vendimet përmes një buletini 2-mujor, si në letër, edhe në versionin elektronik.

Në progres-raportin e vitit 2022, Komisioni Europian për Shqipërinë, në kapitullin "Për pajtimin dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore"

nënvizoi nevojën për përfundimin e procesit të deklasifikimit të dosjeve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, duke i bërë ato më të aksesueshme për studiuesit dhe për publikun e gjerë. Në këtë kuadër, Autoriteti, përgjatë vitit 2022, e ka intensifikuar punën për deklasifikimin e dosjeve, gjithmonë duke përjashtuar ato ku cenohet siguria kombëtare dhe ka vijuar punën me digjitalizimin e tyre. Me ndryshimet ligjore kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet një pune të kujdesshme, ku gjithmonë duhet të kihet kujdes siguria kombëtare dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me aktet ndërkombëtare dhe ato të legjislacionit shqiptar.

Sot Shqipëria është pjesë e Rrjetit Europian të Institucioneve të ish-Policive Sekrete, ku ndodhen të lidhura institucione të ngjashme dhe homologe të AIDSSH-së. Vijon të jetë e pranishme si anëtare vëzhguese në Rrjetin Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit, ku përmes Ministrisë së Kulturës po përpiqemi për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë, dhe besoj se një dokument ligjor do të vijë në parlament për t'u miratuar përmes Ministrisë së Kulturës. Me rotacion, Shqipëria do të drejtojë Rrjetin Evropian të Institucioneve të ish-Policive Sekrete, duke organizuar në vend edhe konferencën periodike për të gjithë anëtarët e Rrjetit.

Partnere aktive të Autoritetit ndër vite kanë qenë organizatat ndërkombëtare si OSBE-ja, Kombet e Bashkuara, Bashkimi Europian, por edhe partnerët bilateralë si ata amerikanë, gjermanë, suedezë, të cilët gjej rastin t'i falënderoj, sepse na mundësuan një financim serioz për godinën, zviceranë, italianë, polakë, izraelitë e të tjerë.

Autoriteti e gjen veten me një bilanc pozitiv sa i takon infrastrukturës së arkivës, shërbimit të dokumentacionit, rolit në komunikimin publik dhe rritjes së ndërgjegjësimit për të zhdukurit në komunizëm.

Me pak fjalë do t'ju përmbledh se ku jemi me plotësimin e rezolutës së Kuvendit për vitin 2022. Aktiviteti i AIDSSH-së është zhvilluar në bazë të këtyre pikave:

Së pari, në angazhimin për hartimin e draftit të aktit nënligjor, i cili përcakton autoritetet përgjegjëse dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara, për të cilën janë realizuar disa tryeza teknike me partnerët e përfshirë. Jemi të mendimit se ky rekomandim i parlamentit është realizuar.

Së dyti, në dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga arkivi i sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kemi pasur vështirësi për tërheqjen e disa akteve dhe të shumë fondeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në zbatim të urdhrit të përbashkët ndërmjet dy institucioneve ka filluar dorëzimi, kemi marrë në dorëzim 5 fonde dhe po vijon puna.

Së treti, në intensifikimi e bashkëpunimit me institucionet qeveritare për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm. Në datën 3 shkurt të vitit 2022, është nënshkruar marrëveshja me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, për garantimin dhe realizimin e një procesi të rregullt ligjor për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të atyre që u zhdukën gjatë periudhës komuniste. Nga Ministria e Brendshme na është vënë në dispozicion një fond i rëndësishëm arkivor, fondi i komunikatave ditore për periudhën 1949–1991, si dhe janë vendosur memoriale përkujtimore për të zhdukurit në Tepelenë dhe në Maliq.

Gjithashtu, është organizuar një vizitë pune pranë institucionit homolog kroat, për të parë teknikalitetet dhe mënyrën se si organizohet procesi i gjetjes dhe i identifikimit të të zhdukurve, e cili do të na ndihmojë për të krijuar aktet e nevojshme dhe për ta operacionalizuar më mirë procesin.

Së katërti, në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të arkivit digjital, me qëllim lehtësimin e procesit të kërkimit dhe të konsultimit me dokumente arkivore, sipas standardeve ndërkombëtare. Autoriteti nga njëra anë ka zhvilluar *software-in*, i cili do të bëjë të mundur identifikimin në dokumente, qoftë në nivel fjale, por njëkohësisht ka filluar të pasurojë me dokumentacion të skanuar arkivor, arkivin digjital, i cili do ta lehtësojë shumë procesin e kërkimit. Pra, është një rekomandim i zbatuar.

Së pesti, në bashkëpunimin me ISKK-në (Institutin e Studimit të Krimeve të Komunizmit dhe të Pasojave). Gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish- Sigurimit të Shtetit gjatë vitit 2022 është realizuar një bashkëpunim shumë i mirë ndërmjet dy institucioneve, duke vënë në dispozicion materialet, sipas kërkesës.

Së gjashti, në bashkëpunimin me institucionet homologe të huaja, me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira nga

veprimtaria e tyre. Siç jua përmenda, institucioni ka qenë në aktivitete me institucione të ndryshme për të siguruar një kulturë të kujtesës të standardeve ndërkombëtare.

Së shtati, në intensifikimin e punës për deklasifikimin e dosjeve, duke përjashtuar ato që cenojnë sigurinë kombëtare dhe duke vazhduar me digjitalizimin e tyre. Autoriteti ka punuar intensivisht për deklasifikimin e dokumenteve. Vjet janë deklasifikuar 75 mijë dokumente arkivore. Me ndryshimet ligjore, kjo kërkesë do të intensifikohet edhe më shumë në kohët që vijnë. Do të flas më tej lidhur me këtë.

Së teti, publikimin në faqen zyrtare *online* të Autoritetit, të listës së individëve që kanë rezultuar si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit. Lidhur me këtë pikë të rezolutës është hasur vështirësi, për shkak se të dhënat personale mbrohen nga një kuadër i gjerë ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, që synon të mos cenohet imazhi dhe jeta private e personave. Sidoqoftë, në lidhje me këtë, Autoriteti ka shprehur edhe mënyrën se si mund të zgjidhet më tej transparenca, duke propozuar ndryshime ligjore në kuadrin e reformës së Kodit Zgjedhor, për të cilën mund të flas më tej.

Ky vit kaq qenë i rëndësishëm, sepse janë bërë disa ndryshime ligjore që synuan:

Së pari, siç jeni në dijeni, lindi nevoja për ndryshime të mëtejshme në disa dispozita ligjore, për të cilat Kuvendi u investua dhe realisht realizoi ndryshimin e ligjit nr. 45/2015. Kështu, për shembull, u hoq mburoja për figurat e larta publike, përmes shfuqizimit të pikës 4, të nenit 29, që rezultonin me certifikatë sigurie nga komisionet "Mezini" dhe "Bezhani".

Së dyti, thellimin e hetimit, marrjen e informacionit nga personat e tretë në funksion të zgjidhjes së problematikave të krijuara rast pas rasti. Pra, institucioni mori disa kompetenca shtesë.

Së treti, u hoqën barrierat për kërkuesit shkencorë dhe mediatikë, të cilët, kanë tashmë mundësi më të shtuar për të parë dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Së katërti, u vendos pika e bashkëpunimit me muzetë kombëtarë të kujtesës dhe organizimi i vizitave shkollore, duke zgjeruar funksionet e edukimit qytetar edhe në funksion të brezave të rinj dhe të përfshirjes së tyre në aktivitet përkujtimore.

Së pesti, u vendosën sanksione nga Autoriteti. Pra, nga ana e Autoritetit mund të vendosen sanksione, në rast se ka keqpërdorim ose shpërndarje të paautorizuar të informacioneve apo të të dhënave personale që gjenden në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Së gjashti, kompetencë e shtuar për të ndërvepruar me Ministrinë e Brendshme për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të ekzekutuarve.

Së shtati, garantohet e drejta e çdo qytetari për t'u njohur me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, duke e vënë theksin te përgjegjësia që mbart çdo kërkues për keqpërdorimin e informacionit të marrë.

Së teti, u rishikua edhe fusha e veprimit të ligjit, që rregullon veprimtarinë e institucionit për të shmangur problematikat e hasura nga Autoriteti dhe institucionet e tjera gjatë procesit të dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit apo të lidhura me to, sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Pra, patëm një zgjerim dhe përmirësim shumë të madh të kuadrit ligjor.

Ndërkohë kemi marrë edhe një shtesë organike prej 5 personash, që na lejoi krijimin e një drejtorie të posaçme për trajtimin e personave të zhdukur gjatë komunizmit.

Në fushën e arkivit, puna është evidentuar në rritje. Ka qenë thelbësor transferimi i dokumenteve arkivore të dorëzuara nga SHISH-i dhe Ministria e Brendshme në godinën e re, ku jemi tashmë. Është vazhduar me përmirësimin e kushteve të ruajtjes së dokumenteve, në kushte të caktuara fizike dhe klimaterike më të mira, për t'i ruajtur nga dëmtimi dhe shpërdorimi, duke garantuar se dokumentet nuk lexohen, nuk kopjohen, nuk ndryshohen dhe nuk asgjësohen apo largohen pa autorizim. Vazhdon procesi i grumbullimit dhe i marrjes në dorëzim të dokumenteve që evidentohen në arkiva të ndryshme të rrjetit.

Në fushën e kërkimit të individëve, ju thashë se vazhdon intensiteti, ka pasur rritje. Për sa u përket kërkesave institucionale ka një rritje të bashkëpunimit me bashkitë. Kështu, për shembull, në 9 bashki ka filluar verifikimi jo vetëm i personave që marrin detyra të larta publike, por edhe i atyre që propozohen për tituj vendorë të nderit si "Qytetar Nderi", apo për dekorime të ndryshme. Janë mbyllur procedurat e verifikimit për rreth 44 kandidatë, 5 nga të cilët

figurojnë si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit, ndërsa një kandidat si dëshmitar për çështje politike.

Kemi 122 kërkesa studimore/mediatike, dhe ky është një proces që vjen në rritje. Çdo kërkesë është trajtuar nga 500-600 dokumente që u janë dhënë palëve, pra, bëhet fjalë për një volum të madh pune, i cili vazhdon, duke qenë se interesi publik për çështjet e ish-Sigurimit të Shtetit ka ardhur në rritje.

Për sa i përket ecurisë së procesit të identifikimit dhe të rikuperimit të trupave të zhdukur, ka pasur një rritje të kërkesave. Janë depozituar 94 kërkesa, nga të afërm të personave të zhdukur. Kërkimi arkivor ka vijuar qoftë në arkivat e Autoritetit, qoftë në arkivat e rrjetit. Duhet thënë se shumë dokumente nuk gjenden, por gjenden vetëm disa prej tyre. Kështu, për shembull, në arkivin tonë rezultojnë 23 kërkesa me të dhëna arkivore, 25 kërkesa pa të dhëna; Ministria e Brendshme ka të dhëna për 4 kërkesa, 81 kërkesa pa të dhëna arkivore; nga 38 kërkesa drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, 11 janë me të dhëna dhe 27 pa të dhëna. Sidoqoftë, më duhet t'ju them se edhe kaq informacion sa gjejmë, është i mjaftueshëm për të kërkuar dhe për ta dokumentuar sa më mirë fenomenin dhe për të shkuar drejt së vërtetës.

Kemi ndërtuar *database-n* e detajuar për personat e zhdukur, personat e afërm të të cilëve kanë aplikuar pranë institucionit tonë dhe jemi në proces pune për miratimin e një draft-vendimi për Këshillin e Ministrave, i cili duhet t'i rregullojë veprimtarinë mes të gjitha institucione.

Për fat të mirë, OSBE-ja në Shqipëri po vazhdon të moderojë një proces bashkëpunimi me gjithë institucionet e tjera. Shpresojmë shumë që këtë vit kjo VKM të bëhet realitet, sepse megjithëse institucioni ka filluar punën, ndërveprimi me institucionet e tjera ligjzbatuese vihet në pikëpyetje.

Edukimi qytetar është një aktivitet shumë i rëndësishëm i Autoritetit me brezat gjithnjë e më të rinj, pasi jo vetëm fëmijët e shkollave, por edhe mësuesit tashmë janë të painformuar mirë për periudhën e diktaturës, kështu që kemi qenë aktivë në këtë fushë. Aktiviteti kryesor është marrëveshja me Ministrinë e Arsimit për krijimin e platformës "Mësojmë për të shkuarën", një platformë me burime të hapura përmes së cilës kemi shpresë që ngjarje të ndryshme që po zbardhen, të përçohen te fëmijët.

Aktivitete të rëndësishme janë bërë edhe në bashkëpunim me pushtetin vendor. Do të doja ta theksoja këtë, pasi ka qenë e rëndësishme për vitin e shkuar. Kemi punuar në Elbasan, në Tepelenë, në Maliq, në Qafë Bari, në Valmir, në Vlorë dhe në Gjirokastër, duke prekur ngjarje shumë të rëndësishme të asaj periudhe që nga revolta e Qafë-Barit, revolta e Valmirit; kemi vijuar me pelegrinazhin e dhimbjes në kampin e Tepelenës; kemi prekur çështjen e punës së detyruar dhe të zhdukurve në ish-kënetën e Maliqit, në kampin e Vloçishtit; kemi promovuar filmin "Fluturat", me të internuarat në Gradisht e Savër; në qytetin e Vlorës kemi filluar bashkëpunimin me ish-të përndjekurit politikë të qytetit, me synimin për të hapur dialogun lokal për të shkuarën në këtë trevë, ku ka ngjarje të panjohura për publikun; kemi punuar me të rinj artistë në aktivitetin "Muza ime", kushtuar kujtimit të Musine Kokalarit, në qytetin e Gjirokastrës. Në Tiranë kemi pasur një simpozium shkencor: "Tirana nën kontrollin e pushtetit komunist- tatimet, konfiskimet, internimet, rezistenca në fillimet e regjimit totalitar 1945-1949". Kemi promovuar një libër shumë interesant të autorit Jozef Radi, "Njeriu përballë përbindëshit - dosje të pafundme të Musa Sinës"; u shfaq monodrama "Udha e qumështit", leximi i një dosjeje shumë interesante.

Njëkohësisht kemi pasur veprimtari edhe jashtë Shqipërisë. Kështu, për shembull, me diasporën e Belgjikës kemi pasur një aktivitet shumë interesant në Bruksel, ku kemi dorëzuar dosje që ishin kërkuar nga diaspora; kemi shfaqur filmin "Edhe muret kanë veshë"; kemi krijuar ura shumë të mira bashkëpunimi qoftë me ambasadën shqiptare, apo me shoqatat atje, si, për shembull, me shoqatën "Vlera", apo radion "Jehona e shqipes" si dhe me Zyrën për Shqipërinë në BE për t'u komunikuar vizionin tonë për dialogun mbi të shkuarën.

Për sa u përket botimeve, Autoriteti ka realizuar 56 botime në letër, 59 botime *online* dhe kemi qenë aktivë në medien sociale. Një ndër aktivitetet më të rëndësishme, për të cilën jeni vënë në dijeni përmes komunikimeve publike, ka qenë edhe mbledhja e dëshmimeve, ku janë mbledhur rreth 14 orë intervista me dëshmi të familjarëve të të zhdukurve, e cila është botuar.

Për sa u përket sfidave për të ardhmen, do të doja të flisja për problematikat dhe të bëja disa sugjerime ku kërkohet edhe ndihma juaj.

Çështja e parë ka të bëjë me një sfidë që e përmenda. Duhet miratuar një vendim i Këshillit të Ministrave për të përcaktuar autoritetet përgjegjëse për mënyrën e mbrojtjes dhe të ruajtjes së vendvarrimeve të të zhdukurve. Ju përmenda se kemi bërë një draft për këtë, i cili po përmirësohet duke e detajuar nga ana teknike dhe mendojmë se këtë vit duhet të miratohet patjetër. Këtu kërkojmë edhe angazhimin e deputetëve, që kanë qasje edhe në qeveri, të cilët mund të na ndihmojnë.

Çështja e dytë ka të bëjë me procesin e verifikimit të kandidatëve për deputetë/ kryetarë bashkie, ku vihet re një angazhim minimalist i subjekteve politike për zbatimin e nenit 30, të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar.

Në përmbushje të detyrave funksionale ne kemi qenë aktivë dhe u kemi dërguar letra partive politike, që në prag të zgjedhjeve të na bëjnë prezent formularët e mbushur për të gjithë kandidatët, por kjo ka ndodhur në mënyrë sporadike. Për këtë arsye nevojiten ndryshime imediate në dispozitat e Kodit Zgjedhor, në mënyrë që neni 30 të jetë i zbatueshëm për të gjithë.

Insistojmë se ky është një standard që e kanë të gjitha vendet e tjera, që kanë pasur probleme me diktaturën dhe nuk ka pse të mos ecet me këto eksperienca pozitive të vendeve të tjera. Të paktën vetëdeklarimi duhet të bëhet, kështu na japin edhe ne mundësinë që me kohën të mund të realizojmë verifikimet.

Çështja e tretë ka të bëjë me propozime të Autoritetit për Informimin për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për ligjin "Për medaljet, dekoratat dhe titujt e nderit". Tashmë Autoriteti, pas verifikimeve lidhur me pastërtinë e figurës së personit të propozuar për dekorim, ka konstatuar se shpeshherë kandidatët për tituj medaljesh kanë qenë të implikuar. Është e udhës që çdo dhënie tituj/medaljesh të kalojë nga Autoriteti për t'u verifikuar.

Çështja e katërt, ka të bëjë me ligjin "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Edhe këtu mendojmë se Autoriteti duhet të jetë palë prezente dhe të ndihmojë institucionet e kulturës që të themelojnë muzetë e nevojshëm. Për këtë kemi bërë dy propozime për kampet e punës në Tepelenë dhe në Spaç, të cilët janë propozuar për t'u kthyer në muze

E fundit, ne kemi folur edhe herë të tjera lidhur me nevojën për të përmirësuar dëmshpërblimin e viteve të internimit të fëmijëve, që kanë jetuar më familjet e tyre në internim. Shpeshherë është i pamundur dokumentimi i tyre, por kemi evidentuar edhe rrugën se si mund të bëhet ky dokumentim, të cilin e kemi bërë të ditur dhe do të vazhdojmë ta bëjmë.

Në mënyrë të përmbledhur, ky ishte aktiviteti ynë për vitin 2022.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Faleminderit, zonja Sula!

Pyetjet nga deputetja Mesila Doda, i keni në dispozicion, kështu që mund të përgjigjeni.

Gentiana Sula – Pyetja që më është bërë, është kjo: ju keni punuar për historinë e burgut të Spaçit dhe aktivitetin e zhvilluar atje. Sipas të dhënave të media, në këtë burg janë prodhuar nga të burgosurit 3,2 milionë tonë bakër dhe 2 mijë tonë ar. A keni dijeni se ku ka përfunduar ari i nxjerrë nga të burgosurit e Spaçit? A ka një hetim nga organet e drejtësisë për këtë vjedhje të jashtëzakonshme për shqiptarët, që është thuajse sa vlera e përgjithshme e thesarit të shtetit?

Në raport me burgun e Spaçit, këtë vit në kuadrin e 50-vjetorit të revoltës së Spaçit, Autoriteti krijoi një grup pune dhe ka punuar intensivisht për ta dokumentuar sa më mirë çështjen. Kemi evidentuar personat, kemi evidentuar edhe kontekstin e burgut të Spaçit dhe të revoltës, duke shfrytëzuar burime të tjera si burimi arkivor i "al-bakrit"; është evidentuar puna e detyruar dhe produktet e saj, siç janë 4 milionë tonë bakër mineral dhe pirit dhe njëkohësisht edhe një sasi ari. Nuk ka qenë në fushën e veprimit të ligjit të gjejmë se ku ka shkuar ari i nxjerrë, gjithsesi jemi në proces të deklasifikimit të dokumenteve të industrisë nxjerrëse dhe minerare, bëhet fjalë për mijëra faqe. Mendoj se çdo kërkesë studimore që paraqitet, duhet ta shfrytëzojë këtë fond për të njohur fatin e produkteve të punës të ish-burgosurve të Spaçit.

Lindita Nikolla - Faleminderit, zonja Sulaj!

Fillojmë me diskutimet.

Fjala për zonjën Ermonela Felaj. Të përgatitet zoti Lefter Gështenja.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Kryetare!

Nuk e mora rastësisht këtë fjalë, por pikërisht sepse raportohej nga Autoriteti i Dosjeve ose Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Në fakt, ne, në këtë parlament, kemi lënë diçka përgjysmë që nga viti i shkuar, gjë e cila u vu në dukje edhe në formën e një sugjerimi nga ana e kryetares së Autoritetit. Po, në fund të vitit të shkuar, ne miratuam disa ndryshime shumë të rëndësishme në ligjin për autoritetin e dosjeve, që ka për detyrë të informojë publikun mbi ish-të kaluarën e regjimit komunist, në fakt, i duheshin dhënë mjetet dhe instrumentet ligjore në duar për të bërë të mundur ushtrimin e kësaj detyre dhe për të mos u ndarë me të njëjtat rezultate, siç më herët janë ndarë të ashtuquajturit komisione "Mezini" dhe "Bezhani".

E dini se sa ka qenë bilanci i dosjeve së dy komisioneve të ngritura nga politika e 30 vjetëve? Përfundoi në 6 kuti nga komisioni "Mezini" dhe 3 kuti nga komisioni "Bezhani", sepse kaq punuan. Politika e 30 vjetëve, ajo politika që flet gjithë ditën për moral, ajo politika që të drejton gishtin pa vënë një herë veten përballë pasqyrës, ajo politikë, në fakt, çoi në këtë bilanc, sepse i instrumentalizoi ato komisione, instrumentalizoi ligjin duke lejuar që ish-bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, , hierarkë të armës më të fortë që kishte regjimi komunist, të depërtonin dhe të vijonin të dominonin dhe të dominojnë edhe sot në jetën politike dhe shoqërore të këtij vendi.

E pra, në fund të dhjetorit 2022, ne kemi premtuar se nuk do ta linim me kaq ndërhyrjen në ligjin për Autoritetin e Dosjeve, por do të vijonim më tej, që "gjuetia e shtrigave" që këtu ndodh rëndom, që njerëzve u vihet gishti dhe pastaj u kërkohet ta provojnë a janë kështu apo nuk janë, të mos ndodhë.

Po kthehem te neni 30 i ligjit. Ky nen i ligjit të Autoritetit të Dosjeve, kjo dispozitë për të cilën sapo foli kryetarja e Autoritetit, ku shprehu shqetësimin që zyrtarët e niveleve lokale, po, në fakt, të gjithë zyrtarët, nuk vijnë që të marrin *clearing* nga Autoriteti i Dosjeve, sigurisht që nuk do të vijnë dhe nuk ka për të ndodhur asnjëherë, sa kohë që kjo gjë të jetë diskrecionale, sepse duhet ta bëjmë me detyrim.

E pra, në nenin 30 të ligjit, thuhet: "Të gjithë ata që kanë qenë anëtarë ose kandidatë të Byrosë Politike, anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtarë të Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetarë të Gjykatës së Lartë, prokurorë të Përgjithshëm, kryetarë të Hetuesisë së Përgjithshme, anëtarë të Këshillit të Ministrave, kryetar të degëve të Punëve të Brendshme, anëtarë të Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokurorë, gjyqtarë në procese të posaçme politike, dëshmitarë të akuzës në këto procese apo punonjës të nivelit të lartë të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, duke përfshirë këtu edhe denoncuesit, edhe akuzatorët...", pra, të gjithë këta që regjimi i përdori për të nëpërkëmbur jetë njerëzish, nuk mund të jenë, nuk duhet të jenë dhe nuk duhet të bëjnë punën, fjala vjen, të Presidentit të Republikës, të anëtares së Këshillit të Ministrave, të zëvendësministrave, të funksionarëve politikë, anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore dhe pozicione të barasvlershme me to, anëtarë të organeve të sistemit të drejtësisë, nuk mund të jenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të jenë funksionarë të Forcave të Armatosura të Shtabit të Përgjithshëm, të Gardës së Republikës, nuk mund të jenë ata që mund të mbajnë gradën "Gjeneral" apo "Kolonel", nuk mund të jenë prefektë, por nuk mund të jenë as në shërbimet informative të vendit, nuk mund të jenë as drejtues policie në nivel qarku dhe komisariati, nuk mund të jenë drejtues, nuk mund të jenë në përfaqësitë tona diplomatike, nuk mund të jenë në Bankën e Shqipërisë, nuk mund të jenë në Akademinë e Shkencave, nuk mund të jenë në Radio-Televizionin Publik, nuk mund të jenë në Agjencinë Telegrafike Shqiptare. Çdokush që emërohet, çdokush që zgjidhet, çdokush që merr një post zyrtari për të influencuar në jetën shoqërore në këtë vend, sigurisht, kur më herët ka pasur këto rekorde, nuk duhet të jetë në këto detyra, e, nëse është, duhet t'i ndërpritet ky lloj mandati dhe duhet të shkarkohet.

Këtë ka propozuar Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste të adresohet si ndryshim në ligjin për dekriminalizimin me vetëm 4 nene, dhe ne shlyejmë atë që ka bërë gabim për 30 vjet gjithë politika e mbrapshtë në këtë vend, duke larguar një herë e përgjithmonë jo thjesht origjinalët e ish-Sigurimit të Shtetit, kjo patjetër që është një shqetësim i madh mbarëshoqëror, por të largojmë edhe kopjet, se për sa kohë do të jetë në qarkullim origjinali, ne do të kemi këtu, do të kemi kudo, edhe kopjet. Kopjet janë ato që vijnë të flasin e të thonë: "hajdut", "gjobaxhi", pa pikën e cipës.

Kopjet janë asgjë më shumë. Këtë bënte regjimi, të vinte gishtin dhe pastaj të ndërtonte faktin.

Po këta njerëz, që e kanë kaq të lehtë t'i thonë dikujt që e kanë përballë, që e kanë kundërshtar, a përballen dot me ligjin dhe të shkojnë të provojnë këto shpifje kaq të ulëta të tyre?! A kanë cipë këta njerëz kur merren me familjarët, kur merren me bashkëshortët, kur merren me motrat, me vëllezërit?! Në këtë vend është bërë që të kesh motër, të kesh vëlla, të kesh burrë, të jesh njeri i ndershëm, të kesh cipë, të kesh guxim, të kesh kurajë, të përballesh, të shohësh në sy, të mos fshihesh pas frustrimit dhe të mos fshihesh pas veshit..., po, e kundërta duartrokitet, sepse publikut i pëlqen loja e gaztorit, i pëlqen loja e palaços, i pëlqen loja e harbutit.

Unë jam në politikë që prej vitit 2009 dhe në politikë kam ardhur me vullnetin tim të lirë, nuk më kanë sjellë as lojërat, as lidhjet, as ndonjë karrierë e hershme e zhvilluar në ndonjë bodrum selie partie. Po, kam qenë prokurore dhe jam e nderuar, sepse në këtë parlament, në 30 vjet, vetëm 3 njerëz kanë ardhur nga Shkolla e Magjistraturës. Në fund të ditës, jam njeri i arsyeshëm dhe formimin dhe arsyen time nuk i nëpërkëmb dhe nuk i ndërroj me bindjen time të brendshme.

Unë kam votuar që të lejohet prokuroria që të vendosë masën e arrestit me burg për Arben Ahmetajn, dhe këtë gjë nuk e kam bërë sepse kështu ka urdhëruar partia ime, këtë gjë e kam bërë sepse kam bindje, dhe bindja ime buron nga formimi im, por kur dëgjoj këtu të thuhet: "T'ju vijë turp atyre që ishin në komisionin hetimor", kjo është skandaloze! Nëse nuk do të ishim ne në komisionin hetimor, zonjë, ti nuk do të kishe mundësi ta drejtoje atë komision hetimor, nuk do të kishe mundësi të lexoje një raport!

Edhe sot që ishte dita t'i falënderoje kolegët e tu, të falënderoje zotin Spaho, fjala vjen, të falënderoje zotin Këlliçi, zotin Boçi, nuk e bëre, sepse kolegët e tu nuk e votuan raportin tënd, sepse këtu logjika e kundërshtarit nuk funksion sipas përballjes me të vërtetën, por funksionon sipas përballjes me gënjeshtrën; këtu logjika e kundërshtarit nuk funksionon sipas standardit të njerëzillëkut dhe qytetarisë, por funksionon sipas standardit të harbutit.

(Debate në sallë)

Unë, kolegë, ju ftoj të gjithëve që, kur të votoni për të hequr origjinalët, të jeni të lumtur se keni hequr edhe kopjet. Dhe e dini çfarë kopjesh keni hequr? Keni hequr kopjet e harbutëve, të cilët nuk meritojnë as të dëgjohen.

Poshtë harbutët, bashkë me spiunët!

Lindita Nikolla - Fjala për zotin Lefter Gështenja. 7 minuta keni, zoti Gështenja.

(Debate në sallë)

Zonja Felaj, zoti Bardhi, vazhdojmë me seancën!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju tërheq vëmendjen të dyve, edhe zonjës Felaj, edhe zotit Bardhi, edhe juve që flisni nga vendi!

Zonja Felaj, ju lutem!

Lefter Gështenja – A mund të filloj, zonja Kryetare?

Lindita Nikolla – Po, jua kam dhënë fjalën, zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, pas këtij debati, duket se situata në këtë sallë është pak e tensionuar. Ajo që nuk arrij të kuptoj nga kjo mazhorancë është se çfarë e shqetëson atë, që ashtu siç ka marrë vendimet deri dje, që pretendojnë se janë promotorët, janë flamurtarët e reformës në drejtësi, çfarë i pengon këta kolegë deputetë të mazhorancës që ta çojnë para këtë reformë? Pra, sot duhet të përfshihej në rendin e ditës kërkesa e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Kjo është shumë e thjeshtë, do të thosha.

Unë do të shkoj pak më tej argumenteve që dhanë në këtë sallë zoti Bardhi, por edhe kolegë të tjerë të opozitës: kjo mazhorancë e ka merak për të mos përfshirë në rendin e ditës heqjen e imunitetit të zotit Ahmetaj, sepse e di shumë mirë që, pas heqjes së imunitetit të tij, një sërë kolegësh të tjerë e kanë radhën në pritje pas dyerve të kësaj salle. E them me bindje absolute këtë, të paktën nga ajo çfarë kemi dëgjuar në komisionin hetimor. I gjithë zinxhiri qeveritar, që ka qenë pjesë e këtyre procedurave, përfshirë edhe drejtuesit vendorë, do të jenë pjesë për të shkuar para drejtësisë, nëse drejtësia do t'i shkojë deri në fund kësaj megaafere.

Gjithsesi, me thënë të drejtën, në fundjavë, dita nisi me një lajm të bujshëm, për të cilin jeni të gjithë në dijeni, lidhur me çështjen e Fushë-

Krujës. Normalisht, mendova të përgatis fjalën time për këtë çështje. Pa kaluar 24 orë, shkarkohet një ministër, ministri Çuçi. Thashë, po e përfshij edhe zotin Çuçi. Pa kaluar 24 orë, një bombë tjetër, kërkohet heqja e imunitetit të zotit Ahmetaj. Epo, thashë, po e ndryshoj si fjalë, po i lë këta dy të parët, po merrem me të tretin. Pa hyrë në këtë sallë në mëngjes, një lajm tjetër, një ish-zyrtar vendor i Partisë Socialiste arrestohet nga SPAK-u. Thashë, *inshallah* po e marr fjalën shpejt, që të mos e ndryshoj prapë, sepse çoç presim!

Gjithsesi, do të ndalem te rasti i inceneratorëve, meqë kam qenë edhe pjesë e këtij komisioni. Çfarë ka ndodhur në këta 10 vjet? Të gjithë e dimë se kjo qeveri e kishte prioritet të madh pastrimin e Shqipërisë, por rruga e ndjekur nga kjo mazhorancë ka qenë e gabuar, pasi kjo mazhorancë ka shkelur me të dyja këmbët ligjet e këtij vendi. Konstatohet lehtësisht se lidhur me inceneratoret kemi të bëjmë me disa shkelje të përbashkëta, që janë shqetësuese për të tre inceneratorët:

Mungesa e garës. Nuk ka pasur garë për asnjë nga koncensionet. Të gjithë e dimë, nuk është nevoja të jesh jurist apo prokuror, se për asnjërin nga koncesionet nuk ka pasur garë; në asnjë nga koncesionet nuk ka pasur procedura të pjesëmarrjes së kompanive të huaja; nuk ka pasur një analizë vlerë/kosto; nuk ka pasur asgjë lidhur me zbatimin e ligjit.

Kompani fituese të regjistruara në parajsa fiskale. Kompani pa licenca, të sapokrijuara. "Perla" e inceneratorit të Elbasanit, (do t'jua them sot) është që më 7 korrik, ish-kryetari i Bashkisë së Elbasanit kërkon të fusë me emergjencë çështjen e plehrave dhe më 11 korrik regjistrohet kompania, e cila është fituese e këtij koncesioni.

Kontrata që favorizojnë totalisht kompanitë private. Kompani të lidhura ngushtë me pushtetin. Janë të njëjtët persona dhe i njëjti grusht njerëzish, për të tria koncesionet. Oferta koncesionare të pakërkuara. Risku, që sipas ligjit duhet të transferohet te privati, transferohet te shteti. Në të tria koncensionet janë përfshirë të njëjtët njerëz.

Asnjë nga inceneratorët sot që flasim, (dy të parët në Elbasan dhe në Fier kanë përlarë fonde publike), nuk funksionojnë, nuk punojnë. Ky i Tiranës, po njëlloj, edhe pse gllabëron fondet publike dhe para nga taksat e qytetarëve të Tiranës, nuk funksionon si incenerator, por të tre luajnë atë rol që luajnë në të gjitha bashkitë e vendit, *landfille*, venddepozitime.

Inceneratori në Fier, edhe pse ende nuk ka përfunduar, i cili duhet të përfundonte në vitin 2019, vazhdon edhe sot merr para publike. Për atë që ka dyshime që inceneratorët janë në punë apo jo, mjafton një fakt shumë i thjeshtë: qëllimi për të cilin u ndërtuan inceneratorët, kolegë, ishte prodhimi i energjisë elektrike. Sot që ne flasim asnjë nga inceneratorët nuk prodhon energji elektrike, kjo tashmë e vërtetuar.

Si ka mundësi që i njëjti autoritet kontraktor, që është Ministria e Mjedisit, dhe qeveria për të tria procedurat kanë përdorur 3 standarde jo të njëjta. A e dini se cilat janë kriteret teknike dhe ligjore që duhet të plotësojë ofertuesi, të kërkuara nga autoriteti kontraktor? Ofertuesi i koncesionarit duhet të ketë paguar faturën e energjisë elektrike, ky është kushti i vetëm, dhe të jetë i regjistruar në QKB. Ndërkohë, koncesionari i parë i Elbasanit nuk ka pasur licencë për ndërtim dhe shitje energjie. Është e çuditshme që është tjetër procedurë. E njëjta gjë ka ndodhur në Tiranë, e njëjta gjë në Fier, si në vlerë dhe në kohë, nuk kemi një procedurë standarde për të tria koncesionet. Nuk ka një krahasim nëpërmjet alternativës së prokurimit publik me koncesion, ku të tregojë se zgjidhja e dytë ofron vlerën më të mirë të parasë. Vetëm atëherë autoriteti kontraktues do të duhet të merrte vendimin e përgatitjes së procedurës për dhënien e kontratës me koncesion, pasi sot, sipas raportit të KLSH-së, qytetarëve u kushton 3 deri në 4-fish më shumë.

Zonja Kryetare,

Meqë kohën e kemi të kufizuar në 7 minuta ne të opozitës, më duhet t'i kaloj disa paragrafë.

Dua të sjell në vëmendjen e qytetarëve që ne nuk duam të ecim me të njëjtin ritëm si kjo qeveri, kjo mazhorancë dhe ky parlament, që nuk kanë kohë dhe nuk duan të shkellin ligjin, kur më 16 dhjetor morën 17 vendime brenda 8 orëve. Ne nuk kërkojmë këtë ritëm, por të paktën një amendim, një ndryshim plani, mund ta bënit sot.

Më duhet të them se të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që afera prej 430 milionë eurosh, që është afera më e madhe korruptive e inceneratorëve, nuk mund të bëhej pa ideimin dhe pa mbështetjen e Kryeministrit. Hetimet e deritanishme i dhanë të drejtë Partisë Demokratike, por deri tani është zbuluar vetëm maja e ajsbergut. Siç e thashë, këto procedura e

përfshijnë të gjithë zinxhirin e zyrtarëve. Pse vetëm zoti Koka dhe zoti Ahmetaj janë përpara drejtësisë, kur i gjithë zinxhiri qeveritar është i përfshirë në këtë aferë? Pse fshihen ish-ministrat, qoftë ai i Transportit, qoftë ish-ministri i Drejtësisë dhe të gjithë ish-ministrat me radhë? Unë mendoj se kjo qeveri sot duhet të ketë frikë nga ligji. Tashmë ish-ministrat kanë marrë tmerr dhe këtë e tregon edhe mosprezenca e tyre në këtë parlament.

Të dashur shqiptarë,

Shkurt dhe shqip, me këta që kemi në krye Shqipëria nuk mund të ketë zhvillim. Është koha kur shqiptarët duhet ta braktisin të shkuarën dhe të korruptuarën e këtij vendi.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Dashamir Shehi. Të përgatitet zoti Isuf Çelaj. Zoti Shehi keni 5 minuta në dispozicion.

Dashamir Shehi – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Doja të thosha edhe unë 2 gjëra për temën e ditës, por do ta lë për një ditë tjetër, kur të kem pak më shumë kohë, sepse ia vlen.

Le të kthehemi te raporti i veprimtarisë së Autoritetit për Informimin, që është edhe çështje e rendit të ditës, sepse në këtë rrëmujë të përgjithshme edhe kjo është një temë të cilën nuk duhet ta harrojmë, pasi është një përgjegjësi shumë e madhe politike e morale për Parlamentin e Shqipërisë dhe për shoqërinë shqiptare.

Ky institucion nuk është bërë thjesht për të gjetur spiunët. Unë them që t'u japim një afat 3 apo 4-vjeçar, aq sa do të duhet, dhe besoj se nga koha e vjetër, spiunë materialë që janë marrë direkt me letrat, kanë ngelur shumë pak. Shyqyr që janë shumë pak! Sigurisht, duhen hapur letrat për ata që janë akoma sot në politikë dhe në administratën publike, sepse është gjynah i madh, pasi në ato fillime, në atë pasionin e madh, jemi marrë shpeshherë edhe me ndonjë nëpunës të vogël dhe gjatë këtyre viteve kemi parë që kanë hipur edhe te kjo tribuna këtu njerëz të cilët duhet të ishin larguar me kohë nga politika. Për këtë arsye them të vëmë një afat dhe kjo lloj historie, me spiunë e pa spiunë, të mbyllet për Shqipërinë, për të hapur një etapë tjetër më të rëndësishme, në gjykimin tim, edhe më të moralshme, të domosdoshme për shtetin shqiptar, por edhe për shoqërinë shqiptare, të bëjmë një operacion të madh politik, historik, por edhe kulturor.

Sa kanë vuajtur këta njerëz, se po harrohet kjo punë?! Pse vuajtën? Çfarë ka ngelur nga ato që kanë thënë këta zotërinj, e folur apo e shkruar, sepse jo të gjithë ishin heronj? Një pjesë e tyre mund të kenë qenë edhe viktima. Brezat që po vijnë nuk dinë kurrgjë se çfarë është bërë në kurriz të këtij populli, dhe kjo është shumë më e rëndësishme sesa të zbulojmë 1, 2 apo 3 spiunë, që kanë tepruar brenda politikës shqiptare. Edhe kjo ka rëndësinë e saj, por unë gjykoj që është më e rëndësishme kjo punë. Detyrimet materiale dhe detyrimet e tjera, në njëfarë mënyre, mirë apo keq, janë relativisht të zgjidhshme, kjo nuk është zgjidhur. Pse shkuan atje? Kush i çoi? Cila ishte kjo shejtan ideologjie, ky organizim absurd shtetëror, që bënte fajtorë njerëzit e vet, shpeshherë nga më të mirët?! Çfarë ka ngelur nga kujtesa historike e këtyre zotërinjve? A do të vlerësohen ato që kanë shkruar ata? A do të shkruajmë edhe ne se çfarë mendonin ata, se jo të gjithë kanë pasur mundësi të shkruajnë e të kujtohen? Cili është roli i shtetit në këtë mes dhe cili është roli i institucionit?

Unë gjykoj se ky institucion ka një rol të madh. Këtë operacion të madh ky institucion nuk mund ta bëjë vetëm, por edhe me institucionet e tjera, me mediet, me Ministrinë e Kulturës, me Ministrinë e Arsimit, e cila duhet ta fusë në tekstet shkollore atë që ka ndodhur në historinë e Shqipërisë, se si janë futur gjermanët apo italianët në kohën e fashizmit. Pra, gjykoj se institucioni duhet të mbështetet me të gjitha instrumentet që ka, me arkivat në radhë të parë. Arkiva e këtij institucioni nuk mjafton, pasi duhet të koordinohet me të gjitha arkivat e tjera të shtetit shqiptar, për të bërë një detyrë që i ka rënë këtij brezi.

Shumë prej jush janë të rinj dhe ndoshta nuk e dinë fare se çfarë ka qenë ajo histori, por i ka rënë këtij brezi që të bëjë këtë reflektim të madh moral, politik dhe historik. Në një farë mënyre, ne i kërkojmë vetes sonë që shoqëria jonë, "Shqipëria europiane", siç e quajmë, të reflektojë për të kaluarën e vet, të shkruajë për të kaluarën e vet, të ketë kurajën të pranojë gabimet e të kaluarës së vet. Ky do të jetë një lloj katarsisi edhe për politikën shqiptare, edhe për historinë e Shqipërisë, edhe për shoqërinë shqiptare. Unë

këtë e gjykoj më të rëndësishme sesa zbulimin e ndonjë emri apo të ndonjë dosjeje.

Siç e thashë, e mira është të largohen njëherë e mirë, sepse pas 30 vjetësh mbajmë ndërgjegjen e asaj që kanë bërë, por mbajmë në ndërgjegje edhe ata që, në emër të pastrimit, u larguan duke qenë shërbyesit e këtyre, nëpunës fare të vegjël.

Unë do ta mbështesja institucionin, nëse do të merrte këtë rrugë, nëse, siç e thashë, do të bënte një operacion të madh historik, politik dhe kulturor, që e gjithë shoqëria shqiptare të reflektojë për të kaluarën e saj. Pas 33 vjetësh duket sikur gjërat u mbyllën, u harruan dhe këtu qysh pas luftës kemi jetuar të lumtur të gjithë bashkë. Kjo është një gënjeshtër e madhe, sepse një pjesë e shqiptarëve kanë futur në burg shqiptarë të tjerë, një pjesë e shqiptarëve kanë gënjyer për të dëmtuar shqiptarë të tjerë. Kjo është e vërteta që duhet vënë në vend! Në qoftë se do ta bëjnë këtë punë, unë mendoj se e kanë bërë detyrën e tyre, por nuk mjafton një institucion i vetëm, i vogël siç është, për të reflektuar mbi një temë kaq të madhe, nëse këtë temë nuk e bën të vetën shteti shqiptar me të gjithë hallkat që ka.

Unë kaq kisha për këtë temë, sepse 5 minuta na keni lënë në dispozicion. Kjo është një temë që, edhe 5 orë po të flasësh, nuk mbaron, por mendoj se ky është tharmi i asaj që duhet thënë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala është për zotin Isuf Çelaj.

Të përgatitet zoti Tritan Shehu.

Isuf Çelaj – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

E ndoqa me vëmendje raportin vjetor të mbajtur nga zonja Sula, drejtuesja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Po ashtu, jam njohur edhe me projektrezolutën e Kuvendit për këtë institucion dhe në vazhdim po paraqes disa projeksione, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e punës dhe arritjen e objektivave të këtij institucioni kushtetues.

Duke analizuar pikën 2 të rekomandimit të Kuvendit, mendoj se, duke qenë se Autoriteti është i detyruar me ligj t'u shërbejë dhe të bashkëpunojë me institucionet kushtetuese të shtetit, është detyra jonë si legjislativ t'i detyrojë me ligj institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, që t'i drejtohen Autoritetit të Dosjeve me kërkesë për riverifikim të figurës së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie, pasi Autoriteti nuk bën verifikime kryesisht dhe, nëse do të lihet evazive në kuadër të bashkëpunimit sipas dëshirës, rrezikon të kemi keqpërdorimin e verifikimeve selektive, me mundësi shmangieje e mosdhënie përgjigjeje për subjekte të ndryshme, duke e kthyer në gjueti shtrigash ndaj personave të ndryshëm dhe sipas porosive politike të shefave. Kështu siç është ndërtuar ky rekomandim, e detyron Autoritetin të veprojë në formë lutjeje për bashkëpunim, ndërsa për palën tjetër, për institucionet, bashkëpunimi mbetet fakultativ, sipas dëshirës.

Po ashtu, edhe në pikën 5 të rekomandimit, përveç se të shkruhet, duhet të shprehet qartë, të parashikohet dhe të merren masa konkrete për vënien para përgjegjësisë të të gjitha institucioneve, të cilat kanë dhe vazhdojnë të mbajnë dokumente që kanë të bëjnë me ish-Sigurimin dhe veprimtarinë e tij. Brenda një afati të arsyeshëm dhe sa më të shkurtër, ky dokumentacion duhet të dorëzohet tek Autoriteti, sipas parashikimeve ligjore në origjinal ose në dublikat, në mënyrë që t'i shërbehet publikut, siç dhe ligji 45/2015 dhe VKM-të përkatëse e parashikojnë.

Më së shumti, kjo kategori dokumentacioni mbahet në arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe, nga informacionet që unë kam, padrejtësisht po përgatiten aktet e transferimit në Arkivin Qendror të Shtetit, duke ndjekur fatin e dokumentacionit të ish-Hetuesisë së Përgjithshme, i cili mbahet i vdekur, ndonëse është përgatitur dhe është i lidhur totalisht me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi hallka kyçe e veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit ishte hetuesia. Në fakt, aty montoheshin dhe fabrikoheshin të gjitha akuzat ndaj qytetarëve, duke i torturuar me metodat më makabre dhe shtazarake, duke i detyruar të pranonin faje dhe veprime që nuk i kishin bërë kurrë.

Ky material i arkivit të Hetuesisë së Përgjithshme, nga koha kur është dërguar në Arkivin Qendror të Shtetit dhe nga fillimi i veprimtarisë së Autoritetit, me kapacitetet që ai ka dhe me ritmet që ka ecur, do të ishte përpunuar e njëherazi do t'u ishte shërbyer subjekteve përkatëse, të cilave u takon të njihen me këto dokumente, duke mos i mbajtur e lënë të vdekura, njëherazi në funksion të publikut dhe për të

shmangur çdo dyshim për fshehje të qëllimshme, gjë e cila mund të thuhet me plot gojën për dokumentet e arkivit të ish-Partisë së Punës së Shqipërisë, e cila ishte ideatorja, krijuesja, organizatorja dhe drejtuesja e armës famëkeqe të ish-Sigurimit të Shtetit, ku raportohej për gjithçka dhe nga ku merreshin direktivat dhe urdhrat. Mbajtja më tej dhe mosshërbimi i këtij dokumentacioni e bën procesin të mangët, njohjen e kujtesën të zbehtë dhe kompromet imin e të gjithë aktorëve e faktorëve në këtë proces të hapjes së dosjeve dhe të njohjes së të kaluarës dhe të krimeve të komunizmit. Po kështu, dokumentet që duhet të jenë në Autoritet, të cilat e kanë mbaruar funksionin për të cilin janë krijuar, tashmë janë vetëm me vlerë historike dhe studimore, dhe, fatmirësisht, jo vetëm kemi miratuar ligjin për deklasifikimin e tyre total, por edhe afatet kohore, pa ndryshimet tona, e kanë bërë të tyren.

Nuk mund të vazhdohet vetëm me dosjet e përndjekjes së viktimave, por të zgjerohet diapazoni me ato të strukturuesve e superstrukturës, që mbahen akoma të fshehura pas krijimit të Autoritetit, gjë të cilën mund ta them me plot gojën. Ata oficerë sigurimi e hetues nuk paskan faj e përgjegjësi që i kanë detyruar forcërisht me dhunë e terror këta qytetarë, për të nënshkruar si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit! Kjo është e paligjshme dhe e pamoralshme, e kompromet on këtë proces dhe faktohet politikisht hapja e pjesshme, jo e plotë, dhe vetëm e dokumentacionit të viktimave, duke i viktimizuar për së dyti, duke u hapur plagë të reja. Por ne duhet të kthehemi në kohë e të gjykojmë rrethanat në të cilat ata janë detyruar ta pranojnë bashkëpunimin, me dhunë dhe me të gjitha format e presionit. Kështu që, ky do të mbetet vetëm një veprim për të hedhur hi syve, sa për të krijuar mjegullnajë.

Po kështu, dokumentacion që lidhet me ish-Sigurimin ka edhe në Ministrinë e Jashtme, ka edhe në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe në arkivat personale të ish-oficereve dhe të hetuesve të kohës së ish-diktaturës komuniste. Kjo kategori e përdor këtë dokumentacion për presion, si dhe i shet nëpër medie, në disa raste edhe të deformuara apo dhe sipas interesave të tyre okulte. Prandaj, të gjitha këto materiale, të këtyre arkivave, duhet të dorëzohen tek Autoriteti, që të përpunohen sipas ligjit që normon punën e tij.

Me shumë rëndësi mbetet zgjidhja e situatës së procesit të gjetjes së të zhdukurve dhe e rikuperimit të pasojave, barrë të cilën ia kemi ngarkuar Autoritetit, duke e "dërguar në pyll pa sëpatë". E them kështu, pasi as nuk i janë parashikuar fonde dhe për këtë është bërë pengesë nxjerrja e një VKM-je që i hap rrugën veprimit, pasi pa këtë VKM, Autoriteti dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë ligj nuk mund të hedhin asnjë hap, kazmë apo lopatë për të gërmuar në terren.

Po kështu, në ecurinë e procesit të gjetjes së personave të zhdukur rezulton se Autoriteti, në dijeninë time, ka mungesa të theksuara të dokumentacionit, i cili normalisht duhet të jetë në arkivin e Ministrisë së Brendshme, si për shembull ekzistenca e togave të pushkatimit që kanë funksionuar pranë policisë; hartat e vendvarrimeve; raportet e kufirit mbi vrasjet në kufi; korrespondencat e kabinetit të ish-ministrit, sidomos raportimet në sekretariatet e ish-Byrosë Politike të ish-Komitetit Qendror të ish-Partisë së Punës së Shqipërisë e të tjera; vendndodhje që unë nuk jam në gjendje t'i përcaktoj, por mbetet detyrë e specialistëve përkatës, e cila normalisht mund të parashikohet e të lihet detyrë nga kjo rezolutë, jo vetëm për Autoritetin, por edhe për institucionet e tjera, të cilat disponojnë të dhëna dhe informacione për këto raste.

Parlamenti nuk mund të mjaftohet vetëm me rezoluta e raportime formale, por të ngrejë grupe për inspektim. Në rastet kur gjendet dokumentacion i këtij lloji nëpër institucione që ende sot, pas 6 vjetësh të fillimit të veprimtarisë së Autoritetit, nuk është dorëzuar në destinacion, tek Autoriteti, në trajtë origjinale apo dublikat, siç dhe ligji e parashikon, personat përgjegjës të vendosen përpara përgjegjësisë, duke e trajtuar si fshehje të krimeve dhe pengim të zbatimit të ligjit e të transparencës.

Gjithashtu, do të propozoja të shtohet, të parashikohet, një detyrë për Autoritetin që në bashkëpunim me grupet e interesit, me Institutin e ish-të Përndjekurve Politikë, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Drejtësisë, të hartojnë akte e të sjellin propozime për ndërhyrje në ligj, në mënyrë që t'u jepet zgjidhje njëherë e mirë çështjeve që kanë të bëjnë me dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe me trajtimin dinjitoz, ekonomik e social të

tyre. Vetëm në rastin e pensioneve ka një ngërç të krijuar për shumë persona që kanë jetuar në internim apo edhe për fëmijët e lindur atje, për të cilët ka vështirësi në gjetjen e dokumentacionit për shume arsye, si parregullsitë e mbajtjes, ku ka raste kur në vendim figuron vetëm kryefamiljari, dhe, për më keq, kur dokumentacioni është zhdukur e nuk ekziston. Ndërsa, fakti është i njohur botërisht, problematika që në të kaluarën kanë qenë zgjidhur nëpërmjet komisionit trepalësh, sot mund të gjendet edhe një zgjidhje tjetër.

Shqipëria duhet t'i hetojë këto krime, t'i ndjekë penalisht ata që janë përgjegjës dhe të sigurojë dëmshpërblime për viktimat dhe familjet e tyre, kërkesa këto të ngritura, edhe nga institucionet e Bashkimit Europian, edhe nga OKB-ja. Jam i bindur se përpjekjet e qeverisë janë minimaliste dhe ka mungesë të qartë vullneti, pasi nuk është vetëm ngritja e 2 muzeve, e Shtëpisë me Gjethe dhe e Bunk'artit, që mjaftojnë për të mësuar historinë e ish-komunizmit dhe krimet e ish-Sigurimit të Shtetit, por ne duhet t'i qetësojmë vuajtjet e afërsisht 6 000 familjeve që kërkojnë ngushëllim, për të pasur mundësinë që të vendosin një tufë lule te varri i njerëzve të tyre të dashur. Duhet ta mbyllim këtë çështje që zvarritet për 32 vjet, si dhe duhet të japim kompensim për mundin, për djersën dhe për gjakun e tyre. Personat përgjegjës janë paraardhësit tuaj, si trashëgimtarë të ish-Partisë së Punës së Shqipërisë dhe të ish-Sigurimit famëkeq të Shtetit.

Shpirtrat e tyre na bëjnë thirrje nga përjetësia për të mos harruar kalvarin e vuajtjeve që ata kaluan, por edhe për një ndjesë publike nga ana juaj si mazhorancë, të cilën asnjëherë të vetme nuk e keni bërë dhe, siç duket, as që keni ndërmend ta bëni.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Shehu ka 10 minuta në dispozicion, sepse ka marrë nga koha e kolegëve.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Çështja që po diskutohet rreth pasojave, aktivitetit të vjetër të ish-Sigurimit, pa dyshim mbetet një temë e rëndësishme, sepse, të them të drejtën, gjatë këtyre viteve nuk ka marrë një zgjidhje, në atë mënyrë e në ato dimensione që duhet të merrte kjo çështje, e cila vazhdon të afektojë, në një mënyrë apo në një tjetër, shpeshherë jetën e qytetarëve dhe jo vetëm jetën e qytetarëve në tërësi, si element konkret, por edhe si psikologji, mentalitet, metoda që nuk janë ndarë nga jeta jonë e tërësishme në Shqipëri. Ajo që është e rëndësishme, fatkeqësisht, është se kjo çështje në tërësinë e saj është keqpërdorur dhe vazhdon të keqpërdoret, për të mos gjetur ato zgjidhje që duhet të gjejë apo për t'u kthyer në një teatralitet, për të thënë se po bëjmë diçka, kur në të vërtetë nuk po bëjmë asgjë.

Kjo është e lidhur edhe me ligjin e fundit që u miratua, ligj i cili i detyron edhe institucionet përkatëse të punojnë në bazë të tij, një ligj i cili, për mendimin tim, është një mendim i shtrembër, një ligj kokëposhtë, një ligj i cili nuk ka në sensin e tij, ndërkohë që duhet të ishte thelbi i procesit dhe i çështjes, lustracionin. Mungon lustracioni dhe, nëse mungon lustracioni, mungon ajo që duhet bërë. Fatkeqësisht, ju kolegë të mazhorancës, ndoshta jo ju, personalisht, 2 herë i keni rrëzuar 2 ligje të lustracionit që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë, të cilët do të ishin zgjidhje, deri diku optimale e këtij procesi në tërësinë e tij. Pse ndodh kjo? Pse keni miratuar një ligj të tillë?

Së pari, unë mendoj se niset nga mendime të gabuara dhe nga keqdashje për ta përdorur këtë çështje si një shantazh, si një mjet presioni në luftën politike, dhe kjo u pa që në fillim, madje ende pa hyrë në fuqi ky ligj. U pa shantazhi që iu bë personave dhe pastaj heshtje, avullim. Pra, qartësisht u duk që ishte shantazh, një keqpërdorim i të dhënave për kapitale politike, për luftë politike dhe influenca apo pushtete politike. Çfarë ndodhi më shumë? Asgjë! Kush i pengon të ecin përpara? Asgjë, ligji u miratua! Pra, kjo tregon se e gjitha ishte një kala e krijuar qëllimisht, në bazë të një ligji të bërë së prapthi, për t'u përdorur për shantazhe për periudha të caktuara të luftërave politike. Por nuk është vetëm kjo! Unë mendoj se në këtë ligj nuk mund të sigurohet dhe nuk keni dashur të siguroni dhe të realizoni atë që duhet të realizohet në këtë drejtim, pra të zhbëjmë jo vetëm thjesht strukturën, por të zhdukim konceptet, trashëgiminë, rrezikun e ripërsëritjes të elementeve që la në kurriz të këtij vendi ish-Sigurimi i Shtetit, që ishte një organizatë kriminale, terroriste, organizata më e errët që ka pasur historia e Shqipërisë në të gjitha periudhat. Mjeti kryesor i saj ishte pa dyshim dhuna, mohimi i të drejtave, keqpërdorimi i

njeriut, hakmarrja, diktatura. Ish-Sigurimi i Shtetit ishte edhe një organizatë antishqiptare, antikombëtare në thellësinë e tij, në të gjitha dimensionet e tij. Realisht, ai ishte një paradhomë e UDB-së jugosllave në Shqipëri, edhe e KGB-së ruse disa herë, por kryesisht e UDB-së jugosllave. Agjentët kryesorë të ish-Sigurimit të Shtetit ishin agjentë të dyfishtë, punonin për shtetin këtu, por edhe për UDB-në jugosllave, për t'i thënë gjërat siç janë. Drejtuesit kryesorë të ish-Sigurimit të Shtetit ishin edhe agjentë të UDB-së jugosllave. Kjo është e vërteta! Ka shumë fakte dhe prova për këtë gjë. Pra, ishte një organizatë thellësisht antishqiptare dhe thellësisht antikombëtare dhe kjo nuk lidhet me agjentët e thjeshtë, me atë fshataren që u bë agjente, me ish-të persekutuarin politik që e bën agjent, duke i bërë presione nga më të tmerrshmet mbi kurriz, me atë personin diku tjetër, të cilin e joshi me 1 200 lekë apo me disa favore, në shumicën e rasteve të dënueshme.

Unë nuk mund të marr përsipër të gjykoj ata që kanë qenë në kampe, në burgje, dhe atje kanë pësuar depersonalizime dhe sjellje çnjerëzore në kurrizin e tyre, që mund t'i kenë detyruar më pas edhe për hapa të tjerë. Ata, unë nuk marr guximin t'i gjykoj. Unë gjykoj ata që kanë qenë si unë, qytetarë të lirë, aq sa ishim të lirë të gjithë bashkë në atë periudhë, por kjo është e vërteta. Nuk janë këta shkaktarët kryesorë të këtyre fenomeneve, të këtyre tipareve kaq të egra të ish-Sigurimit të Shtetit, të asaj që ish-Sigurimi i Shtetit ishte një paradhomë e UDB-së jugosllave në Shqipëri dhe në shërbim të saj, por ishin ata që e krijuan, e drejtuan. Ata që ishin në prapaskenë ishin ata që ishin në krye të asaj partie në pushtet, ishin ata prokurorë, hetues, që u kthyen në instrumente dhe në bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit kundër qytetarëve, që torturonin, që dënonin dhe që ky ligj nuk i prek. Ky ligj nuk bën asgjë dhe prandaj duhet ligji i lustracionit, pikërisht për të krijuar mundësinë e një ndërprerjeje, për t'iu kundërvënë pikërisht asaj që është e nevojshme: vazhdimësisë, sepse unë po ju them përsëri, që UDB-ja me organizmat e saj, ka shtrat këtu në Shqipëri. E ka shumë të fortë shtratin, ndaj realisht duhej parë në një dimension shumë tjetër çështja, që të zhdukeshin e të goditeshin edhe metodat e ish-Sigurimit të Shtetit, presionet mbi njerëzit.

Le të marrim një metodë të re, të përdorur kohët e fundit, që u ngjan tërësisht atyre të ish-Sigurimit të Shtetit: patronazhistët. Çfarë janë ata? Janë një *brutta copia*, do të thoshin italianët, e ish-Sigurimit të Shtetit, të shtrirë kudo, që spiunojnë për çdo gjë, që dërgojnë informacione, që kontrollojnë se kush i hyn në shtëpi Tritan Shehut, se çfarë mendime politike ka Tritan Shehu apo dikush tjetër, dhe paguhen për këtë gjë. Po, po, ju i paguani për këtë gjë! Nuk u jepni 1 200 lekë, siç u jepte ish-Sigurimi i Shtetit dikur, as 1 800 si presidentët, por i paguani. Ju i paguani duke i bërë punonjës të një pallati për mirëmbajtjen, që paguhen nga bashkitë; duke i bërë punonjës të ujësjellësit; duke i bërë punonjës të ndërmarrjeve të tjera, të cilat janë fryrë dhe janë shtuar në numër shumë më tepër nga sa kanë nevojë dhe nuk punojnë atje, por bëjnë spiunllëqe diku tjetër dhe mbajnë listat tuaja. A është kjo një reminishencë e ish-Sigurimit të Shtetit? Po, patjetër që është reminishencë e ish-Sigurimit të Shtetit. Pse? Sepse nuk u ndërprenë lidhjet organike me ish-Sigurimin e Shtetit, metodat, sepse masat kanë qenë të gjitha gjysmake, sepse edhe masat që u bënë për lustracionin e vërtetë duheshin më të gjëra. Ju i rrëzuat menjëherë, 2 herë resht dhe pastaj sollët këtë paçavure ligj, i cili përdoret për presione, për arsye politike, pikërisht për ta fshehur të vërtetën, për ta hedhur fajin tek agjenti i thjeshtë, i cili pa dyshim ka përgjegjësitë e tij, por shkaqet janë shumë më tepër dhe shumë më lart. Ata duheshin dënuar, siç dënoheshin me ligjin e lustracionit, edhe në bazë të ligjeve ndërkombëtare. Pra, ju bëtë një shou, një teatër, prandaj jemi sot kështu, kur nuk është bërë asgjë. Çfarë është bërë në këto periudha? Më thoni diçka! Asgjë nuk është bërë, po jua them unë. Asgjë reale nuk është bërë, jo më të flasim për politika të vërteta, për të çrrënjosur konceptet dhe mentalitetet e ish-Sigurimit të Shtetit. Ju nuk doni, se mund t'i përdorni përsëri sot. Jua thashë që i përdorni me patronazhistët, të cilët nuk janë gjë tjetër veçse një detashment modern i ish-Sigurimit të Shtetit.

Pra, fatkeqësisht, në këtë mënyrë ne vazhdojmë ta ripërsërisim historinë në një stad të ri, në një periudhë të re, pa dyshim duke e dëmtuar rëndë demokracinë e vendit, të drejtat e njeriut dhe jo vetëm kaq, por duke favorizuar disa lidhje të rrezikshme të këtij vendi me ustallarët e vjetër të ish-Sigurimit të Shtetit, me ata që e komanduan për shumë kohë dhe që e patën thjesht një aneks

të tyre Shqipërinë dhe ish-Sigurimin e Shtetit shqiptar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Monika Kryemadhi nuk është.

Zoti Balla, ju doni ta merrni fjalën? Jo.

Atëherë, mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Raporti i veprimtarisë vjetore të Institutit të Statistikave për vitin 2022. Në bazë të nenit 103, pika 2 e Rregullores së Kuvendit dhe nenit 13, pika 2, germa "d" e ligjit nr.17/2018 "Për statistikat zyrtare", sot do ta paraqesë raportin vjetor për vitin 2022, drejtorja e Përgjithshme, zonja Elsa Dhuli.

Zonja Dhuli, fjala për ju.

Koha në dispozicion deri në 20 minuta!

Elsa Dhuli- Përshëndetje!

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Veprimtaria e Sistemit Statistikor Kombëtar dhe INSTAT-it, si pjesë kryesore përbërëse e tij, ushtrohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.17/2018 "Për statistikat zyrtare", ligjit nr. 30/2022, "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2022–2026", si dhe të gjitha akteve të tjera nënligjore për zbatimin e tyre.

Në këtë kontekst, mbështetur në germën "d" të pikës 2, të nenit 13 të ligjit "Për statistikat zyrtare", në cilësinë e përfaqësuesit të Sistemit Kombëtar Statistikor, Instituti i Statistikave, kam kënaqësinë të paraqes përpara Kuvendit të Shqipërisë raportin vjetor 2022 mbi veprimtarinë e sistemit dhe vetë institucionit, i përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë.

Nëpërmjet këtij raporti paraqiten veprimtaritë për realizimin e objektivave dhe programit të kryera nga stafi i agjencive statistikore, ana e padukshme e ajsbergut të madh të prodhimit dhe komunikimit të statistikave zyrtare, ofruar gamës së gjerë të përdoruesve, në kohë dhe me cilësi.

Gjatë vitit të kaluar INSTAT-i dhe agjencitë e tjera statistikore, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kanë punuar me profesionalizëm për përmbushjen e aktiviteteve jo vetëm në mbështetje të strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim europian, strategjisë së zhvillimit të vetë sistemit statistikor apo strategjive sektoriale, por edhe në mbështetje të plotësimit të kërkesave europiane dhe ndërkombëtare për produkte statistikore.

Viti 2022, edhe pse impakti i krizave botërore vazhdoi, ka angazhuar sistemin në realizimin e objektivave strategjike dhe aktiviteteve statistikore të programit 5-vjeçar, si dhe zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë të dhëna në rezolutat e mëparshme.

Një nga sfidat kryesore që shoqëroi INSTAT-in dhe agjencitë statistikore gjatë vitit 2022 ishte përfshirja e kapitullit 18 "Statistikat", në grupin e parë themeltar të kapitujve për hapjen e negociatave për Shqipërinë për anëtarësim në Bashkimin Europian. Ky proces angazhoi afërsisht 100 persona për përgatitjen e 42 prezantimeve, ku paraqiteshin të përmbledhura 420 akte ligjore europiane, të cilat u paraqitën përpara Komisionit Europian me profesionalizëm dhe me një strukturë gjithëpërfshirëse, në të cilën pasqyrohej situata aktuale, problematikat dhe planet për të ardhmen.

Në progresraportin për Shqipërinë, Komisioni Europian vlerësoi hapat pozitive që ky sistem ka bërë në drejtim të zbatimit të Sistemit të Europian të Llogarive Kombëtare, publikimit të shpejtë të statistikave, rritjes së transmetimit të të dhënave në Eurostat; miratimit me ligj nga Kuvendi të Programit Kombëtar Statistikor; forcimit të rolit të Sistemit Kombëtar Statistikor, si dhe përgatitjeve për censin e popullsisë dhe banesave. Pavarësisht notave pozitive të vlerësimit, aktorët e sistemit statistikor janë të ndërgjegjshëm që mbetet akoma për t'u bërë, madje duhet angazhim edhe më sfidues për të kaluar nga një përgatitje e moderuar e statistikave në një nivel më të lartë përafrimi me standardet ndërkombëtare, duke rekomanduar kryerjen e censeve të popullsisë dhe banesave, si dhe zbatimin e plotë të sistemit europian të llogarive kombëtare.

Në zbatim të këtyre rekomandimeve, veçanërisht përpjekje të mëdha duhen bërë në zbatimin e metodave moderne inovative të grumbullimit dhe përpunimit të informacionit apo të përmirësimit të burimeve statistikore.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të adresuara nga Kuvendi i Shqipërisë, rezulton se nga 8 rekomandime të dhëna, 6 prej tyre janë në proces, nga të cilat 2 lidhen me censin e popullsisë

dhe banesave, i cili do të realizohet këtë vit, 4 janë në proces të vazhdueshëm zhvillimi dhe përmirësimi, 1 rekomandim është realizuar pjesërisht, pasi lidhet edhe me aktorë të tjerë në vend dhe jashtë tij, si dhe 1 rekomandim është në zbatim të vazhdueshëm.

Sistemi statistikor në vend ka arritur të gjenerojë një numër të konsiderueshëm të dhënash, duke u bërë pjesë e databazave europiane dhe botërore. Shqipëria është pjesë e databazës së hapur në nivel botëror, ku ka bërë progres me 6 poste në renditje, nga vendi i 62-të në vendin e 56-të, ndër 192 shtete. Në nivel europian është pjesë e databazës së Eurostat-it me 4,6 milionë të dhëna. Për herë të parë, në vitin 2022 Shqipëria u bë pjesë e raportit europian të klasifikimit në inovacion, ku renditet përkrah vendeve të tjera europiane.

Në fokus të veprimtarisë profesionale për një zhvillim të qëndrueshëm ka qenë dhe angazhimi në rritjen e numrit të treguesve statistikorë në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ku treguesit statistikorë zyrtarë përbëjnë rreth 67% të treguesve të prodhuar në nivel vendi.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Veprimtaria e INSTAT-it dhe e agjencive statistikore për zbatimin e planit vjetor sipas programit të statistikave zyrtare u mbështet në zbatimin e objektivave zhvillimore 2022-2026, të cilat, të pasqyruara me tregues konkretë, u realizuan si në vijim:

Për objektivin e parë, i cili synon zhvillimin e Sistemit Statistikor Kombëtar për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe në mbështetje plotësisht të procesit të integrimit europian, u shtua numri i të dhënave, *data points*, të shfaqura në databazën statistikore të Eurostat-it, me 21%; zbatimi i rekomandimeve të vlerësimit të cilësisë nga Eurostat-i u realizua në masën 89 %; u miratuan të gjitha aktet ligjore të planifikuara sipas Planit Kombëtar për Integrimin Europian për vitin 2022, përkatësisht 5 akte të propozuara nga INSTAT-i dhe 4 akte nga Banka e Shqipërisë.

Për objektivin e dytë, i cili synon plotësimin e kërkesave të përdoruesve për statistika zyrtare, u realizuan 165 publikime statistikore, u prodhuan 1056 tregues statistikorë sipas programit dhe 117 tregues statistikorë jashtë këtij programi. Gjithashtu, janë plotësuar 48 pyetësorë europianë dhe ndërkombëtarë me një gamë të gjerë informacioni të ofruar dhe të ardhur nga institucione statistikore apo organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Për objektivin e tretë, prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, u shoqërua me publikimin e 52 raporteve të cilësisë për aktivitetet statistikore, nga 48 të prodhuara një vit më parë, me orientim prodhues dhe përdorues. Nga viti në vit është rritur numri i aktiviteteve të dokumentuara sipas modelit të përgjithshëm ndërkombëtar, i zbatuar nga shumë vende europiane dhe botërore, ku gjatë vitit 2022 janë dokumentuar 78 aktivitete, krahasuar me 70 të tilla për vitin 2021.

Për objektivin e katërt, i cili lidhet me përfshirjen e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare, është bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore për të mbuluar fushën e statistikave të bilancit të energjisë. Jemi në proces diskutimi, sepse duhet të sigurohemi që Agjencia zbaton dhe merr përsipër të respektojë kodin e praktikave europiane, 15 parimet e kodit të praktikave europiane për prodhimin e statistikave zyrtare.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit të Sistemit Kombëtar Statistikor, gjatë vitit 2022 INSTAT-i ka zhvilluar 11 trajnime për statisticienët dhe nëpunësit nga institucionet e tjera dhe bashkitë e vendit, që furnizojnë me të dhëna administrative, ku janë trajnuar gjithsej 426 persona.

Për objektivin e pestë, i cili lidhet me modernizimin e proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve, janë ndërtuar aplikacione të reja dhe janë përditësuar ato ekzistuese, si me metodën e grumbullimit nëpërmjet uebit, edhe nëpërmjet metodave elektronike.

Modernizimi i teknikave dhe metodave të grumbullimit statistikor, edhe pse vazhdon të mbetet sfidë, ka sjellë ulje të nivelit të ngarkesës së të intervistuarve, duke shkurtuar kohëzgjatjen e intervistave pranë familjeve dhe pranë ndërmarrjeve.

Për objektivin e gjashtë, në të cilin synohet rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor, mund të theksohen 2671 përmendje në gazeta, 5688 përmendje në kanale televizive të ndryshme dhe 19613 përmendje në portalet *online*. Një prej nismave, e cila po merr vëmendje

në vazhdimësi, është rubrika "Statistika në shkolla" e krijuar për t'u ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve, si dhe atyre që kanë interes për statistikat, për të qenë në gjendje të kuptojnë më mirë statistikat dhe disa nga konceptet themelore të tyre, por kjo nismë ka vazhduar më tej, duke i intensifikuar takimet me parlamentarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, si një nga grupet kryesore të përdorimit të të dhënave për vendimmarrje. Statistikat zyrtare të shpërndara gjatë vitit 2022 rritën nivelin e kënaqësisë së përdoruesve me 0,0 pikë përqindje, dhe indikatori i besimit se INSTAT-i ka të dhëna të besueshme, u rrit me 0,03 pikë përqindje.

Referuar zbatimit të aktiviteteve statistikore, sipas programit të statistikave zyrtare, për vitin 2022 ishte planifikuar realizimi i 98 aktiviteteve statistikore, nga të cilat 87 aktivitete statistikore nga INSTAT-i, 9 nga Banka e Shqipërisë dhe 2 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nga Instituti i Statistikave u realizuan në kohë 87 aktivitete dhe 3 të tjerat u realizuan me 4 javë vonesë. Nga Banka e Shqipërisë u realizuan në kohë të gjitha aktivitetet dhe, gjithashtu, nga Ministria e Financave të gjitha aktivitetet u realizuan në kohë.

Viti 2022 u karakterizua me përgatitjen për realizimin me sukses të aktivitetit statistikor më të madh në vend, censit të popullsisë dhe banesave, dhe fillimin e punës për censin e bujqësisë. Për të pasur një proces cilësor, transparent dhe të besueshëm, përgatitjet për censin e popullsisë dhe banesave u intensifikuan gjatë viteve 2020-2022, duke analizuar problematikat e hasura gjatë kësaj periudhe. Në drejtim të realizimit me sukses të këtij aktiviteti madhor, ndër më kryesorët për jetën social-ekonomike të një vendi, viti 2023 është vit sfide për këtë institucion. Censi kryhet çdo 10 vjet dhe, si i tillë, ai merr vëmendje kryesore nga qeveria, nga institucionet e tjera në vend, bota akademike, grupet e interesit, partnerët ndërkombëtarë e të tjerë. Në këtë drejtim, pasja e një baze të plotë ligjore, ngritja e strukturave mbështetëse dhe mbulimi i plotë me fonde i aktiviteteve të censit është një arritje për institucionin, por dhe për vetë realizimin me sukses të këtij procesi.

Kryerja e censit të popullsisë dhe banesave mbështetet nga buxheti i shtetit me 54% dhe nga donatorë të ndryshëm me 46%, si: Komisioni Europian, qeveria suedeze, qeveria zvicerane dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara. Kostoja e këtij procesi është vlerësuar të jetë 16,9 milionë euro. Kjo përfaqëson mesatarisht 5,7 euro për banor, e cila korrespondon me mesataren e vendeve evropiane që kryejnë një cens tradicional derë më derë, sikurse do të kryhet edhe censi i popullsisë dhe banesave. Mbi 50% e kostove janë për stafin e angazhuar në terren, ndërkohë, ju bëj me dije se do të angazhohen rreth 7800 persona në terren. Komponentët e tjerë të buxhetit janë investime afatgjata për një sistem të qëndrueshëm statistikor. Suksesi i censit varet nga qasja pozitive dhe pjesëmarrja e popullatës në të. Prandaj, gjatë këtij viti do t'i kushtohet një vëmendje e veçantë zbatimit dhe monitorimit të strategjisë së komunikimit, ku elementi bazë është komunikimi me palët e interesuara dhe publikun në përgjithësi. Fushata e komunikimit, e cila ka filluar tashmë, do të promovojë censin, duke e informuar publikun për qëllimin e tij, si dhe do të ndihmojë në forcimin e besueshmërisë së të dhënave dhe institucioneve përgjegjëse për prodhimin e tyre. Do të vihet në zbatim një plan logjistik, në të cilin do të adresohen kërkesa për mbështetje nga pushteti vendor për sigurimin e elementeve operacionale nga këto struktura, duke vlerësuar edhe rastet kur njësitë vendore nuk mund ta mbështesin censin sipas kërkesave të INSTAT-it.

Infrastruktura teknologjike do të mundësojë mbledhjen e të dhënave në terren përmes pyetësorëve elektronikë me tablet, monitorimin e këtij procesi në sigurimin e cilësisë statistikore, monitorimin e punës së stafit, transmetimin e informacionit në kohë reale në INSTAT dhe përpunimin e të dhënave në kohë më të shpejtë, duke siguruar ruajtjen e privatësisë, si dhe konfidencialitetit e informacionit të grumbulluar.

Dita e censit konsiderohet data 18 shtator 2023, me një kohëzgjatje në terren 6 javë, duke përfunduar në 28 tetor 2023 grumbullimin e informacionit për popullsinë rezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë. Do të angazhohen 7800 persona, të cilët do të jenë në terren, si anketues, kontrollorë, mbikëqyrës, staf INSTAT-i, qendër dhe zyra rajonale në të gjithë territorin e vendit.

Rezultatet e censit parashikohen të publikohen në muajin qershor të vitit 2024, të

detajuara në nivele rajone administrative deri në nivel bashkie, në muajin dhjetor të vitit 2024.

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë**,**

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndikojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Në kuadrin rregullator të sistemit përfshihen edhe konventat e marrëveshjet me institucionet ndërkombëtare në interes të zhvillimit statistikor në vend, si dhe aktet komunitare të BE-së në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojnë të përafrojnë standardet statistikore të përcaktuara, veçanërisht në rregulloren e Komisionit Europian nr. 223/2009 "Për statistikat europiane". Instrumente të tjera rregullatore të veprimtarisë statistikore të Sistemit janë edhe marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT-it dhe institucioneve që furnizojnë këtë institut me informacion statistikor. Deri tani janë nënshkruar 31 marrëveshje bashkëpunimi dhe gjatë vitit 2022 u shtuan edhe 2 marrëveshje të reja, si dhe dy marrëveshje të tjera të lidhura edhe me institucionet e tjera simotra.

Bota akademike është një prej palëve të interesit dhe përdoruesve të informacionit statistikor, me të cilën kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi, gjithashtu. Auditimi statistikor, si rruga konkrete për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo aktiviteti statistikor, kryhet nëpërmjet një procesi sistematik të programuar, të pavarur dhe të dokumentuar, ku bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor, i zbatuar në vitin 2022 në 2 aktivitete statistikore me vetëvlerësim dhe 1 aktivitet me auditim statistikor.

Anketa "Për kënaqësinë e përdoruesve të statistikave", që INSTAT-i prodhon si një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre, tregoi se kënaqësia e përdoruesve u rrit me 0,05%, por edhe kënaqësia e përdoruesve me përdorimin e faqes së internetit të INSTAT-it dhe me lehtësirat e krijuara nga kjo faqe pati një rritje me 0,04 pikë përqindje, ndërkohë besimi te statistikat u rrit me 0,03% dhe marrëdhënia më stafin e INSTAT-it u rrit me 0,08%.

Për sa u takon burimeve njerëzore, në fund të vitit 2022 gjendja faktike në INSTAT ishte 216 punonjës, nga të cilët 204 ishin punonjës në shërbimin civil, 12 punonjës administrativë dhe 20 pozicione vakante, por INSTAT-i kontrakton edhe punonjës të tjerë me kontratë afatgjatë dhe afatshkurtër, të cilët kanë qenë rreth 1000 në total për vitin 2022.

Referuar legjislacionit për statistikat zyrtare, organizmat mbështetës për prodhimin statistikor janë: Bordi Drejtues i INSTAT-it, i cili ka kryer 5 takime; Këshilli i Statistikave, i cili ka zhvilluar 3 mbledhje dhe Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën, i cili ka zhvilluar 2 mbledhje.

Për sa i përket raportit gjinor të punonjësve të INSTAT-it, ashtu sikurse edhe në vitet e mëparshme, në përbërjen e tij kryeson gjinia femërore me 72% kundrejt gjinisë mashkullore, e cila zë 28% të totalit.

Buxheti është realizuar në masën 97,9% të vlerës së parashikuar në planin vjetor për kryerjen dhe zbatimin e veprimtarisë statistikore.

Për një zhvillim të qëndrueshëm të sistemit statistikor kombëtar për vitin 2023, puna do të vazhdojë në drejtim të prodhimit të statistikave me cilësi, në kohë dhe gjithëpërfshirëse, kjo për të siguruar rritje të besimit në statistikat zyrtare dhe forcimin e sistemit statistikor kombëtar në funksion të rolit që ky sistem ka në shoqëri.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë**,**

INSTAT-i dhe agjencitë statistikore shprehin falënderimet për mbështetjen e dhënë në vazhdimësi për realizimin e misionit të këtij institucioni dhe të gjithë sistemit me sukses!

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla- Faleminderit, zonja Dhuli!

Keni pyetje të bëra nga deputetët: zonja Ina Zhupa, zoti Vangjel Dule dhe zonja Albana Vokshi.

Zonja Zhupa, fjala për ju.

Ina Zhupa - Faleminderit, Kryetare!

Pyetjet e mia janë këto:

Pyetja e parë. Një nga ankesat e rëndësishme të INSTAT-it është ajo e buxhetit të familjes, ku ne arrijmë të kuptojmë qartësisht edhe nivelin e pabarazisë në një shoqëri. Si ka mundësi që nga vitit 2020 ju nuk e publikoni më këtë raport, i cili duhet të ishte detyrim për INSTAT-in dhe i

domosdoshëm edhe për ne, për të kuptuar më shumë?

Pyetja e dytë. Censi duhet të ishte kryer që në vitin 2021, sipas standardeve të Eurostat-it, pra, 10 vjet pas atij të vitit 2011. Vonesa në kryerjen e censit sjell dëmtime serioze në politikat e ndërmarra ekonomike dhe sociale. Pse nuk e keni kryer atë dhe pse nuk arrini dot nivelin e INSTAT-it, të paktën atë të para 12 vjetëve, dhe jo më të progresoni me ritmin e shoqërisë dhe teknologjisë në bërjen e statistikave?

Pyetja e tretë: pse nuk janë publikuar rezultatet e censit të bujqësisë? Ne e kemi thënë edhe në këtë parlament që bujqësia është një nga fushat dhe degët prioritare, pasi në momentin që neve na mungojnë këto statistika të rëndësishme, ne nuk vazhdojmë dot më tej me politika të suksesshme në këtë fushë.

Pyetja e katërt: si e mat INSTAT-i numrin e turistëve në vend (ju na keni deklaruar vitin e kaluar një numër rekord vizitorësh), sipas strukturave akomoduese apo nga hyrje-daljet në pikat doganore? Për shembull, unë mund të dal për të shkuar me pushime në Itali dhe kur kthehem në Shqipëri të llogaritem si turiste, sepse kam hyrë në Shqipëri, ose raste të tilla, ku i njëjti qytetar vjen nga Rinasi, del në Kosovë për dy ditë, kthehet prapë në Shqipëri, del përsëri, ju e llogaritni 5 apo 6 turistë, ndërkohë që ai është i njëjti person.

Pyetja e pestë: në një kohë kur qytetarët sot, po t'i pyesësh dhe po t'i dëgjosh, thonë se blejnë më pak për shkak të çmimeve të larta (besoj se ky është një realitet qe e pranojmë të gjithë), instituti juaj raporton për rritje të konsumit në vend, sepse sipas INSTAT-it në tremujorin e parë të vitit shitjet me pakicë u zgjeruan me 4,4% në raport me të njëjtën periudhë kohore të një viti më parë. Ju matni realitetin apo shkruani siç i nevojitet qeverisë që të paraqesë propagandën?

Shumë faleminderit!

Elsa Dhuli - Faleminderit për pyetjet!

Zonja Kryetare, a mund të vazhdoj me përgjigjet?

Lindita Nikolla - Patjetër, fjala për ju!

Elsa Dhuli - Në lidhje me publikimin e anketës së buxhetit të familjes për vitin 2020, ju bëj me dije se rezultatet janë publikuar në formën e njoftimit për shtyp, si dhe në një seksion të veçantë në faqen e uebit të INSTAT-it, "Tabelat kryesore për shifrat". Ndërkohë, duhet të keni parasysh se viti 2020 ishte viti i pandemisë globale dhe për 4 muaj rresht u stopua grumbullimi i të dhënave pranë familjeve, por, duke ndjekur rekomandimet botërore dhe në konsultim me të gjithë ekspertët ndërkombëtarë jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet e tjera, këto të dhëna u vlerësuan statistikisht, duke bërë të mundur publikimin e tyre në nivel më të agreguar dhe duke mos bërë të mundur kalimin e tyre në nivel shumë më të detajuar, pasi prekej cilësia dhe konfidencialiteti i të dhënave. Në mënyrë që të ruhej cilësia dhe konfidencialiteti, u gjykua nga institucioni që të publikoheshin të dhënat në formë tabele dhe në formë njoftimi për shtyp, të cilat ndodhen në faqen e uebit të INSTAT-it, tek "Treguesit për kushtet e jetesës". Pra, nuk është pa informacion, është pjesë e një vendimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është kryer edhe viti 2020, edhe viti 2021 dhe në muajin tetor të këtij viti do të publikojmë anketën për vitin 2022, për të cilën jemi në proces.

Në lidhje me pyetjen e dytë, në fakt, censi ishte planifikuar të kryhej në vitin 2022, por për shkak të mossigurimit në kohë të instrumentit bazë të grumbullimit e informacionit, tableteve, pra, që ishin probleme teknike, u detyruam të shtynim grumbullimin e informacionit në vitin 2023, por gjatë kësaj periudhe, sikurse e përmenda edhe në raport, INSTAT-i ka vazhduar punën me të gjithë aktorët dhe me asistencën teknike, në mënyrë që të garantojë dhe të sigurojë një proces sa më cilësor dhe të suksesshëm. Për informacion, tabletet janë siguruar dhe jemi në momentin që në datën 18 shtator do të fillojmë procesin e grumbullimit të të dhënave në terren, duke filluar në datën 24 korrik dhe 1 gusht me sesionet e trajnimeve të të gjithë stafit të terrenit.

Në lidhje me pyetjen për rezultatet e censit të bujqësisë, në faqen zyrtare të INSTAT-it gjendet një rubrikë "Censet", ku një prej tyre është edhe censi i bujqësisë, në të cilin janë publikuar të gjitha rezultatet e censit të fundit të kryer në vitin 2012.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ky është censi i fundit i bujqësisë, i kryer në vitin 2012. Censi i radhës është planifikuar të kryhet në vitin 2024, pra vitin që vjen. Për këtë arsye, INSTAT-i në bashkëpunim edhe me ministrinë dhe aktorët e tjerë, po përgatitet për realizimin me sukses edhe të këtij aktiviteti.

Lidhur me pyetjen si e mat INSTAT-i numrin e turistëve në vend, në lidhje me hyrje-daljet, dua t'ju them se numri i turistëve në vend bazohet në burimet administrative nëpërmjet hyrjeve të shtetasve të huaj dhe shqiptarë, por, gjithashtu, të gjithë shtetasit e huaj dhe shqiptarë kanë një rubrikë "Qëllimi i hyrjes" dhe, një nga qëllimet është: për qëllime individuale, për pushime, për vizita te miqtë apo tek të afërm. Gjithashtu, nëpërmjet mjetit të udhëtimit merret informacion për mënyrën se si të gjithë shtetasit e huaj apo shqiptarë hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kur flasim për rritje të ndjeshme të numrave, peshën më të madhe e zënë shtetasit e huaj, ku INSTAT-i në botimet mujore publikon edhe shtetet kryesore nga janë hyrjet më të larta. Ky është një botim, i cili publikohet rregullisht në datën e caktuar në kalendarin e publikimeve.

Në lidhje me konsumin dhe ndryshimin vjetor të tregtisë me pakicë, sepse shifra që ju përmendët 4,4%, i referohet tregtisë me pakicë, ju bëjmë me dije se për grumbullimin e informacionit organizohet një vrojtim tremujor pranë të gjitha njësive tregtare, si dhe kombinohet me burime administrative, duke ndjekur dhe zbatuar një metodologji korrekte, që është e standardeve europiane. Ndaj, dua t'ju them se shifra nuk është e stisur, është reale dhe është bërë mbi matje reale. Ne bëjmë edhe një publikim të detajuar sipas grupeve të caktuara të konsumit jo vetëm ato ushqimore, por edhe grupe të tjera, si ai i karburantit e të tjerë. Pra, ju siguroj që ndjekim një metodologji dhe standard europian për grumbullimin e informacionit.

Këto ishin pyetjet.

Ju falënderoj për pyetjet!

Lindita Nikolla – Zoti Dule, keni fjalën për të parashtruar pyetjet tuaja.

Vangjel Dule – Faleminderit, zonja Kryetare!

E nderuar zonja drejtoreshë, dëshiroj që t'ju parashtroj pyetjet e mëposhtme.

Së pari, a është zyrtarizuar versioni përfundimtar i pyetësorit të censit, ku dhe si është publikuar?

Së dyti, kur është mbledhur për herë të fundit komisioni qendror i censit?

Së treti, në sa bashki janë aktualisht funksionale zyrat e censit?

Së katërti, si do të garantohet pjesëmarrja e pjesëtarëve të minoriteteve etnike në aspektin administrativ të procesit të censit?

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla - Po, zonja Dhuli.

Elsa Dhuli – Ju faleminderit për pyetjet!

Në lidhje me pyetjen nëse është zyrtarizuar versioni përfundimtar i censit, INSTAT-i, në bashkëpunim me asistencën teknike deri në momentet e fundit, do të sigurohet që ajo platformë është përfundimtare dhe e sigurt, që impaktohet nga çdo rregullim i përmbajtjes së pyetësorit. Kjo do të thotë se pyetësori final, versioni final do të publikohet në afërsi të muajit korrik, edhe pse nuk është detyrim i instituteve të statistikave, të paktën në eksperiencat e vendeve të tjera, për ta publikuar, por ne për transparencë do të publikojmë.

Ndërkohë, ju bëjmë me dije se ne, nëpërmjet planit vjetor të vitit 2023, në Kuvendin e Shqipërisë kemi miratuar 18 shtatorin si datën e censit, si dhe 8 modulet e pyetësorit të censit, të cilat do të përdoren për grumbullimin e informacionit në terren. Çdo modul përmban të gjithë treguesit, me të cilët do të intervistohen qytetarët rezidentë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto modele lidhen me modulet mbi ndërtesën, banesën, familjen, individin, një modul për bujqësinë, një modul për personat vizitorë gjatë natës së censit në familje dhe një modul për personat, të cilët kanë lëvizur nga familja. Këto module ndodhen të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT-it, në rubrikën "Censi i popullsisë", i cili është publikisht i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit. Gjithsesi, sikurse e bëra me dije, pyetësori, versioni final i censit do të publikohet në fund të muajit korrik. Duhet të kemi në vëmendje që ne kemi skicuar dhe formatuar një pyetësor në format elektronik, i cili do të jetë një përmbledhje në format narrativ, të jetë i lexueshëm dhe i kuptueshëm për përdoruesit.

Në lidhje me pyetjen se kur është mbledhur për herë të fundit komisioni qendror i censit, ne kemi një komunikim të vazhdueshëm, periodik dhe mujor për të gjitha problematikat dhe çështjet që diskutojmë. Ne organizojmë takime intensive me të gjithë anëtarët e komisionit qendror të censit, të cilët na kanë mbështetur (unë këtu gjej rastin t'i falënderoj) për të gjitha çështjet që ky institucion ka nevojë për mbështetje gjatë procesit realizmit të tij. Këtu mund të përmend një sërë

ministrish, si: Ministria e Arsimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, e cila vazhdon ende të na mundësojë takime me pushtetin vendor në nivel grumbullime prefekturash.

Në lidhje me komisionet e censit në nivel bashkie, ju bëj me dije se ato janë bërë funksionalë që prej janarit të vitit 2021, në zbatim të ligjit nr. 140/2020 "Për censin e popullsisë dhe të banesave". Për shkak të zgjedhjeve vendore ky proces u ngadalësua, ndërkohë, menjëherë pas fillimit të konstituimit të kryetarë të bashkive, ka rifilluar takimet intensive me kryetarët e bashkive apo me stafin e bashkive.

Për informacion, komisioni i censit në nivel bashkie drejtohet nga kryetarët e bashkive; nënkryetar i komisionit është përfaqësues i Institutit të Statistikave; anëtarë janë përfaqësues të administratës së çdo bashkie, si dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

INSTAT-i ka angazhuar stafin e tij në zyrat në qendër dhe në zyrat rajonale. Në datën 1 qershor filloi fushata e rekrutimeve të stafit të terrenit dhe janë marrë kontakte me të gjitha bashkitë: kryetarë, nënkryetarë apo drejtorë (persona menaxherialë nëpër bashki) për t'i pasur mbështetje jo vetëm për ambientet, por edhe për suporte dhe mbështetje të tjera. Prandaj, mund t'ju bëj me dije se kemi një bashkëpunim shumë të mirë dhe shumë të frytshëm jo vetëm me komisionet në nivel bashkie, por edhe me të gjithë fokus grupet, për të cilët ju raportoj dhe ju informoj se gjatë vitit 2021-2022 janë organizuar në 9 bashki 9 takime me fokus grupe të ndryshme, ku përfaqësuesit e etniciteteve kanë qenë jo vetëm prezentë, por edhe shumë aktivë dhe me diskutime shumë të vlefshme.

Në lidhje me pyetjen se si do të garantohet pjesëmarrja e pjesëtarëve, nisur nga procesi pilot me të gjitha bashkitë, ku ju ra fati të intervistoheshin gjatë këtij procesi pilot, ne patëm jo vetëm një marrëveshje dhe një situatë shumë pozitive, një organizim administrativ shumë të mirë, patjetër që edhe censi real do të ketë të njëjtin bashkëpunim, sepse nuk është ndërprerë bashkëpunimi me administratat e bashkive.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Zonja Vokshi, keni fjalën për pyetje.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, dy prej pyetjeve i përmendi edhe zonja Zhupa, por, gjithsesi, mendoj se përgjigjja e drejtueses së INSTAT-it nuk ishte shteruese për vetë faktin se ajo përmendi se është intensifikuar puna më 2021-shin dhe 2022-shin për sa i përket censit të popullsisë. Kush e vonoi censin e popullsisë? Nëse nuk janë blerë tabletët, kush e ka fajin për këtë? Është detyrim që kjo të bëhet një herë në 10 vjet dhe jo pa qëllim është vënë një herë në 10 vjet. Pra, është lënë që të bëhet një herë në 10 vjet, sepse janë statistika shumë të rëndësishme, të cilat i shërbejnë politikëbërjes. Pra, unë po përsëris edhe një herë pyetjen e zonjës Zhupa: a është bërë një analizë e faktorëve pse është vonuar dhe jo me një vit, por me dy, censi i popullsisë?

Ju përmendët censin e bujqësisë dhe thatë se është planifikuar më 2024-ën. Pse është planifikuar më 2024-ën, sepse është bërë më 2012-ën, edhe censi i bujqësisë bëhet 1 herë në 10 vjet? Praktikisht duhej bërë më 2022-in. Nëse ju do ta lidhnit me censin e popullsisë, pra për shkak se censi i bujqësisë bëhet pas atij të popullsisë, kjo ka sjellë shtyrje. Pra, fajtorët e shtyrjes së censit të popullsisë, në fakt, nuk kanë shtyrë vetëm një cens, por kanë shtyrë dy. Praktikisht ne nuk e marrim, qoftë ne si politikanë, por edhe kushdo që është i interesuar për këto statistika shumë të rëndësishme, tejet të rëndësishme, këtë informacion. Të vini këtu dhe të na thoni se e keni shtyrë, por tani po intensifikoni punën, më falni, por nuk është shteruese. Pra, në përgjigjen tuaj, dua të më jepnit një përgjigje shteruese. Kush janë fajtorët, pse nuk u bë tenderi? Janë aferat ato që e kanë shtyrë? Një herë u tha se po blihen, pastaj u anulua tenderi. A u anulua tenderi sepse pati ndërhyrje? Kështu ndodh gjithmonë me të gjithë tenderët. Pra, meqenëse keni ardhur këtu, do të doja një përgjigje, nëse mundeni, të sinqertë.

Së dyti, raporti vjetor i INSTAT-it për 2022-shin praktikisht paraqet punën e kryer nga INSTAT-i për kryerjen e aktiviteteve statistikore në përputhje me programin aktual të statistikave zyrtare, të objektivave strategjikë, të sistemit kombëtar statistikor, burimet financiare, njerëzore e kështu me radhë. Sipas ligjit të aprovuar më 2018-ën, në prodhimin statistikor dhe veprimtarinë e tij INSTAT-i duhet të ndjekë parimet e statistikave zyrtare, pra paanshmërinë,

besueshmërinë, pavarësinë profesionale, përkatësinë, zbatimin e parimit: kosto-efektivitet, konfidencialietin statistikor dhe transparencën. A ka një vlerësim si janë zbatuar këto parime konkretisht?

Pothuajse të gjitha vendet kanë kaluar në publikime të statistikave mujore, pra nga ato statistikat tremujore kanë kaluar në statistika mujore. Pse INSTAT-i nuk ka kaluar?

Nëse futesh në faqen e INSTAT-it vë re se janë shumë statistika, të cilat duhet të ishin publikuar muaj më parë, në fillim të vitit apo më 2022-in, po të doni, unë mund t'jua përmend, por jam e sigurt që i dini, për shembull: produkti i brendshëm bruto, Shqipëria në shifra, azilkërkuesit në Shqipëri, burra-gra, treguesit kryesorë e të tjerë. Pse nuk publikohet një pjesë e këtyre statistikave? Cila është arsyeja e vonesës?

Pse nuk publikoni të dhënat administrative të të punësuarve në administratë? Është një shifër, që, sidomos pas zgjedhjeve të 14 majit, merr rëndësi edhe më të lartë. Pra, duhet të ishte raportuar edhe tremujori i dytë i këtij viti, pra i 2023-shit, është një statistikë që tatimet e kanë dhe nuk ka nevojë as për përpunime të shumta, por thjesht duhet të publikohet. Pse nuk e keni publikuar dhe kur parashikoni ta publikoni këtë statistikë?

Unë dëgjova që ju përmendët një shifër, 465, nëse nuk e kam dëgjuar gabim, që është numri i stafit të trajnuar nga Eurostat-i për prodhimin dhe publikimin e statistikave të ndryshme. Sa nga ky staf, që kanë marrë trajnime gjashtëmujore dhe nëntëmujore, e kanë lënë Shqipërinë, madje kanë siguruar edhe kontrata shumë të mira në vende të tjera të BE-së? Në informacionin që unë kam, janë ose shumë pak, ose të gjithë, 100% e tyre janë larguar, por dua një përgjigje nga ju, sepse është një investim i bërë ndër vite nga INSTAT-i, Eurostat-i dhe nga institucione të tjera.

Unë kam edhe disa pyetje të tjera dhe do të mundohem të shkoj tek ajo që e kam më të rëndësishme. Të gjitha statistikat për sa i përket migrimit dhe emigrimit ne i marrim nga Eurostat-i. Pse nuk ka një bashkëpunim të INSTAT-it me Eurostat-in për të marrë statistika, të cilat u shërbejnë edhe publikimeve të INSTAT-it? Për shembull, nëse ne futemi në faqen e Eurostat-it, aty mund të marrim statistika të sakta sot për azilin në vendet e BE-së, për qëndrimet ilegale, për qëndrimet me dokumente. Kështu, në 10-vjeçarin e fundit rezulton se 204 mijë persona kanë kërkuar azil; 301 mijë persona qëndrojnë ilegalisht, siç raporton Eurostati; 432 mijë janë me dokumente, pra janë 937 mijë persona, gati 1 milion, që janë larguar nga Shqipëria këtë 10-vjeçarin e fundit. Nëse bazohemi vetëm nga zgjedhjet e 25 prillit 2021 deri në zgjedhjet e 2023-shit, janë larguar rreth 200 mijë. Përse këto statistika nuk i gjejmë të publikuara tek INSTAT-i, por duhet të futemi tek Eurostat-i për t'i marrë? A është në këndvështrimin tuaj ky një shpopullim? Si do ta konsideronit ju ikjen, largimin masiv të 1 milion shqiptarëve në 10 vjetët e fundit?

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Po, zonja Dhuli.

Elsa Dhuli – Faleminderit për pyetjet!

Unë mendoj se i kam mbajtur shënim të gjitha pyetjet, megjithatë do të përpiqem të jem sa më korrekte dhe transparente në përgjigje, duke ndjekur të gjitha pyetjet që u adresuan.

Në fakt, po e filloj me pjesën e shtyrjes së censit të popullsisë dhe të banesave, pasi është një pyetje dhe një informacion shumë i drejtë për t'u ditur. Unë vazhdimisht e kam theksuar se censi i popullsisë dhe i banesave ishte planifikuar të kryhej në vitin 2020, nuk u realizua për shkak të pandemisë globale, aktivitet që është shtyrë edhe nga vendet e tjera europiane. Në vitin 2021 nuk është planifikuar të kryhet censi i popullsisë për shkak të zgjedhjeve qendrore dhe u planifikua në vitin 2022, i cili, sikurse e theksova, për shkak të problematikave teknike të mossigurimit të instrumentit bazë mbledhës, ishte e pamundur të kryhej grumbullimi i informacionit në terren. Kjo nuk do të thotë se ndaloi puna për përgatitjen e censit, sepse është bërë një projekt pilot në vitin 2021 dhe janë kryer 6 teste për të testuar jo vetëm platformat e grumbullimit të informacionit, por edhe të gjitha platformat e tjera, të cilat janë ngritur për rekrutimin e stafit të terrenit, për të cilin aplikimet janë kryer *online*; platforma të monitorimit të cilësisë, të grumbullimit, të menaxhimit të problematikave. Pra, ka qenë një proces pune që nuk ka ndaluar. Kjo nuk e bën Shqipërinë apo INSTAT-in të prodhojë rezultate, që të mos jenë të krahasueshme me vendet e tjera evropiane. Jo të gjitha vendet e kanë kryer censin në vitin 2021 për shkak të situatave globale që ndodhën, por me rekomandim të Eurostat-it, të gjitha vendet do të bëjnë një ribazim, në gjuhën

teknike, të rezultateve me vitin 2021 për t'i bërë ato të krahasueshme me të gjitha vendet europiane. Ky është një rekomandim europian, standard jo vetëm për vendet anëtare, por edhe për ne, dhe Shqipëria ka pranuar që ta kryejë këtë proces në bashkëpunim, me asistencë teknike. Ky është një hap pozitiv për Shqipërinë, sepse, pavarësisht se ne procesin do ta kryejmë në vitin 2023, rezultatet do të jenë të krahasueshme me vitin 2021, që përkon me periudhën 10-vjeçare, 2011.

Në lidhje me matjen e parimeve të statistikave zyrtare, kjo është një nga pikat kryesore, me të cilën INSTAT-i mat veprimtarinë jo vetëm të vetë institucionit, por edhe të agjencive statistikore. Unë në raportin vjetor përmenda pyetësorin e vlerësimit të cilësisë, të rekomanduar nga Eurostat-i, me të cilin matet çdo vit, në periudha tremujore, dhe raportohet rregullisht, pikërisht, zbatimi i këtyre 15 parimeve. Në vitin 2022 zbatimi i këtyre parimeve arriti në masën 89%, që do të thotë se kemi bërë hapa përpara, kemi bërë progres, por kemi ende shumë punë të tjera për të bërë. Kjo është ajo për të cilën ne raportojmë vazhdimisht dhe matim zbatimin korrekt të 15 parimeve të kodit të praktikave europiane.

Ndërkohë, kemi edhe elemente të tjera, sikurse është kalendari i publikimeve (në këtë mënyrë unë po kaloj edhe te përgjigjja e pyetjeve në lidhje me vonesat e publikimeve), ne në datën 20 dhjetor të çdo viti publikojmë kalendarin e publikimeve. Periudha e censit, sidomos botimet që ju përmendët, janë në një periudhë intensive të punës për fillimin e censit të popullsisë dhe të banesave. Këto botime u referohen të gjitha statistikave sociale, ku edhe vetë censi është më shumë angazhimi e këtij stafi për këtë staf, duke kërkuar lejen dhe mirëkuptimin e të gjithë përdoruesve, në faqen e uebit të INSTAT-it kemi vendosur shënim, ku kërkojmë mirëkuptim për vonesat në publikime, por jo për mospublikime. Stafi i INSTAT-it bën vërtet një punë profesionale dhe shumë intensive, që jo vetëm të sigurojë cilësi në produktet që prodhon dhe komunikon, por edhe të kryejë me cilësi procesin e censit të popullsisë. Prandaj, ky institucion u ka kërkuar mirëkuptim të gjithë përdoruesve vetëm për vonesat në këtë periudhë intensive.

Në lidhje me pyetjen për censin e bujqësisë, unë e theksova se një nga modulet që do të pyetet gjatë censit të popullsisë në vitin 2023 është edhe një modul që lidhet me bujqësinë. Ky modul do të përdoret i kombinuar edhe me informacionet administrative për të krijuar bazën kryesore të grumbullimit të informacionit për censin e bujqësisë. Për këtë arsye censi i bujqësisë do të realizohet në vitin 2024, por puna përgatitore, në bashkëpunim me të gjithë aktorët përfshirës në këtë cens, ka filluar që në vitin 2021.

Në fakt, dua të bëj një saktësim, unë përmenda 465 persona të trajnuar nga institucionet brenda vendit, pra INSTAT-i ka trajnuar 465 punonjës të institucioneve të tjera, furnizuese me të dhëna statistikore: ministrive, institucioneve, agjencive, si dhe 61 bashkive të vendit. Ndërkohë, janë kryer trajnime tremujore, deri vitin e kaluar janë kryer vetëm dy trajnime tremujore të stafit të INSTAT-it në Eurostat, të cilët janë kthyer dhe kanë sjellë ekspertizën e tyre pranë institucionit.

Unë e theksova edhe në raport, ne kemi 20 vende vakante, nuk kemi largime në masë të stafit, por kemi ngritje profesionale akademike. Pra, ata persona që kanë shkuar jashtë vendit, kanë shkuar për ndjekje të studimeve të doktoraturës, ndërkohë që stafi tjetër ka lëvizur brenda për brenda Shqipërisë në institucione të tjera, duke çuar përsëri profesionalizmin e tyre.

Në lidhje me pyetjen për të dhënat për azilkërkuesit, dua t'ju bëj me dije se INSTAT-i publikon numrin, statistikat mbi azilkërkuesit, të cilët hyjnë në Shqipëri. Eurostat-i, sikurse merr të dhëna për azilkërkuesit e vendeve të tjera që hyjnë në Shqipëri, grumbullon nga institutet e statistikave të vendeve të tjera azilkërkuesit që shkojnë, drejtohen në ato vende. Në këtë mënyrë, për këto statistika është Eurostat-i përgjegjës dhe e ka informacionin për të gjitha vendet europiane. Ndërkohë, për të gjitha statistikat e tjera është Instituti i Statistikave dhe dy agjencitë e tjera, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, por kryesisht Banka e Shqipërisë dhe INSTAT-i, që furnizojnë Eurostat-in me të dhëna statistikore. Janë rreth 4,6 milionë *data points*, të cilat janë të dhëna të prodhuara nga Instituti i Statistikave dhe të shfaqura në databazën europiane.

Nuk e di nëse kam lënë ndonjë pyetje pa përgjigje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Ajo u përgjigj.

Zonja Vokshi, nuk do të komentojmë përgjigjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cilën pyetje?

Albana Vokshi – Unë nuk do ta vonoj, sepse e di që mund të mos e japë përgjigjen, por publikimeve që unë iu referova, pra atyre që ju nuk keni publikuar, nuk kanë të bëjnë me censin, janë të dhëna ekonomike-sociale, domethënë nuk kanë lidhje me atë që thatë ju. Më vjen keq! Ju nuk keni publikuar edhe të dhënat administrative të punësimit në administratë.

Unë nuk iu referova trajnimeve të INSTAT-it, Eurostat-i ka filluar që prej vitit 2008 që jep asistencë për ngritjen e burimeve njerëzore. Në informacionin që kam unë, një pjesë e mirë e tyre ose të gjithë mund të kenë ikur. Nuk ka problem nëse nuk përgjigjeni.

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja Dhuli!

Elsa Dhuli – Faleminderit!

Lindita Nikolla – Atëherë, vazhdojmë me debatin.

Fjala për zonjën Sorina Koti, 7 minuta.

Të përgatitet zoti Vangjel Dule.

Sorina Koti – Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë personalisht raportin e INSTAT-it e konsideroj shumë të rëndësishëm, për vetë faktin se të dhënat që prodhohen nga ky institucion përdoren nga shumë grupe interesi, nga institucionet qeveritare, ndërkombëtare, kombëtare, nga shoqëria civile, nga akademitë e të tjerë.

Në bazë të të dhënave që ne marrim nga ky institucion hartojmë projektligjet, hartojmë projektet, hartojmë politikat, si dhe reforma të ndryshme. Pavarësisht ndryshimeve pozitive që ky institucion ka bërë, përsëri vërtetësia e shifrave ngre pikëpyetje, pasi të dhënat bazë kryesisht vijnë nga institucionet qeveritare, të cilat përpunohen dhe publikohen sipas interesave të qeverisë herë pas here.

Po i kthehem temës aktuale, projektligjit që u soll me një shpejtësi marramendëse në Kuvend, atij për kanabizimin e vendit. A ka të dhëna INSTAT-i për kanabisin e mbjellë? Po për të ardhurat që janë gjeneruar? Ku është bazuar qeveria që e kaloi me procedurë të përshpejtuar dhe është miratuar nëpër komisionet parlamentare? Ku do të shkojnë paratë që do të vijnë nga legalizimi i këtij produkti kaq problematik për shqiptarët? A do të rriten pensionet, ndihma ekonomike, ndihma sociale, meqenëse po e legalizojmë këtë produkt, dhe ju shumë shpejt me votën tuaj do ta ligjëroni? Maqedonia e Veriut, që është vendi më i afërt fqinj, gjënë e parë që bëri, të paktën ndihmoi shtresat në nevojë. Këtë do t'ia lëmë kohës, do ta shohim se çfarë do të bëni ju me ato para, pasi ju ende nuk e keni bërë publik planin se si do ta menaxhoni mbjelljen e kanabisit.

Mendoj se INSTAT-i ka edhe detyra të tjera të rëndësishme, siç është censi për popullatën, ashtu edhe ai për bujqësinë. Ato të dhëna që ju prodhoni për stabilitetin ekonomik-social, ne duhet t'i debatojmë dhe t'i diskutojmë, ashtu siç kemi bërë edhe në Komisionin e Ekonomisë, por jo vetëm; sepse nuk i marrim vetëm ne që jemi anëtarë të atij komisioni, por i merr e gjithë Shqipëria. Censi për popullatën dhe ai për bujqësinë janë dy detyra, që duhet të ndodhnin kohë më parë, por ju i keni parashikuar të ndodhin këtë vit dhe në vitin 2024.

Po i kthehem pak mirëqenies së qytetarëve, meqenëse e lidha edhe me projektligjin e përshpejtuar të kanabisit. Minimumi jetik, ky është thelbi i gjithë problematikës që kemi ne si vend. Ne jemi vendi i vetëm në rajon, në Ballkan dhe në Europë që nuk e kemi miratuar ende minimumin jetik. Përsëri rëndësia e shifrave që prodhon INSTAT-i është shumë e rëndësishme. Në bazë të shifrave të konsumit të shportës bazë, ushqimore dhe peshave përkatëse, llogaritet edhe vlera e minimumit jetik. Me formulë të përcaktuar, Avokati i Popullit më 2019-ën e ka përcaktuar minimumin jetik 17 mijë e 785 lekë në muaj. Ne si PD, para një muaj dorëzuam projektligjin për minimumin jetik, i cili nuk është marrë ende në konsideratë për t'u diskutuar në komisionet bazë. Po e theksoj përsëri, pa një minimum jetik nuk mund të ketë zhvillim ekonomik dhe social të vendit, ky është jetik për shqiptarët, sepse në bazë të këtij minimumi jetik vendosen pensionet, vendoset ndihma ekonomike, vendoset ndihma sociale, çdo pagesë që del nga buxheti i shtetit. Ne propozuam që në lidhje me inflacionin dhe indeksimin e tij minimumi jetik të ishte të paktën 200 euro, por nuk ka pasur asnjë lloj reagimi qoftë nga mazhoranca, qoftë nga grupet e interesit.

Unë shpresoj shumë që kjo çështje të diskutohet të paktën në seancën e radhës, kur të

vijmë në shtator. Pra, të mos diskutojmë më për kanabizimin e vendit apo për projektligje të tjera, sepse nuk ka gjë më të rëndësishme në Shqipëri se sa rritja e mirëqenies së shqiptarëve; nuk ka rëndësi rritja ekonomike në përgjithësi kur shqiptarët në xhepat e tyre kanë më pak para se ç'kanë pasur më parë.

Unë shpresoj që kjo nismë të miratohet, sepse është për të mirën e të gjithëve! Këtu nuk ka ngjyrim politik, të majtë dhe të djathtë, por duhet marrë parasysh dhe duhet miratuar. pra, këtë nismë e ndërmorëm ne dhe shpresoj shumë që të miratohet!

Po i rikthehem censit, që shpresoj të realizohet, sepse shtatori është afër; ndoshta mund të dalin edhe problematika gjatë rrugës dhe mund të shtyhet përsëri, por shpresojmë që këtë radhë të jetë i vërtetë, sepse do të na duhet të shohim situatën demografike, ekonomike, minoritetet, situatën e tyre deri ku janë. Në të vërtetë, gjithkush duhet të marrë atë që meriton.

Censin e bujqësisë ne e kemi kërkuar në Komisionin e Ekonomisë dhe çdo herë që Instituti i Statistikave apo Ministria e Bujqësisë kanë qenë në komision, kemi kërkuar regjistrin e fermerëve, regjistrin e bujqësisë, sepse në bazë të tij ne mund dhe duhet të dimë se ku është realisht ky sektor. Bujqësia është një nga sektorët më jetikë që ka Shqipëria, pasi kontribuon në GDP-në e vendit me mbi 50% të tij dhe, për fat të keq, është ende i paformalizuar.

Janë me qindra e mijëra euro të hedhura dëm nga fondet e Bashkimit Europian, të cilat nuk shkojnë në xhepat e fermerëve, nuk shkojnë as në xhepat e blegtorëve për shkak të mosregjistrimit të pasurive të tyre, të burokracive pafund që ka nëpër ministri dhe nëpër institucionet shtetërore.

Skemat e mbështetjes së fermerëve dhe blegtorëve nuk mund të funksionojnë nëse nuk kemi realisht një regjistër të shkruar, që të mirëfunksionojë jo vetëm në nivel qendror, por edhe në çdo bashki.

Unë dua që ekonomia jonë të mos jetë më në të zezë, ashtu siç po funksionon aktualisht, ku 64% e ekonomisë është informale. Kështu që, le të miratojmë një orë e më parë minimumin jetik, t'u japim dritën jeshile shqiptarëve, që në xhepat e tyre të ketë më shumë para vitin që vjen.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Dule.

Keni 5 minuta në dispozicion.

Vangjel Dule - Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë,

E nderuar drejtoreshë e INSTAT-it,

Thembra e Akilit në regjistrimet e mëparshme të popullsisë në vendin tonë ka qenë regjistrimi i pjesëtarëve të minoriteteve etnike dhe komuniteteve fetare. Ju pyeta se çfarë keni menduar për përfshirjen e tyre në administrimin e procesit, me idenë se do të isha më i informuar, më i qetë dhe më i sigurt, sepse edhe ky aspekt do të merrte një zgjidhje përfundimtare dhe të besueshme, por nga përgjigjja që mora nuk dola optimist. Pse? Shikoj që nuk e keni vënë ujin në zjarr për trajtimin e këtij problemi. Ka mosbesim të dyanshëm. Ku qëndron mosbesimi?! Ju, si institucion, nuk operoni me një mentalitet europian, që ta konsideroni censin si një instrument, keni fobi; keni fobi nga produkti që do të sjellë përdorimi i këtij instrumenti, në një kohë kur duhet të ishit të parët që të sillnit mesazhe civilizuese, madje edhe për politikën. Nuk ju vjen asgjë e keqe nga kjo gjë, përkundrazi, ka vetëm anë pozitive.

Duhet të bëhet "inventarizimi i popullsisë", nëse ky është termi i përshtatshëm, që ta dimë se kush është kush. Ne si politikanë e duam produktin tuaj, që të dimë se si do t'i implementojmë ato detyrime në politikat tona për pjesëtarët e minoriteteve; ku jetojnë ato tradicionalisht; sa është numri i komuniteteve të tyre. Ju sërish nuk do të na jepni një produkt të besueshëm. Pse? Pas 2 vjetëve shtyrje të censit, na thoni, se ende nuk e keni bërë publik pyetësorin e tij, sepse nuk e keni detyrim ligjor. A nuk keni qenë në atë institucion për debatet që u bënë për këtë të shkretë pyetësor?! Ky pyetësor në vitin 2001 nuk përmbante pyetje në lidhje me përkatësinë etnike, gjuhën amtare dhe afilimin fetar; në vitin 2011 këto u përfshinë, por me klauzolat e gjobëvënies.

Tani, vijmë në një moment tjetër, kur ligji i ka kapërcyer këto. A nuk duhet të ishit ju pararendës të një fryme të re, konstruktive? A i keni përfshirë komunitetet e minoriteteve në një dialog? A jeni përpjekur t'i përfshini, t'i rekrutoni, që të jenë pjesë e stafit në nivele të ndryshme për censin e ardhshëm? Jo. Me sa kuptoj, nuk e keni bërë. Jemi 2 muaj, pas 2-3 ditësh, përpara fillimit të censit dhe ligji ju

detyron të filloni informimin publik dhe sensibilizimin publik. Kur do ta bëni, nëpër plazhe, gjatë muajit gusht?!

Zonja drejtoreshë, ju lutem, nuk është ende vonë që të ndërmerrni hapa rregullues të këtyre aspekteve, të cilat janë domethënëse, nuk janë dytësore. Përfshini grupet e interesit, përfshini minoritetet me përfaqësuesit e tyre, që përfundimisht të kemi një cens europian, si në çdo vend tjetër; të mos jemi më vendi që nuk kemi bërë, si shumë gjëra të tjera, një cens të gjithëpranuar.

Ne kemi bërë një cens që nga ana statistikore (dhe ju duhet të ishit të parët të shqetësuar) komunitetin e besimtarëve ortodoksë e ka nxjerrë 6%, pra pothuajse 4 herë më pak se regjistrimet e paraluftës dhe të pasluftës. Me këto procedura dhe me këtë mentalitet që unë konstatova, të paktën në përgjigjet që iu dhatë pyetjeve të mia, nuk shikoj se diçka ka ndryshuar. Prandaj, shfrytëzojeni kohën që keni deri në fillimin e këtij procesi; operoni me një frymë profesioniste dhe statistikore; na jepni ne politikanëve atë që ju thashë në fillim instrumentin e duhur për të ushtruar politika adekuate. Largojuni steriotipeve! Largojuni paragjykimeve! Duhet të jeni të parët. Largojuni fobive!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Bujar Leskaj.

5 minuta në dispozicion.

Të përgatitet zoti Saimir Korreshi.

Bujar Leskaj – E nderuar zonja Kryetare,

Personalisht e vlerësoj kontributin e INSTAT-it ndër vite, sidomos gjatë viteve të fundit, pasi ka njohur një zhvillim të konsiderueshëm profesional dhe po provon të luajë një rol në rritje në vendimmarrjen ekonomike të vendit si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat, përmes produkteve periodike dhe serive të tij statistikore. Këtu dua theksoj vjetarin e tij "Shqipëria në shifra 2021", produkt i nxjerrë gjatë vitit 2022, në vijim të anuarëve të mëparshëm profesionalë.

INSTAT-i është përpjekur që të gjenerojë informacion objektiv dhe të plotë sa më shumë të jetë e mundur, kjo falë drejtuesve të tij ndër vite deri te drejtuesja aktuale.

Personalisht i vlerësoj përpjekjet e INSTAT-it për hapjen dhe mbylljen me sukses të bisedimeve për kapitullin 18 "Statistikat" të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian, gjithashtu ligjin "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022–2026", si një dokument i qartë strategjik dhe udhërrëfyes i mirë, i cili e sjell INSTAT-in më pranë sivëllezërve të tij të vendeve anëtare të BE-së dhe më pranë Eurostatit. Këto janë dy hapa para shumë të mirë dhe shumë cilësorë të INSTAT-it, por, nuk e di pse më kujtohet një titull i vjetër, që nuk ka rëndësi të pohoj autorin, INSTAT-i ka ecur dy hapa para dhe një hap pas.

Unë mendoj se, për fat të keq, mosrealizimi i censit të popullsisë dhe banesave gjatë vitit 2022 për probleme në prokurim, përbën një hap madhor prapa, pra një dukuri tejet negative. Mangësitë që u vunë re gjatë vitit 2022 po përsëriten në mënyrë shqetësuese edhe këtë vit. Gjykoj, dhe uroj që të jem gabim, se as për këtë vit nuk do të jemi në gjendje të nisim me realizimin e censit të popullsisë dhe banesave. Kjo është e rëndë, sepse prodhon një vonesë trevjeçare në realizimin e aktivitetit më madhor të INSTAT-it brenda një dekade. Këtu drejtoresha duhet të jetë shumë e vëmendshme, duhet t'u thërrasë atyre sirenave të alarmit, sepse me mosrealizimin e censit tri nga parimet themelore të statistikave: paanshmëria, besueshmëria dhe pavarësia profesionale, vihen në pikëpyetje të madhe.

Mosrealizimi i censit, duke ngelur peng i mosrealizimit në kohë të një tenderi është një paradoks i madh, është defekt madhor i statistikave tona dhe i institucioneve. Personalisht nuk besoj se përgjegjësia për mosrealizimin e censit bie vetëm mbi INSTAT-in, por gjykoj se kjo vonesë trevjeçare është e gatuar në zyra të tjera, është e qëllimshme dhe strumbullari i saj kryesor ka qenë qeveria, e cila stepet përballë dokumentimit të boshatisjes së frikshme të vendit.

Informacionet që do të mbledhë INSTAT-i, në fakt, përbëjnë edhe një shumatore të qeverisjes defektoze dhe autokratike të vendit, humbjes së perspektivës, sidomos nga të rinjtë, dhe mungesës së shanseve për konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun shqiptar të punës dhe të sipërmarrjes.

Pra, për mendimin tim, qeveria është ajo që e vonon dhe e pengon censin, jo vetë INSTAT-i, ndërkohë që qeveria duhej të ishte e interesuara kryesore, pasi ky informacion është i dobishëm edhe për politika të tjera qeveritare dhe jo vetëm.

Shtatë mungesat kronike të INSTAT-it, të cilat i paraqet edhe vetë institucioni në analizën e tij SWOT, do t'i përmend telegrafisht për mungesë kohe.

Së pari, mungesa kronike e fondeve.

Së dyti, burimet e pamjaftueshme njerëzore.

Së treti, INSTAT-i thekson se sistemi i trajnimit të stafit të tij nuk paraqitet i konsoliduar.

Së katërti, për fat të keq, te ne mungon auditi i mirëfilltë statistikor.

Së pesti, edukimi i mangët statistikor.

Së gjashti, forma të pamjaftueshme komunikimi me palët e interesit.

Së shtati, shpërndarja joefektive e informacionit statistikor.

Në këto pak minuta dua të theksoj se kërcënimi i pavarësisë së INSTAT-it nga ekzekutivi, është kërcënimi më serioz ndaj tij. Të gjithë ne duhet ta pranojmë se sistemi ynë i llogarive kombëtare është ende shumë i mangët. Një pjesë e të dhënave të raportuara, përfshirë edhe produktin e brendshëm bruto, paraqiten jo rrallëherë si vlerësime dhe jo matje faktike, ku një pjesë e informacionit statistikor që mbledh INSTAT-i vjen i cunguar në kohë dhe në fushat që ai mbulon.

Në këto kushte të vështira të punës së INSTAT-it dhe të sfidave të mëdha që e presin këtë institucion serioz dhe profesional në gjysmën e dytë të këtij viti dhe në vitet në vijim, të gjithë ne: Kuvendi, institucionet e tjera, qeveria, institucionet qendrore dhe vendore, publiku dhe media, duhet të bëjmë më shumë për ta ndihmuar INSTAT-in. Në radhë të parë, ne duhet të kontribuojmë në plotësimin e mangësive me të cilat përballet ky institucion. Si kërcënim kryesor për efektivitetin dhe eficiencën e produktit statistikor të INSTAT-it, unë shikoj mungesën e garancive të plota për pavarësinë e këtij institucioni statistikor, thelbësor për vendimmarrje publike. Personalisht, e quaj të rëndësishme këtë pavarësi.

Ju lutem, në këto pak sekonda, dua të theksoj se krahas kryerjes së censit, sa më shpejt të jetë mundur (pra, në kohën kur ju keni përcaktuar, në vjeshtë apo dimrin e fundvitit), me cilësinë e duhur, gjykoj se dy sfidat themelore të INSTAT-it në të ardhmen janë: rritja e gamës së produkteve statistikore dhe ruajta e vlerave të statistikave zyrtare si cilësore dhe të besueshme.

Unë u bëj thirrje institucioneve shtetërore, që t'i zbatojnë me seriozitet dhe me përgjegjësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga programi i statistikave zyrtare 2022–2026.

Në vlerësim të raportit, të fjalës dhe të prezencës së drejtoreshës së institucionit sot këtu (duket që është një institucion serioz, i përgjegjshëm dhe që e respekton Kuvendin), do të më lejojë drejtoresha dhe ju, e nderuar zonja Kryetare, që t'i jap një këshillë: ju lutem, ruhuni nga patronazhistët dhe mos i bashkoni ata me administratën profesionale të INSTAT-it, sepse, po e them me gjuhë popullore, do t'jua hanë si mola institucionin.

Faleminderit për kohën!

Lindita Nikolla – Zoti Saimir Korreshi nuk është.

Fjalën e ka zonja Ina Zhupa.

Të përgatitet zoti Shalsi.

Ina Zhupa - Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, e them pa frikë se Instituti i Statistikave sot është instituti i falsiteteve, sepse mjafton të kuptojmë që bazohet në të dhënat e popullsisë së matur në vitin 2011. Në momentin kur ti nuk mat popullsinë, çdo e dhënë që ty të vjen për papunësinë, çdo e dhënë që ty të vjen për GDP-në për frymë e ka bazën e gabuar dhe çdo e dhënë që paraqet INSTAT-i ka një marzh shumë të lartë gabimi. Për të mos thënë që është shndërruar si një drejtori statistikash, në funksion të nevojave të propagandës që ka qeveria; kur INSTAT-i thotë se janë rritur shitjet dhe blerjet me pakicë, qytetarët tregojnë se janë më të varfër dhe që blejnë më pak; kur INSTAT-i thotë se janë punësuar..., sukses..., pensionistët..., 500 mijë pensionistë; kur INSTAT-i tregon të pavërteta të një realiteti që qytetarët e jetojnë çdo ditë.

INSTAT-i sot nuk ka arritur dot as standardet e INSTAT-it të qeverisjes së vitit 2011 apo të vitit 2012, pasi ai ende sot punon me të dhënat e censit të popullsisë së vitit 2011 dhe me censin e bujqësisë së vitit 2012, kur drejtohej në mënyrë profesionale nga drejtoreshë Ines Nurja, e doktoruar në Francë, e cila e ktheu këtë institucion në diçka profesionale. Ju jo vetëm që nuk e arrini dot këtë, por nuk arrini dot as standardin e drejtoreshës Milva Ekonomi, e cila bëri edhe më shumë përpjekje, që mund të ishte edhe më politike, por bëri një punë shumë më të mirë sesa ju sot. Pra, ju as standardin e këtyre dy ish-drejtoreshave të INSTAT-it nuk e arrini dot. Edhe

pse keni një teknologji shumë më të avancuar, edhe pse keni stafeve profesionale me një përgatitje shumë më të avancuar, madje që janë doktoruar në Shqipëri, përsëri nuk i arrini dot këto standarde.

Në këtë parlament diskutojmë gjithmonë për portalin e-Albania, për teknologjinë, për ecjen përpara në teknologji, ndërkohë keni dy vjet që thoni se nuk keni tableta për të bërë censin e popullsisë. A e kuptoni tani sa fasadë është kjo që ju thoni: "Ne ecim përpara me teknologji avangardë dhe nuk kemi tableta për të bërë censin e popullsisë"?! Pra, që këtu fillon dështimi! Keni dy vjet që nuk blini dot tableta, ndërkohë ju mungon edhe profesionalizmi qoftë për të bërë tenderin, qoftë për të bërë censin. Më pas të gjitha të dhënat vijnë dhe riciklohen nga të dhënat e censit të vitit 2011, ku popullsia ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë, ku ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë mënyra se si duhen bërë këto të dhëna dhe mënyra se si duhen reflektuar këto të dhëna.

Po si është e mundur që ju në raport na përmendët se është sukses që INSTAT-i është cituar kaq herë në televizion dhe kaq herë në portale! Mirë që i keni matur edhe këto! Madje, shpresoj t'i keni matur saktë, jo si gjërat e tjera! Po çfarë tregon kjo?! Po t'i lexoni ato artikuj, gjysma apo treçereku i tyre tregojnë se si të dhënat tuaja nuk përputhen me realitetin. Si i keni matur ju këto të dhëna, sa herë ju ka dalë emri në *google search*, apo sa herë jeni përmendur për mirë ose për keq? Ju siguroj që më shumë jemi përmendur për keq sesa për mirë, sepse të dhënat që thoni ju, nuk bazohen me realitetin. Këtë duhet të matni.

Ashtu siç e thatë edhe ju kur iu përgjigjët pyetjes sime: e matni numrin e turistëve nga hyrjet dhe daljet në dogana. Pra, keni një fiktivitet shumë të madh në matjen e numrit të turistëve.

Gazetarja investigative kishte bërë një investigim se çfarë deklaronte koncensionari për hyrjet dhe daljet nga Kosova, (sepse nuk besoj që vëllezërit tanë kosovarë vijnë me traget, në shumicën e tyre, por një hyrje përdorin kryesisht), dhe çfarë të dhënash kishte INSTAT-i për njerëzit e ardhur nga Kosova gjatë vitit 2022. Shifrat tuaja ishin totalisht të ekzagjeruara dhe nuk përputheshin me realitetin. Më pas, vjen ministrja Kumbaro këtu, me shifrat tuaja, dhe thotë: "Parajsa e turizmit në Shqipëri! Ja ku i keni shifrat, sa turistë kanë hyrë dhe sa kanë dalë në Shqipëri, gjë që nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër gjatë sezonit turistik". Ndërkohë, jua thashë dhe po përsëris: hyrjet dhe daljet e të njëjtit person nga pika të ndryshme doganore apo në ditë të ndryshme, sidomos gjatë sezonit veror, ju i llogarisni si hyrjet dhe daljet e një turisti, ju e futni në numrin e turistëve, sepse nuk përpiqeni të kuptoni sa është numri i atyre që akomodohen në strukturat akomoduese. Ata janë turistët. Nuk është turist ai që vjen për të takuar nënën e sëmurë dhe ikën për dy ditë. Ai nuk i prodhon të ardhura këtij vendi. Turist është ai që qëndron gjatë në struktura akomoduese dhe që prodhon ekonomi, por këto të dhëna ju nuk i bëni, sepse jeni një institut në shërbim të qeverisë.

Mua më vjen shumë keq që, ju sot nuk ishit e aftë të tregonit se ku jeni me censin e popullsisë dhe ku jeni me censin e bujqësisë. Ky parlament miraton politika për bujqësinë, politika për fermerin, kur nuk e ka idenë se sa të sakta janë të dhënat, sa funksionojnë realisht fermerët, si punohet toka dhe se cilat janë produktet, pra gjithçka që duhet të dihet për bujqësinë.

Në momentin kur ne dështojmë në statistika, dështojmë edhe në politika, sepse politika të ndërmarra me statistika gjysmake, me statistika të pavërteta, me statistika që vijnë si rezultat i mbledhjes së të dhënave sipas kohës së shkuar, atëherë janë statistika që nuk hyjnë në punë për asgjë. Në qoftë se nuk jeni të aftë të bëni censin, në qoftë se nuk jeni të aftë të prodhoni statistika dhe t'i publikoni ato, jo të vini rrengje, që shko atje dhe merr një njoftim për shtyp, por të krijohet mundësia që të merren të gjitha tabelat, edhe në formë *excel*-i, për të kuptuar si kanë ardhur në ato të dhëna, atëherë, ju po fshini realitetin dhe po përdoreni thjesht si një drejtori tjetër e shumtë e propagandës së qeverisë "Rama".

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Eduard Shalsi.

Eduard Shalsi – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, më lejoni të falënderoj drejtoreshën e Institutit të Statistikave, sidomos punonjësit dhe ekipin e saj, me të cilët Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, që kam nderin të drejtoj, ka pasur vazhdimisht kontakte!

Për shembull, nëse zonja parafolëse do të kishte marrë mundimin t'u ishte bashkëngjitur deputetëve të Komisionit të Ekonomisë, aty kishte

të djathtë dhe të majtë, do të kishte kuptuar se çfarë ndodh në atë institucion apo si funksionojnë këto institucione të pavarura.

Ka perënduar një herë e mirë koha kur Kryeministri dilte deklaronte rritjen ekonomike dhe të nesërmen dilte Instituti i Statistikave, apo kur ish-Kryeministri jepte shifra dhe pastaj Instituti i konfirmonte. Tashmë prej shumë kohësh kemi të bëjmë me një institucion të konsoliduar dhe, nëse do të kishit marrë mundimin të lexonit më shumë, të kuptonit më shumë, të diskutonit me punonjësit për sfidat që kanë, jam i bindur që sado pozicione partiake të verbra të donit të mbanit, përsëri nuk mund të flisnit jashtë realitetit, siç e bëni rëndom.

Ne si komision, e theksoj, si komision, sepse bashkë me deputetët që i përkasin opozitës, këtu fus të gjitha copëzat e opozitës, kemi pasur kontakte të vazhdueshme me Institutin e Statistikave, madje disa prej jush kanë qenë në vizitën që kemi bërë pranë institucionit, ku jemi informuar dhe kemi kuptuar akoma më shumë. Kemi nevojë të mësojmë. Nuk e kam problem ta pohoj se ka shumë gjëra që nuk i dimë dhe nuk i di, por nuk mund t'i kuptosh nëse nuk komunikon me specialistët. Titullarët e institucionit janë njerëz të përgatitur, profesionistë dhe njerëz me dinjitet, ku nuk mund t'u diktosh se çfarë duhet të prodhojnë apo çfarë duhet të thonë. Kini parasysh një gjë, ju kam këshilluar disa herë: jini të kujdesshëm kur flisni për institucione të tilla dhe për njerëzit pas këtyre institucioneve. A e dini pse?! Sepse ndoshta juve nuk ju bën përshtypje çfarë dëgjoni, çfarë thoni dhe çfarë nxirrni nga goja, por janë njerëz seriozë dhe unë e kuptova nga shqetësimi që kanë pasur disa herë, pas mbledhjeve që kemi zhvilluar në komision, kur i keni akuzuar për falsifikime.

Dëgjova një koleg tjetër të nderuar, i cili vendosi disa epitete aspak të denja, "fobi" apo "paragjykime", tha zoti Dule. Në fakt, dua t'i them, sepse e kam ndjekur nga afër procesin edhe për shkak të funksionit: a je në dijeni të takimit të fundit që është bërë në qarkun e Gjirokastrës, ku ka qenë vetë titullarja bashkë me ekipin e saj? A je në dijeni të takimeve të vazhdueshme që disa ambasada, për shkak të shqetësimeve të tyre për minoritetet, kanë pasur me Institutin e Statistikave? A je në dijeni të diskutimeve, apo ke humbur kontaktet me ata njerëz dhe nuk e di që po zhvillohen konsulta? Për shembull, a e di që Komisioni Europian po asiston procesin e censit qoftë të popullsisë dhe të banesave, qoftë edhe të bujqësisë? Po të thuash që nuk je në dijeni, atëherë të falet kjo padijeni, por nuk të falen ato lloj aludimesh që bëre.

Pra, Komisioni Europian po asiston procesin e censit, madje ka alokuar njerëz që merren me metodologjinë, merren me sektorin e teknologjisë së informacionit, merren edhe me sektorin e komunikimit. Po, është shumë e rëndësishme dhe biem dakord, që aspekti i komunikimit të censit është shumë i rëndësishëm. Mos i fryni skepticizmit, me të cilin me sa duket doni të mbani larg disa njerëz, nuk është e shëndetshme, nuk vlen. Metodologjia po asistohet nga një njeri me shumë eksperiencë që e ka sjellë Bashkimi Europian nga Holanda; sektori i teknologjisë së informacionit, nga një njeri me shumë eksperiencë, italian, ndërkohë për sektorin e komunikimit kemi një specialist gjerman. Pra, a e dini që në këtë proces është përfshirë dhe po jep asistencën teknike edhe Komisioni Europian, apo jo? Me sa duket, nuk e ditkeni. Nëse doni të flisni sa për të folur, në rregull. A e dini sa takime janë bërë nga komunitetet fetare? U çuditët: si ka mundësi që censi është shtyrë me 2 vjet! Po pandemia ku ishte?! Dikush tjetër foli e habitur për tabletat: si ka mundësi! Jo. A e dini që para dy vjetësh ndodhi pandemia, apo e keni harruar?!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po jua kujtoj me përulësi që bota u përfshi nga një pandemi, ku nuk bëri përjashtim as Shqipëria dhe kjo ishte arsyeja. Po pse nxirrni...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju që po më pyesni tani, nuk jeni ju që e keni ngritur si shqetësim, sepse jam i bindur që jeni mjaftueshëm të arsyeshëm dhe të logjikshëm sa të mos ngrini pyetje të tilla paradoksale.

Pra, konsultat janë element i domosdoshëm i një censi të rëndësishëm. Po, është e vërtetë: ne kemi nevojë për të dhëna të besueshme, por ama gjatë gjithë këtyre viteve Instituti i Statistikave është një nga institucionet që meriton respekt, por nuk mund t'i bënte i vetëm, pa agjentët statistikorë si Ministria e Financave apo Banka e Shqipërisë.

Kam qenë, jam dhe do të mbetem i shqetësuar për të dhënat e bujqësisë. Nëse nuk e dini, aty nga fundi i vitit 2000, statistikat e bujqësisë u prodhuan në zyra pa lidhje me bujqësinë dhe që nga ajo kohë kemi probleme të

mëdha me të dhënat. Unë jam një fanatik i të dhënave të sakta dhe shpeshherë qëllon që, ndoshta dëshira është e mirë, vullneti, por për shkak se vendimmarrja bazohet mbi të dhëna të gabuara, na ka çuar në disa vendime jo të drejta.

Bujqësia është një sektor, që sot e kësaj dite vuan nga mungesa adekuate e të dhënave. Më duhet ta pranoj që çalojmë shumë në këtë sektor dhe është një nga padurimet e mëdha që unë kam për të parë të dhëna reale për bujqësinë dhe kemi shumë për të bërë. Kjo ishte edhe arsyeja pse bujqësia u vendos si pjesë e censusit, por progresin në përmirësimin e të dhënave askush nuk mund ta mohojë. Pra, duam apo nuk duam, ne jemi bërë pjesë e raportimeve falë këtyre ndërkëmbimeve të shpeshta me Eurostat-in, me Komisionin Europian, çka pasqyrohet edhe në raport, çka pasqyrohet edhe gjatë diktimeve në kapitullin e 18-të, të cilat dëshmojnë se ka një progres të dukshëm. A duhet të bëjmë më shumë? Patjetër që duhet të bëjmë më shumë, vetëm se një kërkesë kam: larg politizimit të punës së këtyre institucioneve, sepse dëgjova me shumë vëmendje një koleg tjetër, i cili i njohu meritën INSTAT-it, por aludoi dhe këshilloi me demek atë makthin e patronazhistëve. Mos ki merak, i nderuar, sepse edhe të duash të depërtosh me ide të tilla, aty ka njerëz profesionistë, mjaftueshëm të ndërgjegjshëm, të cilët nuk mund të bëhen pjesë.

Ndaj, të nderuar kolegë deputetë, është momenti që të bëhemi bashkë që të kërkojmë të dhëna më të shpejta, më të sakta, por për këtë gjë duhet t'i inkurajojmë këto institucione dhe jo t'i anatemojmë me të pavërteta që vijnë nga moskuptimësia, ajo çka do të dëshiroja të besoja, apo nga arsye të tjera, të cilat askush nuk i di më mirë sesa ju vetë.

Më lejoni t'ju them se brenda jush ka zëra racionalë, ka njerëz që unë i vlerësoj dhe i respektoj. Ndaj, dua ta falënderoj Institutin e Statistikave për punën dhe ta inkurajoj fort për këtë sfidë, pasi është një sfidë shumë e rëndësishme për të dhe për ne. Pra, ne duhet ta inkurajojmë këtë institucion dhe të mos e fusim në debate banale politike, që shpeshherë kanë molepsur këtë parlament.

Shumë faleminderit!

Lindita Nikolla – Dy minuta replikë zoti Dule.

Vangjel Dule – Faleminderit, zonja Kryetare!

Kam thjesht një replikë të shkurtër me zotin Shalsi.

Unë e vlerësoj gjithmonë për ndërhyrjet e tij se janë informuese, moralizuese, këshilluese dhe të pranuara, por reflektimi që më provokoi në këto sekuenca kohore më bën edhe më të shqetësuar në lidhje me fatin e "thembrës së Akilit", që thashë edhe më parë, të censusit. Kemi dy censuse të dështuara në aspektin e regjistrimit të pjesëtarëve të minoriteteve dhe të komuniteteve fetare. Në asnjë rast kjo nuk duhet të na vërë në gjumë se e kemi përgatitur mbarë kësaj here, por duhet të jemi në alert të vazhdueshëm që censusi i ardhshëm të mos jetë në të njëjtën rrjedhë.

Edhe në vitin 2001 ishte nën vëzhgimin e Komisionit Europian dhe me financim të huaj. E njëjta gjë edhe në vitin 2011, ishte i dështuar. Ne duhet të bëjmë çmos, dhe, natyrisht, nuk e kam diskutimin tim për të akuzuar apo për të vënë përpara përgjegjësisë, por për të inkurajuar, sepse sot që flasim mund të ketë patur kontakte, mund të ketë patur konsultime. Me përfaqësues zyrtarë të shoqatave përfaqësuese kryesore të minoriteteve nuk ka patur, por ka patur me përfaqësues periferikë dhe me synim, këtë nuk mund të mos e karakterizoj si politikë, për të shmangur përfaqësues të mirëfilltë apo përfaqësim gjithëpërfshirës të tyre për të qenë më objektiv.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te raporti i veprimtarisë vjetore të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022.

Në bazë të nenit 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 39 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar"" sot do të paraqesë raportin vjetor për vitin 2022, inspektorja e Përgjithshme, zonja Evgjeni Bashari.

Zonja Bashari, fjala për ju.

Koha për ju është deri në 20 minuta.

Evgjeni Bashari – Faleminderit!

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Në përmbushje të detyrimit ligjor kam kënaqësinë t'ju prezantoj raportin vjetor të veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022.

Inspektorati i Lartë, në përmbushje të kompetencave ligjore për kontrollin e interesave private të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, në funksion të evidentimit, shmangies e parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe të monitorimit të sinjalizimeve, është angazhuar maksimalisht në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij funksionale.

Konkretisht, gjatë vitit raportues janë marrë të gjitha masat e nevojshme duke arritur përmbushjen e plotë të rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën për vitin 2022, Këshilli i Europës, GRECO në raundin V të vlerësimit, si dhe nga Komisioni Europian në raportin për Shqipërinë.

Kështu, në raportin e parë të përputhshmërisë, të paraqitur në seancën e 92-të plenare të GRECO-s për raundin e V të vlerësimit "Për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në qeverisjen qendrore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit", Inspektorati i Lartë u vlerësua si institucioni që kishte plotësuar të gjitha rekomandimet, të cilat kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e tij.

GRECO vlerësoi masat e marra në drejtim të vendosjes në funksionalitet të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Private; rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të institucionit; rritjen e burimeve të përgjithshme financiare të akorduara nga buxheti i shtetit, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e informacionit në 15 raste me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit.

Në rekomandimet drejtuar Inspektoratit të Lartë në kuadër të proceseve reformuese të sistemit të drejtësisë për të pasur prioritet të punës verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, ka vijuar edhe përgjatë periudhës raportuese ushtrimin e kontrollit të deklaratave të pasurisë për kandidatët, të cilët kishin shprehur interes për të qenë pjesë e këtij sistemi.

Në këtë drejtim u morën të gjitha masat e nevojshme për të përfunduar në një kohë sa më të shkurtër verifikimet për 264 kandidatë në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, duke i dhënë përparësi përfundimit brenda afateve të proceseve verifikuese për kandidatët anëtarë në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë, hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, inspektorë pranë zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, personelit administrativ në SPAK, gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, magjistratë pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe këshilltarë në Gjykatën Kushtetuese.

Aktet e kontrollit të plotë, së bashku me dosjet përkatëse, janë dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe organeve të tjera të emërtesës. Për më tepër, Inspektorati i Lartë ka vijuar mbështetjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke bashkëpunuar me organet e rivlerësimit në adresimin e kërkesave për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit për subjektet, të cilat po i nënshtrohen ende këtij procesi.

Për përudhën raportuese janë marrë dhe janë trajtuar në total 63 kërkesa për dhënie informacioni dhe dokumentacioni brenda afateve të përcaktuara nga këto organe, si dhe një kërkesë e adresuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

Në të njëjtën kohë, Inspektorati i Lartë ka vijuar me zbatimin e tri ligjeve bazë: për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, konfliktin e interesave, si dhe sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Përtej sfidave dhe vështirësive, Inspektorati i Lartë mori të gjitha masat institucionale për funksionimin e plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Private, ku, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, gjatë periudhës raportuese zhvilloi aktivitete për rritjen e kapaciteteve për më shumë se 310 autoritete përgjegjëse pranë institucioneve publike, si dhe garantoi asistencë për më shumë se 2000 subjekte deklaruese.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, të gjitha subjektet u deklaruan përmes Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë, brenda 31 tetorit 2022. Në përfundim të procesit, nga të

dhënat e administruara në sistem rezultoi se numri total i deklaratave të interesave private në këtë sistem për vitin 2022 ishte 3975, për të cilat filloi procedura për verifikimin dhe administrimin e tyre në mënyrë shkresore, si dhe kryerja e përpunimit paraprak të të dhënave të paraqitura në deklaratat e interesave private.

Në zbatim të skemës së kontrollit të parashikuar nga kuadri ligjor, iu nënshtruan kontrollit të plotë 806 subjekte, ku, në përfundim të procedurave administrative, u referuan pranë organeve ligjzbatuese 37 raste, si dhe u aplikuan 128 masa administrative me gjobë.

Në përmbushje të rekomandimit të Kuvendit, i cili kërkoi krijimin e një instrumenti të qëndrueshëm që të mundësojë fuqizimin e rolit proaktiv në drejtim të monitorimit sistematik të njësive përgjegjëse për zbatimin efektiv të ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Inspektorati i Lartë ka vijuar të ketë kontakte të ngushta me njësitë përgjegjëse.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë gjatë periudhës raportuese mori të gjitha masat e nevojshme për monitorimin dhe ngritjen e njësive përgjegjëse pranë institucioneve publike dhe private, ku nga administrimi i të dhënave rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë 199 njësi në sektorin publik dhe 565 njësi në sektorin privat.

Në zbatim të parashikimeve të neneve 13 dhe 22 të ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", brenda datës 15 janar 2023 Inspektorati i Lartë ka pritur dhe ka administruar raportet vjetore të dërguara nga njësitë përgjegjëse si nga autoritetet publike, edhe nga sektori privat.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka administruar 178 raporte vjetore nga njësitë përgjegjëse pranë autoriteteve publike, nga të cilat rezultoi se 151 njësi përgjegjëse i kanë paraqitur raportet brenda afateve ligjore. Në analizim të raporteve konstatohet se vetëm në 3 njësi përgjegjëse pranë sektorit publik ka pasur dhe janë trajtuar raste sinjalizimi.

Në lidhje me njësitë përgjegjëse pranë sektorit privat janë marrë dhe administruar 261 raporte sinjalizimi, nga të cilat rezulton se 229 njësi kanë paraqitur raportet brenda afatit ligjor. Në analizim të raporteve të ardhura nga këto njësi të sektorit privat, nuk rezulton të kenë pasur raste të sinjalizimit.

Për sa i përket mekanizmit të jashtëm të raportimit, gjatë vitit raportues Inspektorati i Lartë ka regjistruar dhe ka trajtuar në total 13 raste sinjalizimi dhe 2 kërkesa për mbrojtje. Në analizim të rasteve të paraqitura rezulton se sinjalizimet janë paraqitur kryesisht nëpërmjet postës elektronike, ku 12 raste sinjalizimi kanë ardhur nga sektori publik dhe 1 rast nga sektori privat. Në përfundim të hetimeve administrative është kërkuar dhe janë marrë masat për zgjidhjet e rasteve të gjetura në shkelje të ligjit, si dhe janë njoftuar Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit; KLSH-ja; Policia e Shtetit, për ndjekje të mëtejshme të rasteve, si dhe autoritetet publike për marrjen e masave përkatëse.

Në lidhje me angazhimin e Inspektoratit të Lartë në procesin e përafrimit të legjislacionit me direktivën e BE-së "Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjeve në kuadër të Bashkimit Europian", u garantua përfaqësimi pranë Komisionin Europian në grupin e ekspertëve që është ngritur për realizimin e këtij përafrimi.

Për më tepër, gjatë vitit raportues Inspektorati i Lartë vijoi përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me RAI-n, për projektin e financuar nga BE-ja, i cili synonte përmirësimin e politikave të sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe në Moldavi. Kështu, u garantua përfaqësimi në një sërë aktivitetesh të organizuara nga RAI për njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave rajonale në fushën e sinjalizimit, si dhe u angazhua në hartimin e raportit për vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor në fuqi me direktivën e BE-së.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar ka qenë një ndër prioritetet e këtij institucioni përgjatë vitit 2022, duke synuar edhe zbatimin e rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë, i cili kërkonte intensifikimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit dhe me organet ligjzbatuese.

Vlen për t'u theksuar nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë dhe shkëmbimi i informacioneve në rastet që kanë qenë në fushën e veprimtarisë të secilit institucion, si dhe vijimi i bashkëpunimit me vetë SPAK-un. Në këtë drejtim, me qëllim garantimin e plotësimit të strukturave me

kapacitetet e nevojshme në burime njerëzore, Inspektorati i Lartë mori të gjitha masat për të kryer në kohë sa më shkurtër verifikimin e deklaratave të kandidatëve që kishin shprehur interes për të qenë pjesë e BKH-së dhe SPAK-ut.

Gjithashtu, në vijim të mbështetjes së strukturave të SPAK-ut për hetimet e rasteve për zyrtarët, të cilët janë subjekt i deklarimit të interesave private, Inspektorati ka vendosur në dispozicion të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që ka në dispozicion ky institucion për këto subjekte deklaruese.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, krahas vijimit të marrëdhënieve të ngushta me delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri, Këshillin e Europës, zyrën e OSBE-së, Inspektorati i Lartë ka vijuar komunikimin dhe shtimin e kontakteve me zyrat homologe apo me agjencitë antikorrupsion në rajon dhe më gjerë.

Konkretisht, vlen për t'u theksuar nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet ILDKPKI-së dhe Agjencisë Kombëtare të Integritetit në Rumani, ku palët u angazhuan për të vlerësuar fushat me interes të përbashkët në implementimin e mekanizmave efektive për rritjen e integritetit dhe transparencës.

Në vijim të marrëdhënieve ndërinstitucionale me këtë agjenci, Inspektorati i Lartë mori ftesën për të qenë anëtar me të drejta të plota në *Network for Integrity*, si një forum i rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave të institucioneve nga vende të ndryshme në rritjen e instrumenteve të integritetit, transparencës dhe etikës.

Inspektorati i Lartë, në përmbushje të rekomandimit për forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, medien dhe publikun e gjerë, ka marrë dhe ka trajtuar brenda afateve ligjore 31 kërkesa të ardhura nga shoqëria civile dhe media, si dhe ka mundësuar publikimin e rreth 4 271 deklaratave të interesave private.

Duke dashur ta përmbyll këtë prezantim, gjej rastin të falënderoj Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisionin e Ligjeve për të gjithë mbështetjen e dhënë!

Gjithashtu, dëshiroj të theksoj që prioritetet e këtij institucioni për vitin në vijim mbeten:

1. Garantimi i funksionalitetit të plotë të sistemit elektronik, duke synuar rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të autoriteteve përgjegjëse, si dhe marrja e masave të nevojshme ligjore dhe institucionale për garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së informacionit.

2. Vazhdimi i ndjekjes dhe implementimit të ndjekjes së kontrollit të deklaratave të pasurisë, të interesave private për subjektete deklaruese, si dhe monitorimi i njësive përgjegjëse për regjistrimin dhe hetimin e rasteve të sinjalizimit.

3. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendase dhe ndërkombëtare për të përmbushur të gjitha rekomandimet, të cilat do të hartohen në përfundim të takimeve dypalëshe për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire*, me fokus proceset e integrimit europian.

3. Intensifikimi i bashkëpunimin me organet ligjzbatuese në kuadër të luftës kundër korrupsionit, si një element i domosdoshëm në drejtim të garantimit të sigurisë dhe efektivitetit të kontrolleve dhe hetimeve administrative.

4. Një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkombëtar dhe anëtarësimit në rrjetin për integrim, si një instrument i rëndësishëm për të rritur më tej mekanizmat e integritetit.

Si përfundim, institucioni do të angazhohet për të përmbushur me kompetenca të plota vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim kjo edhe me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Zoti Bardhi ka fjalën për pyetje.

Gazment Bardhi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, unë kam bërë 3 pyetje dhe do të doja të merrja përgjigje.

Zonja Inspektore, besoj se ju e dini që unë i jam drejtuar zyrtarisht institucionit tuaj, sepse opozita ka paraqitur një mocion në Kuvend ndaj deputetes Olta Xhaçka (meqenëse ra fjala, zonja Kryetare, besoj se ka mbi 10 ditë që në tryezën tuaj është paraqitur raporti i Këshillit të Legjislacionit dhe duhet të merrni masa për ta çuar çështjen përpara në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren, sepse po bëheni pengesë për zbatimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, kjo është thjesht për kujtesë, meqenëse jemi tek tema), nga ku rezulton se ministrja, njëkohësisht deputetja Olta Xhaçka, së bashku me bashkëshortin e saj janë bërë

investitorë strategjikë në përputhje me një ligj që, në fakt, e kanë votuar të dy në cilësinë e tyre si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

Sipas këtij statusi, bashkëshorti i ministres dhe deputetes Olta Xhaçka e për rrjedhojë, sipas Kodit të Familjes, edhe vetë ministrja, kanë përfituar në masën 50% të drejtën për të përdorur pasuri publike të shtetit shqiptar, sikundër kanë përfituar lehtësira të tjera, përfshirë reduktimin e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Verifikimi i gjendjes së konfliktit të interesit e mbi të gjitha i ligjshmërisë së pasurisë është nga përgjegjësitë ligjore që ka institucioni juaj. Pavarësisht mocionit, debatit në Kuvend e me radhë, rezulton që ju nuk keni nisur asnjë procedurë verifikimi deri në momentin kur unë i jam drejtuar zyrtarisht institucionit tuaj, sipas përgjigjes së parë të ardhur nga ju. Më pas keni bërë një verifikim, siç më keni informuar, ku, në fakt, nuk keni nxjerrë dot asnjë konkluzion.

Pyetja që kam unë, sipas verifikimit që ju keni kryer, është: cili është burimi i 5 milionë eurove të investimit të familjes së ministres Xhaçka? Sepse, siç e dini, projekti për të cilin është dhënë statusi i investitorit strategjik ka një vlerë prej 5 milionë eurosh. Nga konsultimi që ne kemi bërë lidhur me deklaratat e pasurisë së familjes së ministres, nuk rezulton që ata të kenë burim të ligjshëm në vlerën 5 milionë euro. A keni ju ndonjë informacion se cili është burimi i këtyre të ardhurave dhe a është i ligjshëm ky burim? Shtuar kësaj si nënpyetje: a mundet një deputet i Kuvendit të Shqipërisë të përfitojë të drejtën për të përdorur brigjet e detit, pra një pasuri publike? A mundet që një deputet të votojë një ligj, nga i cili më vonë do të përfitojë vetë?

Pyetja e dytë ka të bëjë me një tjetër rast, që tregon mosveprim nga ana e institucionit tuaj. Besoj se jeni njohur gjatë këtyre ditëve me një pasuri përrallore të padeklaruar të ish-zëvendëskryeministrit, zotit Arben Ahmetaj, që sipas prokurorisë ka fshehur pronësinë mbi dy vila në bregdet, ka një shumë të konsiderueshme parash të padeklaruara, si dhe ka kryer transaksione të paligjshme për të fshehur paratë e korrupsionit.

Në dijeninë tuaj, a ka qenë zoti Ahmetaj, gjatë këtyre viteve që ka kryer funksionin e ministrit, zëvendëskryeministrit dhe deputetit, subjekt i një hetimi të thelluar nga ILDKPKI-ja? Si ka mundësi që institucioni juaj ka pasur një mungesë veprimi apo nuk ka qenë në gjendje të identifikojë këtë pasuri të paligjshme të këtij zyrtari?

Së treti, gjatë gjithë kësaj kohe që ju jeni në krye të këtij institucioni, rezulton që nuk keni marrë asnjë masë apo sanksion ndaj ndonjë deputeti apo ministri për deklarim të rremë, fshehje të të ardhurave apo fshehje të pasurisë. A besoni vërtet se deputetët apo ministrat, gjatë gjithë kësaj periudhe që ju drejtoni këtë institucion, e kanë kaq të ligjshme pasurinë e tyre?

Perceptimi që ka opinioni publik është se deputetët apo ministrat, në abuzim me detyrën e tyre, përfitojnë para në mënyrë të parregullt. A është ky një perceptim i gabuar i opinionit publik, apo është mosveprim i institucionit tuaj për të verifikuar ligjshmërinë e pasurisë në mënyrë korrekte të secilit prej tyre?

Faleminderit!

Evgjeni Bashari – Faleminderit, zoti Bardhi, për pyetjet!

Në lidhje me pyetjen e parë për deputeten Olta Xhaçka, është e vërtetë që ju keni paraqitur një kërkesë dhe në lidhje me këtë kërkesë ju keni marrë edhe një informacion zyrtar nga institucioni. Duke qenë se ky rast është ende në shqyrtim pranë komisionit tuaj, unë nuk dua të shkoj më tej në detaje përtej shkresës zyrtare që ne kemi paraqitur. Doja thjesht të saktësoja që Inspektorati i Lartë e ka të mirëpërcaktuar fushën mbi të cilën vepron dhe heton. Pra, Inspektorati i Lartë vepron dhe verifikon përputhshmërinë apo papajtueshmërinë e një mandati bazuar në ligjin nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave private" dhe lidhur me këtë është bërë edhe hetimi.

Për sa i përket ligjshmërisë së burimit këto janë të dhëna të një hetimi individual administrativ për të cilin Inspektorati i Lartë nuk mund të japë detaje, sepse kjo është shprehimisht e ndaluar me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese që lidhet me publikimin e të dhënave mbi deklaratën e interesave private, thuhet se mund të bëhen publike vetëm ato të dhëna që përmbahen në deklaratat e interesave private dhe që nuk kanë lidhje me proceset hetimore.

Në këtë aspekt, unë nuk mund të jap detaje për rastin konkret në lidhje me çfarë ju parashtroni

si burim i ligjshëm apo burim jo i ligjshëm. Ajo që mund të them është se Inspektorati i Lartë i ka përmbushur të gjitha kompetencat brenda kuadrit të tij ligjor, pra ligjit nr. 9049 për deklarimin, ligjit nr. 9367, si dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Në lidhje me zotin Ahmetaj, për sa kohë ky është një rast në hetim, unë nuk mund të jap detaje të mëtejshme.

Në lidhje me mosveprimin e institucionit për sa i përket marrjes së masave për deputetët, vetë ligji nr. 9367 e ka të paracaktuar skemën e subjekteve që i nënshtrohen kontrollit vit pas viti në mënyrë periodike. Në fakt, në periudhën që unë kam marrë...

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Zoti Bardhi, ju i bëtë pyetjet, ndaj kini mirësinë të dëgjoni përgjigjet!

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Evgjeni Bashari – Çështja "Ahmetaj" është një çështje në tërësi në hetim, dhe unë nuk mund të jap informacion të mëtejshëm.

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

A mund të vazhdoj me përgjigjen e pyetjes së tretë?

Lindita Nikolla – Vazhdoni me përgjigjen, zonja Bashari.

Evgjeni Bashari – Në lidhje me pyetjen e tretë mund t'ju bëj me dije...

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Unë e dhashë përgjigjen e pyetjes suaj...

Lindita Nikolla – Zoti Bardhi, e dha përgjigjen.

Evgjeni Bashari – Në lidhje me pyetjen e tretë doja të specifikoja që...

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Zoti Bardhi, a ka mundësi të ndaloni dhe të dëgjoni?

Evgjeni Bashari – Unë iu përgjigja të dyja pyetjeve, zoti Bardhi.

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

A mund të vazhdoj me përgjigjen e pyetjes së tretë?

Në lidhje me pyetjen e tretë doja të sqaroja që gjatë vitit 2020, kur unë kam marrë mandatin, i janë nënshtruar kontrollit edhe një kategori e deputetëve, të cilët...

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Jo, nuk është e vërtetë!

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Nëse do të më lejoni, unë mund të vazhdoj të përgjigjem.

Vetë Inspektorati i Lartë, në thelb është një organ administrativ të cilit ligji i njeh detyrimin që të përcaktojë masat administrative për kundërvajtje administrative. Në të kundërt, kur dyshon se ka elemente të veprës penale, mund ta referojë çështjen pranë organeve ligjzbatuese.

Ajo që po mundohem të them...

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Jo, edhe kjo nuk është e vërtetë!

Unë do t'jua bëj me dije zyrtarisht ndër vite se sa...

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Zoti Bardhi, unë jam këtu për raportimin e vitit të fundit, kështu që për vitin e fundit nuk ka qenë në skemë kontrolli i deputetëve.

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Kjo nuk do të thotë zero, sepse çdo vit institucioni ka skemën e tij të kontrollit dhe po mundohem t'ju them se në vitin 2021 i janë nënshtruar kontrollit të plotë një kategori e caktuar deputetësh që kishin përudhën e kontrollit, ku janë vendosur një sërë masash administrative për parregullsitë që janë gjetur në deklaratat e interesave private dhe numrin mund t'jua vë në dispozicion.

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja Bashari!

Vazhdojmë me diskutimet.

Fjala për zotin Saimir Hasalla!

Saimir Hasalla – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Veprimtaria e Inspektoratit të Lartë gjatë vitit 2022 është zhvilluar në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore për sa i takon zbulimit të fshehjes së pasurisë dhe zbulimit të shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave private.

Në mënyrë të detajuar, veprimtaria e këtij institucioni për vitin 2022 rezulton si më poshtë:

Numri i deklaratave të administruara nga Inspektorati i Lartë për vitin 2022 është 3975, të cilat të ndara sipas llojit të tyre rezultojnë: deklarata periodike 2785; deklarata para fillimit të detyrës 544; deklarata pas largimit nga funksioni 438 dhe deklarata kandidati 208.

Gjatë vitit 2022, ILDKPKI-ja ka vijuar mbështetjen e procesit reformues të sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë forcimin e

bashkëpunimit me organet e rivlerësimit dhe ONM-në nëpërmjet trajtimit me përparësi të 63 kërkesave të ardhura nga këto institucione, si dhe vendosjes së çdo dokumenti shtesë të kërkuar prej tyre brenda afateve të parashikuara ligjore. Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme" dhe rekomandimit të lënë në rezolutën e Kuvendit, nga Inspektorati është ushtruar kontroll i plotë për 264 kandidatë në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë.

Në vitin 2022 rezulton se në përputhje me përcaktimet e ligjit ""Për deklarimin dhe kontrollin pasurive", të ndryshuar", është bërë kontroll i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave private për 806 subjekte deklaruese. Gjithashtu, rezulton se janë ndëshkuar me masën administrative "gjobë" për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit, 128 zyrtarë.

Për vitin 2022, Inspektorati i Lartë ka paraqitur pranë Prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 37 raste referimesh penale.

Për vitin 2022, numri i deklaratave të interesave private të publikuara nga Inspektorati me kërkesë të publikut, rezulton të jetë 4271.

Gjithashtu, është për t'u vlerësuar veprimtaria e punës së Inspektoratit edhe në drejtim të marrjes së të gjitha masave institucionale për funksionimin e plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Private, me fokus rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për plotësimin e deklaratave nga subjektet e ligjit në mënyrë të saktë. Konkretisht: u organizuan sesione trajnuese për 310 autoritete përgjegjëse, si dhe u adresuan të gjitha kërkesat për asistencë të paraqitura nga subjektet deklaruese, duke përmbyllur procesin e deklarimit brenda afateve të lejuara; përmbushja në mënyrë të efektshme e rekomandimeve të lëna në raportin e vlerësimit të grupit të shteteve kundër korrupsionit, të Këshillit të Europës, GRECO-s në raundin V, ku në raportin e parë të përputhshmërisë, Inspektorati i Lartë u vlerësua si institucioni që plotësoi në mënyrë të kënaqshme ose plotësisht të tria rekomandimet, të cilat kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e tij; konsolidimi i marrëdhënieve me organet e tjera të sistemit të drejtësisë, si: KLGJ-ja, KLP-ja, ILD-ja dhe SPAK-u, kryesisht në verifikimin brenda afateve ligjore të deklaratave, pasurive dhe interesave privatë për kandidatët për pozicione të ndryshme të këtyre organeve; intensifikimi i bashkëpunimit të ndërsjellë ndaj luftës kundër korrupsionit, me qëllim shkëmbimin e informacioneve ndërmjet palëve, siç është nënshkrimi i disa marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionin e SPAK-ut dhe Ministrinë e Drejtësisë; administrimi dhe analizimi i 439 raportimeve të dërguara nga njësitë përgjegjëse, nga të cilat 178 i përkasin sektorit publik dhe 261 sektorit privat, si dhe përditësimi i të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive, sipas kompetencave që i janë caktuar Inspektoratit në dispozitat e ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Nga të dhënat rezulton se 325 njësi përgjegjëse, ku 21 i përkasin sektorit publik, nuk kanë paraqitur raporte vjetore në zbatim të parashikimeve të neneve të këtij ligji. Numri i njësive përgjegjëse që nuk raportojnë është ende shumë i lartë, ku për vitin 2022 rezulton të jetë 42,5% e totalit të këtyre njësive.

Po ashtu, është për t'u vlerësuar veprimtaria e punës së ILDKPKI-së, me fokus: regjistrimin dhe trajtimin në zbatim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtjen nga hakmarrja; nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, ku krahas vijimit të marrëdhënieve të ngushta dhe të frytshme me delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri, Këshillin e Europës në Shqipëri, zyrën e OSBE-së në Tiranë, agjencitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si USAID-i, u intensifikua komunikimi me zyrat homologe apo agjencitë antikorrupsion në rajon e më gjerë, ku vlen për t'u theksuar edhe nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit në shtator të këtij viti, e nënshkruar me Agjencinë Kombëtare të Integritetit të Rumanisë; angazhimin e mëtejshëm për përmirësimin e kanaleve të raportimit të sinjalizimeve dhe mekanizmat e mbrojtjes për sinjalizuesit, nëpërmjet përmbushjes së angazhimeve të marra në marrëveshjen e bashkëpunimit me Iniciativën Rajonale Antikorrupsion (RAI), të financuar nga BE-ja, si dhe ndjekjes së një politike të hapur me

qytetarët e shoqërisë civile dhe forcimin e bashkëpunimit me medien investigative, në veçanti duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore kërkesat e publikut për publikimin e deklaratave të interesave privatë.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetarja, zonja Felaj.)

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hasalla!

Fjalën e ka zoti Bylykbashi.

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Dakord. Flisni një herë për procedurë dhe më pas merreni sërish fjalën.

Oerd Bylykbashi – Të nderuar kolegë,

Pas insistimeve u vendos të zhvillohet nesër seanca për vendimin e parlamentit për heqjen e imunitetit të deputetit Ahmetaj. Seanca e nesërme duhet të zhvillohet me debate dhe diskutime, siç thuhet në pikën 4, të nenin 73 të Kushtetutës: "Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura". Pra, thelbi është që Kuvendi mund të diskutojë. Pa diskutim, kjo çështje nuk duhet të përfshijë vetëm votimin, por duhet edhe që opinioni publik të përballet me mënyrën se si formohen qëndrimet e këtij Kuvendi në raport me këtë çështje.

Nga ana tjetër, dua të theksoj se me nenin 118 të Rregullores, të cilin e keni vënë pas çështjes "Tahiri" në vitin 2019, pasi krijuat një lloj gjykate të posaçme në parlament për të shqyrtuar rastin "Tahiri", ju keni kthyer në normë të Kuvendit rregulla, që, në gjykimin tim, janë antikushtetuese.

Kur kemi bërë reformimin e imunitetit në vitin 2012, në një negociatë të bërë me OPDAT-in, me EURALIUS-in dhe OSBE-në me kërkesën tuaj, ne kërkuam të hiqej, por ju insistuat ndaj partnerëve ndërkombëtarë që të mos hiqej, sepse kishit frikë në atë kohë. Në fund u ra dakord që imuniteti të mos qëndronte siç kërkonit ta mbanit ju, por të kufizohej, dhe këtu ka një ndryshim thelbësor: nëse atëherë duhej të jepej autorizimi paraprak, sot është vetëm ndalimi për arrestimin, kontrollin e banesës apo kontrollin fizik.

Prokuroria nuk duhet të paraqitet në Kuvend. Me procedurën që ju keni vendosur, e detyroni prokurorinë të justifikojë masën që kërkon dhe, për rrjedhojë, ju t'i kërkoni provat. Ç'punë ka Kuvendi të diskutojë provat?! Prokuroria duhet t'i drejtohet patjetër gjykatës, dhe gjykata të marrë vendimin pas shqyrtimit të provave. Më pas, nëse Kuvendi ka perceptimin se kjo bëhet me qëllim politik për goditjen e Kuvendit, parlamenti mund të mbrojë veten, jo Arben Ahmetajn apo këdo tjetër. Opozita nuk e ka fare këtë shqetësim, është e gatshme menjëherë që të hiqet imuniteti, pra anëtari i parlamentit, i cili tashmë është në sytë e të gjithëve i damkosur për këtë çështje, të shkojë përpara drejtësisë. Ju keni vendosur një dispozitë, e cila e ka futur Kuvendin në një hulli antikushtetuese. Kjo është hera e dytë.

Do të kthehem te çështja.

Ermonela Felaj – Ju lutem, startoni kohën!10 minuta për zotin Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Ky parlament ka investuar vazhdimisht tek ILDKPKI-ja si një instrument për luftën kundër korrupsionit. Kemi forcuar bazën ligjore, kemi dhënë mbështetje financiare dhe materiale për çfarë ka qenë e nevojshme, por jo vetëm kaq. Ky parlament, me tamtame, sigurisht, me vullnetin për ta bërë, por shpeshherë me retorikë të inflacionuar për të fshehur të vërtetën, ka bërë edhe reformën në drejtësi. Ndoshta me të drejtë fokusohemi tek antikorrupsioni, por reforma në drejtësi nuk duhet të fokusohet vetëm këtu; reforma në drejtësi nuk është vetëm SPAK-u, duhet të jetë shumë më tepër se kaq. Ju e keni fokusuar aty të gjithë vëmendjen dhe, për fat të keq, ky duhet të jetë ende tehu i thikës.

Çfarë kemi ne sot? Me investimin tonë ne forcojmë ILDKPKI-në, forcojmë prokurorinë, forcojmë instrumentet, forcojmë legjislacionin, forcojmë ndëshkimet. Cila është gjendja? Inceneratorët. Nuk ka çështje më manuale për të kuptuar korrupsionin qeveritar të Edi Ramës, jo thjesht korrupsionin. Kjo çështje do të studiohet jo vetëm për emra të përveçëm, por edhe për mënyrën se si mund të bëhet një korrupsion qeveritar, që kapërcen çdo lloj instrumenti kontrolli, deklarimi pasurish apo konflikti interesash, sepse nuk është në nivelin e korrupsionit të zakonshëm, që një zyrtar me dikë tjetër bëjnë veprimin në mënyrë të fshehtë, por është veprim i koncentruar nga qeveria, nga Kryeministri, sepse është e pamundur që individë të veçantë, qofshin ministra, të inicionin dhe të garantonin vazhdueshmërinë e veprimit kriminal, numrin në sekuencë të vendimeve të qeverisë, dhe një ministër i veçantë apo një deputet të ishte përgjegjës për të gjithë këtë. Kjo nuk mund të

fragmentohet, por duhet parë e gjitha në një sistem. Ky manual shpjegon se qeverisja e Edi Ramës është qeverisje mafioze. E kam thënë edhe herë tjetër dhe do ta përsëris: veprimi që ju keni bërë me çështjen e inceneratorëve është çështje tipike e mafies në Jugun e Italisë, pra riciklim i parasë në sektorin e ndërtimit, mbetje urbane, faturim fiktiv, krijim i kompanive fiktive. Të njëjtën gjë që atje e bën mafia, këtu e bën qeveria, e bëjnë njerëzit e lidhur me qeverinë, dhe e bëjnë në mënyrë të tillë që, lënë gjurmë, sepse ka një arsye: e ndiejnë vetën të pandëshkueshëm. Ky nuk është perceptim, por ata kanë sigurinë që janë të pandëshkueshëm, sepse e dinë shumë mirë që *master*-i, i pari, ka kapur drejtësinë, ka kapur të gjitha institucionet e tjera. Me ketë siguri vazhdojnë.

Ka edhe një element tjetër.

Kjo histori ka filluar në vitin 2014, një vit pasi keni ardhur në pushtet. Pra, ky koncept kriminal filloi në vitin 2014. Fakti që përfshihen dhe do të përfshihen ministra të tjerë, ish-ministra të tjerë, nga ajo që shikojmë, tregon se nuk janë secili për hesapin e vet, por kjo ka qenë e koncentruar. Në vitin 2014 keni ardhur me ide shumë të qartë, precize, se çfarë do të bënit, se cila ishte mënyra juaj e qeverisjes dhe për çfarë arsyeje ju duhej reforma në drejtësi: të shpartallonit drejtësinë, që të jeni të sigurt; ta shpartallonit, që të kapnin ata që do t'ju hetojnë juve imunitetin gjyqësor për 30 vjetët e ardhshëm. Arsyeja pse ju shpartalloni zgjedhjet është sepse doni të përdorni pushtetin, që askush të mos guxojë të ngrejë kokën, në mënyrë që, atë që ju po investoni... Kjo nuk është histori "Edi Ramës i pëlqen pushteti, i pëlqen të qeverisë, pse jo, të vazhdojë edhe një mandat, edhe një mandat tjetër", jo, këto janë projekte shumëvjeçare, të cilat duhet të mbrohen, pasi, në të kundërt, shkojnë në burg me radhë, njëri pas tjetrit, ministra dhe deputetë. Kjo çështje është një gropë e madhe, që vazhdon të hapet, vazhdon të thellohet dhe do t'i marrë me radhë, një nga një. Ju do ta shikoni këtë. Këta persona nuk e besonin. Me sa duket, ishin shumë të sigurt kur firmosnin, kur shkëmbenin *e-mail*-e me personat e përfshirë në këtë vepër penale kaq të rëndë. SPAK-u nuk shpëton nga kjo çështje. Mos thoni se SPAK-u po bën mrekulli me këtë çështje, se SPAK-u e ka për detyrë, nuk shpëton dot.

Maksimumi që mund të bëni ju në këtë histori, me gjithë përpjekjen tuaj për të kontrolluar drejtësinë, është të menaxhoni dëmin, ta zvogëloni dëmin. Si? Ta copëtoni në pjesë të vogla, që të duket si përgjegjësi individuale. Këtë thotë Edi Rama: "Ç'problem kam unë? E ka bërë iks ministër. Ai të shkojë në burg", më pas ky tjetri, edhe ky tjetri. Mund ta konceptoni edhe që po ju shet një nga një. Në fakt, përpjekja është që të zvogëlojë dëmin, sepse, nëse do të mblidhen të gjitha bashkë, siç e thashë, është manual i një qeverisjeje mafioze të Edi Ramës.

E gjithë përpjekja këto ditë është për të thënë: shikoni, ky është oriz i zier, ky është majdanoz dhe këto janë qepë, por në fund fare, po ta mbledhësh, ky është japraku i korrupsionit, që ka një emër: Edi Rama. Mblidhini bashkë, nuk ka nevojë t'u vësh emra të veçantë, ka një emër, ka një shëmti, është mënyra kriminale, mafioze, me të cilën qeveris Edi Rama dhe më pas shpartallon zgjedhjet vetëm për një arsye, që t'i përdorë si alibinë më të shëmtuar: "Mua ma dhanë votën të qeveris në këtë mënyrë mafioze dhe kriminale. Për sa kohë që mua më japin votën shqiptarët, ky nuk është krim". Ndërkohë, të gjithë këtu skandalizohen. Edhe ju skandalizoheni, por nuk e ngrini kokën, nuk keni guxim të kundërshtoni.

Parlamenti sot nuk është garanci për popullin, sepse nuk e kontrollon dot qeverinë e vet, as ministrat nuk e ngrenë dot kokën, sepse "fluturojnë" nesër. Më pas fusni rregulla, si e si ta bëni të vështirë që drejtësia të ketë mundësi të hetojë e papenguar.

Siç e thashë, prokuroria duhet të shkonte drejtpërdrejt në gjykatë dhe të merrte vendimin, sepse i ka provat. Ky parlament, me një vendim gjykate, nuk mund të diskutonte arrestin, kontrollin e banesës apo atë fizik të Arben Ahmetajt, ne thjesht do të votonim, do të mbështesnim drejtësinë. Sigurisht, ne do ta bëjmë, edhe ju jeni të detyruar ta bëni, nuk shpëtoni dot.

Unë jam i sigurt se Edi Rama nesër nuk do të vijë në parlament, jo për faktin se e bën gjithmonë, sepse beson se ky parlament nuk ka vlerë, por ai nuk mund të jetë këtu nesër. Nga ana tjetër, fakti që nuk vjen është provë, që tregon se ai e kupton shumë mirë se çfarë do të thotë kjo çështje për të.

E kujtoni "tubin e Rozetës", apo jo? "Tubi i Rozetës" ishte si Guri i Rozetës, i cili deshifroi dikur hieroglifët egjiptianë. "Tubi i Rozetës", si

Guri i Rozetës, deshifroi modelin kriminal, mafioz, me të cilin ju qeverisni. SPAK-u, duke ndjekur paranë te ky tub, nga Rozeta duhet të shkojë të shefja e kabinetit, e zëvendësit dhe Kryeministrit. Deri tani ka shkuar deri te zëvendësi. Edhe pak ta shtyjë shkopin SPAK-u, është e sigurt se aty do të ngecë Edi Rama. Tani do të presim të shikojmë sa guxim do të ketë SPAK-u për t'i mbledhur të gjitha bashkë, në një dorë të vetme, dhe të mos i ndajë në copa të vogla, që Edi Rama të thotë: "Ç'problem ka?! E ka iksi apo ipsiloni përgjegjësinë. Unë mund të bëj liderin global".

Kjo histori ka një përfundim: Edi Rama është autori, konceptuesi, iniciuesi dhe ekzekutori i të gjithë kësaj skeme kriminale, mafioze të qeverisjes shqiptare.

E njëjta histori është edhe me portin e Durrësit dhe do të vazhdojë të ketë të tilla. Nëse ne nuk do të bëjmë një përpjekje minimale për të kuptuar dhe për t'u treguar shqiptarëve që ky parlament nuk duhet ta lejojë të ndodhë kjo gjë, Edi Rama sigurisht që do të vazhdojë. Ju nuk keni guxim ta bëni dhe ai do të vazhdojë me këtë gjë, por detyra jonë është t'i tregojmë vendin Edi Ramës, me aq mundësi sa ne kemi.

Nga ana tjetër, siç e thashë, SPAK-u nuk shpëton nga kjo histori, dhe bashkë me SPAK-un edhe Gjykata e Posaçme. Në këtë gropë do të bien njëri pas tjetrit, me radhë, ministra, dhe në fund Kryeministri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Meqenëse deputetët e regjistruar për të folur në vijim për këtë pikë të rendit të ditës, nuk janë në sallë, konsiderohen se janë tërhequr.

Këtu mbyllen diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Faleminderit, zonja Bashari!

Mund të largoheni.

Ftoj zotin Petrit Ahmeti për të mbajtur raportin për vitin 2022 për institucionin që ai drejton, Entin Rregullator të Energjisë.

Ky raport mbahet në bazë të nenit 103, pika 2, të Rregullores.

Koha në dispozicion për ju është 20 minuta, zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Entit Rregullator të Energjisë do t'ju paraqes raportin vjetor për situatën e sektorit të energjisë dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin 2022.

Sipas përcaktimeve në ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe në ligjin "Për sektorin e gazit natyror", në këtë raport prezantohet një panoramë e plotë e formimit dhe funksionimit të ERE-s, e strukturës dhe e treguesve të tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror, e veprimtarisë së ERE-s në drejtim të licencimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e energjisë, vendosjes së tarifave të rregulluara, monitorimit të tregut e të tjera. Në këtë raport kemi prezantuar gjerësisht punën e ERE-s në drejtim të realizimit të detyrave sipas rezolutës së Kuvendit, objektivave të strategjisë së saj dhe sfidave në zhvillimin e sektorit.

ERE-ja u krijua në vitin 1995 dhe aktualisht vepron si një autoritet i pavarur. ERE-ja është përgjegjëse për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

ERE-ja merr vendime për çështjet, si vijojnë: miraton aktet rregullatore në fushën e prodhimit, të transmetimit, të shpërndarjes, të tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, përfshirë kontratat TIP ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara; trajton mosmarrëveshjet në lidhje me ankesat e klientëve dhe të të licencuarve; trajton kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave. Aktivitetet që lidhen me detyrimet e shërbimit publik realizohen me tarifa dhe çmime të përcaktuara nga ERE-ja.

Siç dihet, në vitin 2022 kaluam një krizë energjetike, që u shoqërua me masa të rrepta kufizuese, ndër të cilat mund të përmendim: pezullimin e investimeve për shoqëritë publike dhe alokimin e fondeve për përballimin e importit të energjisë elektrike; vendosjen nën detyrimin e shërbimit publik të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike; vendosjen e detyrimit për kompanitë publike të gjenerimit *cash* për mbulimin e humbjeve për operatorët e rrjetit, për të parandaluar efektin financiar të blerjes së kësaj energjie me çmime të larta në treg; optimizmin e burimeve hidrike nga prodhuesit e pavarur, nëpërmjet kontratave të depozitimit, si dhe vendosjen e kontributit për solidaritetin gjatë kohëzgjatjes së krizës energjetike për prodhuesit e energjisë elektrike që tregtojnë me çmim të

liberalizuar. Këto masa garantuan furnizimin e pandërprerë me energji elektrike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke mundësuar edhe mospasjen e kostove shtesë për konsumatorin tarifor. Shqipëria ishte ndër të paktat vende që mbajti të pandryshuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike në tregun e rregulluar, përfshirë këtu edhe konsumatorët e lidhur në tensionin e mesëm, 20, 10, 6 kilovolt.

Në analizën e këtij raporti vërehet se viti 2022 shënon një vit të mirë hidrologjik, me një prodhim më të lartë se një vit më parë, pra në vitin 2021. Prodhimi i realizuar këtë vit, prej 7002 gigavat/orë, rezultoi të jetë më i madh se prodhimi i vitit të kaluar.

Edhe këtë vit ka vijuar diversifikimi i burimeve në prodhimin e energjisë elektrike përmes instalimit të impianteve fotovoltaike, ku kapaciteti total i instaluar i tyre është 23 megavat dhe prodhimi total rezulton të jetë në masën 5092 megavat/orë.

Humbjet e përgjithshme në sistemin e shpërndarjes për vitin 2022 rezultuan me një nivel uljeje krahasuar me vitin 2021. Niveli total i arkëtimeve për vitin 2022 rezulton me një rritje të lehtë krahasuar me nivelin e arkëtimeve të realizuar në vitin 2021, prej 97,4%.

Në përputhje me funksionet e saj, ERE-ja ka ushtruar veprimtarinë në drejtim të licencimit të subjekteve në treg. Gjatë vitit 2022 janë licencuar 22 subjekte në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Për vitin 2022 janë realizuar 16 licencime nga ERE-ja në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe 5 licenca në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Një risi në vendimmarrjet e ERE-s për vitin 2022 ka qenë licencimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.

Në përputhje me ligjin për burimet e rinovueshme janë marrë vendime për kualifikimin dhe pajisjen me certifikatë garancie të origjinës për 3 impiante të prodhimit të energjisë elektrike.

Një nga veprimtaritë kryesore të ERE-s në fushën e rregullimit është edhe përcaktimi i tarifave dhe i çmimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

Gjatë vitit 2022 ERE-ja përcaktoi tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike prej 0,85 lekësh për kilovat/orë, për periudhën 1 maj 2022 –31 dhjetor 2024.

Në prill të vitit 2022, ERE-ja vendosi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj– 31 dhjetor 2022, si vijon: tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kilovolt, 1,55 lekë për kilovat/orë; tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 6, 20 kilovolt, 3,99 lekë për kilovat/orë; tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kilovolt, 6,42 lekë për kilovat/orë; miratimin e çmimit të aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive për periudhën 1 maj – 31 dhjetor 2022 prej 1,92 lekësh për kilovat/orë reaktiv.

Po ashtu, u vendos lënia në fuqi e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për klientët fundorë, të cilëve u shërben Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2022, dhe ka vijuar çdo muaj përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Në zbatim të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, shoqëria KESH sh.a. furnizoi të gjithë sasinë e kërkuar të energjisë elektrike për klientët e FSHU-së, përfshirë edhe klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20, 10, 6 kilovolt, të cilët u gjendën në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit pas datës 1 janar 2022. Kostoja e blerjes së sasisë së energjisë për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh, e përcaktuar në vendimin e sipërcituar, ishte 12 lekë për kilovat/orë.

Gjatë vitit 2022 iu dha zgjidhje problematikës për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit.

Gjithashtu, janë përcaktuar çmimet e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 megavat, prej 97,21 euro për megavat/orë për vitin 2022, dhe u miratua çmimi vjetor prej 8,5 lekësh për kilovat/orë që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022.

Në tregun e gazit natyror vërehet se nga data e operacioneve tregtare të TAP-it, 15 nëntor 2020, e deri sot, TAP-i ka transportuar afërsisht një total prej 19 BCM nga kufiri greko-turk në Kripoi, por pa shkurtime të kapacitetit, me 16 BCM të transportuara gjatë gjithë rrugës për në Itali, duke kaluar Shqipërinë, dhe afërsisht 2,3 BCM që dalin

në Greqi dhe 0,5 BCM shkojnë në Bullgari përmes gazsjellësit.

ERE-ja ka vijuar edhe gjatë vitit 2022 plotësimin e kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

Në këto kushte, janë miratuar: metodologjia e llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror; rregullorja për masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit, për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE-ja të performancës së shërbimit të klientit; miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në kodin e rrjetit TAP, me propozim të shoqërisë TAP-AG; rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; kontratat për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën 02.07.2022–31.12.2022; rregullat e harmonizimit të alokimit të kapaciteteve, të interkonjeksionit, për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve në Europën Juglindore, për kufijtë Shqipëri-Greqi, Shqipëri-Mal i Zi dhe Shqipëri-Kosovë; rregullat e tregut të energjisë elektrike ALPEX dhe shumë elemente të tjera që i shërbenin praktikisht këtij tregu.

Një pjesë e rëndësishme e punës së ERE-s fokusohet në zgjidhjen e ankesave të klientëve të energjisë elektrike. Për vitin 2022 ka një rënie të numrit të ankesave, të cilat në total kanë qenë rreth 189 të tilla. Sikurse edhe më parë, ka vijuar monitorimi i të dhënave të tregut dhe i treguesve të cilësisë së operatorëve në rrjet.

Në vijim të rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021, ERE-ja miratoi planin e masave për zbatimin dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimit të rezolutës së Kuvendit. Rezulton se ERE-ja ka trajtuar çështjet e bashkëpunimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorët e tjerë, për të bërë të mundur lehtësimin e barrierave, promovimin dhe investigimin e impianteve të vetëprodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme. Aktualisht ka hyrë në fuqi ligji i ri për burimet e rinovueshme.

Për sa i përket rekomandimit për të bërë të mundur forcimin e mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë, si dhe ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve, ERE-ja realizoi studimin e praktikave më të mira rregullatore për adresimin e mbështetjes për kategorinë e klientëve në nevojë dhe nxjerrjen e skenarëve më të aplikueshëm, publikuar aktualisht edhe në faqen e internetit të ERE-s.

Për sa i përket rekomandimit ku ERE-s i kërkohej impenjim maksimal nga të gjithë aktorët për të bërë të mundur që brenda vitit 2022 operimi i bursës të jetë funksional, rezulton se, nëpërmjet vendimit nr. 347, në datën 27.12.2022 u miratuan rregullat e tregut të energjisë elektrike, rregullat e ALPEX-it, përkufizimet dhe procedurat për tregtimin e energjisë elektrike mbi bazën e bursës.

Në zbatim të detyrës për bashkëpunimin me agjencitë e eficiencës dhe për sensibilizimin e konsumatorit për përdorimin eficient të energjisë elektrike, ERE-ja ka ndërmarrë një sërë fushatash sensibilizuese për rritjen e eficiencës së përdorimit dhe uljen e konsumit të energjisë elektrike, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ERE-s, në zërin "Shërbime konsumatori", por edhe në rrjetet sociale.

Gjatë vitit 2023, në përputhje me dinamikat e zhvillimit të tregut të energjisë elektrike, ERE-ja është fokusuar në plotësimin e kuadrit rregullator në përputhje me ligjin e ri për burimet e rinovueshme. Me shumë rëndësi është bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë në proceset e nevojshme për ndryshimet në ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike".

Për sa i përket ndërgjegjësimit të konsumatorëve për vlerësimin e ofertave, për të kuptuar drejt mekanizmat e tregut, ERE-ja do të vijojë punën në implementimin e platformës së krahasimit të çmimeve, do t'u ofrojë furnizuesve mundësinë e paraqitjes së çmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët që zgjedhin të furnizohen nga tregu i lirë.

Gjithashtu, ERE-ja do të fokusohet në zhvillimin e një reforme tarifore, nisur nga riorganizimi, hapja e tregut dhe monitorimi i vazhdueshëm i tij.

Ndër aktivitetet që vlejnë të përmenden në arenën ndërkombëtare përgjatë vitit 2022 janë: përmbyllja me sukses e mandatit 2-vjeçar të presidencës së Shoqatës së Rregullatorëve të Vendeve të Mesdheut (MEDREG) për periudhën 2021-2022, duke marrë konsideratat maksimale nga vendet pjesëmarrëse; krijimi i Shkollës Ballkanike të Energjisë, me pjesëmarrjen e rregullatorëve të Italisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Mali të Zi

dhe Shqipërisë, e cila do të shërbejë si një platformë për shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet rregullatorëve dhe pjesëtarëve të tjerë të tregut lidhur me sfidat që dalin në kuadrin e përgatitjes së legjislacionit, për mundësimin e bashkimit të tregjeve mes vendeve të Bashkimit Europian dhe vendeve të rajonit tonë. Pjesë e këtij bashkëpunimi është edhe puna që pritet të finalizohet me një memorandum mirëkuptimi mes rregullatorëve, operatorëve të sistemit të transmetimit dhe bursave të energjisë elektrike të Shqipërisë, të Greqisë, të Maqedonisë së Veriut dhe të Kosovës, për bashkimin e tregjeve në katër vendet, një iniciativë kjo që do të mbështetet edhe nga USAID-i.

Me gjithë arritjet apo përmirësimet e përshkruara më lart në këtë raport, në vijim, puna jonë do të fokusohet edhe në çështje që lidhen me:

- zbatimin e rregullores së transparencës dhe integritetit të tregut me shumicë të energjisë elektrike dhe përpilimin e akteve për implementimin e plotë të saj, sipas legjislacionit të vendeve të Bashkimit Europian;
- monitorimin e vazhdueshëm të implementimit të ndarjes funksionale dhe organizative të OSSH-së dhe FSHU-së;
- zbatimin e planit strategjik për reformat në sektorin elektroenergjetik;
- përpilimin e akteve rregullatore që rrjedhin si rezultat i zbatimit të ligjit të ri të burimeve të rinovueshme, që kanë të bëjnë me impaktin e burimeve të rinovueshme në treg;
- zbatimin dhe rishikimin e strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë edhe sektorin e gazit natyror;
- bashkëpunimin dhe përpilimin e paketës së elektricitetit, siç është miratuar në Këshillin e Ministrave të vendeve të traktatit të energjisë, për të cilën Shqipëria është kryesuese e radhës;
- transpozimin e rregullores për alokimin e kapaciteteve të interkonjuksionit dhe menaxhimin e koncesioneve në përputhje me legjislacionin europian;
- zbatimin e mekanizmit të tregut të balancimit dhe garantimin e shërbimeve ndihmëse;
- operimin e platformës së krahasimit të çmimeve të furnizuesve në tregun e parregulluar;
- krijimin e tregut rajonal të garancive të origjinës dhe pjesëmarrjen në regjistrin rajonal të garancive të origjinës, si dhe zbatimin e strategjisë 3-vjeçare të rregullatorit për vitet 2022- 2023.

Në punën tonë një vend të rëndësishëm dhe prioritar ka pasur edhe transparenca e sektorit. Në kuadër të transparencës, ky raport vjetor, si gjithmonë, është vënë në dispozicion të të gjitha institucioneve dhe konsumatorëve për konsultim apo edhe për vërejtjet e tyre.

Këto ishin në mënyrë të përmbledhur disa nga zhvillimet dhe objektivat e punës dhe të aktivitetit të Entit Rregullator për periudhën në vazhdim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ahmeti!

A ka pyetje nga kolegët, përpara se të fillojmë me diskutimet? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Ahmeti!

Mund të na ndiqni nga lozha.

Fjalën e ka zoti Nasufi. Koha në dispozicion është 7 minuta.

Fadil Nasufi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2022, që paraqiti zoti Ahmeti, konfirmon se ky institucion është i konsoliduar dhe ka përmbushur me sukses angazhimet, përgjegjësitë dhe funksionet e tij, si një autoritet i pavarur.

Enti Rregullator i Energjisë, pas 28 vjetësh, ka një histori suksesi, sepse ka stabilizuar sektorin e energjisë elektrike, ka miratuar aktet rregullatore në fushën e prodhimit, të transmetimit, të shpërndarjes, tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike dhe ka realizuar rekomandimet e rezolutës së Kuvendit.

Njëkohësisht, Enti Rregullator i Energjisë rreshtohet si partner dinjitoz, konkurrues dhe bashkëpunues me entet rregullatore të vendeve të rajonit, të Mesdheut dhe me Agjencinë Europiane të Energjisë, që është jo vetëm një protokoll aderimi, por edhe një prezencë e bashkëpunim që imponohet edhe nga aftësia profesionale, menaxhuese dhe me kredite përfaqësuese të besueshme, nga ana e drejtuesve të bordit të Entit Rregullator të Energjisë në audiencën ndërkombëtare.

Në raportin që u paraqit, ne ju informuam në mënyrë analitike për të gjithë bilancin e punës për vitin 2022 dhe programin e punës për vitin 2023.

Dua të theksoj se kryefjala e vitit 2022 ishte menaxhimi i krizës energjetike, që u shkaktua nga lufta e Rusisë ndaj Ukrainës, e cila destabilizoi tregun e energjisë dhe atë të karburanteve në Europë dhe në të gjithë botën. Jo vetëm që u garantua furnizimi me energji elektrike, në mënyrë të pandërprerë, por e gjithë kostoja e çmimit të energjisë, gati e pesëfishuar në tregjet ndërkombëtare, u përballua nga buxheti i shtetit, duke mbrojtur konsumatorët familjarë dhe biznesin e vogël, duke ruajtur çmimin 9,5 lekë për kilovat. Me këtë mburojë dhe paketë financiare u morën në mbrojtje rreth 96% e konsumatorëve të vendit, të cilët nuk konsumojnë më shumë se 800 kilovat/orë në muaj. Ndërkohë, 4% e konsumatorëve të mëdhenj shpenzojnë rreth 20% të totalit të energjisë.

Ne duhet ta përmendim këtë përkujdesje të qeverisë ndaj qytetarëve, për ruajtjen e paprekur të faturës së çmimit të energjisë, jo thjesht si bamirësi, por si një politikë e qartë e të qenit në krah të qytetarit, kur ekonomia dhe nevojat jetike të familjeve tona goditen nga krizat, nga fatkeqësitë natyrore apo nga risqet e reformave të zhvillimit. Këtë ka bërë dhe vazhdon ta bëjë kjo qeveri dhe kjo mazhorancë, e cila ka një bilanc dhe një histori sfiduese dhe fituese ndaj tërmetit, pandemisë, krizës së luftës dhe vështirësimit të realizimit të reformave që ka ndërmarrë.

Nga ana tjetër, ka një qasje dhe reflektim edhe të qytetarëve, për përdorimin efikas të energjisë nëpërmjet kursimit. Kursimi i energjisë është mënyra më e lirë, më e sigurt dhe më e pastër për të reduktuar varësinë e energjisë nga importet.

Viti 2022 dhe masat strukturore të eficiencës së energjisë konfirmuan se me reduktimin e konsumimit të energjisë kemi arritur të kryejmë plotësisht detyrat dhe nevojat tona dhe kemi prodhuar të njëjtin rezultat. Prandaj, nëpërmjet këtij diskutimi që po bëj, duke folur për raportin e Entit Rregullator të Energjisë, sërish u bëj thirrje të gjithëve të kontribuojmë si qytetarë në përdorimin efikas të energjisë elektrike, të kursejmë dhe të krijojmë kulturën e eficiencës dhe të shpenzimeve të panevojshme. Ne kemi tregues konsumi të energjisë, që dëshmojnë për një komoditet luksi, ku 34% e energjisë përdoret për ngrohje dhe klimatizim, 26% e saj për ujin sanitar dhe dushet, si dhe 40% për pajisjet elektroshtëpiake.

Është inkurajues diversifikimi i burimeve në prodhimin e energjisë elektrike përmes instalimit të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike, ku kapaciteti total i instaluar deri në vitin 2023 është 23 megavat.

Janë licencuar 22 subjekte për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet alternative dhe ka një numër të lartë aplikimesh.

Kriza energjetike e vitit 2022, që vazhdon të na bashkëshoqërojë, vuri në lëvizje edhe investime të reja në programet e eficiencës së energjisë. Në këtë kuadër, po sjell si shembull kryerjen e investimit, me financim nga Bashkia e Beratit dhe qeveria zvicerane, për shtrimin e linjave nëntokësore, vendosjen e shtyllave të reja dhe instalimin e ndriçuesve *led* në të gjitha akset kryesore të rrugëve të qytetit të Beratit për ndriçimin publik.

Raporti i Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2022, sjell si risi licencimin për herë të parë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), e cila ka filluar operimin në tregun e energjisë elektrike. Edhe në tregun e gazit natyror, gjatë vitit 2022, Entit Rregullator i Energjisë i ka plotësuar të gjitha detyrimet nga rezoluta e parlamentit dhe ka miratuar të gjitha aktet nënligjore që do të luajnë rol në zhvillimet e pritshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes.

Pritet të realizohen projekte të rëndësishme për terminalin e gazit metan të lëngëzuar dhe për ruajtjen nëntokësore të gazit natyror në zonën e Dumresë. Enti Rregullator i Energjisë ka përmbyllur dokumentacionin dhe procedurat për investime në ndërtimin e tubacionit 30 kilometra, nga terminali në Vlorë, deri në pikën e takimit me TAP-in në Fier. Tubacioni Jonian – Adriatik, që do të lidhet me TAP-in në nyjën lidhëse në Fier, do të përshkojë 170 kilometra në territorin shqiptar, për të vazhduar më tej në drejtim të Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, deri në Kroaci.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me kompaninë Albgaz, do të investojë në seksionin me gjatësi 86 kilometra, nga Kashari deri në pikën kufitare me Malin e Zi, me një vlerë financimi investimi deri në 165 milionë euro.

Duke sjellë këto pika kulmore të asaj që pritet në përmirësimin e situatës energjetike dhe të gazit në Shqipëri, unë e miratoj plotësisht raportin e Entit Rregullator të Energjisë dhe e

inkurajoj bordin në përmbushjen e sfidave të vitit 2023 dhe të vizionit "Shqipëria 2030".

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Nasufi!

Fjala është për ju, zoti Vasili. Koha në dispozicion është 5 minuta.

Petrit Vasili – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa asnjë diskutim, çështja e sotme dhe raportimi i këtij institucioni vjen në një moment shumë delikat, për një arsye shumë të thjeshtë: qytetarët shqiptarë prej më shumë se një vit e gjysmë ndodhen nën shantazhin e vazhdueshëm të qeverisë për energjinë. Një herë kanë dëgjuar se do të vihet fasha dhe pak muaj më parë dëgjuan t'u thuhet: "Prisni në gusht, se do të ndodhë rritja tjetër". Pra, energjia është kthyer sa në një element presioni politik me synime të qarta për të realizuar qëllimet e ditës, aq edhe në një moment shumë të madh dhe të veçantë korrupsioni, ku paratë që shpërdorohen janë të frikshme.

Është e vërtetë që prodhimi i energjisë në vitin 2022 ka qenë 14% më i lartë se mesatarja e periudhës 2009-2022. Të gjithë pyesim: përse u vendos fasha? Çfarë lidhjeje kishte fasha, për më tepër kur bëhej fjalë për një vit mjaft të mirë hidrologjik? Çfarë ndodhi me historinë e fashës? Ju e mbani mend, sepse kemi debatuar në këtë parlament, fasha u vendos dhe qeveria e mori, e mban në xhep dhe vendos ta përdorë sa herë të ketë nevojë. Besoj se këtu jemi në kushtet flagrante të një paligjshmërie të turpshme. Prandaj, sa herë do të kishte nevojë, pavarësisht se ishte një masë arbitrare, qeveria do të duhej t'i drejtohej institucionit përkatës, i cili raporton këtu, që të kishte të drejtë ta bënte këtë gjë.

Po sot, në këtë vit, i cili konsiderohet një vit akoma më i mirë energjetik, si shpjegohet që nuk vihet me propozim (ERE-ja mund ta kishte thënë këtë publikisht) për ulje çmimi? Rishikimi i çmimit në një vit, nuk do të thotë detyrimisht që çmimi të rritet, por sipas situatave çmimi edhe mund të ulet. Apo shqiptarët nuk kanë kurrë të drejtë të kenë mundësinë dhe fatin që çmimi i energjisë t'u ulet edhe kur Shqipëria, si këtë vit, kthehet në një eksportuese neto e energjisë elektrike? Pra, qytetarët duhet ta kuptojnë se kanë një qeveri shpërdoruese, e cila me energjinë bën thjesht dhe vetëm pazar dhe korrupsion.

Njëherazi, duke lexuar raportin e ERE-s, ai të vë në vështirësi të mëdha për ta mirëkuptuar, kur thuhet se ERE-ja ka miratuar programe ekonomike dhe programe zhvillimi për energjinë, ndërkohë që TEC-i i Vlorës mbahet në konservim dhe kemi 2 gërmadha, 2 "xhenaze" të mëdha në mes të detit, komentet për të cilat janë një turp, që zhvatin para. Jam i bindur se specialistët e ERE-s, që janë profesionistë shumë të mirë, në këtë pikë, kanë bërë gjënë e vetmen që nuk duhet ta bënin: i janë nënshtruar presionit të qeverisë dhe nuk e thonë fjalën e tyre. Të gjithë shqiptarët e kuptojnë që ai është një turp i padëgjuar, është një lubi që vetëm merr para, shkatërron natyrën dhe nuk sjell asnjë të mirë. Ndërkohë, ne paguajmë para për to, kur kemi energji me bollëk dhe jemi edhe eksportues neto. Pra, është shumë e vështirë t'ua shpjegoni shqiptarëve që kanë të drejtë.

E gjithë situata në sektorin e energjisë ka rrjedhur nga një keqmenaxhim i tmerrshëm. Ne kemi pasur mundësi t'i diskutojmë borxhet në këtë sallë. Vetëm ujësjellësit kanë rreth 150 milionë euro borxh, ndërsa qytetarëve mendohet t'u rritet tarifa. A ka zullum më të madh, kur shqiptarët e varfër paguajnë, ndërsa kusarët e qeverisë kanë akumuluar borxhe kaq të frikshme? Nuk e di sa çfarë avokatie mund t'i bëhet nga mazhoranca kësaj gjëje! Duhet të kesh paturpësi të madhe t'i bësh avokati.

Njëherazi problematike është edhe situata në sektorin e gazit, ku, sado që flitet për të, me keqardhje mund të them se gjithçka është spontane, pra asgjë nuk është e planifikuar. Për të thënë të drejtën, mbeta i shokuar kur pashë në raportin e ERE-s që referohen konsulta me kompani, kur disave prej tyre u është hequr licenca. Si mund të komunikojë institucioni me kompani të cilave u është hequr licenca për perspektivën e gazit në Shqipëri?

I gjithë projekti tjetër dhe çdo gjë që lidhej me ndryshimet e koniunkturës në rajon, me ndryshimet në Greqi, në Kroaci, me prodhuesit e mëdhenj, sigurisht, kërkon që në këtë situatë të rishikohet me themel dhe me synime afatgjata strategjia e gazit.

Në këtë mënyrë, kemi një raport të shkruar mirë në *excel*, por përputhja e tij me realitetin ka diferenca të mëdha. Dua të besoj se kjo vjen vetëm nga një presion konstant, i palodhur dhe i paepur i qeverisë mbi institucionin, sepse nuk dua

të besoj kurrë që profesionistët e këtij institucioni i besojnë të gjitha ato që kanë shkruar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Sipas listës së diskutantëve janë dhe 3 diskutantë për të folur për këtë pikë të rendit të ditës, por, në fakt, asnjëri prej tyre nuk është në sallë, ndaj konsiderohen se kanë hequr dorë nga diskutimet.

Me diskutimin e zotit Vasili mbyllen diskutimet për raportin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2022.

Faleminderit, zoti Ahmeti!

Mund të largoheni.

Vijojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: projektligji "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera". Nga shërbimet nuk më është vënë në dispozicion ndonjë pyetje në lidhje me këtë projektligj.

A ka pyetje nga kolegët që janë në sallë? Nuk ka.

Besoj se do të kemi të gjithë kohën në dispozicion për të diskutuar për këtë projekt.

Atëherë, zonja Gjylameti.

Nuk është në sallë.

Zonja Zhupa.

Nuk është në sallë.

Zonja Tabaku.

Nuk është në sallë.

Zoti Berisha.

Nuk është në sallë.

Zoti Tritan Shehu.

Nuk është në sallë.

Zonja Monika Kryemadhi.

Nuk është në sallë.

Zoti Noka.

Nuk është në sallë.

Zoti Balla.

Nuk është në sallë.

Këta ishin diskutantët e regjistruar për këtë pikë të rendit të ditës. Meqenëse askush prej tyre nuk është i pranishëm, projektligji konsiderohet i diskutuar.

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, lidhur me një hua koncesionale për programin "Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore pas tërmetit të vitit 2019"".

Fjala është për ministren Edona Bilali.

Edona Bilali – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Projektligji që po shqyrtojmë i mundëson Shqipërisë marrjen e një huaje koncesionale për programin "Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore pas tërmetit të vitit 2019", me një vlerë që nuk i kalon 35 milionë euro për mbulimin e kostove të ndërhyrjes. Kjo ndërhyrje parashikohet të realizohet në 3 qarqe, përkatësisht në qarkun e Shkodrës, ku do të mbulohen Bashkia e Malësisë së Madhe dhe Bashkia e Shkodrës, në qarkun e Lezhës, ku do të mbulohet zona e Shëngjinit, që është e lidhur edhe me Velipojën, si dhe në qarkun e Durrësit, konkretisht në bashkinë Fushë-Krujë. Ndërhyrja synon të përmirësojë lidhjen dhe cilësinë e rrjetit të energjisë elektrike, për të plotësuar nevojat e familjeve dhe të sektorit privat.

Një nga rajonet më problematike për sa i përket lidhjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike është rajoni i Shkodrës. Përafërsisht, 56% e popullsisë së qarkut jeton në zona rurale. Me gjendjen aktuale të infrastrukturës elektrike të nënstacioneve, të rrjetit të shpërndarjes së tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët, të kabinave të këtij rajoni nuk përmbushen kushtet teknike për sa i përket rritjes dhe zhvillimit urban të zonës, gjë që sjell kufizime dhe cilësi të ulët të furnizimit me energji elektrike për përdoruesit.

Ka filluar rehabilitimi i tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët. Kryesisht në Shkodër është rehabilituar tensioni 20 kilovolt, i cili përkthehet në mosndërprerje të energjisë elektrike.

Kompania OSHEE ka miratuar ndërtimin e nënstacionit të tretë, i cili do të ndërtohet pranë njësisë administrative Velipojë, për t'i dhënë një hov zhvillimi turizmit, por edhe zonave e njësive administrative përreth.

OSHEE-ja planifikon të ndërhyjë në investime për ndërtimin e nënstacioneve të reja, si dhe në rikonstruksionin e disa nënstacioneve ekzistuese në qark. Rrjeti aktual i tensionit të ulët vazhdon të ketë problematika, të cilat lidhen me mbingarkesat në transformator, krahasuar me kapacitetet, veçanërisht në periudha të caktuara të vitit, kur ka fluks, siç është periudha e sezonit veror.

Disa prej transformatorëve janë në funksion prej më shumë se 50 vjetësh dhe nënstacionet e shpërndarjes janë në gjendje tejet të amortizuar. Për të përmirësuar në tërësi furnizimin me energji elektrike dhe për të hapur mundësi investimi në sektorin privat, si në industrinë e turizmit, agroturizmit, në blegtori apo në sektorë të tjerë të industrisë, është propozuar ndërtimi nga e para e nënstacionit 35/20/10 kilovolt në Tamarë, e cila është pjesë e njësisë administrative Kelmend, në Bashkinë e Malësisë së Madhe. Sigurisht, Tamara është një nga perlat e turizmit, e njohur jo vetëm për bukurinë dhe freskinë e lumit Cem, për troftën dhe për blegtorinë, por edhe për ndërhyrjen që qeveria ka bërë në sheshin e saj, duke e kthyer atë në një pikë dhe në një atraksion turistik. Gjithashtu, për t'u përmendur është edhe spitali, i cili i ka të gjitha kushtet dhe i mirëpret turistët që marrin shërbimet bazike gjatë fluksit turistik në sezonin e verës. Aktualisht Tamara furnizohet me energji nga nënstacioni i Vukpalajt, i cili ka një gjatësi 120 kilometra dhe ka afërsisht 120 kabina transformimi. Projekti për azhurnimin e linjave ka përfunduar, si dhe është marrë miratimi teknik për këtë investim. Sapo të lëvrohet fondi, do të vijohet me implementimin e projektit.

Është propozuar rindërtimi dhe fuqizimi i nënstacionit 35/20/10 kilovolt në Koplik. Ndërhyrjet në zonën e Koplikut konsistojnë në nënstacione që lidhen me rrjetin e tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët. Nënstacioni i Koplikut është ndërtuar në vitin 1964, ka ende çelësa të vjetër të modelit rus dhe kinez, madje janë modele aq të vjetra dhe të amortizuara, sa është e vështirë, thuajse e pamundur, të gjenden pjesë zëvendësuese apo të bëhet ndërrimi i tyre në raste defektesh. Nisur nga gjendja teknike shumë e amortizuar e pajisjeve të nënstacionit të Koplikut, ndërhyja është tashmë domosdoshmëri. Pavarësisht se janë bërë punime të vazhdueshme në rrjet, kryesisht për mirëmbajtjen, është e nevojshme të ndërhyhet me investime madhore, për t'u dhënë një frymëmarrje klientëve familjarë, por edhe operatorëve ekzistues apo potencialë të biznesit, pasi në periudhën e fundit në këtë zonë raportohen problematika.

Ndërhyrja e radhës lidhet me rindërtimin dhe fuqizimin e nënstacionit 35/ 20/10 kilovolt në Bajzë. Nënstacioni i Bajzës është ndërtuar në vitin 1967. Ky nënstacion paraqet, pak a shumë, të njëjtën problematikë me nënstacionin e Koplikut. Për çdo problem në nënstacion, lidhja 35 kilovolt ndërpritet totalisht, duke lënë pa energji elektrike nënstacionet që lidhen me të, si dhe nënstacionin e Hanit të Hotit, i cili njëkohësisht furnizon edhe doganën e Hanit të Hotit. Përveç amortizimit, rrjeti elektrik kalon edhe në zona malore, ku gjatë stinës së dimrit është jashtëzakonisht i vështirë riparimi i defekteve brenda kohës së planifikuar.

Besoj se të gjithë deputetët, të majtë dhe të djathtë, janë njohur me këto problematika, pasi kontaktohen shpesh nga banorët e këtyre zonave për t'i raportuar ato. Megjithëse ndërhyrjet për mirëmbajtjen janë bërë, tashmë është e nevojshme një ndërhyrje thelbësore për sa i përket miradministrimit dhe optimizmit të rrjetit në këtë nënstacion.

Rindërtimi i nënstacionit të Rrencit (linja 110/6 kilovolt) është propozimi i radhës për këtë marrëveshje. Ndërhyrjet konsistojnë në nënstacionet që lidhen me rrjetin e tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët. Nënstacioni i Rrencit në Shkodër është ndërtuar në vitin 1976 dhe furnizon me energji elektrike Rrencin dhe Gurin e Zi. Është e rëndësishme të theksohet se në këtë nënstacion edhe kabinat janë dëmtuar për shkak të tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019. Pas dëmeve të shkaktuara nga tërmeti janë kryer vetëm punime të emergjencës apo të pjesshme, për të garantuar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike, por ato përbëjnë rrezik edhe për vetë punonjësit, pra këto kabina nuk garantojnë furnizim të pandërprerë për të gjithë zonën.

Po ashtu, është propozuar rindërtimi i nënstacionit 110/20/6 kilovolt "Shkodra 1". Nënstacioni i Shkodrës është i vitit 1966. Ndër vite rritja e ngarkesës ka ndryshuar dhe është përforcuar, por për shkak të amortizimit është domosdoshmëri ndërhyrja.

Rindërtimi i nënstacionit 110/35/20/6 kilovolt "Shkodra 2", është propozimi i radhës që OSHEE-ja i ka bërë kundërpalës italiane për këtë marrëveshje. Rindërtimi do të sjellë përmirësimin e furnizimit me energji elektrike, reduktimin e humbjeve, përmirësimin e situatës mjedisore dhe sociale, duke bërë të mundur zhvillimin ekonomik të zonës. Ky nënstacion është ndërtuar në vitin 1976. Fillimisht u instaluan transformatorë që furnizonin qytetin e Shkodrës dhe zonën e Velipojës, ndërkohë që ndër vite nënstacioni ka ndryshuar dhe është përforcuar me transformatorë

të tjerë, por tashmë kjo nuk është e mjaftueshme, pasi nevojitet një ndërhyrje thelbësore.

Ndërhyrjet në rrjetin e tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët në nënstacionet "Shkodra 1" dhe "Shkodra 2" shtrihen jo vetëm në qytetin e Shkodrës dhe në rrethinat e saj, por edhe në zonat e thella rurale.

Së fundi, është propozuar instalimi i sistemit të telekontrollit, i kontrollit në distancë për qarkun e Shkodrës, për 20 kabina elektrike 20 dhe 0,4 kilovolt. Sistemi i kontrollit të kabinës në distancë është investim në efikasitet. Parashikimi i zbatimit të këtij investimi sjell përmirësime të dukshme në disa fusha, si: monitorimi i sistemit në kohë reale; shmangia në kohë e defekteve, duke përmirësuar shërbimin ndaj klientit; informacion në kohë reale për gjendjen e rrjetit, si dhe rritjen e sigurisë në punë për punonjësit e OSHEE-së që janë në terren. Ky projekt është miratuar teknikisht dhe pritet me shumë interes edhe nga OSHEE-ja, sepse do të ndihmojë në verifikimin e humbjeve në rrjet.

Kjo marrëveshje në total i hap rrugën një kapitulli të ri për qarkun e Shkodrës, për sa i përket furnizimit me energji elektrike, duke zgjidhur njëherë e mirë një nga problematikat më të mëdha të trashëguara që nga sistemi i kaluar, prej më shumë se 50 vjetësh.

Besimplotë se kjo ndërhyrje nga ana e qeverisë do t'u hapë rrugë investimeve private në shumë sektorë të ekonomisë në këto zona, ju ftoj ta votojmë bashkërisht.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Përpara se të kalojmë te diskutanti tjetër, dua t'ju njoftoj se projektligji "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera" do të diskutohet pas përfundimit të diskutimit të këtij projektligji, duke iu lutur të gjithë kolegëve që ta ndjekin dinamikën e diskutimeve në sallë, sepse drejtuesi i seancës shikon se çfarë ka në sallë dhe jo jashtë saj.

Fjalën e ka zonja Bardeli.

Të përgatitet zonja Marnoj.

Greta Bardeli – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Më në fund u erdhi radha edhe zonave të Veriut, që të prekin investimet e kësaj qeverie. Patjetër, si deputete e qarkut të Shkodrës do të votoj për këtë investim që po bëhen në dy qarqet e zonave të Veriut, në Lezhë dhe në Shkodër.

Edhe pse kam rezervat e mia në lidhje me këtë projektligj, të cilat i kemi diskutuar edhe në komisione, unë i ftoj të gjithë kolegët e mi të zonës së Veriut, që ta votojnë dhe ta mbështesin këtë investim që po bëhet në këto zonave.

Një vëmendje të veçantë, në fakt, kërkojnë investimet në infrastrukturën rrugore.

Më 6 korrik të vitit 2023, në "rrugën e vdekjes", sikurse e kanë pagëzuar banorët e zonës (është rruga që lidh 3 njësitë administrative: Pult, Shosh dhe Shalë), u shtua viktima e radhës. Një kumt i zi mbuloi të gjithë zonën e Dukagjinit. Një nga burrat më të mirë të asaj zone, i ndjeri Gjelosh Rushaj, humbi jetën për shkak të shembjes së asaj rruge. Unë sot, më e motivuar se kurrë, dua t'ju drejtohem juve, si kolegë deputetë, por edhe të gjithë banorëve të qarkut të Shkodrës, dukagjinasve që jetojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, duke lexuar një peticion, i cili është hartuar nga banorët dhe organizatorët. Këtu vlen të theksohet fakti se një nga organizatorët e lëvizjes "Dukagjini kërkon rrugën" ishte pikërisht edhe i ndjeri Gjelosh Rushaj. Ky peticion vjen në mbështetje të 6101 firmëtarëve, të cilët më parë u janë adresuar të gjitha zyrave të pushtetit lokal dhe qendror, duke zhvilluar edhe seminare të ndryshme teknike, edhe thirrje në media, dhe këtu vlen të theksohet fakti se banorët zhvilluan edhe dy protesta shumë qytetare, në të cilat kërkonin rindërtimin dhe asfaltimin e rrugës së Dukagjinit.

Në peticion thuhet: "Dukagjini i izoluar rrezikon shumë jetë njerëzish. Rruga e Dukagjinit është një aks rrugor shumë i rëndësishëm, që lidh Shkodrën me 3 njësitë administrative: Shosh, Shalë dhe Pult. Për shkak të mungesës së investimeve dhe mungesës së vëmendjes së autoriteteve vendore dhe qendrore, kjo rrugë ka pësuar shumë dëmtime, duke sjellë pasoja të rënda, deri në humbjen e jetëve të banorëve të zonës. Rruga e Dukagjinit, e ndërtuar 55 vjet më parë, sot është krejtësisht e amortizuar, jashtë çdo parametri teknik dhe ligjor. Rrezikohet jeta e banorëve dhe e mijëra vizitorëve që e përshkojnë këtë aks rrugor në periudha të ndryshme të vitit. Janë mbi 60 persona që kanë humbur jetën në këtë aks rrugor dhe qindra të tjerë të plagosur dhe të gjymtuar, vendas dhe të huaj. Mungesa e rrugës po shkakton edhe shpopullimin e kësaj

zone. Banorët janë lënë jashtë shërbimit të rregullt shëndetësor dhe arsimor, pa të drejtë pronësie dhe larg mundësive të barabarta për zhvillim ekonomik".

Për sa më sipër, banorët dhe hartuesit e këtij peticioni u janë drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit të Shqipërisë, Presidentit të Republikës dhe Kryetares së Kuvendit.

Prandaj, të nderuar kolegë, sidomos ju, qeveritarë, që jeni të pranishëm në këtë seancë, ju ftoj t'i hidhni përsëri sytë për investime të qenësishme për rrugën e Dukagjinit!

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bardeli!

Fjalën e ka zonja Marnoji.

Të përgatitet zonja Andia Ulliri.

Shpresa Marnoj – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë në lidhje me një hua koncensionale për programin "Përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore, pas tërmetit të vitit 2019"", synon apo ka si objektiva specifikë përmirësimin e sektorit shqiptar të energjisë elektrike, të bazuar në parimet e tregut dhe në zhvillimin e një sektori modern të energjisë elektrike, me ndërtimin e nënstacioneve elektrike tërësisht të reja apo me riparimin e atyre ekzistuese në zonat e Durrësit dhe Shkodrës, si dhe përmirësimin e lidhjes, cilësisë, efikasitetit të transportimit dhe rrjetit në tërësi, për të nxitur kështu zhvillimin e sektorit familjar dhe atij privat.

Ky projektligj është një propozim i Këshillit të Ministrave, i cili i paraqitet Kuvendit bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 121 të saj, ku Komisioni për Ekonominë dhe Financat e ka shqyrtuar atë, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Kjo hua vjen në kuadër të konferencës së donatorëve "Bashkë për Shqipërinë", e organizuar në muajin shkurt të vitit 2020, në Bruksel, për masat e rimëkëmbjes, me qëllim financimin nga donatorët ndërkombëtarë pas tërmetit të nëntorit të vitit 2019, ku qeveria e Republikës së Italisë ka dhënë një garanci formale prej 5 milionë eurosh në grante dhe 90 milionë euro në hua koncesionale. Kjo hua koncesionale me kërkesën e qeverisë shqiptare është ndarë, duke rënë dakord që të përdoret për financimin e projekteve dhe importimin e mallrave në shumën e 35 milionë eurove për ndërhyrje në infrastrukturë, me qëllim përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri dhe për përmirësimin e linjave të shpërndarjes në Veri të vendit. Në kuadër të marrëveshjes, qeveria italiane angazhohet në disbursimin e huasë koncesionale, e cila nuk e tejkalon shumën e 35 milionë eurove dhe vjen në terma mjaft të mirë: me një normë interesi prej 0,5%, element granti 60% dhe periudhë shlyerje 25 vjet, nga të cilat 12 vjet do të jenë periudhë mospagimi, gjatë së cilës do të paguhen vetëm interesat. Kjo do të përdoret nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë për mbulimin e kostove aktuale për punimet civile dhe për furnizimet me pajisje dhe shërbime, të cilat do të blihen përmes një oferte konkurruese ndërmjet shoqërive ndërkombëtare, që do të organizohet në Republikën e Shqipërisë. Qeveria shqiptare do të jetë pala që do të sigurojë zbatimin e programit në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje huaje, do të jetë përgjegjëse për përdorimin e huasë koncesionale, për përcaktimin dhe menaxhimin e kontratave, si dhe për mbikëqyrjen e veprimtarive, pasi do të sigurojë disponueshmërinë dhe sigurimin në kohë të burimeve financiare dhe njerëzore, me qëllim përmbushjen e kërkesave për investimin e projektit, të cilat nuk mbulohen nga huaja koncesionale.

Objekti i kësaj kontrate vjen kryesisht si nevojë e rikuperimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019 në zonat më të prekura, siç është zona Fushë-Krujë – Kurbin (këtu u referohem zonave sipas projekteve të parashikuara në këtë program), por njëkohësisht edhe si nevojë për të ndërhyrë njëherë e mirë në rrjetet ekzistuese tejet të amortizuara, të cilat me kapacitetet që kanë aktualisht nuk përmbushin nevojat e zakonshme të konsumatorëve (kryesisht në zonat rurale apo malore, ku ka ndërprerje të herëpashershme të energjisë si pasojë e defekteve), dhe për të përballuar zhvillimin e këtyre zonave me ndërtime të reja dhe zhvillimin e turizmit përgjatë vijës bregdetare të zonës Shëngjin-Velipojë, që në këtë periudhë përkon me

një shtim të fluksit të numrit të turistëve dhe për rrjedhojë nevojat janë shumë herë më të larta.

Gjithashtu, projektet do të shtrihen edhe në qarkun e Shkodrës, duke prekur pothuajse të gjithë zonën, si në Koplik, në Tamarë e më gjerë, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në turizmin malor, i cili kohët e fundit po merr një zhvillim të veçantë.

Kuptohet se të gjitha këto projekte do të marrin kohën e nevojshme për t'u realizuar, por do të zgjidhin përfundimisht problemet më të mëdha të energjisë elektrike në këto zona, duke përmirësuar ndjeshëm zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe jetën e qytetarëve në përgjithësi, e cila është në thelb të përpjekjeve dhe punës së kësaj qeverie ndër vite, duke u kujdesur që vëmendja të shtrihet në çdo sektor apo sistem, si në përmirësimet në infrastrukturën e përgjithshme, në shëndetësi, në arsim, në ujësjellës-kanalizime, në energji, në turizëm, në shërbime të digjitalizuara dhe në shumë fusha të tjera, për të mbajtur një ekonomi stabël edhe në situata të vështira kombëtare apo ndërkombëtare, qofshin këto ekonomike apo politike, madje duke marrë përsipër edhe rritjen e pagave të të gjithë administratës publike, pavarësisht zhvillimeve.

Ndaj, edhe një herë, duke e vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, që prek një ndër sektorët më jetikë, siç është ai i energjisë elektrike, ju ftoj të gjithëve ta miratojmë!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Marnoj!

Fjalën e ka zonja Ulliri.

(*Ndërhyrje nga salla*)

Po, zoti Dogjani.

Pse e keni kërkuar fjalën?

Asllan Dogjani – Për procedurë.

Ermonela Felaj – Në rregull.

Fjala për zotin Dogjani, për procedurë.

Asllan Dogjani – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Ne diskutuam edhe në Komisionin e Ligjeve për sa i përket përdorimit të fjalës "Shqipëria Veriore". Në Kushtetutë është e përcaktuar: "Republika e Shqipërisë", dhe nuk ka ndarje, Shqipëri Veriore apo Jugore, por meqenëse heqja e kësaj fjale do të ndikonte në shtyrjen e marrëveshjes, ne e pranuam. Por të paktën të mos përdoren nga kolegët fjalët "Shqipëria Veriore" dhe "Shqipëria Jugore", sepse këto përcaktime janë një diskriminim, dhe në vend të tyre mund të përdoren: "në Veri apo në Jug të vendit". Prandaj, kërkoj që në të ardhmen të mos lejojmë më të vijnë të shkruara në mënyrë të tillë shkresa, marrëveshje apo projektligje, duke qenë se ne jemi Kuvendi i Shqipërisë. U kërkoj kolegëve, të paktën, këtu në parlament, të mos e përmendin këtë frazë, sepse në këtë mënyrë shtrembërojmë Kushtetutën, pasi në të është parashikuar një Shqipëri, dhe ajo është Republika e Shqipërisë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se kolegët që do të flasin më pas, Andia Ulliri dhe zoti Eduard Ndreca, do ta kenë parasysh sugjerimin e kolegut Dogjani.

Zonja Ulliri, fjala për ju.

(*Ndërhyrje nga salla*)

Ju lutem kolegë, të mos diskutojmë nga vendi, por ta lejojmë zonjën Ulliri të mbajë fjalën e saj.

Andia Ulliri – Të nderuar kolegë,

Së pari, dua të shtoj se jam dakord me parafolësin për çështjen që ngriti, duke treguar se, kur bëhet fjalë për mënyrën se si ne i shkruajmë ligjet, duhet të jemi të kujdesshëm, që të mos cenojmë të drejtat dhe të mos jemi diskriminues, pavarësisht se projektligji që vjen sot është i një rëndësie të veçantë, i cili duhet marrë dhe zbatuar me përpikëri.

Dua të marr vëmendjen tuaj për një nga shqetësimet dhe ngjarjet që ka ndodhur javën e kaluar, për të cilën ka pasur një impakt të gjerë. Përfundimi i sesionit parlamentar shoqërohet me raporte të shumta dhe seanca të gjata, ku shpeshherë jemi të detyruar të flasim më shumë për çështje të ndryshme, duke bërë që të bjerë fokusi për disa shqetësime.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj një shqetësim: sigurinë në det. Do të marr vetëm pak minuta kohë, duke dalë nga rendi i ditës, për të sjellë një shqetësim që ma kanë përcjellë shumë qytetarë. Si fillim, dua t'u kërkoj ndjesë dhe t'u shpreh ngushëllimet e mia dhe të kolegëve të mi të gjithë familjarëve të viktimave, për të cilët do të diskutoj, për tragjedinë e datës 9 korrik në Kavajë, ku humbën jetën 3 persona! Prej vitesh një shqetësim i madh mbetet mungesa e sigurisë në vijën bregdetare, por këtu nuk dua të flas për çmimet abuzive apo për faktin se ligji përcakton që çdo subjekt duhet të garantojë 20% e plazhit të jetë publik, kriter që nuk është zbatuar asnjëherë, siç edhe e kemi dëshmuar, por në nenin 5 të

VKM-së nr. 171, datë 27.03.2019, ndryshuar në vitin 2022, bazuar në ligjin "Për turizmin", në pikën 8, shpjegohet se çdo subjekt i interesuar duhet të paraqesë një marrëveshje paraprake me vrojtues plazhi, e cila garanton sigurinë në stacionin e plazhit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Këtu lind pyetja: a u zbatua pika 8 e kësaj VKM-je, e ligjit tonë, në të cilën thuhet se vrojtuesi i plazhit duhej të ishte dhe të kishte dhënë sinjalizime dhe kufizime për hapësirën ujore në momentin kur tragjedia u mori jetën 3 qytetarëve shqiptarë? Gjithashtu, a u zbatua ligji, që për çdo stacion plazhi duhet të garantohet shërbimi me vrojtues plazhi çdo ditë, për çdo 80 metra vijë lineare bregdetare në hapësirë publike ose jo? Në nenin 14, pika 13, shpjegohet se, në rastin e shkeljes së zbatimit të kushteve të kontratës së lidhur, inspektorati përgjegjës për turizmin merr masa administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin, deri në zgjidhjen e kontratës.

Thënë këto, dua të shtroj disa pyetje.

A kishte roje bregdetare në ditën kur ndodhi ngjarja fatkeqe?

A monitorohen apo zbatohen ligjet që garantojnë sigurinë në det?

Pse nuk kanë reaguar institucionet dhe ministritë përkatëse deri më sot?

A kemi ne kapacitetet e nevojshme për garantimin e këtij ligji, kur duhet të kemi vrojtues plazhi në çdo 80 metra të vijës bregdetare në hapësira publike ose jo?

Sa asistohen subjektet përkatëse në sigurimin e vrojtuesve të plazhit?

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Pse asnjëherë nuk flitet apo nuk merret asnjë përgjegjësi, edhe pse prej vitesh ndodhin ngjarje të tilla? Sepse qeveria ka treguar dhe faktuar se është e papërgjegjshme dhe e painteresuar në vendosjen e standardeve. Po të flasim për standardet që janë vendosur në çdo vend tjetër të rajonit apo të Europës, do të shohim se ka ligje që zbatohen dhe kritere të përcaktuara, të cilat vijnë në ndihmë, që këto situata të evitohen. Patjetër, ne duhet të bëjmë çfarëdolloj gjëje që kemi në dorë. Edhe personat që kanë përgjegjësi për zbatimin e ligjit duhet të jenë në lartësinë e detyrës së tyre, duhet të marrin përgjegjësinë që u takon për t'i vendosur këto standarde dhe për t'u siguruar se ligji zbatohet kudo njësoj, sepse standardi i sotëm nuk flet për mbrojtje jete apo për forcimin dhe garantimin e sigurisë publike.

Pavarësisht se karriget pas meje janë bosh, shpresoj që personat përgjegjës të ngrihen në lartësinë e detyrës që u është besuar dhe të garantojnë zbatimin e ligjit, sepse sot diskutohet për jetë të humbura dhe për rrezikun e përsëritjes së kësaj ngjarjeje edhe në vijim të sezonit.

Duke ju falënderuar për vëmendjen për këtë çështje, dua të kaloj edhe te pika 9 e rendit të ditës, te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, në lidhje me një hua koncesionale për programin "Përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore, pas tërmetit të vitit 2019"".

Në fillim të fjalës sime, dua të përmend se, në dy vjetët e fundit, prej momentit kur kam marr detyrën time, sa herë kemi diskutuar me zgjedhësit, kjo çështje ka qenë një nga kryefjalët e diskutimeve. Kjo për faktin se prej vitesh në shumë zona të njësisë Fushë-Krujë ka pasur ndërprerje të vazhdueshme të energjisë elektrike, ka pasur probleme në rrjetin shpërndarës, madje në pjesën më të madhe ka pasur furnizim me tension të ulët dhe për këto probleme asnjëherë nuk ka pasur asistim.

Dua ta falënderoj ministren, e cila në fjalën e saj tha se Fusha-Kruja ishte bashki!

E nderuar zonja Ministre, ka disa vite që Fushë-Kruja nuk është bashki, por është njësi administrative dhe si e tillë është trajtuar në investimet që ka marrë. Si pasojë e këtyre problematikave të gjithë banorët do t'i mirëpresin krahëhapur investime të tilla, duke shpresuar dhe besuar se do të ketë një zbatim të ligjit me përpikëri, ku të gjitha investimet të shkojnë në vendin ku u takon dhe të respektohen të gjitha kriteret. Në një njësi me shumë problematika infrastrukturore dhe pa investime serioze nga pushteti vendor dhe qendror, duhet të merret parasysh fakti se fshati Qerekë, në njësinë Nikël, është një nga zonat që lidhet ngushtë me zonën e aeroportit dhe prej vitesh përballet me ndërprerje të energjisë elektrike dhe tension të ulët, gjë që ka dëmtuar familjet dhe bizneset e kësaj zone. Diskutimi im për këtë çështje konsiston në faktin se rrjeti shpërndarës lidhet me nënstacionin e Valiasit të Bashkisë së Kamzës, pavarësisht se fshati ndodhet në njësinë administrative Nikël, e

cila ndodhet në Bashkinë e Krujës. Çfarë ndodh me këta banorë? A e marrin këta ata përfitimin nga ky investim, duke qenë se janë banorë të njësisë administrative Nikël, por në të vërtetë nënstacioni i tyre nuk ndodhet në zonën e Bashkisë së Krujës? Çfarë ndodh me këta banorë, të cilët presin prej vitesh ndërhyrje në rrjet?

Po ashtu, zona e Bubqit është njëra nga njësitë që është përballur me vështirësitë e ndërprerjes së energjisë elektrike ndër vite, shoqëruar nga një rrjet i amortizuar dhe tension i ulët. Sidomos nëse do të shkojmë në zonat më malore të asaj zone, do të shikojmë që rrjeti shpërndarës konsiston në disa shkopinj druri të periudhës komuniste, pasi edhe sot e kësaj dite nuk ka pasur asnjë ndërhyrje në rrjet.

Të nderuar kolegë,

Investime të tilla jenë themelore për të garantuar të drejtat kushtetuese të qytetarëve tanë. Investime të tilla janë të vonuara. Këto investime duhet të vendosin një standard të ri jo vetëm për rrjetin e shpërndarjes, por, siç e thashë, për garantimin e të drejtave kushtetuese të qytetarëve tanë.

Nuk dua të përmend këtu se çfarë ka ndodhur apo si ka reaguar qeveria në rastet kur ka pasur pagesa të vonuara dhe kamatëvonesa. Nuk dua të përmend jetët e humbura, njerëz të cilët janë hedhur nga ballkonet e spitaleve, sepse nuk paguanin dot faturat e tyre. Sot dua të flas për një standard të ri që ne duhet të vendosim për energjinë elektrike. Sa diskutojmë ne për përmirësimin e standardit të jetesës në vendin tonë? Sa nga ju e dini se çfarë do të thotë sot "varfëri energjetike"? Shqipëria është një nga vendet me impaktin më të gjerë të varfërisë energjetike në rajon, pasi ne jemi një nga vendet që ende po kalon periudhën e tranzicionit dhe ende nuk po rikuperohemi nga ky tranzicion. Ne kemi banorë që nuk kanë asnjë mbështetje për problematikat energjetike.

Së fundi, uroj që kjo marrëveshje të zbatohet me transparencë dhe përpikëri! Uroj që shuma prej 35 milionë eurosh të vihet në dispozicion të të gjithë këtyre banorëve të qarkqeve Durrës, Lezhë dhe Shkodër, sepse këto janë 3 zona që nuk kanë përfituar investime, qoftë në infrastrukturë, qoftë në infrastrukturën energjetike, por janë edhe disa prej zonave më të privuara nga qeveria ndër vite.

Dua të sjell në vëmendje edhe rastin e rrugës Thumanë-Kashar, e cila trumbetohet si një nga investimet më serioze. Çfarë ndodhi me atë rrugë? A ka pyetur ndonjëri prej jush se çfarë do të ndodhë me shtyllat e tensionit të lartë që janë anës rrugës? Sa do të kushtojë largimi i këtyre shtyllave nga rruga, duke qenë se gjurma e rrugës u ndryshua për të tretën herë, për disa arsye që ne nuk i dimë edhe sot, sepse nuk ka transparencë?

Prandaj, të nderuar kolegë, uroj që ky ligj të jetë fillesa e vendosjes së një standardi të ri, ku transparenca të jetë kryefjala e këtij projektligji, dhe që korrupsioni të mos e prekë këtë projektligj si shumë projektligje të tjera!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Ndreca.

Eduard Ndreca – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Përpara se të nis fjalën time, dua të jap një përgjigje për kolegun që bëri një vërejtje me vend, kur e shikon në qasje të parë, por ndarje të tilla, Veri-Jug, janë të përbotshme dhe nuk duhet të kemi ngarkesa kur i lexojmë në projektligje apo kudo tjetër.

I nderuar koleg, ne, si deputetë të Veriut, ngarkesat duhet t'i kemi nëse shohim se ka disbalancë ndërmjet ofrimit të fondeve mes njërës krahinë apo tjetrës.

Një përgjigje tjetër për kolegen që sapo foli: rruga Thumanë-Kashar vijon me ritme shumë të shpejta, sepse, si deputet i Lezhës, e shoh çdo ditë punën që bëhet dhe jam i bindur se shumë shpejt ajo do të jetë një rrugë e aksesueshme. Pyetja që shtrohet për ne që vijmë nga Lezha është: a e zgjidh plotësisht problemin kjo rrugë? Patjetër që jo. Këtë do ta shpjegoj edhe në fjalën time më poshtë.

Të nderuar kolegë, në Komisionin e Ligjeve kam qenë relator për projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, në lidhje me një hua për programin "Përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore, pas tërmetit të vitit 2019"". Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ne i marrim qeverisë italiane një borxh prej 35 milionë eurosh dhe nuk do të hy në detaje të tjera, sepse kolegët parafolës i përmendën. Ky borxh shkon për të përmirësuar sistemin energjetik në Veri të vendit. Ky fond vjen në kuadër të Konferencës së Donatorëve

"Bashkë për Shqipërinë", pas tërmetit të vitit 2019. Të gjithë jemi koshientë se tërmeti i vitit 2019 la shumë pasoja në vend, por falë angazhimit të qeverisë shqiptare dhe me ndihmën e shumë qeverive të tjera, që i dimë tashmë, ne mundëm ta kryenim si duhet detyrën për t'i ndihmuar qytetarët tanë jo vetëm për strehim, por për çdo nevojë tjetër që ata patën. Patjetër, dëmtimet që shkaktoi tërmeti prekën edhe sistemin energjetik, ndaj ky investim apo çdo investim tjetër në këtë rrjet është jetik. Ky projektligj nuk është planifikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2023 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por nisur nga rëndësia që paraqet, ky investim për energjinë duhet miratuar dhe votuar nga të gjithë ne, kolegë, sepse është një mundësi më shumë për të përmirësuar jetën e qytetarëve.

Investimet që parashikohen në zonën e Shkodrës dhe në Lezhë (i përmendën ministrja dhe të gjithë kolegët e tjerë) janë shumë të mëdha. Pra, janë disa punë të mira që po bëhen dhe e vlerësoj shumë.

Për faktin se këto punë janë cilësuar që do të bëhen në Veriun e Shqipërisë, dua të flas edhe si deputet i kësaj zone. Përtej vlerësimeve për punët që janë bërë dhe po bëhen, duhet të flasim të vërtetën për gjithçka që nuk është bërë dhe nuk funksionon si duhet. Në Lezhë kemi marrë shumë investime për përmirësimin e sistemit të rrjetit energjetik, por ende sot kemi një pjesë të mirë të rrjetit që daton në "orën e parë" të ndërtimit të këtij rrjeti. Kjo është bërë shkak që në çdo njësi administrative, pra në pjesën më të madhe të fshatrave të Lezhës, të ketë ndërprerje të energjisë jo vetëm në dimër, për shkak të reshjeve dhe erës, por edhe në verë, për shkak të mbingarkesave. Në këto momente që flasim kam marrë mesazhe nga Shëngjini se mungon energjia elektrike. Kjo është e pafalshme, duke qenë se jemi edhe në kulmin e sezonit turistik dhe kjo ndodh vetëm prej mungesës së investimeve në rrjet. Ky është një rrjet i amortizuar plotësisht, me tela që në "orën e parë" të nisjes së këtij shërbimi dhe kjo situatë nuk është për faj të punës që bëjnë drejtoritë rajonale në Shkodrës apo në Lezhës, të cilat janë *nonstop* të angazhuara, por e kanë të pamundur për ta mbajtur në këmbë këtë shërbim, kur telat e kalbur tanimë këputen në njëmijë vende.

Realisht, marr qindra mesazhe në ditë për problemin e ndërprerjes së energjisë, duke filluar nga njësia administrative Zejmen, me fshatin Pllanë, e në skajin tjetër, në Spiten, po ashtu në njësinë administrative Kolsh, kryesisht në fshatin e Barbullojit, në Grykë dhe në Lalm. Dua të ndalem në fshatin Lalm, duke qenë se është bërë një investim shumë serioz nga qeveria shqiptare para disa vitesh, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, i iniciuar nga Bashkia e Lezhës, me këmbënguljen e drejtpërdrejtë të kryetarit të bashkisë, i cili, në fakt, sot është një investim që shijohet në mënyrë gjysmake, për shkak se mungon një leje nga qendra për të spostuar shtyllat e tensionit të mesëm dhe të ulët. A thua se këtu kemi dy shtete që veprojnë në kahe krejt të kundërta, në një kohë kur, natyrshëm, bashkia apo zyrat e OSSHE-së duhej ta merrnin lejen për t'i spostuar këto shtylla. Pra, ky është një investim të cilit po i humbet vlera dita ditës, për shkak të një kapriçoje të institucioneve qendrore të këtij vendi. Po ashtu, edhe të gjitha njësitë e tjera: Kallmet, Blinisht, Dajç, sot që flasim kanë ndërprerje pa kufi të energjisë elektrike. Fatkeqësisht, të njëjtin fat kanë edhe zonat bregdetare. Prandaj, unë e vlerësoj këtë marrëveshje, për shkak se në Shëngjin do të bëhet një ndërhyrje domethënëse, por sot që flasim kemi ndërprerje të mëdha energjie si në Shëngjin, ashtu edhe në Talë, në njësinë administrative Shënkoll. Është e pafalshme që në kulmin e sezonit, për shkak të mungesës së investimeve, ne të dobësojmë forcën e strukturave pritëse. Pa dyshim, zhvillimi i turizmit tkurret kur një problem i tillë bëhet rrugë, shto këtu edhe disa probleme të tjera që kërkojnë zgjidhje, të cilat më lejoni t'i them, sepse janë probleme të ngritura vazhdimisht nga qytetarët e qarkut të Lezhës, por edhe më gjerë.

Një nga problemet që kërkon zgjidhje është infrastruktura rrugore. Në mënyrë që të shmangen radhët e mëdha të trafikut, ajo duhet parë me seriozitet. Unë nuk jam xheloz për investimet që bëhen në çdo cep të Shqipërisë, por të lësh Lezhën, Shkodrën dhe Dibrën me një rrugë gjysmake, siç është rruga e Fushë-Krujës, me një korsi vajtjeje dhe një korsi ardhjeje, e shkatërruar disa herë, besoj se është e pafalshme. E vlerësoj shumë punën për rrugën Thumanë-Kashar, sepse realisht po punohet shumë, se e shoh çdo ditë, por a e zgjidh kjo rrugë çështjen e trafikut? E thashë edhe në fillim, kjo rrugë nuk e zgjidh makthin që ka Veriu nga trafiku. I gjithë trafiku që do të zbresë për në Lezhë, në Shkodër dhe në territore

të tjera, do të ngushtohet në një hinkë, që quhet "Milot-Balldren", një rrugë që është premtuar nga qeveria, dhe jam i bindur se do ta bëjë, por, unë si deputet i qarkut të Lezhës dhe të gjithë deputetët e tjerë duam të shohim hapa konkretë për të, shtuar kësaj edhe bajpasin e Shëngjinit, për të shfryrë trafikun e madh në këtë zonë të rëndësishme bregdetare. Bajpasi i Shëngjinit ndihmon dhe e bën më të aksesueshme rrugën e re që po bëhet mes Shëngjinit dhe Velipojës, e cila është një kryevepër e kësaj qeverie.

E thashë edhe më herët se i vlerësoj investimet që janë bërë edhe në plazhe shumë më të vogla se Shëngjini, se e meritojnë, por të lësh Shëngjinin, që është njëri nga plazhet më të mëdha, më të bukur dhe me numrin më të madh të pushuesve në vend, kryesisht nga Kosova, me këtë hyrje, për ne është e pafalshme. U kërkoj institucioneve, ministrisë dhe Kryeministrit, që të marrin masa në mënyrë të menjëhershme për ta zgjidhur këtë problem, sepse është një kaos total.

Fatkeqësisht, këtë verë këtyre problemeve u shtohet edhe mungesa e dezinfektimit të plazhit publik nga mushkonjat. Qindra biznese po shpenzojnë para pa fund për ta bërë vetë dezinfektimin. A ka efekt kjo? Kur ky dezinfektim nuk bëhet në bllok, nuk ka efekt. Qytetarët nuk duan të dinë ngërçet dhe problemet që kanë dalë gjatë rrugës. Qytetarët duan që zona bregdetare të dezinfektohet, sepse, sidomos në orët e mbrëmjes, pjesa e bregdetit është kthyer në një makth për pushuesit në Shëngjin.

I përmenda të gjitha këto si shqetësime të drejtpërdrejta që më vijnë çdo ditë nga qytetarët e qarkut tim dhe do t'i përmend për sa kohë të jem në këtë parlament, deri kur të marrin zgjidhje përfundimisht. Përveç kësaj, duhet t'i përmend, sepse nuk më shkon të përmend vazhdimisht vetëm punët e mira që janë bërë, të cilat në qarkun e Lezhës janë shumë, por ne duhet të kurohemi nëpërmjet gjetjes së defekteve tona.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreca!

Mbyllet këtu diskutimi për këtë pikë.

Rikthehemi te projektligji "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera".

(Diskutime pa mikrofon)

A ka mundësi të mbani qetësi në këtë sallë, se seanca po vazhdon?

Fjalën e ka Ministrja e Financave, zonja Ibrahimaj, për të prezantuar projektligjin.

Delina Ibrahimaj – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Jam sot para jush për të prezantuar projektligjin e ri "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera". Ky projektligj është një tjetër mjet i rëndësishëm në bashkësinë e ndërhyrjeve tona për të përmirësuar menaxhimin e borxhit publik në Shqipëri. Më lejoni t'ju bëj një panoramë të plotë të të gjitha nismave dhe ndërhyrjeve që ne kemi ndërmarrë gjatë 18 muajve të fundit, me qëllim kryesor reduktimin e borxhit publik. Këta tre vjet ne kemi kaluar disa goditje, për të cilat ka pasur nevojë për ndërmarrjen e masave emergjente, dhe të gjitha këto masa kanë rezultuar në përmirësimin e aktivitetit ekonomik të vendit, në përmirësimin e treguesve kryesorë makroekonomikë, duke filluar që nga prodhimi i brendshëm bruto, i cili pati rritje të lartë në vitin 2021 dhe në vitin 2022, si dhe vijon të jetë me rritje dhe në vitin 2023, duke vazhduar me të dhënat e punësimit dhe me të dhënat e papunësisë, por edhe me të dhënat e investimeve apo të ecurisë së sektorëve tanë prioritarë dhe strategjikë, siç është turizmi.

Nga ana tjetër, më lejoni t'ju rikujtoj që kryefjala e të gjitha debateve dhe diskutimeve që ne kemi pasur gjatë vitit të kaluar ka qenë inflacioni dhe rritja e çmimeve. Sigurisht që inflacioni ka sjellë disa dukuri zinxhir në të gjithë botën, në të gjithë rajonin dhe në të gjithë Europën, ku rritja e normave të inflacionit u shoqërua me rritje të normave të interesit, ku Banka Qendrore Europiane arriti në normën e interesit 3,5 %, nga norma negative e interesit që ishte në periudhën përpara agresionit rus ndaj Ukrainës, ndërsa disa banka të vendeve të rajonit arritën në nivelet 6 % të normave të interesit.

Të dhënat e fundit të INSTAT-it tregojnë se inflacioni në vend dhe çmimet e përgjithshme të ushqimeve kanë ardhur duke u stabilizuar, sipas të gjitha parashikimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por edhe të Bankës së Shqipërisë dhe të institucioneve ndërkombëtare si FMN-ja dhe Banka Botërore. Në muajin qershor inflacioni arriti në nivelin 4,5 %.

Dua t'ju rikujtoj që piku i inflacionit ishte gjatë vitit të kaluar, në tetor, kur norma arriti në 8,3%, norma këto, siç e kemi diskutuar

shpeshherë, ndjeshëm më të ulëta se normat e rajonit apo edhe të Europës. Këtu e kam fjalën jo vetëm për inflacionin total, por edhe për inflacionin e ushqimeve dhe aq më shumë për inflacionin e produkteve të lidhura me energjinë, që kanë qenë problematikat më të mëdha që vendet e rajonit, të Europës dhe të botës kanë pasur në përballimin e kësaj krize të jashtëzakonshme.

Gjithashtu, dua të theksoj se gjatë vitit 2022, por edhe në fillim të vitit 2023, normat e borxhit publik kanë ardhur duke u reduktuar dhe duke shënuar nivelin 63% në tremujorin e parë të vitit 2023, normë kjo më e ulët se norma e parakrizave, pra norma e vitit 2019.

Këto rezultate kanë ardhur si pasojë e politikave që ka ndërmarrë qeveria, që ka ndërmarrë Ministria e Financave në bashkërendim me Bankën e Shqipërisë.

Më lejoni t'ju kujtoj se në muajin nëntor të vitit të kaluar ne, Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Kryeministrin, u bëmë një thirrje të hapur qytetarëve shqiptarë, me qëllim që të investonin në titujt e qeverisë, në bono dhe në obligacione, që qytetarët të ndërgjegjësoheshin për një alternativë shumë fitimprurëse të investimeve, e cila do të sillte më shumë të ardhura në buxhetet e tyre familjare dhe, nga ana tjetër, do të rriste kërkesën për titujt e qeverisë, që më tutje do të sillte reduktimin e normave të interesit, të cilat gjatë vitit të kaluar ishin jashtëzakonisht të larta.

Ftesa që ne u bëmë qytetarëve u dëgjua. Kërkesa për titujt e qeverisë u rrit në mënyrë të ndjeshme që pas muajit nëntor, fill pas thirrjes që Kryeministri u bëri qytetarëve. Nëse më parë gjatë gjithë vitit ne kishim një kërkesë të pambuluar nga kërkesa e tregut, nga muaji nëntor e tutje kërkesa ishte mbi dyfish nga kalendari i emetimeve të titujve të qeverisë shqiptare dhe kjo solli në norma të reduktuara të *yield*-eve të bonove të thesarit, e cila, në ankandet e fundit që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka zhvilluar nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, rezultoi në 3,09 %, ndërsa gjatë vitit të kaluar arritëm në pike, të cilat kishim më shumë se 10 vjet që nuk ishin arritur.

Ky *yield* është niveli më i ulët që është shënuar që nga muaji gusht i vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, politika e menaxhimit të borxhit ka qenë aktive ndër vite dhe ne nuk kemi qenë prezentë vetëm në tregjet kombëtare, por kemi qenë prezentë edhe në tregjet ndërkombëtare, ku kohët e fundit ne emetuam me sukses një eurobond me vlerë 600 milionë euro. Natyrisht që ky eurobond ka një normë interesi më të lartë se eurobondet e viteve të kaluara, për shkak të situatës së përkeqësuar të tregjeve financiare në tregjet ndërkombëtare, për shkak të normave të larta të interesit në Bankën Qendrore Europiane dhe në Bankën Qendrore Amerikane, pra në bankat qendrore të vendeve kryesore, të cilat ndikojnë në normën efektive të interesit. E megjithatë, dalja e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare ishte një dalje e suksesshme. Kërkesa e investitorëve të huaj për titujt e qeverisë ishte rreth dyfishi i shumës që u pranua në përfundim. Ishin rreth 87 investitorë, që ishin të interesuar të blinin titujt e qeverisë shqiptare, duke treguar dhe duke garantuar qëndrueshmërinë e ekonomisë shqiptare dhe besimin që investitorët e huaj kanë në ecurinë e saj.

Unë do të doja të bëja një krahasim me vendet e rajonit, të cilat po në vitin 2023 kanë dalë me tituj në tregjet ndërkombëtare dhe kanë pasur një maturitet të ngjashëm me maturitetin që ne emetuam, pra me maturitetin 5-vjeçar. Maqedonia e Veriut emërtoi në muajin mars një eurobond, i cili pati një kupon 6,25 % dhe një normë interesi 7,25 %; Serbia pati një kupon 6,25 % dhe një normë interesi 6,34 %; ndërsa titujt shqiptarë arritën të marrin një kupon 5,9 % dhe një normë interesi 6,25 %. Dua të theksoj këtu se Shqipëria jo vetëm mori një normë më të ulët se vendet e rajonit, por agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit i kanë vlerësuar vendet e rajonit më lart se Shqipëria. Pra, ndonëse ne kemi një vlerësim më të ulët se vendet e rajonit, arritëm të marrim një normë interesi më të ulët se ato, që do të thotë se ecuria e ekonomisë shqiptare, reformat strukturore që ne kemi bërë, me qëllim forcimin e ekonomisë, kanë dhënë rezultatet e tyre dhe janë të dukshme jo vetëm në shifrat që ne analizojmë përditë, por dhe në besimin e investitorëve ndërkombëtarë.

Të nderuar deputetë,

Projektligji që sjellim sot për miratim është një tjetër përmirësim i rëndësishëm i kuadrit ligjor, në ndihmë të optimizimit të menaxhimit të borxhit publik. Ky projektligj rregullon disa procese të lidhura me menaxhimin efektiv të skemave të veçanta të garancive sovrane, që i vijnë dhe i kanë ardhur në ndihmë biznesit në të

gjitha situatat e vështira që kanë përballuar ekonomia dhe biznesi shqiptar. Në dhjetor të vitit 2022 ne miratuan në Kuvend ndryshimet për shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë". Këto ndryshime përfshijnë parashikimet përkatëse për këto lloj skemash garancie dhe procedurat që ligji parashikon për lëshimin e garancive. Ky projektligj synon të plotësojë menaxhimin dhe rikuperimin e këtyre garancive.

Në kushtet e diktuara nga pandemia Covid-19, qeveria shqiptare ndërmori disa masa të menjëhershme, që kishin si synim jo vetëm mbështetjen financiare të biznesit apo edhe individëve, por edhe garantimin e likuiditetit të nevojshëm për rimëkëmbjen e aktiviteteve tregtare dhe ruajtjen e vendeve të punës, përmes garancive shtetërore të huas me bankat tregtare. Ky instrument është përdorur gjerësisht nga disa vende, me qëllim mbështetjen e bizneseve të prekura. Përmes garancive sovrane 1 dhe 2, qeveria akordoi një fond total prej 24,14 miliardë lekësh dhe garancitë u arritën të përthitheshin kryesisht nga bizneset, që operonin në sektorët e tregtisë, prodhimit, turizmit, ndërtimit apo shërbimeve, çka tregoi se kishim marrë vendimin e duhur, me qëllim që këto instrumente të ndihmonin në arritjen e objektivave që ne kishim vendosur, pra garantimin e vijueshmërisë së punës së biznesit, garantimin e likuiditeteve të nevojshme, me qëllim që ekonomia shqiptare dhe biznesi shqiptar të goditej sa më pak. Por ekonomia shqiptare sërish u përball me një tjetër sfidë, këtë herë të shkaktuar nga konflikti Rusi-Ukrainë, dhe sërish biznesi kishte nevojë për ndërhyrjen tonë. Në qershor të vitit 2022 u emetua skema e tretë e garancisë sovrane, këtë herë për t'u ardhur në ndihmë subjekteve që tregtonin produkte ushqimore bazë me shumicë, në mënyrë që ato të kishin gjithashtu likuiditetin e nevojshëm për të siguruar mbajtjen e rezervave, për të paktën një periudhë 3-mujore. Përdorimi i këtyre instrumenteve bëri të mundur ofrimin e një sigurie më të madhe financiare në një kohë kur paqartësitë ekonomike janë të larta dhe shteti duhet të marrë rolin e vet si garantues i zhvillimit ekonomik.

Pas tre vjetësh dhe pas tri skemash garancie të suksesshme të miratuara për biznesin, me një disbursim total prej 25 miliardë lekësh dhe me 1000 biznese përfituese, ne sot jemi gati të bëjmë një bilanc paraprak të këtij instrumenti specifik në ndihmë të biznesit. Deri sot kanë qenë vetëm dy raste të thirrjes së garancisë nga bankat, me një vlere prej 3 milionë lekësh, dhe këto skema kanë rezultuar shumë të suksesshme. Biznesi ka treguar fleksibilitet dhe elasticitet në përthithjen e të gjitha goditjeve me të cilat ekonomia është përballur. 3 milionë lekë përbëjnë më pak se 0,02% të totalit të garantuar nga këto tri skema së bashku. Këto dhe detyrimet e tjera të akumuluara ndaj buxhetit të shtetit nga nënhuatë e garancive në sektorët e energjisë, ujësjellësve dhe pushtetit vendor, kërkojnë që baza ligjore për shtimin e mekanizmave ligjorë për mbledhjen e të drejtave që i lindin MFE-së, në kuadrin e këtyre garancive, të pësojë një ndryshim. Në këtë kuadër, Agjencia e Trajtimit të Kredive, që tashmë do të quhet Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, do të ketë kompetenca të rëndësishme dhe do të marrë ato kompetenca, të cilat deri tani i ka pasur Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera do të mundësojë ndjekjen efektive të rikuperimit të detyrimit që lind pas pagesës së garancisë sovrane. Një tjetër kompetencë e shtuar është kalimi në këtë agjenci të funksionit të mbledhjes së atyre garancive sovrane që qeveria ka emetuar për marrëveshje të nënhuave, siç thashë, me institucione shtetërore apo me pushtetin lokal.

Të nderuar deputetë,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka në fokus të punës së saj konsolidimin e mëtejshëm fiskal dhe ruajtjen e parametrave kryesorë makroekonomikë. Ky qëndrim është konfirmuar me menaxhimin e situatave emergjente me të cilat jemi përballur vitet e fundit. Ne jemi të angazhuar për të vazhduar me reduktimin e borxhit në vend, duke u mbështetur në ligjin organik të buxhetit dhe në rregullat fiskale të vendosura në të. Synimi ynë është të kemi një balancë primare pozitive që në vitin 2023, ndonëse ligji na e kërkon arritjen e balancës primare pozitive në vitin 2024. Kjo tregon që ne jemi të angazhuar të garantojmë stabilitetin makroekonomik të vendit, të ruajmë konsolidimin fiskal dhe të jemi gati për të përballuar çdo lloj sfide që e ardhmja mund të na sjellë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zonja Tabaku.

Të përgatitet zoti Krrashi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu e kam.

Jorida Tabaku - Të nderuar kolegë, unë dua të diskutoj shkurtimisht një çështje.

Gjatë dy muajve të fundit, në Parlamentin Europian është diskutuar raporti për Shqipërinë, në të cilin janë evidentuar një sërë çështjesh. Unë shpresoja që dikush nga mazhoranca ta ngrinte si shqetësim, por njëkohësisht të vlerësonte punën e deputetëve të Parlamentit Europian, te raportueses për Shqipërinë, zonjës Santos, por edhe zotit David Lega, reporterit në hije, që është përfaqësuesi i grupit të EPP-së. Raporti për Shqipërinë është një paraqitje e saktë e situatës dhe unë shpresoj që qeveria shqiptare, pasi i mbylli sytë për 10 vjet dhe ngeli në vendnumëro, ta heqë maninë e luajtjes së liderit të rajonit dhe të përpiqet të merret me hallet dhe shqetësimet tona të vogla.

Unë dua të theksoj disa elemente, të cilat janë evidentuar në raportin e Parlamentit Europian.

Së pari, Parlamenti Europian mbështet procesin e integrimit të Shqipërisë dhe njëkohësisht të gjitha reformat e nevojshme për këtë proces; i kërkon qeverisë shqiptare që të intensifikojë dhe të përmirësojë funksionimin e ligjit, pushtetin gjyqësor, luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe ndalet në mënyrë të veçantë te liria e medias, si një shqetësim i jashtëzakonshëm për Shqipërinë, me rënien e Shqipërisë në vlerësimin e "Reporterëve pa kufij", por edhe me përmendjen e shqetësimit për mediet në të gjitha raportet ndërkombëtare, përfshi edhe raportin e DASH-it; i kërkon qeverisë shqiptare të rrisë kapacitetet në sistemin gjyqësor, për të investuar në burime financiare, për të investuar në plotësimin e nevojshëm të reformës në drejtësi.

Nga ana tjetër, Parlamenti Europian kërkon që parlamenti i Shqipërisë të ndalojë thyerjen e rregullave dhe të procedurave; shpreh shqetësim për rastet kur roli i opozitës në parlamentin e Shqipërisë nuk është respektuar, duke përfshirë mungesën e ngritjes së komisioneve hetimore, një e drejtë kushtetuese e opozitës, dhe është ndër raportet e fundit që kërkon që opozitës t'i jepet në parlament hapësira e duhur; shpreh shqetësim për përgjegjësinë, përgjegjshmërinë dhe raportimin e administratës publike shqiptare, për përmirësimin e raportimeve dhe monitorimeve të zyrtarëve publikë; kërkon që qeveria shqiptare të tërhiqet nga ligji "Për amnistinë fiskale", por edhe nga ligji "Për pasaportat e arta"; shpreh shqetësim për sistemin e financave publike dhe shqetësime të vazhdueshme në lidhje me mospërputhjen dhe cenimin e fondeve të BE-së.

Këtu po përmend dy raste të veçanta, të cilat janë nën hetim dhe në bashkëpunim me prokurorët e Drejtorisë së Auditit dhe Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë. Gjithashtu, Parlamenti Europian shpreh shqetësim për sa i përket transparencës, përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë për prokurimet publike, për sistemin e koncesioneve, të cilat sot janë problemi real në luftën kundër korrupsionit, ku qeveria shqiptare, fatkeqësisht, jo vetëm nuk ka avancuar, por ka bërë hapa mbrapa; dënon përdorimin e të dhënave private në sistemin zgjedhor, në proceset zgjedhore, nga Partia Socialiste; shpreh shqetësim për njësimin e shtetit me qeverinë.

Një shqetësim kryesor është edhe reforma zgjedhore. Është fatkeqësi e madhe dhe duhet të kishe qenë në interesin e opozitës, fakti që ne nuk kemi arritur në dy vjet të kemi ndryshime të sistemit zgjedhor, si dhe të avancojmë me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Opozita duhet të ishte e para që të kërkonte ecjen përpara të reformës zgjedhore, duhej të ishte e para që të kërkonte që Komisioni Parlamentar për Reformën Zgjedhore të bënte ndryshimet e menjëhershme dhe është e pafalshme për opozitën që nuk kemi asnjë rezultat për shkak të shtyrjeve të njëpasnjëshme. Ky raport i Parlamentit shpreh pikërisht këto shqetësime. Shpresoj që kjo të jetë një thirrje e hapur për Shqipërinë.

Javën tjetër ne do të presim në parlamentin e Shqipërisë, me ministren e Punëve të Jashtme, Komisionin Parlamentar për Zbatimin e MSA-së, ku do të ngrihen po të njëjtat shqetësime. Ne ndodhemi në një moment shumë të rëndësishëm; vjet, në 17 korrik, u hap Konferenca e parë Ndërqeveritare dhe ndërkohë që flasim, nuk kemi asnjë informacion për hapjen e Konferencës së dytë Ndërqeveritare. Opozitës i intereson që negociatat të ishin hapur dje, i intereson që ne të

lëvizim në këtë proces, i intereson të kemi rezultate konkrete, se boll kemi humbur kohë me procese boshe, si Ballkani i Hapur, me demagogji boshe. Sot qytetarët kanë nevojë që parlamenti të realizojë atë që presin prej 10 vjetësh. Ndaj shpresoj që kjo të jetë një thirrje e hapur për politikën shqiptare dhe ta lëmë retorikën boshe, ta lëmë interesin parësor të partisë, ta lëmë interesin politik të ditës, që mund të ketë sot qeveria ose përfaqësues të tjerë të caktuar të politikës dhe të fokusohemi tek interesi i qytetarëve shqiptarë, 90% e të cilëve kërkojnë avancimin në procesin e integrimit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar ministrja Xhaçka.

Olta Xhaçka – Kam një sqarim sa i takon rezolutës së Parlamentit Europian: patjetër që raporti shpreh shqetësime, patjetër që ofron rekomandime, është në natyrën e tij që ta bëjë një gjë të tillë, por ndërkohë ende presim tekstin e përfundimtar të rezolutës së Parlamentit Europian. Ajo që mund të thuhet nga diskutimet e parlamentit është se kemi për herë të parë një rezolutë, që jo vetëm i mirëpret arritjet e vendit tonë për integrimin në BE, dhe e përshkruan Shqipërinë si një partnere të besueshme të politikës së jashtme dhe si një aleate të rëndësishme gjeopolitike, por e paraqet vitin 2030 për herë të parë si një objektiv për përfundimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë, duke u bazuar në arritjet e Shqipërisë sa i takon gjithë këtij procesi. Kjo është një njohje e qartë e progresit që është bërë deri tani, por edhe e avancimit të agjendës së reformave të BE-së. E theksoj edhe një herë që është në natyrën e këtij raporti që të përmbajë edhe rekomandime, të cilat ne do t'i trajtojmë me shumë seriozitet.

Ermonela Felaj – Zonja Tabaku, për çfarë e keni kërkuar fjalën?

Jorida Tabaku – 30 sekonda për procedurë.

Dua të përshëndes Grupin e Partive Popullore në Parlamentin Europian për rolin konstruktiv që ka luajtur. Në fakt, nëse nuk do të ishte për Grupin e PPE-së, sot nuk do ta kishim këtë raport. Dua të theksoj që raporti, siç e thoni me të drejtë edhe ju, zonja Xhaçka, e përmenda edhe unë, përcakton perspektivën e qartë për procesin e integrimit, por, nga ana tjetër, i bën thirrje qeverisë shqiptare që të rrisë patjetër transparencën në këtë proces, duke përfshirë opozitën dhe ta bëjë këtë një proces gjithëpërfshirës, gjë që deri sot nuk ka ndodhur.

Për mua është dështim që qytetarët shqiptarë nuk flasin për këtë, se e keni mbajtur procesin të mbyllur dhe privat. Unë shpresoj që pas procesit "*screening*", për të cilin ka dijeni vetëm kryenegociatorja dhe askush tjetër në Republikën e Shqipërisë, duhet të hapim një diskutim për këtë temë dhe t'i kthejmë këto tema në plan pune.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Balla, dëshironi ta merrni fjalën?

Taulant Balla – Meqë u përmend kjo çështje, kam dy gjëra që mund t'i them me krenari. Deri sot, sa të votohen dekretet, unë kam pasur mundësinë të drejtoj delegacionin shqiptar në Komitetin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit. Dje, në Parlamentin Europian, raporti i përgatitur nga Isabel Santos mori numrin historik të votave, 536, kur u votua në tërësi, dhe vetëm 54 vota kundër, të cilat ju i dini se nga vijnë, janë parti kryesisht të ekstremit të djathtë, që kanë një qasje tjetër ndaj zgjerimit të BE-së. Mesazhi kryesor që çdo shqiptar ka nevojë të dëgjojë ishte ai që dha raporterja Sanots. Zonja ishte e ngarkuar të bënte raportin dhe tha se Shqipëria po ecën me një shpejtësi të lavdërueshme drejt anëtarësimit në BE dhe se Shqipëria mund të jetë shembulli për të gjitha vendet e tjera të rajonit.

Besoj se nuk ka qenë e largët koha, edhe pse mund t'ju duket shumë një 10-vjeçar, kur Shqipëria nuk ishte shembulli për vendet e tjera të rajonit, madje ishte vendi që kishte mbetur pas vendeve të tjera të rajonit, kurse sot Shqipëria është vendi shembull për vendet e tjera. Unë jua kam thënë shpesh, që ne, pa dallim, të majtë apo të djathtë, i kemi mundësitë të punojmë bashkë, që ta realizojmë këtë aspiratë historike të shqiptarëve.

Pastaj, kur fillon diskutimi për hapësirat e opozitës, meqë e mora dhe fjalën, opozita duhet ta meritojë, ashtu sikurse edhe shumica duhet ta meritojë rolin e vet në këtë sallë, por mos harroni një gjë: këtë e përcaktojnë qytetarët shqiptarë.

Ju, opozita, keni për detyrë që, me shumicën, të përmbyllni disa çështje që janë përgjegjësi e përbashkët. Zgjedhja e Avokatit të Popullit është përgjegjësi e përbashkët, që duhet ta përmbyllim, përndryshe, në raportin e vitit të ardhshëm kjo çështje do të reflektohet si mungesë

e dialogut politik konstruktiv në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe çështje të tjera të ngjashme më këtë, përfshi këtu dhe përfundimet e një grupi pune, që e kemi ngritur me konsensus, për të bërë disa ndryshime, të cilat kanë si qëllim rritjen e efektivitetit të reformës në drejtësi.

Para se të hyjmë në këto diskutime, do t'ju lutesha shumë që të mos i veçonit grupet politike në Parlamentin Europian! Unë jam shumë falënderues ndaj Grupit Parlamentar të Partive Popullore Europiane, por edhe ndaj Grupit Socialist e Demokrat! Në fakt, vota tregon se, me përjashtim të ekstremit, të gjithë të tjerët kanë qenë mbështetës, edhe Renew, edhe të Gjelbërit, si dhe plot deputetë të tjerë që e kanë mbështetur. Jua thashë, më shumë se 90% e Parlamentit Europian e ka mbështetur dhe e ka vlerësuar Shqipërinë në këtë proces të integrimit europian, si asnjëherë. Detyra jonë është të bëjmë detyrat tona të shtëpisë, pastaj secili të lexojë çfarë na takon neve dhe çfarë juve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla!

Jua dhashë fjalën, sepse ishit në listën e diskutantëve. Me fjalën tuaj mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar".

Nismëtare e këtij projektligji është zonja Tabaku, kështu që e ftoj të prezantojë projektligjin.

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Në vjeshtën e vitit 2021, parlamenti shqiptar ngriti një komision hetimor për të hetuar çështjen e inceneratorëve dhe djegësve. Më 23 shkurt ne patëm dëshminë e fundit dhe menjëherë pas mbylljes së punës së komisionit hetimor, ne punuam për të sjellë një paketë ligjore, e cila kishte disa ndryshime, që vinin pikërisht nga puna e komisionit hetimor. Si pjesë e kësaj pakete, në emër të PD-së, prezantova ndryshimet në ligjin për komisionin hetimor, ndryshimet në ligjin "Për partneritetin publik-privat", për koncesionet, si dhe dy ligjet që prezantohen sot: "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar" dhe "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë".

I prezantova në datën 5 dhjetor, po vijmë në fundin e këtij sesioni, dhe tani po e shohin dritën e diellit. Gjatë diskutimeve që patëm në komisionin hetimor, nga të gjitha kompanitë që diskutoheshin në lidhje me inceneratorin e Tiranës, shqetësimi ishte pastrimi i parave. Pas një diskutimi të gjatë me dhomat e tregtisë, me pretendentët, por edhe me individë, kompani e shoqata biznesi, që janë të përfshira në këtë sektor, diskutohej fakti që sot qyteti i Tiranës është një nga qytetet kryesore të përmendura për pastrimin e parave lidhur me industrinë e ndërtimit.

Unë kam prezantuar dy ndryshime kryesore në këtë projektligj, bazuar edhe në disa praktika që i ndjekin edhe vende të tjera të BE-së. Pse lindi nevoja? Lindi sepse në Tiranë, pothuaj nga 141 kompani, të cilat kanë marrë leje ndërtimi, 60% e tyre nuk i kanë burimet e mjaftueshme financiare për të realizuar një projekt, ndërkohë që 60% e vlerës së ndërtimeve mendohet se vjen nga paratë e pista. Kjo do të thotë se zyrtarisht 6 në 10 kompani pastrojnë para kur ndërtojnë në qytetin e Tiranës, pra paratë që investojnë këto kompani në qytetin e Tiranës janë para të pista. Ky është problem real për ekonominë shqiptare, sepse është duke e nxjerrë nga tregu biznesin tradicional, sepse po ndikon, pak a shumë, që të rritet çmimi i këtyre ndërtimeve, se po rrit koston për shtresën e mesme, duke krijuar një zinxhir problemesh, që sot besoj se janë shqetësimi kryesor i të rinjve, të cilët, për këto arsye kryesore, e kanë të pamundur të investojnë në një pronë, kryesisht në qytetin e Tiranës, por edhe në qytete të tjera.

Prokurori i Përgjithshëm në këtë parlament dhe në Komisionin e Ligjeve deklaroi se çështja e pastrimit të parave është problemi kryesor dhe se fatkeqësisht në Shqipëri kompanitë e ndërtimit pastrojnë para, dhe ai ngriti duart. Çfarë mund të bëjë sot qeveria shqiptare, kur prokurori i Përgjithshëm ngre duart lart, duke e pranuar që pastrohen para në ndërtim, pastrohen edhe në turizëm, të financuara dhe të mbështetura njëkohësisht edhe nga përjashtimet fiskale që ka bërë qeveria shqiptare, madje edhe në lojërat e fatit?! Do ta shihni se çfarë do të ndodhë me ligjin e lojërave të fatit, kur t'i legalizoni, pasi i hoqët nga tregu të përqendruara tashmë. Ky shqetësim ka ardhur gjithmonë në rritje, duke pasur parasysh faktin që në vitin 2021 pothuajse 3 miliardë euro kanë qenë të ardhurat totale në sektorin e ndërtimit, ndërkohë që fitimet e kompanive të

ndërtimit kanë rënë nga 18% në vitin 2010, në 11,3% në vitin 2021, në një periudhë dhjetëvjeçare, që tregon jo vetëm se pastrohen para, por edhe informalitetin e lartë që ekziston në këtë sektor dhe pamundësia, paaftësia, për të mos thënë bashkëpunimi dhe korrupsioni i institucioneve shtetërore për të mos e kontrolluar këtë sektor, e ka lënë atë jashtë vëmendjes së kontrollit publik.

Sot ndërtimi është sektori që ka rritjen më të madhe në prodhimin e brendshëm bruto. Sot ndërtimi zë pothuajse 11% të prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që turizmi zë 17% dhe bujqësia zë 20%.

Në rritjen e produktit të brendshëm bruto që patëm këtë vit, shitja e pasurisë së paluajtshme ishte me rritjen më të lartë 11%, çka do të thotë se ky është një sektor, që, megjithëse nuk ka një model zhvillimi, megjithëse ka para të pista, megjithëse ka informalitet, megjithëse sot ia ka nxirë faqen Shqipërisë në të gjitha raportet ndërkombëtare, sot ndodhemi në Listën Gri të pastrimit të parave vetëm si rezultat i shqetësimit me pastrimin e parave në sektorin në ndërtimit, përsëri, përsëri, ky sektor është në rritje. Nga vjen kjo rritje? Nga vijnë këto para?

Kur vijnë këtu kolegë të huaj, siç, në fakt, kur erdhi herën e fundit këtu komisioni parlamentar i MSA-së nga Parlamenti Europian, më bënë një koment shumë interesant: "Ju këtu, bashkë me Tiranën, paskeni edhe Manhatanin". Pra, edhe atyre u bëri jashtëzakonisht shumë përshtypje ndërtimi i pakontrolluar në qytetin e Tiranës, duke mos e justifikuar me nivelin e jetesës, me të ardhurat mesatare, me pagën, po njëkohësisht edhe me të ardhurat që sjell në buxhet ky sektor, kështu që njohja reale e shqetësimit të pastrimit të parave në sektorin e ndërtimit mendoj se duhej të kishte një përgjigje imediate nga ana e qeverisë.

Ne, si opozitë, kemi miratuar të gjashta ligjet e nevojshme për taskforcën në kuadrin e detyrimeve që lindën pas përfshirjes së Shqipërisë në Listën Gri të pastrimit të parave. I kemi miratuar me të dyja duart. Çfarë ka ndryshuar në realitet? Çfarë ka ndryshuar në praktikë?

Kemi miratuar ligjin për personat e ekspozuar politikisht. Çfarë ka ndryshuar? A i ka identifikuar ky ligj pronarët e vërtetë të inceneratorëve? E kam thënë këtu kur është miratuar ligji para një viti, po e them edhe sot përsëri: çfarë ka ndodhur në praktikë? Si e ka ndryshuar ky ligj pastrimin e parave?

Kemi miratuar edhe ligjin për pronarët përfitues. Çfarë ka ndodhur realisht në terren? A e ka stopuar pastrimin e parave? Jo, përkundrazi, fenomeni është gjithmonë e më shumë në rritje.

Për këtë arsye ne, kur diskutojmë për shqetësimin e pastrimit të parave, lidhjen e tij me ndërtimin, sigurisht që e lidhim edhe me Listën Gri të pastrimit të parave. Këto shqetësime në rritje na kanë bërë të mendojmë se ka nevojë për ndryshime në këtë fushë në ligjin "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve, me shumë bashkëpunim, i thashë edhe relatorit, zotit Majko që, në qoftë se këto ligje nuk e gjejnë vendin këtu, por gjejnë vend në një rregullim tjetër ligjor, unë tërhiqem dhe bashkërisht mund ta bëjmë këtë ndryshim. Rëndësi ka të ekzistojë vullneti, por vullnetin nuk e jep opozita, vullnetin e jep qeveria, vullnetin e jep mazhoranca.

Në qoftë se qëllimi është i mirë për t'i bërë këto ndryshime, hajdeni ta gjejmë bashkë mundësinë që kështu siç janë këto ndryshime t'i paraqesim në një amendim tjetër, në një ligj tjetër, qoftë edhe tek ai për pastrimin e parave. Por unë nuk bie kurrsesi dakord që ne këto ndryshime t'i bëjmë pjesë të një marrëveshjeje rutinë të një institucioni varësie.

Cilat janë dy ndryshimet që ne kemi paraqitur?

Projektligji parashikon se "Autoriteti përgjegjës për lëshimin e lejes së ndërtimit duhet të mbartë detyrimin për të verifikuar dorëzimin e raportit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave". Me pak fjalë, çdo kompani që do të marrë një leje ndërtimi në Tiranë, përveç 8%-shit, që duhet ta paguajë si pjesë e detyrimit për taksën e infrastrukturës në Tiranë, maksimumi, duhet patjetër që për vlerën e investimit të dorëzojë edhe një raport se si do të jetë ndarja e shpenzimeve.

Për këtë qëllim, Autoriteti mund të kërkojë edhe ndihmën e organeve të specializuara, siç mund të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Mosdorëzimi i raportit ose paaftësia e subjektit për të justifikuar të ardhurat, përbën shkak të ligjshëm për refuzimin e lejes së ndërtimit. Në këtë mënyrë, ligji përmban mekanizma efektivë për të parandaluar që këto burime të pajustifikuara dhe këto para informale

të hyjnë në ekonominë formale ose, ndryshe, të kthehen në investime në sektorin e ndërtimit.

Ky është hapi i parë që kemi parashikuar dhe si hap i parë, sigurisht, nuk pretendojmë që një kompani e cila do të ndërtojë në Tiranë, duhet patjetër të ketë iks milionë euro që në momentin e parë që fillon investimi. Këto mund të jenë të shprehura në kontrata kleringu, në kredi bankare dhe në të gjitha format e mundshme përmes të cilave mund të bëhet një investim ndërtimi, por duhet me patjetër t'i ketë të justifikuara.

Nga një komunikim zyrtar që kam pasur me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, kur e kam pyetur për burimin e parave që sot hidhen në ekonomi, se a vijnë këto nga burimet bankare ose jo, përgjigjja e tij ishte shumë shqetësuese: "Paratë që hidhen sot në sektorin e ndërtimit vijnë nga burime jobankare", gjë e cila do të thotë që sot ndërtimi po përdor sektorin informal dhe paranë e zezë, që vjen nga krimi i organizuar dhe nga korrupsioni.

Ditët e fundit jemi njohur të gjithë me pasuritë e vendosura nga korrupsioni nga zyrtarë të këtij parlamenti në fushën e ndërtimit, në leje ndërtimi, të cilët i kanë përfituar duke marrë favore. Pse nuk e ka identifikuar qeveria shqiptare? Pse nuk ka ngritur mekanizmat qeveria shqiptare?

Dua të ndalem pak te një denoncim i veçantë, që e kam bërë këtu e disa vite më parë në lidhje me Unazën e Re të Tiranës, ku një leje ndërtimi u dha mbi një tokë të privatizuar nga një biznesmen, i cili ndryshoi projektin e Unazës së Re të Tiranës, ndërtoi një investim prej 60 milionë eurosh dhe që, në këmbim të këtij privatizimi, i dha (siç thotë dosja e SPAK-ut) ish-zëvendëskryeministrit, ish-ministrit të Financave, ish-ministrit të Ekonomisë një përfitim financiar me një vilë në Jug të vendit. A e identifikoi qeveria shqiptare këtë rast?

Situata është e tillë që unë jam paditur për shpifje nga biznesmeni, nga zoti Edmond Bego. Unë sot jam në gjyq me Edmond Begon, sepse e kam denoncuar këtë, ndërkohë që ish-zëvendëskryeministri, ish-ministri i Ekonomisë, ish-ministri i Financave, ish-ministri i Rindërtimit, pasi i kaloi të gjitha hallkat qeveritare të kontrollit të pasurisë e me radhë, mori në këmbim një vilë në Jug të vendit, ashtu siç pretendon SPAK-u dhe që sigurisht është ende për t'u vërtetuar.

Propozimi i dytë që kam bërë në këtë projektligj është se jo vetëm në momentin e parë duhet bërë një kontroll për verifikimin e burimit të të ardhurave, por edhe në momentin kur subjekti kërkon të pajiset me certifikatën e përdorimit.

Subjekti ka detyrimin që, krahas deklaratës së përputhshmërisë, të paraqesë edhe një raport të detajuar të të ardhurave. Ky raport përmban vlerën totale të investimit të kryer, totalin e të ardhurave të përdorura, duke specifikuar zërat konkretë. Pra, në qoftë se në hapin e parë kishte një raport parashikimi, në momentin e dytë është një raport fakti, ku duhet të specifikohen të ardhurat e vetë subjektit, hua, kredi, kontrata blerjeje, kontrata kleringu e të tjera.

Subjekti ka detyrimin që të justifikojë ligjshmërinë e të ardhurave të përdorura për realizimin e ndërtimit. Nëse subjekti nuk arrin t'i justifikojë të ardhurat, autoriteti përgjegjës mund të vendosë konfiskimin e ndërtimit, në raport me pjesën që rezulton e pajustifikuar me burime të ligjshme.

Nga ndryshon ky propozim nga ai që bën qeveria sot, që konfiskon ndërtimet pa leje? Po, ka një ndryshim në filozofi. Në qoftë se ne këtu kemi propozuar që kjo duhet parandaluar, pra se nuk duhet lejuar ndërtimi pa leje që në mes të Tiranës, të Durrësit, të Fierit, të Vlorës, të ngrihet një investim që të ketë 6 kate shtesë, që më vonë të konfiskohet dhe t'i jepet e drejta atij që ta legalizojë, ne e parandalojmë këtë gjë.

Unë besoj se të dyja propozimet që Partia Demokratike ka bërë, janë reale, janë konkrete, të cilat, nga njëra anë, u vendosin një kufizim ndërtuesve dhe, nga ana tjetër, u japin vlerë edhe atyre kompanive që janë 30 vjet në treg e që janë duke dalë nga tregu, edhe atyre kompanive që punojnë me para të ndershme, po edhe atyre që nuk pastrojnë paratë e krimit dhe korrupsionit. Sot ka shumë të tilla që kanë dalë, fatkeqësisht, nga tregu, sepse këto para nxjerrin këdo nga tregu. Këto para nxjerrin biznese të mëdha nga tregu. Këto para sot, fatkeqësisht, janë në 40% të ekonomisë dhe i kanë zënë frymën çdo biznesi tjetër të ndershëm!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Përllumbi, dëshironi të shprehni një mendim për propozimin apo kalojmë te diskutimet?

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, të dyja nismat ne i kemi diskutuar me shumë vëmendje dhe me seriozitet, por më vjen shumë keq që dëgjova nga kolegia të etiketonte shumicën e kompanive shqiptare dhe të investitorëve si njerëz të cilët duhet të tregohen me gisht, sepse pastrojnë para apo...

(Deputetja Tabaku flet nga vendi, pa mikrofon.)

Thatë se "6 nga 10 kompani pastrojnë para", thatë se "60% e kompanive të ndërtimit në Shqipëri merren me pastrim parash", për më tepër vutë në gojën e Guvernatorit të Bankës një shprehje, që unë nuk besoj kurrë që ta ketë thënë.

Gjithçka që investohet në sektorin e ndërtimit kryhet nëpërmjet transaksioneve bankare, të gjitha faturat me klering ose pa klering janë fatura që lëvizin nëpërmjet llogarive bankare dhe është krejtësisht e pamundur që 6 kompani në 10 të mund të bëjnë pastrim parash.

Ka njerëz që janë në këtë fushë prej 30 vjetësh, ka investitorë shumë të rëndësishëm që kontribuojnë në ekonominë e këtij vendi dhe më vjen shumë keq, zonja Tabaku, që këta njerëz ju t'i etiketoni si njerëz që merren me pastrim parash.

Si në çdo sektor të ekonomisë, ndoshta edhe në sektorin e ndërtimit mund të ketë infiltrime të parave nga burime të panjohura ose të padeklaruara, por ju jeni ekonomiste dhe duhet ta dini se, që të ketë pastrim parash, duhet që personi të ketë emrin aty dhe unë nuk e di se si mund të pastrohen paratë ndryshe, e kam thënë edhe një herë tjetër, në qoftë se personi i cili i ka këto para nuk ka emrin e vet, ky është pastrimi i parave dhe mos e ngatërroni Listën Gri me këtë gjë.

Sa më shumë ne flasim, sa më shumë ne e nxijmë ekonominë tonë, sa më shumë ne bëhemi xhelozë për rritjen ekonomike të këtij vendi, të jeni të bindur se aty në Listën Gri do të ngelemi, në qoftë se nuk mendojmë ndryshe.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Po, zonja Tabaku. Besoj që fjalën e kërkuat për replikë.

Jorida Tabaku – Po.

Zoti Pëllumbi, unë ju vlerësoj dhe ju falënderoj që komisioni juaj i filloi i pari diskutimet për këtë projektligj, edhe për diskutimet konstruktive që ne patëm.

Në fakt, në këtë komision unë pata diskutime edhe në përmbajtje.

Së dyti, unë nuk e besoj që ju e bëni këtë gabim dhe i citoni keq kolegët. Raporti i *Transparency International* thotë: "Në 144 kompani që fituan leje ndërtimi në masën 59%-60% të tyre nuk kishin burime financiare të mjaftueshme për realizimin e projekteve", këtë e kam cituar dhe e them prej muajsh.

Zoti Pëllumbi, nuk e ka fajin opozita që sot Shqipëria është në Listën Gri.

Nuk e ka fajin opozita që sot nuk ka rritje ekonomike në bujqësi.

Nuk e ka fajin opozita që sot situata në ekonomi është e tillë.

Ne po bëjmë një propozim. Unë nuk besoj që ju shkon juve apo kujtdo tjetër në këtë parlament që të thotë: jeni ju xhelozë nga rritja ekonomike.

Të flasim normalisht. Ka një propozim opozita se si ta zgjidhim këtë çështje.

Meqenëse ankoheni dhe na thoni që vetëm kritikojmë, ja ku e keni një zgjidhje, hajdeni votojeni. Kjo nuk është vetëm çështje e një qëllimi të mirë.

Jam shumë dakord të marr parasysh sugjerimet e kolegëve Majko dhe Braçe, që nuk është sot këtu, të shohim vlerën e investimit, sepse mund të ketë investime në bujqësi, në fshat, të cilat nuk kanë pse të jenë pjesë e këtij procesi që unë kam parashikuar.

Mund të shohim vlerën për disa sektorë të tjerë. Nga të ardhurat, zoti Majko përmendi Veriun e vendit. Por të thuash që opozita është xheloze nga rritja ekonomike...

(Bie gongu.)

...unë nuk di çfarë emri t'i vë. Sepse që të jemi ne xhelozë që sot shqiptarët po vuajnë, nuk e di ku e keni parë dhe dëgjuar ndonjëherë.

Në qoftë se doni, në qoftë se keni vullnetin politik, hajdeni shikoni propozimet që ne kemi bërë dhe hajdeni t'i votojmë, pa asnjë kompleks edhe me ndryshimet që ka propozuar zoti Majko dhe zoti Braçe.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Vijojmë me diskutimet.

Fjalën e ka zoti Laert Duraj.

Të përgatiten deputetët Dashamir Shehi dhe Asllan Dogjani.

Laert Duraj – Në komisionin tonë projektligji dhe nisma e koleges Tabaku u

diskutua me një vëmendje të veçantë, nisur edhe nga fakti që sektori i ndërtimit është një nga sektorët kyç të zhvillimit të ekonomisë shqiptare.

Sigurisht, siç edhe u përmend, diskutimet ishin qoftë në formë, qoftë në përmbajtje, por në fund të diskutimeve ne, si shumicë, gjykojmë që legjislacioni aktual është më se i mjaftueshëm për ta realizuar qëllimin e tij në lidhje me parandalimin e përdorimit të parave të paligjshme në sektorin e ndërtimit.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që, nëse dikush do të përfshihet në transaksionin e shitblerjes së një prone do të kalojë tashmë kohët e fundit në hallka shumë të rrepta, sidomos tani që certifikata e pronës është digjitale, patjetër transaksioni është bankar dhe së fundi, roli i shtuar i noterit kanë bërë të mundur që të ketë një kontroll shumë të plotë dhe efikas ndaj të gjithë procesit.

Ndërkohë, janë marrë edhe masa të tjera nga ana e qeverisë që kanë të bëjnë me agjentët imobiliarë, të cilët tashmë certifikohen dhe kanë një përgjegjësi e detyrim ligjor që edhe ata të bëhen pjesë e këtij procesi. Sigurisht, ne e dimë që ka ekonomi informale, por qëllimi dhe puna e përditshme është që ky proces të jetë sa më kontrollues dhe sa më evidentues i problemeve që mund të shfaqen.

Ndërkohë, gjatë diskutimeve në komision, nga ana e përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave na u bë me dije fakti se mekanizmi që operon në vendin tonë është shumë i ngjashëm me mekanizmin e vendeve të tjera të Bashkimit Europian dhe pothuajse çdo hallkë e tij raporton në formën dhe në mënyrën e duhur për të diskutuar dhe për të marrë masat e duhura për rastet që evidentohen.

Gjithashtu, gjatë diskutimeve që u bënë në komision u vu në dukje edhe fakti që mungojnë instrumentet ligjore që organeve të pushtetit vendor t'u jepen kompetencat e duhura, që edhe ata të përfshihen në këtë proces për të implementuar këtë propozim apo këtë projektligj që zonja Tabaku ka paraqitur.

Si përfundim, megjithëse ne e vlerësuam punën e bërë nga zonja Tabaku, ne si komision gjykojmë që ekzistojnë mekanizmat e duhur ligjorë për të kontrolluar, eliminuar dhe frenuar fenomenet që janë tashmë një shqetësim për të gjithë ne.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duraj! Zoti Shehi, fjala është për ju.

Dashamir Shehi – Të nderuar kolegë,

Ndryshimet në ligjin "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" janë në drejtimin e duhur, në kuptimin për të parandaluar pastrimin e parave në këtë sektor, që është realisht një problem.

Kush mendon që këtu nuk po ndodh ky fenomen, është si puna e asaj që, ujku po e hante atë delen, dhe thotë: "Ej, Zot, bëje ëndërr", por kam frikë se kjo është kaq e dukshme dhe kaq e qartë, saqë këto shtesa që bëhen mbi ligjin, që sigurisht janë një burokraci e shtuar, po ta mendojmë kështu në planin e letrave, por nuk kemi rrugë tjetër.

A do të mjaftojnë këto për ta zgjidhur problemin? Jo, në njëfarë mënyre këto do ta zvogëlojnë problemin, do të bëjnë që ata të cilët merren me këtë punë të fillojnë të mendohen dy herë, se mund t'u dalin letrat gjatë rrugës. Por unë mendoj se problemi është shumë më i madh se kaq dhe kalon përtej problemit të administrimit të territorit e çështjes së ndërtimit.

Problemi është puro financiar. Po ta marrim në bilancin e përgjithshëm të të ardhurave dhe të shpenzimeve, të asaj që harxhohet në këtë sektor, të asaj që tepron nga ky sektor, të diferencialit të çmimeve brenda katër-pesë vjetëve, të gjithë e kuptojnë që këtu ka një masë parash që e ushqen sektorin, që në rrethana të tjera do të ishte lumturi e madhe. Ama, të mos harrojmë që këto para, të cilave disa u thonë gri, por të zeza janë shumica, me thënë të drejtën (se gri janë ato prej të cilave nuk janë paguar taksat, gri janë ato të cilave u janë fshehur të ardhurat), por shumica janë të zeza... Sepse që të hidhen me kaq lehtësi dhe çmimet të ndryshojnë me kaq shpejtësi...! Vetëm para të fituara në mënyra të tjera hidhen në këtë sektor, blihen imobiliare, të cilat shpeshherë janë bosh, ore, dhe të gjithë e dimë...

Shqipëria jonë, nga 3 milionë e ca që ishte, po bëhet 2 milionë e gjysmë. Këtu rendi i blerjeve të imobiliareve është treguesi më në rritje se çdo gjë tjetër dhe nuk ka absolutisht asnjë lloj fenomeni që i justifikon përveçse kësaj, pra pompimit të milionave e milionave që vijnë nga jashtë territorit të Shqipërisë.

Sigurisht, djemtë e Shqipërisë janë ata djemtë problematikë, që thoni ju.

Të gjithëve u vjen mirë kur ndërtohet, kur fitohet, kur shitet, kur blihet, sepse sigurisht që mbajnë, ushqejnë këto. Përqark sektorit të ndërtimit vjen vërdallë një industri tjetër shërbimesh, nga mobiljet, nga perdet, nga enët e kuzhinës. Të gjitha këto do të pajisen dhe të gjithëve na pëlqen që po ndodh ky fenomen, që shyqyr që shqiptarët po pasurohen. Madje, po ta bësh këtë koment, të ofrojnë edhe një analizë tjetër dhe të thonë: ore, pse ngatërrohesh me këtë punë?! Shyqyr që po punojnë.

Mirëpo ky peri diku do të këputet, diku do të shpohet kjo tullumbace dhe efektet do të jenë shumë më negative nga ato që kemi përfituar deri më sot.

Kështu që unë, përtej burokracisë, do t'i aprovoja këto dy ndryshime.

Ta thashë, do të krijojnë probleme për një pjesë të ndërtuesve. Absolutisht, nuk dua t'i përziej të gjithë ndërtuesit, sepse gjykoj që shumica janë njerëz që duan të punojnë, por të mos harrojmë që edhe shumica e ndërtuesve janë të gjithë keq për para, sepse sistemi i kreditimit në Shqipëri është i tillë, me norma kaq të larta interesash, sistemi i *mortgage*-it nuk funksionon fare, që ta ushqente në mënyrë të ligjshme këtë sektor që të ndërtonte dhe qytetarët të blinin, të kishin mundësi t'i shlyenin banesat e veta.

Prandaj i drejtohem këtij lloj sektori, madje i bëra një sugjerim Guvernatorit të Bankës, kur erdhi kësaj here në komision, sepse tha: "Ne do ta bëjmë rritjen e normave të interesit, praktikisht koston e lekut, do ta rrisim në funksion të inflacionit meqë kjo është mënyra për të bllokuar inflacionin". Është vërtet kjo, por nuk është e vetmja mënyrë për ta bllokuar inflacionin, sepse kjo është një mënyrë që, përveç inflacionit, bllokon edhe ekonominë dhe sa herë që do të rritet kostoja e lekut, pra kostoja e kreditimit, aq herë do t'i drejtohet tregu i punës, tregu i biznesit, i kapitalit, i investitorëve, parasë së zezë. Sepse do të jetë shumë më normale t'i mbajmë interesat e ulëta (dhe më bëhet qejfi që ministrja e Financave është këtu, ta dëgjojë këtë lloj arsyetimi që kam unë) që njerëzit të shkojnë të kreditohen në bankë në mënyrë të ligjshme.

Në qoftë se interesat do të jenë të tilla, për sektorin e ndërtimit do t'i drejtohen gjithmonë parasë së zezë, sepse është me kosto më të ulët sot. Madje, në disa raste është edhe fitimprurëse, sepse ata që pastrojnë paranë të japin 100 lekë, por 80 i duan mbrapsht të pastra, nganjëherë edhe 70 i pranojnë, prandaj edhe turren të gjithë me shumë qejf drejt këtij sektori, në qoftë se ne këtu nuk prodhojmë një legjislacion që jo thjesht i mbyll rrugën kësaj pune në mënyrë burokratike, duke shtuar pengesat dhe por duke u hapur rrugë sektorëve prodhues të kenë akses te krediti me çmime më të ulëta, me kosto më të ulët të lekut, me interesa më të ulëta. Kjo është rruga, në njëfarë mënyre, për ta bllokuar këtë sektor.

Pastaj këtu, meqenëse po flasim për territorin, duhet të kujtoj edhe diçka tjetër, që del përtej kësaj pune; po kthehet administrimi i territorit në mënyrë klasike. Ore, keni dëgjuar ndonjëherë ju që bashkitë e Shqipërisë, qeveria shqiptare, bën më plane urbanistike, bën studime për qytete, të ketë përcaktuar normativa ndërtimi? E gjithë kjo është lënë në dorë dhe në ekskluzivitet të kryetarëve të bashkive dhe të qeverisë qendrore këtu në Tiranë për zonat më me rëndësi: qendra e Tiranës, zonat e Bregut, të cilat, në mënyrë administrative, nga Tirana, me drejtori, me sektorë specifikë e kontrollojnë praktikisht ndërtimin e territorit, atje mbi të gjithë territorin.

Nuk kemi plan! A ka Tirana plan urbanistik, që përcakton se te kjo zonë do të ndërtojmë 10 kate, te këto zonat e tjera 5 kate, kjo zona tjetër do të mbetet e gjelbër? Jo, sepse askujt nuk i pëlqen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku është? Si është? Ku, mor, ku?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, mor, ma trego!

Jo, mor, sa vite?! Është plani...

Po, mor, po. Në cilin vend është e përcaktuar me kate?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, mor, ma thoni!

Ore, absolutisht, e gjithë zona, qendra e Tiranës është ekskluzivitet i Kryeministrit dhe i kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

U teket, e bëjnë 30 kate, si këtu përballë Kuvendit. U teket, e lënë 5 kate.

Ku qenka ky plan që e përcakton zonën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, mor, zotëri, nuk ka fare. Dhe jo vetëm që nuk ka fare, por edhe atë gjysmë që qe ndërtuar, dhe një herë qe zvicerane, pastaj u bë franceze, edhe ajo nuk zbatohet sot.

Edhe po ta shihni, në qoftë se vijat, pikat që ishin përcaktuar edhe në atë kohë, 20 vjet më parë, kullat që do të ndërtoheshin në Tiranë, i ndërtojnë,

i zgjerojnë, i bëjnë ku të kenë qejf. Pse? Se ky është domeni i madh që ka sot qeveria, praktikisht Kryeministri, personalisht. Kupton ti?

Kështu që, po të më thoni ju se ka plan urbanistik Tirana dhe zbatohet, jo vetëm Tirana, po edhe qytetet e tjera... A ka plan Bregu, Jugu i Shqipërisë se si do të ndërtohet? Ku është zona e gjelbër? Ku do të ndërtohet...?

Kjo lloj varësie që ka nga administrata sot i gjithë sektori, nuk ka edhe siguri se sa kate do të shkojë, sepse disa fillojnë me 5 kate e shkojnë me 7, me 8 kate, se do t'i legalizojnë nga mbrapa. Ky është fenomen që ka ndodh përditë, me vite e me dekada, fatkeqësisht vazhdon edhe sot, prandaj unë do të thosha që duhet të ketë kontroll financiar dhe kontroll real mbi territorin.

E filloi mirë një herë zoti Kryeministër, prishi disa dhe menduam që po vihet më në fund një lloj rregulli në këtë sektor. Absolutisht, interesat janë kaq të mëdha, bizneset janë kaq të mëdha, presionet janë kaq të mëdha, saqë sot jemi të gjithë të hapur. Po të kesh disa miq aty brenda, e bën kullën si të kesh qejf, si në Hong-Kong.

Kështu që, ky është realiteti në sektorin e ndërtimit. Kush bën sikur nuk e kupton, unë them që...

(Bie gongu.)

...nuk duhet ndonjë inteligjencë e madhe, ndonjë informacion i madh për të kuptuar se sektori është fitimprurës, sektori është në bum në këtë moment, për të qenë realist, por në qoftë se sektori nuk kontrollohet qoftë për burimet financiare, qoftë për planet rregullatore, do ta shikoni që ky sektor do t'i kthehet mbrapsht Shqipërisë në vitet që vijnë.

Ja, kaq desha t'ju thosha.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehi!

Fjala është për ju, zoti Dogjani.

Asllan Dogjani – Faleminderit, e nderuar zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Aq shumë afera korruptive dhe ngjarje ndodhin në këtë vend, saqë po të kishim seanca plenare përditë ne, deputetëve, nuk do të na dilte koha të merreshim me të gjitha.

Sot kemi një zëvendëskryeministër që ka marrë arratinë dhe nuk dihet se ku është, kemi disa ministra në burg, kryetarë bashkish dhe të gjitha këto ndodhin dhe bëhen nën regjinë e Kryeministrit. Them "nën regjinë e Kryeministrit", se kush e beson sot që Arben Ahmetaj mundi të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë në qoftë se nuk do të donte Kryeministri apo Policia e Shtetit?

Kush e beson në këtë vend, që mund të vidhen nëpërmjet tenderëve korruptive, inceneratorëve, 420 milionë euro dhe Kryeministri nuk di asgjë? Sigurisht, ne të gjithë e dimë se ai merret me detaje dhe di çdo gjë që bëhet në këtë vend, por nëpër tavolina dëgjojmë që Kryeministri u thotë: "Vidhni sa të mundni, se nuk mbahet pushteti dhe nuk merret pushteti pa para dhe banditë. Ama, po ju kapën, nuk kemi çfarë t'ju bëjmë. Po ju kapën, do ta hani". E dikujt ia fut, e dikujt ia nxjerr dhe kështu vazhdon me orgjinë e tij, dhe qytetarët vuajnë.

Por ka edhe ngjarje që i dalin jashtë kontrollit. Konkretisht, disa ditë më parë ndodhi një ngjarje shumë e rëndë, një nga ngjarjet më të rënda, një ngjarje e tmerrshme: ditën për diell, e pamë ne, e panë qytetarët shqiptarë, e pa e gjithë bota se si një grup banditësh, të afërm të deputetit Rraja, sulmuan me hunj, me armë, dy banorë të fisit Maja në fshatin Borizanë. Sulmi erdhi vetëm përse këta banorë kishin denoncuar në Policinë e Shtetit se nga shpërthimi i minave në një gurore aty pranë po u dëmtoheshin shtëpitë.

Dhuna ishte aq e pamëshirshme, saqë edhe kur personat ishin rrëzuar përtokë dhe nuk kishin asnjë lloj mundësie të reagonin, goditeshin me hunj dhe me pistoletë nga koka te këmbët, në trup e gjithkund ku kishin mundësi për t'u rënë.

Fatmirësisht, ata dy burra shpëtuan, por nga ajo dhunë edhe mund të kishin vdekur, sepse sulmi ishte i tmerrshëm, maksimal dhe i pamëshirshëm.

Fatmirësisht, falë medies kjo ngjarje u bë publike dhe pati një reagim publik të jashtëzakonshëm. Përndryshe, sot do të ishim në të njëjtat kushte: në gurore do të vazhdohej të punohej dhe banditët do të kishin rrahur edhe ndonjë tjetër, madje të gjithë ata banorë të Borizanës do të ishin detyruar të largoheshin, t'i linin shtëpitë e tyre, sepse nuk kishin asnjë lloj rruge.

40 kallëzime ishin bërë nga banorët e fshatit Borizanë në Policinë e Shtetit, të cilat kishin shërbyer jo për të marrë masa në ndihmë të banorëve, por për t'i kërcënuar ata se po kryenin një vepër penale duke protestuar për të drejtat e tyre për shkak se po u prisheshin shtëpitë.

Sot jemi në të njëjtat kushte. Mafia nuk ka brirë, kolegë deputetë. Kjo është mafia: merret një licencë në kundërshtim me ligjin, vetëm pse janë njerëzit e deputetit; paguhen dhe kërcënohen policë; plasin mina orë e pa orë në mënyrë të pakontrolluar, duke dëmtuar shtëpitë e banorëve të fshatit; rrihen dhe dhunohen në mënyrë shtazarake banorët; publikohen pamjet nga vetë autorët, duke përcjellë një mesazh jo vetëm tek ata banorë, por tek të gjithë qytetarët shqiptarë, që në Shqipëri sundon i forti, banditi, krimineli, pisi dhe mashtruesi. Në fakt, kjo është situata në të gjithë Shqipërinë.

Qytetarët tanë janë të pambrojtur, janë nën kërcënimin e krimit dhe, fatkeqësisht, nuk gjejnë mbrojtje te Policia e Shtetit. Ata nuk kanë një derë ku të ankohen, por edhe kur ankohen, kërcënohen se po kryejnë vepër penale.

Sapo një qytetar del nga shtëpia, përballet në derën e pallatit me të rinj nën efektin e lëndëve narkotike, nuk ka ku të parkojë, ndërkohë që gangsterët lëvizin me makina me xhama të zinj dhe mund të të shtypin edhe në trotuar. Persona të armatosur qarkullojnë me makina me xhama të zinj, duke i lënë ato kryq e tërthor, ndërkohë që policët nuk guxojnë t'i ndalojnë, kurse një fakiri që nuk ka ku të parkojë makinën i vendosin 30 mijë lekë gjobë. Kjo situatë në vendin tonë ka bërë që shumica e qytetarëve të largohen nga Shqipëria.

Jo vetëm qytetarët, por edhe Policia e Shtetit është nën presionin e krimit dhe politikës. Praktika ka treguar, siç ishte rasti i Krujës, që oficeri i policisë u kërcënua po nga ky fis dhe në zyrën e tij u nxor pistoleta. Për këtë arsye oficeri u detyrua të largohej dhe sot është në azil. E njëjta situatë ndodhi edhe me Zaganin.

A nuk është ky një mesazh që e ul në gjunjë Policinë e Shtetit? Sot Policia e Shtetit është e ulur në gjunjë përballë krimit. Ajo nuk guxon të reagojë dhe veprojë, sepse do t'i duhet të përballet me raste si i Nuit dhe Zaganit.

Duke qenë në këto kushte, Policia e Shtetit ka gjetur një rrugëzgjidhje tjetër: më mirë të mos përballet me krimin, të marrë disa para kur është rasti dhe të bëjë sikur punon. Kaq duhet të kishte mjaftuar që sot ne si parlament të diskutonim për këtë situatë kriminale; kaq duhet të kishte mjaftuar që ne sot të analizonim si është marrë ajo licencë, si është dhënë ajo licencë, pse është katandisur policia në këtë gjendje të mjerueshme dhe pse qytetarët tanë janë të pambrojtur dhe nën kërcënimin e banditëve, hajdutëve, kriminelëve, rrugaçëve dhe mafiozëve.

Nuk zgjidhet problemi i rendit dhe sigurisë publike me heqjen dhe vënien e një ministri. Pavarësisht se do ta votoj kundër edhe ministrin e ri, sepse nuk besoj se do ta zgjidhë situatën e rendit dhe sigurisë publike, do t'i kërkoj të ketë distancim të menjëhershëm të policisë nga politika, të ketë policë të zotë, profesionistë dhe me dinjitet, të cilët t'u shërbejnë qytetarëve shqiptarë. Personalisht do të bashkëpunoja me cilindo, me qëllim që qytetarët tanë të jenë më të mbrojtur, që qytetarët tanë të jenë më të sigurt për pronën dhe jetën e tyre, që qytetarët tanë të mos kërcënohen, që ata të mos largohen nga vendi.

Në seancën që vjen do të kërkohet të legalizohet kanabisi në Shqipëri. Sigurisht, qëllimi është për përdorim mjekësor, por ne nuk i kemi kapacitetet, se ligjet i kemi. I kemi pasur ligjet edhe për ngjarjen e Fushë-Krujës, edhe që ndalohet kultivimi i kanabisit në Shqipëri, por sot Shqipëria është e mbushur me kanabis. Prandaj, do t'i kërkoj ministrit të japë provën e parë duke mos e miratuar këtë ligj në parlament, sepse është shumë i rrezikshëm dhe i dëmshëm për shoqërinë shqiptare.

Shumë qytetarë sot vuajnë me fëmijët e tyre, të cilët janë nën varësinë e drogës. Duke mos besuar se do ta ndaloj këtë ligj të miratohet në parlament, unë u kërkoj qytetarëve shqiptarë, kujtdo që nuk do që fëmijët e tij të përdorin drogë, të gjithë atyre që nuk duan t'i kenë komshinjtë përdorues droge, të gjithë atyre që duan të kenë një jetë më të mirë, më të sigurt, të gjithë atyre që duan të jetojnë në vendin e tyre, që ditën e enjte të vijnë përpara parlamentit për të protestuar të gjithë bashkë që ky ligj të mos miratohet, sepse, siç e thashë, është një ligj që do të ngelet në histori dhe historia do të na gjykojë, sepse pasojat do të jenë të jashtëzakonshme. Ne nuk e kemi mundësinë për ta mbajtur nën kontroll kultivimin e kanabisit, sepse sot Shqipëria është e mbushur me drogë dhe mijëra familje shqiptare vuajnë për shkak të përdorimit të drogës nga fëmijët e tyre. Jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën ka qindra të rinj shqiptarë, të cilët kanë përfunduar në çmendinë për shkak të përdorimit të drogës.

Në fund dua t'u bëj edhe një herë thirrje të gjithë qytetarëve shqiptarë, që ditën e enjte të

protestojmë të gjithë bashkë përpara parlamentit për të mos e lejuar miratimin e këtij ligji.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Këtu mbyllen diskutimet edhe për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Propozuese e këtij ligji është zonja Tabaku, të cilën e ftoj të bëjë prezantimin e tij. Ndërkohë, të përgatiten folësit e regjistruar për këtë projektligj.

Jorida Tabaku – Do të flas shkurt, sepse mazhoranca sot ka punuar shumë dhe është lodhur.

Në emër të Partisë Demokratike unë kam propozuar disa ndryshime në ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"". Ky ligj duhet të kishte përfunduar në vitin 2018, por është shtyrë katër herë. Të katërta ndryshimet në ligjin "Për investimet strategjike" kanë qenë vetëm për shtyrje afati. Pra, vetëm kanë shtyrë në kohë afatin e dhënies së disa licencave dhe lejeve të reja për investitorë strategjikë.

Pas shumë përpjekjesh, insistimesh dhe debatesh me qeverinë shqiptare, unë kam arritur të marrë emrat e investitorëve strategjikë në Republikën e Shqipërisë. Të gjithë janë investitorë shqiptarë. Përveç tri rasteve investimesh të huaja, që kanë ardhur me fonde të shtuara, por njëkohësisht edhe që kanë rritur punësimin në Republikën e Shqipërisë, gjithë të tjerët janë biznesmenë shqiptarë, të cilët kanë marrë leje për të ndërtuar resorte në Jug të Shqipërisë.

Ky ligj, përveçse e ka banalizuar dhe degraduar qëllimin për të cilin është krijuar, për të tërhequr investime të huaja, është kthyer qartësisht në një ligj klientelist dhe korruptiv. Ne kemi propozuar që ky ligj duhet të përfundojë menjëherë afatin e tij, që duhet të kishte përfunduar në vitin 2018, dhe jemi të gatshëm të ulemi për të diskutuar një ligj që kryen dy qëllime kryesore.

Qëllimi i parë kryesor është *screening* i të gjitha investimeve që vijnë në Republikën e Shqipërisë. Bashkë me kolegë të Komisionit të Integrimit, me zonjën Gjonaj, ne jemi ulur dhe kemi diskutuar gjatë se si mund të pengojmë ardhjen e fondeve ruse apo kineze në Shqipëri dhe se si Parlamenti i Shqipërisë duhet të ketë patjetër mekanizmat që ka sot në Senatin apo Kongresin Amerikan, për të kryer një *screening* të investimeve, që të mos lejojmë fondet e influencave të huaja të vijnë këtu në Shqipëri.

Së dyti, duhet të kemi patjetër një ligj që lejon garën. Gara në ekonomi bën vetëm mirë. Gara vetëm i jep forcë biznesit shqiptar dhe investimeve të huaja, nuk bën asgjë të keqe. Ndërkohë, vendimi i Këshillit të Investimeve Strategjike për ta ndarë Shqipërinë në copa, për të ndarë portet dhe aeroportet, lejet e ndërtimit nga Veriu në Jug e që e kanë mbushur Jugun e Shqipërisë me resorte, që kanë edhe favore fiskale, që nuk sjellin punësim shtesë, që nuk sjellin absolutisht asgjë shtesë për ekonominë shqiptare, duhet të ndalojë menjëherë. Kaq e thjeshtë është. Çdo gjë tjetër, që hap garën, që krijon një ligj integral për investimet, por njëkohësisht u vë fre edhe investimeve, ndikimeve të huaja në Shqipëri, do të mbështetet edhe nga ana jonë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Fjalën e ka zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Siç e përmendi edhe deputetja Tabaku, besoj se juve ju kujtohet fundi i vitit 2021, kur me propozimin e një deputeti të vetëm të shumicës, ju shtytë për herë të katërt afatin e ligjit "Për investimet strategjike". Kjo shtyrje e afatit të ligjit dhe përvoja e zbatimit të tij, nuk kishte dhe nuk ka logjikë të shëndoshë ekonomike.

Ligji nr. 55/2015 "Për investimet strategjike", i ndryshuar katër herë, i njeh statusin "investitor strategjik" çdo subjekti që investon më shumë se 5 milionë euro dhe punëson 80 njerëz, por ky status, që qeveria jep në mënyrë të veçantë në bregdetin e Jonit, ka krijuar konflikte të forta me banorët e bregdetit të Jugut të Shqipërisë, pasi gjurmët e resorteve janë vendosur mbi prona të kontestuara ose prona të gabuara.

Një vit pas ardhjes në pushtet, në vitin 2013, ju miratuat dy ligje: ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike" dhe ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin". Të dy këta ligje kanë në thelb një rishtetëzim tjetër të tokës në bregdet dhe vënien e saj në dispozicion të klientëve afër qeverisë, duke gllabëruar dhe grabitur pronat e banorëve autoktonë. Fondi i tokave në bregdet me mbi 16 milionë metra katrorë nga Vlora në Ksamil, madje

nga Vlora në Butrint, do të jetë në dispozicion të "investitorëve strategjikë", që, në fakt, nuk janë gjë tjetër veçse individë pranë sektit "Rama", oligarkë që e kanë mbërthyer prej fyti qeverinë dhe që me mbështetjen e paligjshme të saj po u grabisin tokën pronarëve të ligjshëm.

Grabitja po bëhet e gjitha nën dritën e diellit me akte ligjore në emër të progresit, integrimit, shtetbërjes, e mbështetur nga propaganda mediatike 3D pranë qeverisë, kurse ju nuk merrni parasysh as investimin e një jete të tërë që kanë bërë banorët e zonës së bregut me ndërtime dhomash, hotele të vegjël apo restorante, të cilat janë të vetmet burime jetese dhe të ardhurash për ta.

Në fakt, pavarësisht qëllimit, që ju e maskuat dhe reklamuat, ligji i tejzgjatur i investimeve strategjike dështoi të thithë investime të huaja dhe kompletoi masakrën me pronat private që krijoi ligji i përbindshëm nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë". Në pamje të parë duket sikur ligji krijon terren të mirë për mbrojtjen e pasurisë publike, por në realitet parashikimet ligjore janë jo të plota, duke bërë që situata të përkeqësohet në raport me të drejtën e gëzimit dhe posedimit të pronës sipas titujve të fituar të pronësisë.

Ligji cenon haptas parimin kushtetues të shtetit të së drejtës, parimin e sigurisë juridike në lidhje me ushtrimin e të drejtave të pronësisë me të gjithë tagrat e saj, parimin e barazisë përpara ligjit, parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, si dhe parimin e konkurrencës së lirë.

Me këtë krijesë ligjore monstruoze askush nuk mund të përcaktojë të paktën ligjërisht nëse një pasuri pronë private e ndodhur në afërsi të bregdetit dhe e përfituar me një nga mënyrat e ligjshme të fitimit të pronësisë, të parashikuar në Kushtetutë, ndodhet ose jo në regjimin e përcaktuar si pronë publike e patjetërsueshme, pjesë e vijës bregdetare, si dhe çfarë do të ndodhë me mënyrën e gëzimit të kësaj të drejte pronësie mbi këtë pasuri, me të gjitha të drejtat që burojnë prej saj. Në të kundërt, në mungesë të një studimi të mirëfilltë tematik për të përcaktuar me material hartografik të gjithë atë pasuri të paluajtshme, që konsiderohet si bregu i detit përgjatë vijës bregdetare të vendit, është e pritshme dhe në praktikë po ndodhin abuzime të mëdha.

Investitorit strategjik i jepet një ndihmë e padrejtë në raport me pronarin e tokës, duke cenuar një nga bazat e ekonomisë së tregut të lirë: pronësinë mbi tokën. Ligji ka dështuar të thithë investime të huaja, duke u përdorur për përfitime nga njerëz të afërt me sektin në qeverisje.

Deputetja Tabaku ju serviri një listë të përfituesve. Ndoshta do të ishte mirë ta lexonte të plotë, që qytetarët shqiptarë ta kuptojnë më mirë që statuset "investitor strategjik", të dhëna mbi bazën e këtij ligji, nuk janë investime strategjike në masën më të madhe të tyre, por janë vjedhje me ligj dhe procedura në kurriz të pronarëve të ligjshëm të tokave në bregdet.

Departamenti Amerikan i Shtetit, të cilin ju keni dëshirë ta citoni, në një raport të fundit për klimën e investimeve në Shqipëri, ka thënë: "Ligji i investimeve strategjike korrupton logjikën investuese dhe nuk është aspak miqësor me investitorët e huaj".

Në fakt, ligji i investimeve strategjike dhe ligji nr. 20/2020 grabisin pronën e banorëve të Jugut. Të gjithë banorët dhe pronarët e ligjshëm të zonës së Bregut rrezikojnë dhe nga dita në ditë po i humbasin pronat e tyre, sidomos ata që i kanë me pamjen dhe pozicionin që u pëlqen investitorëve strategjikë.

Dy VKM-të e nxjerra në dhjetor të vitit 2020, e thonë qartë se në vendet e planifikuara për investime strategjike nuk do të lejohet asnjë legalizim për hotel, biznes familjar apo edhe shtëpi.

Nga këto vendime të qeverisë nuk shpëtojnë dot as ata pronarë, të cilët e kanë objektin të legalizuar apo në proces legalizimi, raste që ne po i shikojmë çdo ditë. Këto objekte shpronësohen me çmimet e vitit 2016, kur toka përgjatë vijës bregdetare nga Orikumi deri në Ksamil nuk e kalonte vlerën e 20 eurove për metër katror. Viktima të saj janë shumë pronarë të ligjshëm, përfshirë edhe ata që mund ta kenë përfituar tokën pas viteve '90, si banorë fshatrash apo punëtorë në ish-kooperativat bujqësore. Unë mund të vazhdoj të flas më shumë për këtë çështje, por druaj se koha nuk më premton.

Gjithashtu, dua të theksoj edhe diçka tjetër, ndaj, ju lutem, kolegë deputetë, nëse keni mundësi, kërkoj vëmendjen tuaj.

Cilat janë në thelb investimet strategjike? Për këtë do të përmend një vlerësim të bërë nga ish-Kryeministri dhe ish-Presidenti Hashim Thaçi në vitin 2008 ose 2009 në Kuvendin e Shqipërisë. Duke folur për rrugën Durrës-Prishtinë, Hashim

Thaçi ka thënë: "Kombi do t'i jetë përjetë mirënjohës Sali Berishës për rrugën Durrës-Prishtinë". Ky është investim strategjik kombëtar, zotërinj deputetë.

Këtë vlerësim e ka bërë, për mendimin tim, një njeri dhe figurë e lartë politike, edhe pse, edhe në ato vite, edhe sot, nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë dashamirësi ndërmjet ish-presidentëve Thaçi dhe Berisha.

Nëse doni ta konkurroni ish-Presidentin dhe ish-Kryeministrin Berisha për sa u përket investimeve strategjike, për të cilin vazhdoni përditë të villni vrer dhe helm, ndërtoni hekurudhën Durrës-Prishtinë. Këto janë investime strategjike. Nuk është investim strategjik të grabisni portin 2700-vjeçar të Durrësit dhe t'ua jepni arabëve. Investim strategjik kombëtar është të vendosni portin e Shëngjinit në dispozicion të qeverisë së Kosovës, por ju nuk i doni këto lloj investimesh.

Për t'u kthyer te propozimi që ka bërë deputetja Tabaku për shkurtimin e afatit nga fundi i dhjetorit 2023 në janar 2023, meqenëse tani jemi në korrik 2023, praktikisht ka kaluar qëllimi kryesor për të cilin deputetja ka bërë propozimin.

Megjithatë, unë dua t'ju sugjeroj juve, deputetëve të mazhorancës, ta votoni pro këtë propozim, të tregoheni një herë mendjehapur edhe për propozimet e opozitës dhe njëherazi të kërkoni një auditim të plotë dhe të pavarur të pasojave që ka prodhuar mënyra si është zbatuar ky ligj për rastet e abuzuara dhe të kërkohet vënia përpara përgjegjësisë e abuzuesve.

Ju bëtë shumë mirë që e sollët propozimin e zonjës Tabaku për përmirësim ligjor, por në fund dua t'ju them se prej mëse 2 vjetësh në sirtarët e Kuvendit gjenden disa propozime të thjeshta ligjore të deputetit të nderuar dhe mirënjohur Braçe, të deputetit Spaho, por edhe të miat.

Personalisht, propozoj një ndryshim në ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës", ku kërkoj të rritet përgjegjësia dhe mundësia e deputetëve të Kuvendit dhe e komisioneve të Kuvendit për të marrë informacionin e duhur.

Gjithashtu, kam propozuar edhe një ligj tjetër integral "Për përgjegjësinë materiale e financiare të nëpunësve publikë të rangut të mesëm dhe të lartë". Në rast se ne nuk do të orientohemi nga ligji "Për përgjegjësinë financiare të nëpunësve publikë të rangut të mesëm dhe të lartë", gjithmonë do të vazhdojmë që në këtë sallë të prodhojmë një politikë false, shterpe dhe thjesht do të konfliktohemi me njëri-tjetrin me akuza bajate, shumica e të cilave nuk qëndrojnë në mënyrën si ne i formulojmë ose vetëm mjeshtrat që latojnë frazat mund t'i rregullojnë.

Përcaktimi dhe kalimi i ligjit "Për përgjegjësitë materiale" do të na bëjë të gjithëve ne të përgjegjshëm, do t'i bëjë nëpunësit e qeverisë shqiptare të rangut të mesëm dhe të lartë ta kuptojnë që ligji nuk është Kryeministri Edi Rama, ashtu siç dje nuk ishte Kryeministri Sali Berisha, por ligj është ligj, Kushtetuta është Kushtetutë dhe të gjithë nëpunësit e ndershëm dhe profesionistë të këtij shteti duhet të zbatojnë vetëm këto.

Faleminderit për vëmendjen!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Leskaj! Fjalën e ka kërkuar ministrja e Financave.

Delina Ibrahimaj – Unë dua të sqaroj se Minsitria e Financave dhe Ekonomisë është duke punuar për hartimin e një projektligji të ri, i cili ka në themel krijimin e një kornize ligjore të unifikuar dhe mekanizmave që garantojnë zbatimin efikas të ligjit dhe zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të mosmarrëveshjeve.

Këtu u thanë disa aludime, retorika, të cilat unë do t'i konsideroja boshe, pasi ligji i investimeve strategjike në fuqi ka garantuar zhvillimin e disa investimeve me vlerë strategjike, qoftë për vlerën, qoftë për punësimin që ato parashikojnë.

Janë 7 projekte që kanë përfunduar ose janë në fazën përfundimtare të ndërtimit dhe 9 projekte në ndërtim. Deri në vitin 2026, këto projekte do të arrijnë një vlerë investimi prej 733 milionë eurosh dhe do të hapim 5303 vende pune, ndërsa në 14 vjetët e ardhshëm shifrat do të arrijnë në 4,6 miliardë euro dhe më shumë se 29 mijë vende pune. Pra, është e pavërtetë që ligji nuk ka qenë efikas, është e pavërtetë që ligji nuk sjell punësim, është e pavërtetë që ligji nuk sjell investim.

Gjithashtu, u theksua se është bërë një shtyrje e padrejtë e ligjit, ndërkohë që ne e kemi parashikuar dhe argumentuar në kohën kur kemi kërkuar shtyrjen deri në fund të vitit 2023, se ka shumë projekte, të cilat janë në trajtim, sipas paketës ligjore të investimeve strategjike, të cilat shtrihen në zona ku ende nuk kishte përfunduar regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme. Ato projekte ende nuk kanë filluar dhe kjo është

arsyeja pse me pritjen e regjistrimit përfundimtar, ne propozuam shtyrjen e efekteve të ligjit.

Për sa i përket propozimit që ka ardhur në Kuvend, praktikisht ai kërkon pushimin e faktit të fuqisë juridike të ligjit, duke sjellë në këtë mënyrë një ndërprerje të mëtejshme të pasojave që rrjedhin prej tij: bllokimin e investimeve, bllokimin e tërheqjes së investimeve të huaja, duke krijuar një boshllëk ligjor, i cili do të mund të mbushej vetëm nëpërmjet një baze të re ligjore.

Siç e thashë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është duke e hartuar dhe brenda këtij viti do ta propozojë në qeveri dhe parlament bazën e re ligjore, e cila merr parasysh të gjitha problematikat që mund të kenë hasur investitorët ndër vite, kryesisht të lidhura me pronat dhe problematika të tjera, të cilat shkojnë konform arritjeve të të gjitha standardeve ndërkombëtare në fushën e investimeve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Ministre!

Këtu mbyllen diskutimet për projektligjin.

Në rendin e ditës kemi edhe dy dekrete të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe një projektvendim:

dekret i Presidentit të Republikës nr. 113, datë 10. 07. 2023 "Për shkarkim ministri;

dekret i Presidentit të Republikës nr. 114, datë 10. 07. 2023 "Për emërim ministri";

projektvendim "Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit"".

Këtu mbyllet debati për çështjet e sotme.

Ju lutem, kolegë, bëhuni gati për procesin e votimit.

Seanca do të ndërpritet 2 minuta, derisa të gjithë deputetët të ulen në vendet e tyre. Më pas do të fillojmë procesin e votimit.

(Ndërpritet seanca.)

(Rifillon seanca.)

(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla.)

Lindita Nikolla – Të nderuar kolegë deputetë, kalojmë në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi për prezencën.

Nuk ka kuptim të votosh abstenim për prezencën.

93 deputetë janë prezentë.

Projektrezolutë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2022". Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 deputetë pro, 18 deputetë kundër, 1 deputet abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Projektrezolutë "Për vlerësimin e veprimtarisë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2022".

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

73 deputetë pro, 18 deputetë kundër, 1 deputet abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Projektrezolutë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2022". Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedurat e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Zoti Kuri, votoni!

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 18 kundër, 2 abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Kalojmë te projektrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të interesave për vitin 2022.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedurat e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 11 kundër, 4 abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Kalojmë te projektrezoluta për vlerësimin e punës së zyrës së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2022.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedurat e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, 17 kundër, 1 abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera". Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, 17 kundër, 2 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Neni 2 deri te neni 20 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, 18 kundër, 1 abstenim.

Projektligji miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, lidhur me një hua koncesionare për programin "Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore pas tërmetit të vitit 2019". Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 83 vota pro, 1 kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 82 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Vazhdojmë me projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar"" dhe "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"". Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedurat e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Zoti Xhafaj, nuk keni votuar.

Mbyllet votimi.

Janë 21 vota pro, 72 kundër, asnjë abstenim.

Nuk miratohet në parim.

Vazhdojmë me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"". Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedurat e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim.

Mbyllet votimi.

Janë 22 vota pro, 71 kundër, asnjë abstenim.

Nuk miratohet në parim.

Vazhdojmë me dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 113, datë 10.7.2023, "Për shkarkim ministri", zoti Bledi Çuçi, ministër i Brendshëm, shkarkohet nga kjo detyrë. Procedurat e votimit: 1 votim me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 84 vota pro, 3 kundër, 3 abstenim.

Dekreti miratohet.

Vazhdojmë me dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 114, datë 10.7.2023, "Për emërim ministri", zoti Taulant Balla emërohet ministër i Brendshëm. Procedurat e votimit: 1 votim me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

(Duartrokitje)

Janë 75 vota pro, 16 kundër, 1 abstenim.

Dekreti miratohet.

Kalojmë te projektvendimi "Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit" i ndryshuar"". Deputetja Merita Bakiu largohet si anëtare zëvendësuese në Komisionin për Çështjet Europiane. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedurat e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 77 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Sekretare e Sekretariatit për Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka

Drejtore e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala

Këtu mbyllet seanca.
Seanca e radhës do t'ju njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 21:50)

Kryetarja e Kuvendit

Lindita Nikolla